PROGRAMI I TRAJNIMIT PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

PROGRAMI I TRAJNIMIT

PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

ADMINISTRIMI I SHËRBIMIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR

Përmbajtja dhe Struktura e Programit të Trajnimit

Grupi i synuar:

Nëpunësit bashkiakë përgjegjës për poltikat dhe shërbimin e arsimit parashkollor

HELVETAS

Autorët:

Ema Kasapi
Linda Pino
Does Derveni
Save the Children

Kontribuan:

Valbona Karakaçi, Këshilltare strategjike
Voltana Ademi, Eksperte e arsimit parashkollor
Artan Rroji, Ekspert i qeverisjes vendore
Projekti "Bashki të Forta"

Tiranë, Shqipëri, mars 2026

Ky dokument u përgatit me mbështetjen e Helvetas International Cooperation Albania në kuadër të projektit "Bashki të Forta"

@Projekti "Bashki të Forta" i zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation, Albania
Të gjitha të drejtat e rezervuara

Falënderime

Ky program trajnimi për administrimin e shërbimit të arsimit parashkollor është rezultat i një procesi të përbashkët pune, reflektimi dhe bashkëpunimi ndërmjet profesionistëve dhe institucioneve të angazhuara në këtë fushë.

Shprehim mirënjohjen tonë të sinqertë për të gjithë bashkëpunëtorët që kontribuan në hartimin e kësaj kurrikule, përmes ekspertizës së tyre, përvojës praktike dhe angazhimit të vazhdueshëm për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për fëmijët. Kontributi i tyre ka qenë thelbësor në pasurimin e përmbajtjes, strukturimin e moduleve dhe përshtatjen e materialit me nevojat reale të bashkive dhe profesionistëve të fushës.

Një falënderim i veçantë i dedikohet organizatës Smart Processes, për mbështetjen teknike dhe ekspertizën në zhvillimin e përmbajtjes, si dhe Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) për rolin e saj në standardizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve në administratën publike. Gjithashtu, vlerësojmë kontributin e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore (AMVV) për angazhimin dhe mbështetjen institucionale në këtë proces.

Falënderime të veçanta u shkojnë edhe përfaqësuesve të bashkive, ekspertëve të arsimit parashkollor, trajnerëve dhe profesionistëve të tjerë, të cilët, përmes pjesëmarrjes aktive në procesin e konsultimit dhe testimit, ndihmuan në sigurimin e një qasjeje praktike, të aplikueshme dhe të orientuar drejt standardeve bashkëkohore.

Ky dokument pasqyron vlerën e bashkëpunimit dhe përkushtimit të përbashkët për të avancuar zhvillimin dhe cilësinë e arsimit parashkollor.

Përmbajtja

HYRJE **7**
OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT **11**
GRUPI I SYNUAR: **12**
KOHËZGJATJA **13**
REZULTATET E TRAJNIMIT **14**
METODOLOGJIA NË LIDHJE ME KURRIKULËN **14**
MODULI I MENAXHIMI I FUNKSIONIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR NË NIVEL VENDOR **28**
Sesioni 1.1 Funksioni i arsimit parashkollor si kompetencë e bashkive, kuadri ligjor dhe institucional, instrumentet për administrimin e shërbimit. 31
Sesioni 1.2 Menaxhimi i proceseve të shërbimit: Prioritete, plani afatmesëm i shërbimit të arsimit parashkollor, monitorimi dhe përmirësim i shërbimit 51
MODULI 2: IMAZHI I FËMIJËRISË SË HERSHME, FILOZOFIA DHE PRAKTIKAT ARSIMORE/EDUKATIVE DHE MIQËSORE ME FËMIJËT **62**
Sesioni 2.1: Njohja me kornizën rregullatore ligjore për të drejtat e fëmijëve 62
Sesioni 2.2: Katalogu i të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve 70
Sesioni 2.3: Korniza për mbështetjen e integrimit në sistemet e fëmijërisë së hershme: vlerat dhe parimet, faktorët kyç dhe praktika e cilësisë 75
MODULI 3: BARAZI DHE GJITHËPËRFSHIRJE **83**
Sesioni 3.1: Konceptet kyç: krijimi terminologjisë për përfshirje 83
Sesioni 3.2 Procese per realizimin e nje qasjeje gjithëpërfshirëse në institucionet e arsimit parashkollor. 91
Sesioni 3.3: Planifikimi dhe organizimi i Kopshtit për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara. 112
Sesioni 3.4: Partneriteti në shkollë në ndihmë të arsimimit të fëmijës me aftësi të kufizuara (rolet dhe funksionet e personave përgjegjës)..... 119
Sesioni 3.5: Plani Edukativ Individual mjet për gjithëpërfshirjen 130
MODULI 4: PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE KOMUNITETIT **137**
Sesioni 4.1: Përfshirja dhe bashkëpunimi prindër- mësues 137
Sesioni 4.2: Roli i Bordit të kopshtit dhe komunitetit si pjesë aktive e në rritjen e pjesëmarrjes dhe cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor..... 144
MODULI 5: SIGURIA, MBROJTJA, MIRËQENIA DHE SHËNDETI I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARASHKOLLOR **161**
Sesioni 5.1: Bazat teorike dhe praktike të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës 162
Sesioni 5.2: Përkufizimi i mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e mbrojtjes .. 171
Sesioni 5.3: Plani individual i mbrojtjes..... 179
Sesioni 5.4: Procedurat miqësore me fëmijët 188
MODULI 6 ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË **193**
Sesioni 6.1 Nocionet bazë mbi fatkeqësitë natyrore 194

Sesioni 6.2 Kuadri ligjor 198
Sesioni 6.3 Koncepte të emergjencave civile 201
Sesioni 6.4 Kopshte të sigurta 202
Sesioni 6.5 Avokimi 211
MODULI 7 MJEDISI SI EDUKATOR I TRETË 219
Sesioni 7.1 Roli i mjedisit të të nxënit 219
Sesioni 7.2 Mjetet didaktike në ndihmë të proceseve të të nxënit 224
Sesioni 7.3 Instrument për vëzhgimin në klasë – në ndihmë të monitorimit për siguri, aksesueshmëri dhe përshtatshmëri zhvillimore 231
Sesioni 7.4 Krijimi i mjedisit cilësor i të nxënit në kopshte në funksion të standarteve dhe kurrikula e re e Arsimit Parashkollor 235
MODULI 8 PLANI AFATMESËM i KOPSHTIT 241
Sesioni 8.1: Përse një plan afatmesëm për zhvillimin e kopshtit 242
Sesioni 8.2: Misioni, besimet dhe vizionet e kopshtit 246
Sesioni 8.3: Analiza e gjendjes së Kopshtit: Infrastrukturë, Shërbime, Partneritete 252
Sesioni 8.4: Analiza socio-ekonomike, financiare dhe institucionale në funksion të planifikimit strategjik të kopshtit. 256
Sesioni 8.5 Procesi i planifikimit strategjik dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Planit Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit 263
LITERATURA E KONSULTUAR 268
BIBLIOGRAFIA 270

Përmbajtja dhe struktura e programit të trajnimit[1]

“Administrimi i shërbimit të arsimit parshkollor në nivelin vendor’

HYRJE

Kurrikula e trajnimit “Administrimi i Shërbimit të Arsimit Parashkollor” është hartuar për aftësimin e punonjësve të arsimit pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, me qëllim sigurimin e shërbimeve të arsimit parashkollor që janë gjithëpërfshirëse, të sigurta dhe që ofrojnë një mjedis nxitës, i cili garanton përputhshmëri me kuadrin ligjor dhe standardet e cilësisë së shërbimit, duke u bazuar në praktikat e mira globale të përshtatura për kontekstin vendas.

Në çdo vend, përgjegjësia për ofrimin e shërbimeve cilësore të fëmijërisë së hershme bie mbi bashkitë - secila me kontekstin e vet unik. Të mëdha apo të vogla, urbane apo rurale, të pasura me burime apo të kufizuara, çdo bashki përballet me sfida të dallueshme në krijimin e mjediseve më të mira të mundshme që fëmijët të rriten, të mësojnë dhe të lulëzojnë.

Në Shqipëri, ku vetëqeverisja vendore luan një rol kritik në formësimin e politikave të fëmijërisë së hershme, ne e pranojmë se zgjidhjet "një madhësi u përshtatet të gjithëve" nuk do të funksionojnë. Sfidat në zonat urbane në Tiranës ndryshojnë nga ato në Kukësin rural ose Vlorën bregdetare. Megjithatë, të gjitha bashkitë ndajnë një qëllim të përbashkët: sigurimin që çdo fëmijë të ketë qasje në shërbime të sigurta, edukative dhe nxitëse të viteve të hershme.

Ky program trajnimi është hartuar për të mbështetur punonjësit e arsimit në nivel vendor, drejtuesit e kopshteve dhe aktorët e tjerë institucionalë në përmbushjen e rolit të tyre si planifikues, zbatues dhe mbikëqyrës të shërbimeve të fëmijërisë së hershme, në mënyrë efektive, bashkëpunuese dhe të bazuar në të dhëna. Programi synon të forcojë kapacitetet individuale dhe institucionale përmes njohjes dhe përdorimit të kuadrit ligjor, strategjik dhe financiar që rregullon arsimin parashkollor. Kurrikula ndihmon pjesëmarrësit të kuptojnë dhe zbatojnë parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, të bashkëpunojnë ngushtë me strukturat vendore dhe komunitetin, dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive në planifikimin, ofrimin dhe monitorimin e shërbimeve cilësore për fëmijët.

---

[1] Ky program trainimi/ kurrikulë është strukturuar në formën e **moduleve tematike**, ku secili modul përfaqëson një fushë thelbësore të njohurive apo aftësive që lidhen me qëllimet e përgjithshme të trajnimit. Brenda çdo moduli ndodhen **sesione**, të cilat përfaqësojnë njësi të veçanta mësimore me **tematika** që zhvillohen në mënyrë të njëpasnjëshme. Çdo sesion ka objektivat e veta të të nxënit, përfshin metoda ndërvepruese (si diskutime, raste studimore apo ushtrime praktike), dhe ka një kohëzgjatje të sugjeruar. Kjo qasje modulare siguron një rrjedhë logjike të përmbajtjes, mundëson ndërtimin progresiv të aftësive, dhe ofron elasticitet për t’iu përshtatur nivelit të përvojës dhe nevojave të pjesëmarrësve. Struktura e paraqitur këtu shërben si udhëzues për lehtësuesit dhe pjesëmarrësit në lidhje me përmbajtjen, kohëzgjatjen dhe qëllimin e çdo komponenti të trajnimit.

Programi i trajnimit ka 8 module dhe përfshin tema kyç si planifikimi strategjik dhe ligjor, cikli i politikëbërjes, buxhetimi afatmesëm i lidhur me objektivat zhvillimore, monitorimi dhe llogaridhënia, përdorimi i mjeteve digjitale, si dhe reflektimi mbi përvojën e mësuar. Secili modul nëpërmjet ndërveprimit synon të zhvillojë njohuri dhe aftësi konkrete që ndihmojnë në rritjen e efikasitetit dhe ndikimit të këshillave bashkiake në qeverisjen vendore, duke fuqizuar rolin e tyre në ndërtimin e institucioneve më të hapura, të përgjegjshme dhe të orientuara drejt qytetarëve.

VIZIONI

Të krijojmë një sistem arsimor të barabartë, gjithëpërfshirës dhe me cilësi të lartë për fëmijërinë e hershme, ku çdo fëmijë zhvillohet dhe arsimohet në mjedise të sigurta, nxitëse dhe gjithëpërfshirëse, të mbështetura nga institucione parashkollore profesionale, bashkëpunuese dhe të menaxhuara strategjikisht që integrojnë në mënyrë efektive mësimdhënien me në qendër fëmijën, sisteme të fuqishme mbrojtjeje dhe partneritete të forta komunitare.

Arritjet dhe reformat kryesore të kohëve të fundit

Vitet e fundit janë bërë hapa konkretë për të forcuar arsimin parashkollor përmes politikave të reja dhe kontrolleve të cilësisë.

Korniza politike dhe ligjore: Një zhvillim i rëndësishëm është miratimi në vitin 2024 i Kornizës Kurrikulare të përditësuar për arsimin, përfshirë arsimin parashkollor, e cila përditëson fushat e të nxënit dhe qasjet pedagogjike të përqendruara në lojë dhe metodat e përqendruara te fëmija. Gjithashtu synohet rritja e qasjes në arsimin parashkollor për të siguruar që 100% e fëmijëve 5 vjeçarë të ndjekin arsimin parashkollor.

Sigurimi dhe kontrolli i cilësisë: Qeveria ka rritur kontrollet, veçanërisht në kopshtet private. Në vitin 2024, inspektimet e 90 kopshteve private zbuluan se vetëm 67 syresh përmbushnin të gjitha kriteret legjislative, duke çuar në një angazhim për kontrolle më të rregullta. Një "Kornizë Vlerësimi" e re për kopshtet u miratua gjithashtu për të standardizuar vlerësimet e brendshme dhe të jashtme.

Udhëheqja dhe trajnimi: Për të trajtuar nevojën për menaxhim të kualifikuar, programi i parë kombëtar i trajnimit për drejtorët e kopshteve nisi në janar 2025, me qëllim pajisjen e drejtuesve me kompetenca moderne.

Sfidat e vazhdueshme

Pavarësisht progresit, sistemi përballet me pengesa që lidhen me decentralizimin, financimin dhe përfshirjen.

Bashkërendimi dhe qasja e sistemit: Model i përbashkët i qeverisjes midis Ministrisë së Arsimit (MA) dhe qeverisjes vendore shumë shpesh ka bashkëpunim të kufizuar,

dhe jo të bashkërenduar duke cenuar sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ndërsa arsimi bazë – 9 vjeçar është falas.

Fokusi në gjithëpërfshirje: Politikat aktuale i japin përparësi arsimit gjithëpërfshirës, duke u siguruar qasje në arsim të gjitha grupeve të cenueshme, përmes rritjes së numrit të mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara, caktimit të punonjësve të shërbimit psiko-social dhe ndërmjetësve për mbështetjen e komuniteteve rome, egjiptiane dhe grupeve në nevojë.

Shtrirje më e gjerë e sistemit: Raportet tregojnë sfida më të gjera si mungesa e fondeve në krahasim me rekomandimin objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm global prej 6% të PBB-së, duke çuar në probleme me infrastrukturën, burimet dhe mbajtjen e mësuesve.

Konteksti dhe perspektiva strategjike

Shqipëria po punon në mënyrë aktive me partnerë ndërkombëtarë për të arritur Objektivin 4 të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Arsim Cilësor), **konkretisht synimi 4.2 i cili është i lidhur drejtpërdrejt me arsimin parashkollor (deri në vitin 2030, të sigurohet që të gjitha vajzat dhe të gjithë djemtë të kenë qasje në zhvillimin cilësor të fëmijërisë së hershme, në mënyrë që të jenë gati për arsimin bazë, pra ky synim** përfshin sigurimin e qasjes në zhvillim cilësor të fëmijërisë së hershme. Reformat dhe inspektimet e vazhdueshme tregojnë një fokus të qartë të qeverisë në ndërtimin e një sistemi parashkollor më të fuqishëm dhe me cilësi të lartë.

NEVOJAT

Forcimi i Arsimit Parashkollor: Një domosdoshmëri strategjike për bashkitë shqiptare

Si organet kryesore përgjegjëse për administrimin e arsimit parashkollor, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore Shqiptare (Bashkitë) përballen me një detyrë kritike strategjike: të ndërtojnë një sistem racional dhe gjithëpërfshirës dhe me cilësi të lartë të arsimit parashkollor i cili u shërben të gjithë fëmijëve. Arritja e kësaj kërkon vendime të zgjuara politike për të bashkërenduar ofrues të ndryshëm, për të standardizuar cilësinë dhe në fund të fundit për të siguruar qasje të barabartë.

Rruga Përpara: Lidershipi bashkiak për një sistem të harmonizuar

Pasojat e këtij sistemi të fragmentuar janë të qarta:

- cilësi e pabarabartë,
- qasje e pabarabartë për fëmijët nga komunitetet e varfra ose të margjinalizuara dhe
- shpërndarje joefektive e burimeve, duke bërë që mbështetja të mos përqendrohet te fëmijët dhe zonat me nevojat më të mëdha.

Për të trajtuar këtë, bashkitë shqiptare duhet të marrin një rol qendror dhe proaktiv në ndërtimin e një sistemi efektiv të arsimit parashkollor, ku aktorët (institucionet, komuniteti), shërbimet dhe politikat bashkëveprojnë në mënyrë të harmonizuar, duke funksionuar si një sistem i integruar dhe koherent. Kjo përfshin:

Kijimin e një kornize të fortë të sigurimit të cilësisë:

Bashkia duhet të jetë gur themeli i kontrollit të cilësisë, duke zbatuar standarde të qarta të shërbimit, kualifikimet e stafit, sigurinë dhe mjediset e të nxënit në të gjithë kopshtet.

Bashkërendimi strategjik:

Bashkërendimi i vërtetë kërkon largimin e pengesave ndarëse midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore. Bashkitë mund të shfrytëzojnë në mënyrë efektive për të maksimizuar mbulimin dhe efikasitetin vetëm nëse përpjekjet e tyre janë plotësisht të sinkronizuara me politikat dhe burimet e nivelit qendror. Bashkëpunimi i përmirësuar - përmes planifikimit të përbashkët, standardeve të harmonizuara dhe sistemeve të integruara të të dhënave - është themeli i panegociueshëm për ofrimin e një shërbimi të arsimit parashkollor të unifikuar dhe me cilësi të lartë në të gjithë Shqipërinë.

Prioritizimi i barazisë dhe përfshirjes:

Politikat dhe financimi duhet t'u japin përparësi qëllimisht fëmijëve që do të përfitojnë më shumë, veçanërisht ata nga grupet e cenushme dhe të margjinalizuara, për të siguruar që qasja në arsimin parashkollor të jetë një e drejtë, jo një privilegj.

Marrja e zgjedhjeve të informuara mbi modelet e shërbimit:

Modelet operative të shërbimit të arsimit parashkollor përcaktohen përmes bashkëpunimit ndërmjet këshillave bashkiake, administratës dhe drejtuesve të institucioneve, duke synuar një baraspeshim të qëndrueshëm mes përfitimeve arsimore, nevojave të familjeve dhe burimeve financiare.
Duke ndërmarrë hapa të qëndrueshme në këto fusha, njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të përmirësojnë koherencën dhe cilësinë e shërbimeve të arsimit parashkollor, duke krijuar kushte më të barabarta zhvillimi për fëmijët.

QËLLIMET E PROGRAMIT TË TRAJNIMIT

Ky trajnim synon të fuqizojë drejtuesit e kopshteve, edukatorët me rol drejtues dhe specialistët e bashkive në ushtrimin efektiv të funksioneve të tyre menaxheriale, mbikëqyrëse dhe bashkëpunuese në ofrimin e një shërbimi parashkollor gjithëpërfshirës, cilësor dhe të qëndrueshëm.
Në përputhje me kornizat kombëtare dhe evropiane për arsimin dhe kujdesin në fëmijërinë e hershme (ECEC), programi i trajnimit synon të:

Filozofia dhe pedagogjia themelore

- ✓ **Kultivojë një praktikë edukative/arsimore të përqendruar te fëmija**, duke ndërtuar një filozofi pune që respekton të drejtat, zërin dhe nevojat zhvillimore të çdo fëmije në procesin e vendimmarrjes pedagogjike dhe menaxheriale.
- ✓ **Zhvillojë aftësinë për të projektuar mjedise të sigurta, nxitëse dhe gjithëpërfshirëse të të nxënit**, që nxitin zhvillimin integral dhe pjesëmarrjen aktive të fëmijëve në përputhje me standardet kombëtare dhe praktikat bashkëkohore të të nxënit përmes lojës.

Përfshirja, mbrojtja dhe mirëqenia

- ✓ **Forcojë kapacitetet për të promovuar barazinë dhe arsimin gjithëpërfshirës,** përmes identifikimit të pengesave sociale, ekonomike apo fizike dhe zhvillimit të strategjive praktike për garantimin e qasjes së barabartë për çdo fëmijë.
- ✓ **Zhvillojë njohuritë për mbrojtjen e mirëqenies së fëmijëve,** përmes kuptimit të kuadrit ligjor dhe institucional të mbrojtjes së fëmijës, njohjes së shenjave të cenueshmërisë, ofrimit të mbështetjes bazë psiko-sociale dhe zbatimit të procedurave të referimit ndërinstitucional.

Bashkëpunimi dhe angazhimi i komunitetit

- ✓ **Nxitë partneritete të forta me familjet dhe komunitetin,** duke i pajisur drejtuesit e kopshteve dhe stafin me aftësi për ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese, komunikim transparent dhe ndarjen e përgjegjësive për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.
- ✓ **Forcojë bashkërendimin ndërsektorial,** përmes krijimit të protokolleve efektive të bashkëpunimit me sektorin e shëndetësisë, shërbimet sociale dhe institucionet e tjera partnere, me qëllim sigurimin e një qasjeje të integruar dhe të qëndrueshme për çdo fëmijë.

Udhëheqja administrative dhe planifikimi sistemik

- ✓ **Zhvillojë kompetenca në menaxhimin strategjik të institucionit të arsimit parashkollor,** përmes hartimit dhe zbatimit të planeve afatmesme të zhvillimit të bazuara në të dhëna, që nxitin përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe profesionalizmit.
- ✓ **Sigurojë njohuri të thelluara mbi kornizën ligjore dhe politikat kombëtare të arsimit parashkollor,** duke i pajisur pjesëmarrësit me aftësinë për të interpretuar dhe zbatuar legjislacionin dhe standardet e BE-së në praktikën e përditshme menaxheriale.

OBJEKTIVAT E TRAJNIMIT

- Të kultivojë një filozofi të arsimit parashkollor e cila ka në qendër fëmijën e bazuar te të drejtat e fëmijëve për arsim dhe zhvillim tërësor.
- Të ndihmojë specialistë dhe nëpunës të arsimit parashkollor në hartimin e qasjeve të cilat trajtojnë pengesat sistemike nëpërmjet bashkërendimit ndërsektorial në

nivel vendor për të garantuar gjithëpërfshirjen e grupeve të margjinalizuara në arsimin parashkollor.

- Të aftësojë punonjës të arsimit parashkollor në përdorimin e teknikave të nxitjes dhe përfshirjes së prindërve dhe komunitete në vendimmarrje bashkëpunuese, shfrytëzimin efikas të burimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në institucionet e arsimit parashkollor.
- Të pajisë specialistë dhe nëpunës të arsimit parashkollor me kompetencat themelore të procesit të mbrojtjes së fëmijëve.
- Të aftësojë specialistë dhe nëpunës të arsimit parashkollor të hartojnë dhe menaxhojnë një rrugë mbrojtjeje të përqendruar te fëmija që i jep përparësi mirëqenies së fëmijës përmes shërbimeve.
- Të aftësojë specialistë dhe nëpunës të arsimit parashkollor për një kuptim themelor të rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe kuadrit ligjor për sigurinë, duke u mundësuar pjesëmarrësve të vlerësojnë kërcënimet dhe të përmbushin standardet për mjedise të sigurta arsimore.
- Të zhvillojë kompetenca operacionale në menaxhimin e emergjencave përmes ndërtimit të aftësive praktike, dukeui mundësuar pjesëmarrësve të zbatojnë me besim protokollet e reagimit dhe të kontribuojnë në hartimin e planeve të fuqishme të përgatitjes institucionale.
- Të pajisë specialistë dhe nëpunës të arsimit parashkollor me njohuritë dhe kuadrin strategjik për të mbikëqyrur, avokuar dhe siguruar burimet për krijimin e hapësirave të kopshtit që përshtaten fizikisht dhe pedagogjikisht. Kjo siguron që mjediset e të nxënit të jenë elastike, gjithëpërfshirëse dhe të nxitin drejtpërdrejt zhvillimin njohës, social-emocional dhe fizik të të gjithë fëmijëve.
- Të pajisë specialistë dhe nëpunës të arsimit parashkollor me metodologjinë dhe aftësitë udhëheqëse për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar një plan afatmesëm të zhvillimit të kopshtit, i cili është i bazuar në prova, është pjesëmarrës dhe trajton strategjikisht sfidat sistemike për të arritur përmirësime të qëndrueshme të cilësisë.

GRUPI I SYNUAR:

Kurrikula e trajnimi është hartuar për një audiencë shumëdisiplinore që përfshin aktorë kryesorë përgjegjës për qeverisjen, menaxhimin dhe bashkërendimin e shërbimeve të fëmijërisë së hershme në nivel bashkiak. Ky grup përfaqëson ekosistemin thelbësor të nevojshëm për të planifikuar, financuar dhe ofruar arsim parashkollor cilësor. Grupi kryesor i synuar mund të ndahet në katër nëngrupe kryesore:

- **Punonjësit e arsimit në adminsitratën publike të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore**: Ky është shtylla kurrizore teknike dhe administrative e sistemit dhe ka drejtpërdrejt përgjegjësi për zbatimin e politikave të arsimit parashkollor, menaxhimin e kopshteve publike dhe mbikëqyrjen e cilësisë arsimore. Gjithashtu, personeli që merret me buxhetimin, prokurimin dhe ndarjen e burimeve për shërbimet e fëmijërisë së hershme.

- **Drejtuesit e kopshteve** që ofrojnë udhëzime pedagogjike, mentorim dhe monitorim të praktikave mësimore brenda kopshteve bashkiake.
- Tematika të caktuara janë të dobishme për **Drejtuesit Vendorë**: Ky grup përfshin vendimmarrësit politikë dhe ekzekutivë që përcaktojnë përparësitë dhe ndajnë burimet si kryetarët e bashkive, autoritetet përfundimtare përgjegjëse për drejtimin strategjik të bashkisë dhe miratimin e buxhetit dhe këshilltarët bashkiakë (veçanërisht ata në komisionet e arsimit):

  Këshilli Bashkiak krijon komisione të përhershme sipas statutit të bashkisë. Një nga më të shpeshtat është: Komisioni i Arsimit ose Komisioni i Arsimit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

  Roli i komisionit të arsimit:

  - Shqyrton politikat vendore të arsimit
  - Jep mendime për buxhetin e arsimit
  - Mbikëqyr çështje që lidhen me shkollat, infrastrukturën arsimore dhe shërbimet mbështetëse
  - Këshillon Këshillin Bashkiak për vendimmarrje

- **Zyrtarët e zgjedhur** që hartojnë politika vendore, miratojnë plane zhvillimi dhe ofrojnë mbikëqyrje për sektorin e arsimit.
- Gjithashtu, palë të tjera kryesore të interesuara në ofrimin dhe bashkërendimin të cilat mund të përfshihen duke pasur parasysh që arsimi parashkollor kërkon një qasje holistike dhe të integruar ndaj zhvillimit të fëmijërisë së hershme, duke kapërcyer hendekun midis arsimit dhe sektorëve të tjerë mund të përfshihen:

  i. Përfaqësues nga shërbimet sociale: stafi që punon në mbrojtjen e fëmijëve, mbështetjen e familjes dhe përfshirjen për fëmijët e cenueshëm.

  ii. Përfaqësues nga shërbimet e kujdesit shëndetësor: profesionistë të përfshirë në shëndetin e fëmijëve, ushqyerjen dhe shqyrtimin zhvillimor.

  iii. Menaxherët e kopshteve publike dhe private: Individë përgjegjës për funksionimin e përditshëm dhe udhëheqjen pedagogjike të institucioneve individuale parashkollore.

  iv. Përfaqësues nga këshillat e prindërve ose organizatat e bazuara në komunitet: figura kyç që mbrojnë nevojat e familjes dhe komunitetit dhe nxitin pronësinë vendore.

KOHËZGJATJA

- Programi i trajnimit - 3 muaj
- Trajnimi në klasë: 4 ditë

REZULTATET E TRAJNIMIT

Të trajnuarit kanë kompetencën të:

- Formulojnë një kuadër strategjik të bashkërenduar dhe të bazuar në të drejta për shërbimet prë fëmijërisë së hershme (mosha 3-6 vjeç) që përputhet me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, ligjin kombëtar shqiptar dhe një vizion të përbashkët të hartuar në bashkëpunim me palët kryesore të interesuara.
- Hartojnë dhe zbatojnë një plan veprimi të integruar bashkiak që shfrytëzon bashkërendimin ndërsektorial (shëndetësi, mbrojtje të fëmijëve) dhe strategji të synuara për të siguruar qasje të barabartë në arsim dhe tranzicion të suksesshëm në shkollën fillore për të gjithë fëmijët, me një fokus të prioritizuar në grupet e margjinalizuara.
- Udhëheqin dhe zhvillojnë një rrjet formal mbështetës të bazuar në komunitet për zhvillimin e fëmijërisë së hershme duke shfrytëzuar Planet e detyrueshme të Zhvillimit të Kopshtit për të integruar bashkëpunimin e prindërve, partneritetet me OJF-të, praktikat gjithëpërfshirëse dhe shërbimet shumësektoriale përmes bordeve të kopshteve.
- Zbatojnë parimet themelore të mbrojtjes së fëmijëve duke zbatuar procedurat thelbësore - nga identifikimi i rrezikut dhe intervistimi i fëmijëve deri te hartimi i planeve individuale të mbrojtjes dhe referimet e shërbimeve - duke përdorur një qasje të përqendruar te fëmija.
- Hartojnë dhe zbatojnë një plan të qartë dhe të zbatueshëm për t'u përgatitur dhe për të zvogëluar ndikimin e fatkeqësive natyrore në kopshte, duke siguruar që strukturat vendore tv jenë të përkushtuara, rreziqet të jenë të njohura dhe i gjithë komuniteti të jetë i informuar dhe i përfshirë.
- Hartojnë, vlerësojnë dhe sigurojnë burime për mjedise mësimore të përshtatshme për zhvillimin, të sigurta dhe nxitëse për fëmijët 3-6 vjeçarë, në bashkëpunim me stafin arsimor, prindër dhe komunitet.
- Të aftë të udhëheqin një proces pjesëmarrës për të hartuar dhe zbatuar një plan strategjik afatmesëm (3-4 vjeçar) për kopshtin që trajton sfida komplekse dhe nxit përmirësime të qëndrueshme të cilësisë.
- Analizojnë sistemin e arsimit parashkollor përmes një thjerre të menaxhimit të procesit duke lidhur rrjedhat kryesore të punës me kërkesat legjislative, duke zbatuar një metodologji të standardizuar për t'i vlerësuar dhe optimizuar ato për efikasitet dhe cilësi të përmirësuar të shërbimit në nivel vendor.

METODOLOGJIA NË LIDHJE ME KURRIKULËN

- Kurrikula është përgatitur në përputhje me standardet dhe mjetet didaktike të ASPA-s. Kurrikula është shkruar për të qenë e qartë, e kuptueshme, praktike dhe e shoqëruar me mjete të ndryshme didaktike trajnimi si (shembuj: prezantime në PowerPoint, fletëpalosje, pyetje diskutimi, teste të shkurtra (quize), video të shkurtra, raste të dokumentuara dhe/ose praktika të mira, intervista, lista me pyetje

dhe përgjigje etj)., për të lehtësuar kuptimin e temave në diskutim dhe për të ndihmuar në demonstrimin e sfidave dhe zgjidhjeve praktike.

- Kurrikula është harmonizuar me parimet dhe praktikat e Bashkimit Europian në fushën e Edukimit/Arsimit dhe Kujdesit në Fëmijërinë e Hershme (ECEC), duke reflektuar qasjen e BE-së ndaj cilësisë, gjithëpërfshirjes, barazisë dhe të të nxënit gjatë gjithë jetës, si dhe duke mbështetur përgatitjen institucionale të NJVV-ve në kuadër të procesit të integrimit europian.
- Kurrikula mundëson përdorimin e metodave bashkëkohore, ndërvepruese dhe novatore të mësimdhënies.
- Kurrikula mundëson hartimin e versionit elektronik të saj, duke mundësuar kështu një marrje nga kurrikula të njohurive të udhëzuar e me ritëm të vetëvendosur gjatë përdorimit të e-kurrikulës.
- Hatuesit e kurrikulës kanë ekuilibruar aspektet teknike dhe joteknike të kurrikulës, në mënyrë që pjesëmarrësit të fitojnë aftësitë për të zbatuar njohuritë e reja të fituara.
- Sesionet e kurrikulës janë hartuar bazuar në qasjen e të nxënit për të rritur (Cikli i Kolbit). Qasja e të nxënit përmes zgjidhjes së problemeve është konsideruar si një mjet për të tërhequr vëmendjen e pjesëmarrësve dhe për të bërë trajnimin sa më praktik dhe të dobishëm për pjesëmarrësit.
- Në hartimin e përmbajtjes së kurrikulës janë marrë në konsideratë planet dhe rregulloret e këshillave bashkiake të cilat janë pwrgatitur me mbështetjen e BtF-Helvetas, si dhe dokumente të tjera referuese.
- Kurrikula ka të hartuar formularë vlerësimi, p.sh. metoda ndërvepruese trajnimi (test paraprak dhe pasues) dhe detyra/angazhime të caktuara nga trajneri mbi tema specifike për periudhën ndërmjet moduleve të kurrikulës ose pas trajnimit në klasë, si dhe një pyetësor mbi ndikimin e trajnimit te pjesëmarrësit, pas një periudhe tremujore.

Fazat e programit të trajnimit

Kurrikula e trajnimit është e ndarë në katër faza:

Faza 1. Komunikim me grupin e synuar përpara trajnimit në klasë (mbedhje e çështjeve me interes të lartë për grupin e synuar për të indentifikur çështje prioritare për diskutim në klasë - përmes një pyetësori; mbledhje e praktikave të mira/novacioneve të kohës së fundit të zbatuara. Përzgjidhen dhe dërgohen dokumente për lexim që grupi i synuar të marrë njohuri paraprake për temën e programit të trajnimit. Komunikimi kryhet online/me email. Përzgjidhen nga trajneri çështjet prioritare dhe përgatitet trajtimi i tyre gjatë trajnimit në klasë.

Faza 1: Para-trajnimi (përgatitja dhe vendosja e kontekstit)
Fazat e trajnimit - Metoda:
Qëllimi: Të përshtatet përmbajtja e trajnimit dhe rastet studimore me kontekstin real të bashkive të përfshira në trajnim. Vlerësimi i Nevojave: Anketa online e dërguar pjesëmarrësve të regjistruar për të identifikuar sfidat e tyre specifike, njohuritë e mëparshme është sfida juaj më e madhe me bashkërendimin e bashkive të përfshira. P.sh. “Cila është sfida juaj më e madhe në bashkërendimin ndërsektorial?").
Para-Trajnimi Qëllimi: Të sigurohet një bazë e përbashkët njohurish dhe të nxiten pjesëmarrësit të fillojnë të mendojnë për kontekstet e tyre institucionale para se të fillojë trajnimi. Pjesëmarrësit marrin dokumentet kryesore të politikave kombëtare (p.sh., ligjet përkatëse, Strategjia Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve) dhe në një pyetësor të shkurtër fillojnë të mendojnë për kontekstet e tyre reflektues institucional para se të fillojë trajnimi.

Faza 2. Trajnimi në klasë. Faza e dytë ka prezantime, raste studimore, ushtrime në grup, pyetje dhe përgjigje, diskutime në grup (workshop), lojë me role, diskutim me personin burimor (me përvojë të drejtpërdrejtë), ushtrim me fokus projekti për ta zbatuar pas trajnimit, sesion reflektimi para fillimit të çdo sesioni, hapësirë për reagim (feedback) ndaj çdo sesioni, video ilustruese.

Faza 2: Ofrimi i trajnimit - Mësim i përzier dhe ndërveprues	
Ofrimi i trajnimit	**Metoda:**
Modeli i klasës Qëllimi: Të zhvillohen aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve në një mjedis të sigurtë dhe bashkëpunues. Metoda: Konceptet teorike (p.sh., kornizat e mbrojtjes së fëmijëve, bazat legjislative) ofrohen nëpërmjet leksioneve të shkurtra ose leximeve të kuruara para një sesioni dhe zgjidhjes së problemeve në një mjedis të drejtpërdrejtë. Koha në sesion: I kushtohet diskutimit, pyetjeve dhe përgjigjeve me ekspertë dhe zbatimit praktik të teorisë.	

Qëllimi: Të zhvillohen aftësitë e të menduarit kritik dhe zgjidhjes së problemeve në një mjedis të sigurt dhe bashkëpunues.

Përdorni raste nga bota reale, specifike për kontekstin shqiptar.

Raste studimore dhe të nxënit i bazuar në probleme:

Shembull Rasti (Gjithëpërfshirje): "Hartoni një strategji për një komunitet rom në një njësi administrative specifike me regjistrim të ulët."

Shembull Rasti (Planifikim): "Analizoni pikat e forta, të sigurta dhe bashkëpunuese, pikat e dobëta të një plani shembullor 4-vjeçar (anonim) të zhvillimit të kopshtit."

Simulime dhe lojë me role:

Qëllimi**:** Të ndërtohet besimi dhe kujtesa muskulore për situata me rrezik të lartë.

Simulim i mbrojtjes së fëmijëve: Një lojë me role e strukturuar e një procesi referimi, me pjesëmarrësit që veprojnë si mësues kopshti, punonjës social dhe përfaqësues shëndetësor.

Simulim i stërvitjes së emergjencës: Një ushtrim në tavolinë për hartimin dhe testimin e një plani evakuimi emergjence për një kopsht hipotetik.

Simulim i takimit me palët e interesuara**:** Lojë me role e një takimi të bordit të kopshtit për të diskutuar një nismë të re, duke praktikuar aftësitë e lehtësimit dhe bashkëpunimit.

Seminar praktik:

Qëllimi: Të krijohen rezultate të prekshme dhe të ndërtohen aftësi praktike.

Seminar për projektimin e mjedisit: Duke përdorur materiale me kosto të ulët, pjesëmarrësit prototipojnë dhe projektojnë një model të një këndi ideal mësimi.

Seminar për planifikim strategjik: Duke përdorur modele tip dhe lehtësim të udhëhequr, pjesëmarrësit fillojnë hartimin e seksioneve të planit 4-vjeçar të njësisë vendore të tyre.

Faza 3. Komunikim me grupin e synuar pas trajnimit në klasë. Kjo fazë mundëson ndjekjen e detyrave të dhëna në klasë. Kryerja e seancave të drejtpërdrejta, të udhëhequra nga trajneri nëpërmjet platformave në internet, të cilat lejojnë ndërveprim në kohë reale, pyetje-përgjigje dhe diskutime, udhëzime nga personi burimor ndaj nevojave të pjesëmarrësve për detyrat e lëna nga trajneri, pas trajnimit në klasë.

Faza 3: Pas-trajnimi (zbatimi dhe qëndrueshmëria)	
Pas - trajnimi	**Metoda:**
Projekte të mësimit në veprim: Të sigurohet që trajnimi të rezultojë në një produkt të prekshëm me rëndësi të menjëhershme. Gjatë trajnimit, pjesëmarrësit nga e njëjta bashki formojnë grupe për të zhvilluar një projekt konkret (p.sh., një projektplan për angazhimin e palëve të interesuara, një vlerësim rreziku për kopshtin e tyre, një qëllim dhe plan veprimtarish për planin e tyre 4-vjeçar).	

Rrjetëzimi dhe mbështetja mes kolegëve
Krijohen grupe të strukturuara të trajnimit nga kolegët ose grupe komunikimi online (p.sh., whatsapp, forum) për pjesëmarrësit për të mbështetur njëri-tjetrin në zbatimin e mësimeve të tyre gjatë 3 muajve vijues.

Ndjekja dhe mentorimi:

Të sigurohet llogaridhënia dhe të ofrohet mbështetje e vazhdueshme, duke rritur ndjeshëm mundësinë e ndikimit afatgjatë.

Caktohet një seancë kontrolli jo më shumë se një në muaj, pas trajnimit për pjesëmarrësit, për të paraqitur progresin në projektet e tyre përfundimtare, për të diskutuar sfidat dhe për të marrë udhëzime nga lehtësuesit.

Faza 4. Pjesëmarrësit dërgojnë detyrat e përfunduara. Pjesëmarrësit dërgojnë detyrat e përfunduara dhe marrin përshtypjet dhe vlerësimet nga trajnerët dhe menaxherët e trajnimit.

Sesionet e trajnimit paraprihen nga prezantimi i nevojës së trajnimit në kuadër të politikës kombëtare dhe vendore, bëhet prezantimi i programit të trajnimit (qëllimi dhe objektivat, prezantimi i pjesëmarrësve dhe pyetje për pritshmëri për trajnimin).

Në fund të trajnimit në klasë prezantohen përfundimet, detyrat për ndjekur në vendin e punës dhe vlerësimi në fund të trajnimit në klasë.

Metodologjia holistike dhe e aplikuar e trajnimit "*Mëso-Zbato-Mbështet*"

Kjo metodologji është ndërtuar mbi parimet e të nxënit të të rriturve (Andragogjia), duke theksuar përvojën, zgjidhjen e problemeve dhe rëndësinë e menjëhershme për rolet e pjesëmarrësve.

Ky model siguron që trajnimi të mos jetë një ngjarje e vetme, por fillimi i një procesi përmirësimi të vazhdueshëm. Ai i zhvendos pjesëmarrësit nga marrës pasivë të informacionit në bashkëkrijues aktivë të zgjidhjeve për bashkitë e tyre, duke u përafruar drejtpërdrejt në një strategji me vizion bashkëpunues.

Agjenda e programit të trajnimit

Ora	Moduli/Tema Kryesore	Përshkrimi	Sesionet/ Tematikat
Dita 1			
09:00 – 09:15	Hyrje dhe prezantime	- Hapja e trajnimit dhe prezantimi i pjesmarrësve - Prezantimi i qëllimit, objektivave dhe strukturës së programit të trajnimit - Pjesëmarrësit diskutojnë mbi pritshmëritë e trajnimit	—
9.15-10.45 (90')	**MODULI 1: Menaxhimi i funksionit të arsimit parashkollor në nivel vendor**	- Kuptimi i procesit të decentralizimit të arsimit parashkollor dhe bazës ligjore që e mbështet; - Kompetencat bashkiake në ofrimin e arsimit parashkollor; - Zbatimi i standardeve kombëtare dhe rregulloreve vendore për cilësinë e shërbimit; - Përdorimi i instrumenteve të administrimit, planifikimi, zbatimi dhe mbikëqyrja e shërbimit në nivel vendor; - Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, prindërve dhe komunitetit për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve.	- Sesioni 1.1 Funksioni i arsimit parashkollor si kompetencë e bashkive, kuadri ligjor dhe institucional, instrumentet për administrimin e shërbimit
10.45-11.00	Pushim kafeje		

11.00-12.15 75'	**MODULI 1: Menaxhimi i funksionit të arsimit parashkollor në nivel vendor (vazhdim)**	- Proceset e menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor; - Caktimi i prioriteteve të shërbimit; - Hartimi i objektivave afatmesme; - Planifikimi i veprimtarive; - Përdorimi i instrumenteve menaxheriale; - Përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe motivimi i stafit	- Sesioni 1.2 Menaxhimi i Proceseve të shërbimit: Prioritetet, Plani Afatmesëm i Shërbimit (PASH) të arsimit parashkollor, monitorimi dhe përmirësimi i shërbimit
12.15-13.30	Pushim dreke		-
13.30 – 14.45 (75')	**MODULI 2: Imazhi i femijërisë së hershme, filozofia dhe praktikat edukative dhe miqësore me fëmijët**	- Njohja me kornizën ligjore: Prezantimi i akteve ndërkombëtare dhe kombëtare për të drejtat e fëmijëve, me fokus në rolin e pushtetit vendor në zbatimin e tyre. - Katalogu i të drejtave: Diskutim mbi kategoritë dhe rëndësinë e lirive themelore të fëmijëve; ushtrim në grupe për hartimin e një udhëzuesi praktik.	- Sesioni 2.1: Njohja me kornizën rregullatore ligjore për të drejtat e fëmijëve - Sesioni 2.2: Katalogu i të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve
14.45 – 15.00	Pushim kafeje		—
15.00 – 16.10 (70')	**MODULI 2: Imazhi i fëmijërisë së hershme, filozofia dhe praktikat edukative dhe miqësore me fëmijët (vazhdim)**	- Korniza e integrimit në sistemet e fëmijërisë së hershme: Analiza e vlerave, parimeve dhe faktorëve kyç të cilësisë përmes punës në grupe, rasteve konkrete dhe prezantimeve reflektuese.	- Sesioni 2.3: Korniza për mbështetjen e integrimit në sistemet e fëmijërisë së hershme: Vlerat dhe Parimet, Faktorët kyç dhe Praktika e cilësisë

16:10– 16:30	**Mbyllja e sesionit tematik**	- Plotesimi i bankës së pyetjeve në fund të ditës 1 (formati i ASPA-s, 24 pyetje për 6 orë trajnimi, kompetencat që trajnimi zhvillon tek pjesëmarrësit) - Dhënia e detyrave për ditën e dytë të trajnimit.	- Lehtësuesi, trajneri
Dita 2			
Ora	**Moduli / Tema Kryesore**	**Përshkrimi**	**Komponentët**
09:00 – 09:15	**Rikthim në ditën e parë**	Rikthim në ditën e parë - Përmbledhje e mesazheve kyç - Diskutime dhe shkëmbim refleksionesh nga pjesëmarrësit	- Lehtësues, trajner
09.15 – 10.45 (90')	**MODULI 3. Barazi dhe gjithëpërfshirje**	- Korniza ligjore dhe dokumentet bazë për gjithëpërfshirjen në arsimin parashkollor dhe fillor. - Konceptet bazë mbi gjithëpërfshirjen dhe kuptimi i saj në praktikë. - Korniza për mbështetjen e integrimit në sistemet e fëmijërisë së hershme: Vlerat, Parimet, Faktorët kyç dhe Praktika e cilësisë	- Sesioni 3.1: Konceptet kyç: krijimi i terminologjisë për përfshirje. - Sesioni 3.2 Procese per realizimin e nje qasjeje gjithëpërfshirëse në institucionet e arsimit parashkollor. - Sesioni 3.3: Planifikimi dhe organizimi i kopshtit për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara.
10:45 – 11:00	Pushim kafeje		—
11.00 – 12:15 (75')	**MODULI 3. Barazi dhe gjithëpërfshirje**	- Partneriteti në shkollë në ndihmë të arsimimit të fëmijës me aftësi të kufizuara.	- Sesioni 3.4: Partneriteti në shkollë në ndihmë të arsimimit të fëmijës me aftësi të

		- Analiza e roleve të bordit, drejtorit, mësuesve, prindërve dhe aktorëve të tjerë - Plani edukativ/arsimor individual mjet për gjithëpërfshirjen.	kufizuara (rolet dhe funksionet e personave përgjegjës). - Sesioni 3.5: Plani edukativ/arsimor individual mjet për gjithëpërfshirjen.
12.15 – 13:30	Pushim dreke		-
13.30 – 14.45 (75')	**MODULI 4 Përfshirja e prindërve dhe komunitetit**	- Roli ndërveprues i fëmijëve, prindërve dhe mësuesve si bashkëndërtues të dijes. - Imazhi i fëmijës si qytetar aktiv dhe kompetent. - Praktikat e përfshirjes prindërore në jetën e institucionit (takime, festa, bordi i kopshtit, grupe projektesh). - Demokracia si mënyrë jetese në institucionin e arsimit parashkollor.	- Sesioni 4. 1.Përfshirja dhe bashkëpunimi prindër- mësues
14:45– 15:00	Pushim kafeje	-	
15:00– 16.10 (70')	**MODULI 4 Përfshirja e prindërve dhe komunitetit (Vazhdim)**	- Krijimi dhe funksionimi i Bordit të institucionit arsimor. - Përbërja, përfaqësimi dhe parimet ligjore të veprimit të Bordit. - Roli i prindërve, komunitetit dhe pushtetit vendor në Bordin e kopshtit. - Sfida dhe mundësi për rritjen e efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes së Bordit.	- Sesioni 4.2. Roli i Bordit të kopshtit dhe komunitetit si pjesë aktive e në rritjen e pjesëmarrjes dhe cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor.

16:10– 16:30	**Mbyllja e sesionit tematik**	- Plotesimi i bankës së pyetjeve në fund të ditës 2 (formati i ASPA-s, 24 pyetje për 6 orë trajnimi, kompetencat që trajnimi zhvillon tek pjesëmarrësit) - Lënia e detyrave për pas trajnimit në klasë - Formulari i Vleresimit për trajnimin në klasë (formati i ASPA-s)	- Lehtësuesi, trajneri
Dita 3			
Ora	**Moduli / Tema Kryesore**	**Përshkrimi**	**Komponentët**
09:00 – 09:15	**Hyrje dhe prezantime**	- Hapja e trajnimit dhe prezantimi i pjesmarrësve - Prezantimi i qëllimit, objektivave dhe strukturës së programit të trajnimit - Pjesëmarrësit diskutojnë mbi pritshmëritë e trajnimit	- —
09:15– 10:45 (90')	**MODULI 5: Siguria, Mbrojtja, Mirëqenia dhe Shëndeti i Fëmijëve në Institucionet e Arsimit Parashkollor**	- Prezantim i koncepteve themelore dhe llojeve kryesore të fatkeqësive natyrore. - Njohje me bazën ligjore që rregullon emergjencat civile në Shqipëri (Ligji nr. 8756). Parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në situata emergjente; - Nocionet bazë të emergjencave civile në arsimin parashkollor.	- Sesioni 5.1 Nocionet bazë mbi fatkeqësitë natyrore - Sesioni 5.2 Kuadri ligjor - Sesioni 5.3 Koncepte të emergjencave civile
10:45 – 11:00	Pushim kafeje		-

11.00 – 12:15 (75')	**MODULI 5: Siguria, Mbrojtja, Mirëqenia dhe Shëndeti i Fëmijëve në Institucionet e Arsimit Parashkollor (vazhdim)**	- Standardet bazë të sigurisë në institucionet arsimore: Kopshte të sigurta - Hartim i planeve konkrete të veprimit në nivel institucional. - Edukim dhe orientim për menaxhimin e rreziqeve dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike. - Promovim i pjesëmarrjes së komunitetit dhe prindërve në planet e mbrojtjes ndaj fatkeqesive natyrore.	- Sesioni 5.4 Kopshte të sigurta - Sesioni 5.5 Avokimi
12.15 – 13:30	Pushim dreke		
13.30 – 14.45 (75')	**MODULI 6 Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë**	- Roli i mjeteve didaktike në zhvillimin e fëmijëve. - Përfshirja e të rriturve dhe burimeve vendore në procesin arsimor. - Klasifikimi dhe planifikimi i mjeteve sipas fushave të zhvillimit.	- Sesioni 6.1 Roli i mjedisit të të nxënit - Sesioni 6.2 Mjetet didaktike në ndihmë të proceseve të të nxënit.
14:45– 15:00	Pushim kafeje		
15:00– 16.10 (70')	**MODULI 6 Zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë (vazhdim)**	- Përdorimi i instrumentit të vëzhgimit për cilësinë e klasave. - Dokumentimi dhe bashkëpunimi për vlerësim të besueshëm. - Funksioni i hapësirave edukative/arsimore në zhvillimin e fëmijëve. - Vëzhgimi dhe analiza e cilësisë së mjedisit edukativ/arsimor. - Rëndësia e regjimit ditor dhe rutinës në organizimin e klasës.	- Sesioni 6.3 Instrument për vëzhgimin në klasë në ndihmë të monitorimit për siguri, aksesueshmëri dhe përshtatshmëri zhvillimore. - Sesioni 6.4 Krijimi i mjedisit cilësor i të nxënit në kopshte në funksion të standarteve.

16:10–16:30	**Mbyllja e sesionit tematik**	- Plotësimi i bankës së pyetjeve në fund të ditës 1 (formati i ASPA-s, 24 pyetje për 6 orë trajnimi, kompetencat që trajnimi zhvillon te pjesëmarrësit). - Dhënia e detyrave për ditën e dytë të trajnimit.	- Lehtësuesi, trajneri
Dita 4			
Ora	**Moduli / Tema Kryesore**	**Përshkrimi**	**Komponentët**
09:00 – 09:15	**Rikthim në ditën e parë**	Rikthim në ditën e parë - Përmbledhje e mesazheve kyç - Diskutime dhe shkëmbim refleksionesh nga pjesëmarrësit	- Lehtësuesi, trajneri
09:15–10:45 (90')	**MODULI 7: Mjedisi si edukator i tretë**	- Roli i mjeteve didaktike në zhvillimin e fëmijëve; - Përfshirja e të rriturve dhe burimeve vendore në procesin edukativ/arsimor; - Klasifikimi dhe planifikimi i mjeteve sipas fushave të zhvillimit; - Përdorimi i instrumentit të vëzhgimit për cilësinë e klasave;	- Sesioni 7.1 Roli i mjedisit të të nxënit - Sesioni 7.2 Mjetet didaktike në ndihmë të proceseve të të nxënit - Sesioni 7.3 Instrument për vëzhgimin në klasë – në ndihmë të monitorimit për siguri, aksesueshmëri dhe përshtatshmëri zhvillimore.
10:45–11:00	**Pushim kafeje**		-
11:00–12:30 (90')	**MODULI 7: Mjedisi si edukator i tretë (vazhdim)**	- Funksioni i hapësirave edukative/arsimore në zhvillimin e fëmijëve; - Vëzhgimi dhe analiza e cilësisë së mjedisit edukativ/arsimor;	- Sesioni 7.4 Krijimi i mjedisit cilësor i të nxënit në kopshte në funksion të standarteve dhe kurrikulës së arsimit parashkollor

		- Rëndësia e regjimit ditor dhe rutinës në organizimin e klasës;	
12.30 - 13.30	**Pushim dreke**		
13:30– 14:45 (75')	**MODULI 8 Plani afatmesëm i kopshtit**	- Përse një plan afatmesëm për zhvillimin e kopshtit: roli i planit afatmesëm si një udhërrëfyes 3-4-vjeçar për ndryshime reale, të qëndrueshme dhe cilësore në institucionet e arsimit parashkollor. - Kuptimi i kredos si hyrje dhe themel i Planit Afatmesëm për Zhvillimin e Kopshtit: Misioni, besimet dhe vizionet e kopshtit.	- Sesioni 8.1: Përse një plan afatmesëm për zhvillimin e kopshtit - Sesioni 8.2: KREDOJA (Misioni, besimet dhe vizionet e kopshtit)
14:45– 15:00	**Pushim kafeje**		-
15:00– 16:10 (70')	**MODULI 8 Plani afatmesëm i kopshtit (vazhdim)**	- Analiza e gjendjes në Planin Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit - Të dhënat sociale, ekonomike dhe financiare në PASH dhe analiza e pikave të forta e të dobëta të kopshtit. Caktimi i prioriteteve, objektivave, planifikimi i veprimtarive dhe mbikëqyrjes në Planin Afatmesëm të zhvillimit të kopshtit	- Sesioni 8.3: Analiza e Gjendjes së Kopshtit: Infrastruktura, Shërbimet, Partneritetet - Sesioni 8.4: Analiza socio-ekonomike, financiare dhe institucionale në funksion të planifikimit strategjik të kopshtit. - Sesioni 8.5 Procesi i planifikimit strategjik dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Planit Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit
16.10 – 16.20	**Mbyllja e sesionit tematik**	- Plotësimi i bankës së pyetjeve në fund të ditës 2 (formati i ASPA-s, 24 pyetje për 6 orë trajnimi,	- Lehtësuesi, trajneri

		kompetencat që trajnimi zhvillon tek pjesëmarrësit) - Dhënia e detyrave për pas trajnimit në klasë - Formulari i vlerësimit për trajnimin në klasë	

MODULI 1 MENAXHIMI I FUNKSIONIT TË ARSIMIT PARASHKOLLOR NË NIVEL VENDOR

Përmbledhje e modulit:

Moduli trajton procesin e decentralizimit të arsimit parashkollor dhe mënyrën se si bashkitë ushtrojnë përgjegjësitë e tyre për ofrimin, menaxhimin, financimin dhe sigurimin e cilësisë së këtij shërbimi publik. Ai shpjegon kuadrin ligjor dhe institucional që rregullon funksionin e arsimit parashkollor si kompetencë e transferuar e njësive të vetëqeverisjes vendore, duke u mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, Ligjin nr. 68/2017 “Për financat vendore”, si dhe në Strategjinë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021–2026 dhe dokumente të tjera strategjike kombëtare.

Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit do të fitojnë një kuptim të plotë mbi rolin dhe kompetencat e bashkive në administrimin e arsimit parashkollor, ndërveprimin ndërmjet politikave kombëtare dhe planifikimit vendor, si dhe mekanizmat e nevojshëm për sigurimin e cilësisë dhe llogaridhënies. Moduli gjithashtu thekson rëndësinë e planifikimit strategjik, menaxhimit të proceseve dhe bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet bashkive, institucioneve arsimore, prindërve dhe komunitetit, për të garantuar një qasje të integruar, gjithëpërfshirëse dhe cilësore ndaj arsimit të fëmijërisë së hershme.

KONTEKSTI

Konteksti i arsimit parashkollor në Shqipëri përcaktohet nga një model i përbashkët qeverisjeje midis Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe qeverisjes vendore, i cili po përjeton përpjekje të konsiderueshme për modernizimin e politikave dhe sigurimin e cilësisë, megjithëse jo pa sfida në zbatim dhe qasje.

Tabela përmbledhëse e përgjegjësive kryesore

Përgjegjësitë	Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)	Njësia e Vetëqeverisjes Vendore (Bashkia)
Politika dhe strategji	Harton politikën kombëtare dhe strategjinë për zhvillimin e arsimit, përfshirë arsimin parashkollor.	Administron dhe zbaton shërbimin e arsimit parashkollor në territorin e bashkisë, në përputhje me kuadrin ligjor dhe standardet kombëtare.
Sigurimi i një shërbimi arsimor cilësor	Harton kurrikulën kombëtare të arsimit, përfshirë arsimin parashkollor, standardet profesionale të mësuesve dhe drejtuesve, programet e zhvillimit të tyre profesional; monitoron cilësinë e shërbimit përmes	Përgjegjëse për infrastrukturën, higjienën, mirëmbajtjen, furnizimet dhe shërbimet mbështetëse të institucioneve arsimore publike.

	ASCAP-it dhe strukturave të varësisë.	
Financim	Përmes portalit “Mësues për Shqipërinë”, siguron përzgjedhjen dhe shpërndarjen e mësuesve në sistemin arsimor publik, duke garantuar standarde të barabarta profesionale, transparencë dhe punësim bazuar në meritë në të gjithë vendin.	Financon pagat e punonjësve pedagogjikë në kopshtet publike (mosha 3–6 vjeç), si dhe pagat e punonjësve jopedagogjikë, infrastrukturën, mirëmbajtjen, pajisjet dhe shërbimet mbështetëse.
Grupmosha	Siguron arsimin parashkollor për fëmijët e moshës 3–6 vjeç, në përputhje me ligjin për sistemin arsimor parauniversitar dhe strategjinë kombëtare të arsimit.	Ndërmerr përgjegjësi të përbashkëta me Ministrinë e Arsimit dhe Sportit për shërbimet 3–6 vjeç (kopshte).

Peizazhi i arsimit parashkollor shqiptar: Një ekosistem kompleks
Ofrimi aktual i shërbimit të arsimit parashkollor në Shqipëri karakterizohet nga një përzierje e larmishme aktorësh dhe modelesh. Ky diversitet paraqet një sfidë të vazhdueshme, por edhe një mundësi të rëndësishme për të krijuar një sistem dinamik që mund të arrijë qëllimin kombëtar të pjesëmarrjes universale.

Ky peizazh përcaktohet nga katër faktorë kryesorë:

1. **Shërbime të shumëfishta me bashkërendim të kufizuar:**
Shërbimet ofrohen nga një përzierje e tipologjive të kopshteve në zona urbane, rurale. Një sfidë e madhe është bashkëpunimi dhe bashkërendimi shpesh i kufizuar midis njësive përgjegjëse për arsimin në bashki dhe autoriteteve shtetërore rajonale duke çuar në joefikasitet dhe cilësi të paqëndrueshme.

2. **Mjedise të ndryshme arsimore:**
Arsimi parashkollor ofrohet në mjedise të ndryshme, kryesisht në kopshte por edhe në klasa parashkollore të atashuara pranë shkollave. Kjo ka çuar në interpretime të ndryshme të "cilësisë" dhe një gamë të gjerë standardesh operative, duke e bërë sigurimin e cilësisë në të gjithë sistemin të vështirë për t'u menaxhuar nga bashkitë.

3. **Kohëzgjatja e arsimit parashkollor:**
Arsimi parashkollor ofrohet në institucione të arsimit parashkollor (kopshte) dhe në shkolla:

- Në kopshte ofrohet në formën e 3 grupeve sipas grupmoshave 3, 4 dhe 5 vjecare). Në zonat rurale shpeshherë kopshti mund të jëtë në të njëjtën ndërtesë me një shkollë të caktuar.
- Në disa shkolla funksionojnë kasa përgatitore për fëmijët 5-vjecarë që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin.

4. **Orare të paqëndrueshme të funksionimit:**

Sidomos në bashkitë më të mëdha, orët e shërbimit ndryshojnë ndjeshëm. Disa kopshte funksionojnë vetëm për 3-4 orë në ditë, ndërsa të tjerat ofrojnë orare të plota ditore. Këto vendime politike mbi orët operative kanë implikime të drejtpërdrejta për kostot bashkiake, pjesëmarrjen e fuqisë punëtore (veçanërisht për nënat) dhe ndikimin arsimor te fëmija.

Qëllimi i modulit:

Moduli synon të aftësojë punonjësit e arsimit në bashki, drejtuesit vendorë, drejtuesit e institucioneve të arsimit parashkollor për të kuptuar dhe zbatuar kuadrin strategjik e ligjor që udhëheq administrimin e shërbimit të arsimit parashkollor, duke forcuar kapacitetet e tyre për planifikim, buxhetim dhe bashkërendim ndërinstitucional në përputhje me politikat kombëtare të arsimit dhe zhvillimit vendor.

Të pajisë pjesëmarrësit me njohuri dhe aftësi për:

- Kuptimin e procesit të decentralizimit të arsimit parashkollor dhe bazës ligjore që e mbështet;
- Identifikimin e kompetencave bashkiake në ofrimin e arsimit parashkollor;
- Zbatimin e standardeve kombëtare dhe rregulloreve vendore për cilësinë e shërbimit;
- Përdorimin e instrumenteve të administrimit, planifikimit, zbatimit dhe mbikëqyrjes së shërbimit në nivel vendor;
- Promovimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, prindërve dhe komunitetit për zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve.

Grupi i synuar:

- ✓ Drejtues dhe vendimmarrës vendorë: Kryetarë bashkish dhe struktura ekzekutive, këshilltarë bashkiakë (veçanërisht Komisionet e Arsimit);
- ✓ Administrata vendore (NJVV): Drejtues dhe specialistë të bashkive që administrojnë shërbimin e arsimit, përfshirë stafin për buxhetim, prokurim dhe menaxhim burimesh, përgjegjës për zbatimin e politikave dhe mbikëqyrjen e cilësisë;
- ✓ Drejtues të institucioneve të arsimit parashkollor;

Sesioni 1.1 Funksioni i arsimit parashkollor si kompetencë e bashkive, kuadri ligjor dhe institucional, instrumentet për administrimin e shërbimit.

Objektivat:

Moduli synon të aftësojë pjesëmarrësit për të kuptuar dhe zbatuar kuadrin ligjor strategjik dhe institucional që rregullon funksionin e arsimit parashkollor si përgjegjësi e transferuar te njësitë e vetëqeverisjes vendore, në kuadër të reformës së decentralizimit. Pjesëmarrësit do të zhvillojnë njohuri dhe aftësi për:

- njohjen dhe interpretimin e rolit dhe kompetencave të bashkive në ofrimin, administrimin dhe financimin e shërbimit të arsimit parashkollor, në përputhje me ligjet dhe politikat kombëtare;
- lidhjen e objektivave dhe prioriteteve të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar 2021–2026 me planifikimin vendor të shërbimeve të arsimit parashkollor;
- përdorimin e instrumenteve të menaxhimit strategjik dhe planifikimit buxhetor për një administrim efektiv dhe të qëndrueshëm të shërbimeve;
- përfshirjen e parimeve të cilësisë, gjithëpërfshirjes dhe barazisë në proceset e ofrimit të arsimit të fëmijërisë së hershme;
- nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve vendore, prindërve dhe komunitetit për përmirësimin e qasjes dhe cilësisë së shërbimeve;
- optimizimin e proceseve administrative për të rritur efikasitetin, transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e arsimit parashkollor.

Tematika:

1. Konteksti i decentralizimit në Shqipëri – kalimi i funksioneve të arsimit parashkollor te bashkitë (pas 2015).
2. Roli dhe kompetencat e bashkive në ofrimin e arsimit parashkollor (infrastruktura, shërbimet publike, cilësia).
3. Kuadri ligjor për ndarjen e funksioneve: (Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.) Funksionet e veta dhe përgjegjësitë kryesore të bashkive në arsimin parashkollor.
4. Marrëdhëniet ndërmjet bashkisë dhe institucioneve arsimore (drejtoritë e kopshteve, DRAP/ZVA, MA).
5. Përmbajtja dhe prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar. Ndikimi i politikave kombëtare në planifikimin vendor dhe përcaktimin e nevojave të bashkive;
6. Parimet, strukturat dhe standardet e arsimit parashkollor (Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”).
7. Roli i bashkisë në administrimin, mirëmbajtjen dhe mbështetjen e institucioneve të arsimit parashkollor.
    a. Administrimi – planifikimi, financimi dhe organizimi i funksionit;
    b. Rregullimi – përcaktimi i rregullave, standardeve dhe kritereve të matshme.
    c. Përputhshmëria me kuadrin ligjor dhe standardet kombëtare.

d. Sqarimi i roleve dhe përgjegjësive – forcimi i llogaridhënies dhe efikasitetit.

1. Planifikimi, buxhetimi dhe alokimi i fondeve për shërbimet e arsimit parashkollor. Burimet e financimit dhe autonomitë buxhetore të bashkive në ofrimin e shërbimeve arsimore.
2. Standartet dhe rregulloret vendore;
3. Planifikim strategjik afatmesëm për zhvillimin e arsimit parashkollor;
    e. Roli i planeve afatmesme buxhetore (PAB) në integrimin e objektivave arsimore.
    f. Sigurimi i qasjes së barabartë dhe cilësisë së shërbimit.
    g. Optimizimi i proceseve administrative për menaxhim më efektiv dhe të qëndrueshëm.

Rezultatet e të nxënit në përfundim të sesionit:

- Pjesemarrësit njohin dhe zbatojnë dhe kompetencat në planifikimin e ofrimit të shërbimit, financimin dhe administrimin e sistemit arsimor parashkollor në koherencë me politikat dhe strategjitë kombëtare.
- Pjesemarrësit kanë të qartë ndërlidhjen e politikave kombëtare, strategjive dhe politikave vendore dhe ndërveprimin mes funksioneve qendrore dhe vendore.
- Pjesemarrësit janë aftësuar të përdorin instrumentet e menaxhimit strategjik dhe buxhetor për administrimin efektiv të sistemit arsimor parashkollor.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren:

- **Pyetësor paraprak (Shtojca Nr.1)**

Ky pyetësor është përzgjedhur si mjet vlerësimi për të matur nivelin e kuptimit të pjesëmarrësve mbi konceptet kryesore të decentralizimit të arsimit parashkollor, kuadrin ligjor dhe rolin e bashkive në administrimin e shërbimit. Ai synon të verifikojë njohuritë mbi detyrimet ligjore, proceset menaxhuese dhe standardet kombëtare, duke siguruar që pjesëmarrësit të jenë të aftë t'i zbatojnë këto parime në praktikë. Në këtë proces përfshihen trajnerët, pjesëmarrësit në trajnim, me qëllim që rezultatet e pyetësorit të përdoren për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin e praktikave vendore me kuadrin kombëtar.

- **Prezantim në Powerpoint (Shtojca Nr. 2)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Tajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim me pyetje e përgjigje (Shtojca nr.3)**

Ky mjet diskutimi është përzgjedhur për të nxitur reflektim dhe shkëmbim përvojash mbi gjendjen aktuale të decentralizimit të arsimit parashkollor. Ai synon të identifikojë sfidat dhe praktikat e mira që bashkitë kanë zbatuar pas transferimit të kompetencave, duke e lidhur teorinë e modulit me realitetin praktik. Përmes pyetjeve të strukturuara, pjesëmarrësit mund të analizojnë rolin e bashkive në administrimin, financimin, organizimin dhe rregullimin e shërbimit. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e

modulit, trajnerët dhe ekipi, me qëllim që rezultatet e diskutimit të përdoren për përmirësimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin e praktikave vendore me kuadrin ligjor kombëtar.

Mesazhet kyç të sesionit:

a) ***"Ju keni autoritetin ligjor dhe përgjegjësinë operative për ofrimin e shërbimit të arsimit parashkollor",*** - duke e bërë këtë funksion një detyrë themelore për ofrimin e shërbimeve cilësore për fëmijët e komunitetit tuaj.
b) ***"Ky transferim kompetencash është një mundësi për të përshtatur shërbimet sipas nevojave vendore",*** por kërkon angazhim për planifikim strategjik, menaxhim financiar dhe sigurimin e cilësisë.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë 2 orë.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme*:*

- Prezantimet në PowerPoint të sesionit 1.1 "Funksioni i arsimit parashkollor si kompetencë e bashkive, kuadri ligjor dhe institucional, instrumentet për administrimin e shërbimit".
- Dokumenti teorik i sesionit 1.1 Funksioni i arsimit parashkollor si kompetencë e bashkive, kuadri ligjor dhe institucional, instrumentet për administrimin e shërbimit.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë njohuritë e marra gjatë sesionit:

I. LIGJE

- Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"
- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me ligjet nr. 56/2015, nr. 48/2018 dhe nr. 44/2023
- Ligji nr. 48/2018, datë 23.07.2018 "Disa shtesa dhe ndryshime në legjislacionin në fushën e arsimit parauniversitar"

II. VENDIME TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE (VKM)

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662, datë 08.10.2014 "Për kriteret dhe procedurat e ushtrimit të veprimtarisë së institucioneve arsimore"
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 873, datë 14.12.2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar"
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1101, datë 28.12.2015 (i përditësuar) "Për transportin e nxënësve dhe studentëve"
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 19.09.2018 "Për krijimin dhe funksionimin e Shkollës së Drejtorëve"

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 662 “Për hapjen, funksionimin dhe mbylljen e institucioneve arsimore”

III. URDHRA TË MINISTRIT
- Urdhër nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e Rregullores për institucionet e arsimit parauniversitar (IAP)”
- Urdhër nr. 477, datë 30.09.2019 “Për miratimin e standardeve profesionale për formimin dhe zhvillimin profesional të drejtuesve të institucioneve arsimore”

IV. UDHËZIME MINISTERIALE
- Udhëzim nr. 25 “Për organizimin dhe funksionimin e Bordit të Shkollës”
- Udhëzim i përbashkët nr. 11 “Për bashkëpunimin ndërinstitucional në fushën e arsimit parauniversitar”
- Udhëzim nr. 12, datë 10.06.2021 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve të arsimit parauniversitar”
- Udhëzim nr. 17, datë 09.07.2025 “Për administrimin dhe menaxhimin e shërbimeve arsimore në nivel vendor”

V. RREGULLORE DHE KODE ETIKE
- Rregullore për funksionimin e Çerdheve dhe Kopshteve (Arsimi Parashkollor) – version i përditësuar 2025
- Kodi i Etikës për punonjësit e administratës publike
-
- VI. DOKUMENTE STRATEGJIKE / PLANIFIKUESE (jo normative)
- Planifikimi i Buxhetit Afatmesëm Vendor (PBA) 2022–2024 – Procesi, rolet dhe përgjegjësitë
- Plani Kombëtar i Veprimit për Arsimin Digjital 2025–2030

Pajisjet që do përdoren:

- Gjatë sesionit do të përdoren
  Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Hyrje

Që nga 1 janari 2019, arsimi parashkollor në Shqipëri është transferuar si funksion ekskluziv i njësive të vetëqeverisjes vendore, në kuadër të reformës së decentralizimit. Ky ndryshim bazohet në Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" dhe Ligjin nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, të cilat përcaktojnë se bashkitë kanë përgjegjësi për administrimin e kopshteve dhe çerdheve, duke përfshirë menaxhimin e burimeve njerëzore, financimin, infrastrukturën dhe sigurimin e cilësisë. Kompetenca është e formalizuar në Nenin 12 të ligjit për vetëqeverisjen vendore, ku arsimi parashkollor kategorizohet si shërbim publik vendor.
Institucionalisht, bashkitë organizojnë sektorë të dedikuar për arsimin parashkollor, krijojnë struktura mbështetëse si Bordet e kopshteve, komisione për sigurinë dhe mirëmbajtjen, si dhe bashkëpunojnë me Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar për harmonizimin me politikat kombëtare. Përveç kësaj, standardet profesionale për drejtuesit e institucioneve parashkollore janë të përcaktuara nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar (ASCAP).

Instrumentet kryesore për administrimin e shërbimit përfshijnë:

- **Planifikimin dhe buxhetimin afatmesëm** (PBA) për investime dhe shërbime.
- **Rregulloret vendore** për funksionimin e kopshteve dhe çerdheve.
- **Sistemet e monitorimit dhe raportimit** për cilësinë e shërbimit.
- **Bordet e Kopshteve dhe Këshillat e Prindërve** për pjesëmarrjen komunitare.
- **Instrumentet digjitale** si regjistrat elektronikë për menaxhimin e të dhënave.
- **Planet për përmirësimin e shërbimit** që trajtojnë infrastrukturën, stafin, përfshirjen sociale dhe mbrojtjen e fëmijëve.

Ky kuadër ligjor dhe institucional synon të garantojë qasje të barabartë, cilësi dhe përshtatje të shërbimeve sipas nevojave vendore, ndërkohë që sfida kryesore mbetet forcimi i kapaciteteve administrative dhe financiare të bashkive.
Bashkitë shqiptare, pas transferimit të funksionit të arsimit parashkollor, mbajnë përgjegjësi të zgjeruara që përfshijnë kontrollin administrativ mbi institucionet, menaxhimin e personelit dhe sigurimin e cilësisë; kujdesin financiar përmes buxheteve vendore dhe planifikimit fiskal; autoritetin për të hartuar dhe zbatuar rregullore që plotësojnë kornizat kombëtare; si dhe hartimin e planeve strategjike për infrastrukturën, qasjen dhe cilësinë e shërbimit. Gjithashtu, ato kanë detyrimin të garantojnë qasje të barabartë për të gjithë fëmijët, duke u bërë drejtpërdrejt përgjegjëse ndaj komunitetit.

Ky decentralizim sjell mundësi për shërbime më të përshtatura, por kërkon kapacitete të forta administrative, ekspertizë të specializuar dhe menaxhim efikas të burimeve për të siguruar cilësi dhe barazi.

Arsimi parashkollor përbën bazën e zhvillimit të hershëm të fëmijëve dhe është një element kyç për përgatitjen e tyre për arsimin fillor. Ai ndikon drejtpërdrejt në aftësitë njohëse, sociale dhe emocionale të fëmijëve, duke krijuar themelet për suksesin e

mëvonshëm në shkollë dhe jetë. Në Shqipëri, ky funksion është transferuar te bashkitë si pjesë e reformës së decentralizimit, duke filluar nga data 1 janar 2019. Ky ndryshim synon të afrojë shërbimet me komunitetin, të rrisë cilësinë e qasjes dhe të sigurojë menaxhim më efikas të burimeve.

Arsimi parashkollor në Shqipëri përbën një fazë themelore të sistemit arsimor parauniversitar, e cila synon zhvillimin e hershëm të fëmijëve dhe përgatitjen e tyre për arsimin fillor. Për të garantuar cilësi dhe gjithëpërfshirje, institucionet arsimore vendore si Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP), në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe drejtuesit e kopshteve publike, duhet të sigurojnë zbatimin e kurrikulës së arsimit parashkollor bazuar në kornizën kurrikulare, standardet e zhvillimit dhe të nxënit për fëmijët e moshës 3-6 vjeç, si dhe programet e përshtatura për çdo grupmoshë. Një detyrë e rëndësishme është regjistrimi i fëmijëve pesëvjeçarë në klasën përgatitore, veçanërisht atyre që nuk kanë ndjekur më parë kopshtin, si dhe përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta, përfshirë ata nga familjet në nevojë, komunitetet rome dhe egjiptiane, si dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Për këta fëmijë, institucionet duhet të ngrenë komisione të posaçme, të caktojnë mësues ndihmës sipas rekomandimeve të komisionit shumëdisiplinor dhe portalit “Mësues për Shqipërinë”, si dhe të hartojnë dhe zbatojnë plane arsimore individuale në bashkëpunim me prindërit, psikologët, punonjësit socialë dhe profesionistët e shëndetësisë. Fëmijët që përfundojnë të paktën njërin nga tri grupet e arsimit parashkollor dhe kanë moshën për klasën e parë pajisen me vërtetim zyrtar të ndjekjes së kopshtit, të nënshkruar nga drejtuesi i institucionit. Çdo kopsht duhet të ketë struktura të pjesëmarrjes dhe llogaridhënies si bordi i kopshtit, këshilli i prindërve, këshilli i mësuesve dhe komisioni i etikës dhe sjelljes, sipas legjislacionit në fuqi. Për më tepër, rrjetet profesionale dhe këshillat e mësuesve duhet të trajtojnë tema kyç si standardet e zhvillimit dhe të nxënit për fëmijët 3-6 vjeç, kurrikula me kompetenca, planifikimi sipas kurrikulës së re, portofoli i të nxënit, vlerësimi i fëmijëve, standardet profesionale të formimit të përgjithshëm të mësuesve, si dhe bashkëpunimi me prindërit për të harmonizuar veprimtaritë e kopshtit me ato në shtëpi. Këto masa synojnë të sigurojnë një arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të harmonizuar me politikat kombëtare, duke krijuar bazën për suksesin e fëmijëve në arsimin fillor dhe më tej.

1. Konteksti i decentralizimit në Shqipëri

Decentralizimi në Shqipëri përfaqëson një nga reformat më të rëndësishme në qeverisjen publike, e përqendruar në transferimin e kompetencave nga niveli qendror drejt atij vendor. Qëllimi është afërsimi i shërbimeve me qytetarët, rritja e efikasitetit të administratës dhe promovimi i transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit, të sanksionuara si në Kushtetutë, ashtu edhe në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Decentralizimi në arsimin parashkollor

Që prej 1 janarit 2019, sistemi i arsimit parashkollor në Shqipëri ka hyrë në një fazë të re të funksionimit përmes procesit të decentralizimit. Ky reformim rrënjësor kaloi përgjegjësinë e plotë për fëmijët e grupmoshës 0–6 vjeç nga pushteti qendror te

bashkitë, duke i kthyer këto të fundit në aktorët kryesorë të menaxhimit të kopshteve dhe çerdheve. Ky ndryshim nuk ishte thjesht administrativ, por një lëvizje strategjike për të afruar shërbimin publik me qytetarin dhe për të rritur llogaridhënien vendore.
Në kuadër të kësaj autonomie, bashkitë sot ushtrojnë kompetenca të plota në katër shtylla kryesore:

Së pari, **menaxhimi i infrastrukturës** është shndërruar në një përgjegjësi ekskluzive vendore. Bashkitë janë tashmë përgjegjëse për ndërtimin, rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e godinave, duke garantuar që mjediset të përmbushin standardet bashkëkohore të sigurisë dhe higjienës. Kjo i lejon pushtetit vendor që të orientojë investimet aty ku nevoja komunitare është më emergjente.

Së dyti, **administrimi i personelit** ka pësuar një transformim të rëndësishëm. Përveç personelit ndihmës, bashkitë menaxhojnë emërimet dhe strukturat organike, duke synuar një shpërndarje më efikase të burimeve njerëzore në raport me numrin e fëmijëve. Kjo autonomi mundëson një monitorim më të rreptë të performancës dhe standardeve të shërbimit.

Së treti, **autonomia financiare dhe buxhetimi** u mundësojnë bashkive të planifikojnë buxhetet afatmesme me një elasticitet më të lartë. Duke kombinuar grantet e qeverisë me të ardhurat e tyre vendore, bashkitë mbulojnë kostot operative që nga ushqimi dhe materialet didaktike, deri te shërbimet mbështetëse si siguria dhe mirëmbajtja.

Së fundmi, ky model synon rritjen e **cilësisë së shërbimit dhe llogaridhënies**. Duke qenë më afër familjeve dhe nevojave të tyre, qeverisja vendore mund të reagojë më shpejt për përmirësimin e dietave ushqimore apo pasurimin e programeve jashtëshkollore. Në këtë mënyrë, arsimi parashkollor nuk shihet më vetëm si një proces edukativ/arsimor i izoluar, por si një shërbim komunitar i integruar që luan një rol kritik në zhvillimin e hershëm të fëmijës dhe mirëqenien e familjes në çdo njësi administrative.

Baza ligjore dhe autonomia institucionale
Reforma e decentralizimit mbështetet solidarisht mbi Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i cili shërben si kushtetuta e funksionimit të bashkive në Shqipëri. Ky ligj sanksionon kalimin e arsimit parashkollor si një "funksion i vet" i bashkive, duke u dhënë atyre autoritetin e plotë për të hartuar politika zhvillimore vendore dhe për të administruar strukturat arsimore (çerdhet dhe kopshtet) në përputhje me demografinë dhe kërkesat e komunitetit. Për më tepër, ky kuadër plotësohet nga Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” (i ndryshuar), i cili përcakton standardet e cilësisë dhe rolin e institucioneve të varësisë në monitorimin e procesit mësimor-edukativ.

Mekanizmi i financimit dhe burimet e alokimit
Sistemi i financimit është i ndërtuar mbi një model të përzier, që synon të sigurojë qëndrueshmëri përmes disa kanaleve:

Transferta e pakushtëzuar sektoriale: Përbën burimin kryesor të financimit, ku fondet alokohen nga buxheti i shtetit bazuar në një formulë specifike. Kjo formulë merr në konsideratë faktorë kritikë si numri i fëmijëve të regjistruar për njësi administrative, dendësia e popullsisë dhe nevojat për personel arsimor dhe mbështetës.

Të ardhurat e veta vendore: Bashkitë kanë të drejtën të rialokojnë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore për të përmirësuar cilësinë e shërbimit, si p.sh. subvencionimin e kostove të ushqimit apo përmirësimin e mjediseve rekreative/zbavitëse.

Transfertat e kushtëzuara (Grantet specifike): Përdoren kryesisht për projekte kapitale me rëndësi kombëtare, si ndërtimi i kopshteve të reja apo programet e eficiencës së energjisë në ndërtesat arsimore.

Sfidat e qëndrueshmërisë financiare dhe operacionale
Pavarësisht progresit të bërë nga viti 2019 e deri më sot (2025), hendeku midis kompetencave të deleguara dhe kapaciteteve financiare mbetet një sfidë kritike:

Kostot reale përkundrejt alokimeve buxhetore: Fondet e alokuara shpesh nuk reflektojnë rritjen e kostove të jetesës, inflacionin e produkteve ushqimore dhe nevojën për materiale didaktike të teknologjisë së lartë.

Infrastruktura dhe mirëmbajtja: Amortizimi i ndërtesave kërkon investime kapitale të vazhdueshme, të cilat tejkalojnë mundësitë e bashkive të vogla apo me bazë të ulët taksapaguesish.

Nevoja për partneritete: Për të trajtuar këto mangësi, bashkitë po orientohen gjithnjë e më shumë drejt bashkëpunimit me organizata ndërkombëtare (si UNICEF-i apo Banka Botërore), përthithjes së granteve nga Bashkimi Evropian, dhe Partneriteteve Publike-Private (PPP), për të siguruar një standard të barabartë shërbimi në të gjithë territorin.

Ndikimi i decentralizimit: avantazhet dhe transformimi i shërbimit
Procesi i decentralizimit të arsimit parashkollor ka krijuar një model të ri qeverisjeje që vendos fëmijën dhe familjen në qendër të politikave publike. Ky kalim kompetencash ka sjellë disa avantazhe strategjike:

1. Hartimi i politikave vendore dhe kohezioni social

- Bashkitë nuk janë më thjesht zbatuese të udhëzimeve qendrore, por arkitekte të zhvillimit social në territorin e tyre. Duke njohur specifikat demografike dhe socio-ekonomike, ato mund të hartojnë plane veprimi që trajtojnë pabarazitë. Kjo përfshin paketa mbështetëse specifike për integrimin e fëmijëve nga minoritetet etnike, zonat rurale të thella, ose familjet në skemën e ndihmës ekonomike, duke garantuar që asnjë fëmijë të mos mbetet jashtë sistemit për shkak të kostove apo largësisë.

2. Optimizimi i transparencës dhe llogaridhënia demokratike

- Vendimmarrja në nivel vendor e bën procesin e menaxhimit të fondeve më "të dukshëm" për qytetarin. Bashkitë janë të detyruara të raportojnë përpara këshillave bashkiake dhe komunitetit për çdo investim në infrastrukturë apo kosto operative. Ky monitorim i drejtpërdrejtë redukton hallkat burokratike dhe rrit përgjegjshmërinë institucionale, duke siguruar që çdo qindarkë e alokuar të shkojë drejt përmirësimit të kushteve të kopshteve dhe çerdheve.

3. Reagimi dinamik dhe elasticiteti operacional

- Një nga përfitimet më të prekshme është eliminimi i vonesave që shkaktonte dikur vendimmarrja e centralizuar. Sot, nëse një kopsht ka nevojë për ndërhyrje emergjente në sistemin e ngrohjes apo ndryshim të menysë ushqimore bazuar në rekomandimet e reja shëndetësore të vitit 2025, bashkia mund të ndërhyjë brenda një kohe rekord. Ky elasticitet lejon gjithashtu futjen e orareve më elastike për t'iu përshtatur nevojave të prindërve të punësuar, duke e kthyer kopshtin në një partner të familjes.

4. Inovacioni në infrastrukturë dhe metodologji didaktike

- Decentralizimi ka nxitur një lloj "gare pozitive" mes bashkive për të krijuar mjedise model. Duke pasur autonomi në investime, shumë njësi vendore po integrojnë konceptet e "kopshteve të gjelbra", mjediseve teknologjike (Smart Labs për moshën e hershme) dhe hapësirave rekreative që nxisin kreativitetin. Kjo i lejon bashkitë që, përveç standardeve kombëtare dhe vendore, të aplikojnë edhe praktika ndërkombëtare të suksesshme (si p.sh. metoda Montessori apo Reggio Emilia) sipas mundësive të tyre.

5. Fuqizimi i partneritetit me prindërit (qeverisje me pjesëmarrje)

- Arsimi parashkollor ka kaluar nga një shërbim "nga lart-poshtë" në një shërbim komunitar të integruar. Përmes dëgjesave publike dhe bordeve të kopshteve, bashkitë krijojnë një forum ku zëri i familjes peshon në vendimmarrje. Kjo pjesëmarrje rrit besimin e qytetarëve te institucionet dhe siguron që shërbimi të mos jetë vetëm cilësor në letër, por edhe i vlerësuar nga ata që e përdorin çdo ditë.

2. Roli dhe kompetencat e bashkive

Pas reformës së decentralizimit, bashkitë janë transformuar nga thjesht mirëmbajtëse të ndërtesave në aktorë strategjikë të zhvillimit të hershëm të fëmijërisë. Sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, arsimi parashkollor është klasifikuar si një "funksion i vet", çka i ngarkon njësitë e qeverisjes vendore me një mandat të gjerë vendimmarrës dhe ekzekutiv.

Kompetencat kryesore të bashkive në këtë sektor janë:

- **Menaxhimi i infrastrukturës dhe modernizimi i mjediseve:** Bashkitë mbajnë përgjegjësinë ekskluzive për ciklin e jetës së ndërtesave: nga planifikimi dhe ndërtimi i kopshteve të reja, deri te rikonstruksioni dhe mirëmbajtja e vazhdueshme. Kjo kompetencë përfshin edhe përshtatjen e infrastrukturës me standardet e

eficiencës së energjisë dhe krijimin e "mjediseve inteligjente" që nxisin stimulimin njohës dhe sigurinë fizike të fëmijëve.

- **Autonomia financiare dhe menaxhimi i buxheteve vendore:** Mbështetur në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, bashkitë kanë autoritetin të alokojnë burimet financiare për të mbuluar kostot operative. Kjo përfshin:
  - Pagat e personelit mbështetës dhe menaxhimin e skemave të shpërblimit.
  - Sigurimin e dietave ushqimore cilësore (bazuar në standardet e reja të shëndetit publik).
  - Blerjen e materialeve didaktike dhe pajisjeve laboratorike për moshën e hershme.

    Bashkitë duhet të ekuilibrojnë Transfertën e Pakushtëzuar nga qeveria qendrore me të ardhurat e tyre vendore për të garantuar qëndrueshmëri financiare.

- **Normimi dhe rregullimi i cilësisë vendore:** Ndërkohë që Ligji nr. 69/2012 përcakton kornizën kombëtare, bashkitë kanë kompetencën të hartojnë rregullore specifike për funksionimin e institucioneve të tyre. Kjo u lejon atyre të vendosin kritere shtesë për sigurinë (p.sh. sisteme monitorimi me kamera), protokollet e emergjencës dhe metodologjitë e shërbimit ndaj prindërve, duke e përshtatur shërbimin me profilin social të zonës.

- **Planifikimi strategjik dhe zhvillimi territorial:** Bashkitë hartojnë Planet Afatmesme Buxhetore (PAB) dhe strategjitë vendore për arsimin, duke parashikuar kërkesën për regjistrime bazuar në zhvillimet urbane. Ato synojnë integrimin e objektivave të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, duke siguruar që rritja e numrit të ndërtesave të shoqërohet me rritjen e cilësisë së edukimit.

- **Gjithëpërfshirja dhe barazia e qasjes:** Ky është një nga detyrimet më kritike sociale. Bashkitë duhet të garantojnë që çdo fëmijë (pa dallim statusi ekonomik apo aftësie) të ketë një vend në sistem. Kjo realizohet përmes:
  - Subvencionimit të tarifave për familjet në nevojë.
  - Përshtatjes së infrastrukturës për fëmijët me aftësi të kufizuara (ashensorë, rampa, mjedise ndijore).
  - Shërbimeve të transportit për zonat rurale të thella për të eliminuar pabarazitë territoriale.

- **Bashkërendimi ndërinstitucional dhe partneriteti:** Roli i bashkisë nuk ushtrohet në izolim. Suksesi i këtij funksioni kërkon një bashkëpunim të ngushtë me:
  - MAS-in dhe ASCAP-in: Për zbatimin e kurrikulës arsimore dhe trajnimet pedagogjike.
  - DRAP/ZVAP-in: Për menaxhimin e burimeve njerëzore arsimore.

- **Organizatat e shoqërisë civile:** Për projekte inovative dhe monitorim të pavarur.

Ky kuadër i zgjeruar kompetencash i jep bashkisë rolin e garantuesit të pikënisjes së barabartë në jetë për çdo fëmijë, duke e kthyer arsimin parashkollor në një shtyllë të zhvillimit të qëndrueshëm vendor.

3. Kuadri ligjor dhe institucional

3.1 Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"

Decentralizimi i arsimit parashkollor në Shqipëri mbështetet në një bazë të fortë ligjore dhe institucionale, e cila përcakton qartë rolet, kompetencat dhe standardet e ofrimit të shërbimit. Dy aktet kryesore që rregullojnë këtë fushë janë:
Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i cili e përcakton arsimin parashkollor si funksion ekskluziv të bashkive.

Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nuk përbën thjesht një akt rregullator, por përfaqëson themeltarin e reformës së decentralizimit në Shqipëri. Përmes tij, arsimi parashkollor u sanksionua si një "funksion ekskluziv" i bashkive, duke shënuar një paradigmë të re në qeverisje: kalimin nga një administrim i centralizuar dhe burokratik, drejt një modeli të bazuar në subsidiaritet, ku vendimet merren sa më pranë qytetarit.

Në kuptimin më domethënës, ky autoritet i plotë i jep bashkive sovranitetin administrativ për të vepruar pa ndërhyrjen e drejtpërdrejtë të pushtetit qendror, duke ruajtur vetëm detyrimin e harmonizimit me standardet dhe politikat kombëtare të edukimit. Ky funksion ekskluziv zbërthehet në disa shtylla jetike:

Administrimi i integruar dhe cilësia e shërbimit: Bashkitë mbajnë përgjegjësinë për të gjithë ekosistemin e kopshteve dhe çerdheve. Kjo përfshin jo vetëm menaxhimin e proceseve ditore, por edhe garantimin e standardeve pedagogjike dhe mbështetëse. Bashkia vepron si garantuese e cilësisë, duke siguruar që mjedisi ku rritet fëmija të jetë nxitës dhe i sigurt.

- **Sovraniteti mbi burimet financiare dhe njerëzore:** Autonomia e vërtetë buron nga kontrolli i buxhetit. Ligji u mundëson bashkive që të hartojnë plane financiare afatmesme, të rekrutojnë personelin sipas nevojave reale të territorit dhe të investojnë në rritjen profesionale të stafit. Ky pushtet u lejon bashkive të lidhin performancën e shërbimit me shpërndarjen e burimeve.

- **Përgjegjësia mbi infrastrukturën si aset komunitar:** Infrastruktura nuk shihet më thjesht si ndërtesë, por si një hapësirë që dikton mirëqenien e fëmijës. Bashkitë menaxhojnë të gjithë ciklin e investimeve, nga projektimi i ndërtesave moderne e ekologjike, deri te mirëmbajtja e rreptë e kushteve higjieno-sanitare, duke iu përgjigjur me shpejtësi amortizimit fizik.

- **Normimi vendor dhe elasticiteti rregullator:** Ndonëse korniza është kombëtare, bashkitë kanë kompetencën të hartojnë rregullore vendore që "përkthejnë" nevojat e komunitetit në norma e standarte vendore specifike. Ky

elasticitet mundëson përfshirjen e shërbimeve novatore, si kopshtet me orare të zgjatura apo programe të specializuara për integrimin e fëmijëve në nevojë.

- **Vizioni strategjik dhe planifikimi territorial:** Përmes këtij ligji, bashkia merr rolin e planifikuesit. Ajo analizon prirjet demografike dhe zgjerimin urban për të parashikuar ku duhen ndërtuar institucionet e reja, duke shmangur mbingarkesën dhe duke siguruar që rrjeti i kopshteve të rritet në përpjestim me zhvillimin e qytetit.

- **Garantimi i barazisë dhe qasjes universale:** Si institucioni më i afërt me familjen, bashkia ka detyrimin etik dhe ligjor të asgjësojë pengesat e qasjes. Pavarësisht sfidave ekonomike apo vendndodhjes gjeografike, çdo fëmijë duhet të ketë qasje të barabartë. Kjo përkthehet në politika gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi ndryshe dhe mbështetje financiare për shtresat e cenueshme.

Në fund të fundit, Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” e shndërron bashkinë nga një administratore teknike në një **mirëbesuese të interesit publik**. Ai mbështetet mbi parimet e **autonomisë efektive, transparencës rrënjësore dhe llogaridhënies demokratike**, duke e kthyer arsimin parashkollor në një platformë ku komuniteti merr pjesë aktive në ndërtimin e të ardhmes së gjeneratës së re.

3.2 Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (SKAP)

Strategjia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar është dokumenti themelor që përcakton vizionin dhe objektivat afatgjata për zhvillimin e arsimit në Shqipëri, përfshirë arsimin parashkollor. Ajo synon të krijojë një sistem arsimor **cilësor, gjithëpërfshirës dhe të aksesueshëm**, duke u bazuar në parimet e barazisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Objektivat kryesore të strategjisë janë:

- **Rritja e qasjes**: Sigurimi që çdo fëmijë, pavarësisht vendbanimit, gjendjes ekonomike apo aftësive, të ketë mundësi të ndjekë arsimin parashkollor. Kjo përfshin zgjerimin e rrjetit të kopshteve, veçanërisht në zonat rurale dhe të thella.
- **Përmirësimi i cilësisë**: Garantimi i standardeve kombëtare për mjediset, kurrikulën, materialet didaktike dhe kualifikimin e personelit. Cilësia lidhet edhe me përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe mbështetjen psikosociale.
- **Gjithëpërfshirja**: Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe atyre nga grupet e cenueshme në sistemin arsimor, përmes klasave burimore, mësuesve ndihmës dhe planeve individuale të arsimit.

Roli i bashkive në zbatimin e strategjisë

Bashkitë duhet të harmonizojnë planet e tyre zhvillimore me objektivat e strategjisë kombëtare. Kjo nënkupton:

- **Identifikimin e nevojave vendore**: Përmes analizave të popullsisë, kërkesës për shërbime dhe gjendjes së infrastrukturës.

- **Integrimin e objektivave kombëtare në planifikimin vendor**: Përmes planeve afatmesme buxhetore (PBA) dhe strategjive vendore për arsimin.
- **Bashkërendimin me institucionet qendrore**: Për të siguruar përputhshmëri me politikat kombëtare dhe për të përfituar mbështetje teknike e financiare.

3.2 Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" i ndryshuar

Ky ligj vendos bazën për funksionimin e arsimit parauniversitar, përfshirë arsimin parashkollor, duke përcaktuar parimet themelore që duhet të respektohen nga çdo institucion. Këto parime janë të detyrueshme për bashkitë, pavarësisht autonomisë së tyre vendore, dhe synojnë të garantojnë një shërbim arsimor cilësor, gjithëpërfshirës dhe të sigurt.

Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar" rregullon standardet kombëtare për arsimin parauniversitar, përfshirë arsimin parashkollor, dhe përcakton parimet themelore që duhet të respektohen nga çdo institucion, pavarësisht autonomisë vendore. Ai garanton që shërbimet e ofruara nga bashkitë të jenë në përputhje me normat kombëtare, duke siguruar cilësi, gjithëpërfshirje dhe siguri.

Parimet kryesore të ligjit:

Barazia dhe gjithëpërfshirja

Çdo fëmijë ka të drejtë të ketë qasje në arsimin parashkollor, pavarësisht gjinisë, gjendjes ekonomike, vendbanimit apo aftësive. Ligji kërkon që bashkitë të marrin masa për të eliminuar pengesat ekonomike dhe sociale, duke ofruar shërbime të subvencionuara, transport aty ku është e nevojshme, si dhe mbështetje për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes klasave burimore dhe mësuesve ndihmës. Gjithëpërfshirja nuk është vetëm një detyrim ligjor, por një parim themelor për zhvillimin e barabartë të fëmijëve.

Cilësia e shërbimit

Ligji përcakton standarde kombëtare për cilësinë e arsimit parashkollor, duke përfshirë kurrikulën, normat për numrin e fëmijëve për grup, kualifikimin e personelit dhe mjediset e sigurta. Bashkitë duhet të sigurojnë që çdo institucion parashkollor të ketë staf të trajnuar, materiale didaktike të përshtatshme dhe kushte që nxisin zhvillimin njohës, social dhe emocional të fëmijëve. Cilësia lidhet edhe me monitorimin e vazhdueshëm dhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimit.

Siguria e fëmijëve

Ky parim përfshin mbrojtjen fizike, emocionale dhe shëndetësore të fëmijëve. Bashkitë duhet të garantojnë kushte higjieno-sanitare, ushqim të sigurt, mbrojtje nga rreziqet fizike dhe zbatimin e protokolleve për emergjencat. Siguria lidhet edhe me krijimin e një mjedisi të shëndetshëm psikologjik, ku fëmijët ndihen të mbrojtur dhe të respektuar.

Detyrimi i bashkive

Bashkitë duhet të sigurojnë që këto parime të zbatohen në çdo institucion i arsimit parashkollor përmes:

- Hartimit të rregulloreve vendore që pasqyrojnë standardet kombëtare.
- Monitorimit të vazhdueshëm të cilësisë dhe sigurisë.

- Trajnimit të personelit për gjithëpërfshirje dhe mbrojtje të fëmijëve.
- Raportimit transparent ndaj komunitetit dhe institucioneve qendrore.

Administrimi dhe kontrolli i institucioneve
Administrimi i arsimit parashkollor nga bashkitë është një proces kompleks që përfshin menaxhimin e burimeve, organizimin e shërbimeve dhe garantimin e cilësisë. Ky funksion nuk kufizohet vetëm në menaxhimin e përditshëm, por kërkon një qasje strategjike për të siguruar që shërbimet të jenë të aksesueshme, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me standardet kombëtare.
Ky ligj përcakton gjithashtu strukturën e arsimit parashkollor, kurrikulën bazë, normat për numrin e fëmijëve për grup, si dhe kërkesat për kualifikimin e personelit. Bashkitë, edhe pse kanë autonomi për menaxhimin e shërbimit, duhet të zbatojnë këto standarde kombëtare për të siguruar uniformitet dhe cilësi në nivel kombëtar.

Institucionet mbështetëse
Në arkitekturën e decentralizuar të arsimit parashkollor, bashkia nuk vepron e izoluar. Suksesi i kësaj reforme mbështetet në një rrjet solid institucionesh mbështetëse që garantojnë që pavarësia administrative e bashkive të shoqërohet me një cilësi të lartë dhe të njëtrajtshme arsimore në mbarë vendin. Ky bashkëveprim institucional shërben si një "busull" që orienton investimet vendore drejt objektivave kombëtare.

Roli i aktorëve kryesorë në këtë ekosistem është i mirëpërcaktuar:
ASCAP-i (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar): Ky institucion vepron si **rojtari i standardeve profesionale**. ASCAP-i nuk kufizohet vetëm në monitorim, por ofron kornizën metodologjike, udhëzuesit kurrikularë dhe instrumentet moderne të vlerësimit. Roli i ASCAP-i është jetik në trajnimin e ekipeve drejtuese të kopshteve dhe në sigurimin që praktikat pedagogjike të jenë në linjë me risitë botërore të zhvillimit të hershëm.

DRAP/ZVAP-të (Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar/Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar): Këto institucione përfaqësojnë urën lidhëse operacionale. Ato sigurojnë një bashkërendim të pandërprerë ndërmjet vullnetit politik të bashkive dhe kërkesave teknike të Ministrisë. DRAP-i dhe ZVA-ja monitorojnë zbatimin e politikave në terren, duke u siguruar që autonomia e bashkive të mos prodhojë pabarazi në procesin mësimor-edukativ, por të shërbejë si mjet për përmbushjen e misionit kombëtar.

MAS-i (Ministria e Arsimit dhe Sportit): Si autoriteti më i lartë i politikëbërjes, MAS-i përcakton vizionin makro dhe strategjitë afatgjata. Ministria garanton që arsimi parashkollor të mbetet një prioritet kombëtar, duke hartuar kornizën ligjore dhe duke siguruar që standardet e kualifikimit të mësuesve dhe edukatorëve të jenë rigorozë. MAS-i luan rolin e rregullatorit që siguron kohezionin e sistemit në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Sinergjia: Një model bashkëkohor i qeverisjes

Ky kuadër ligjor dhe institucional krijon një ekuilibër të brishtë, por të domosdoshëm, mes **autonomisë vendore** dhe **harmonizimit kombëtar**. Ky model siguron që decentralizimi të mos shihet si një fragmentim i sistemit, por si një pasurim i tij.

Bashkitë gëzojnë lirinë dhe elasticitetin për të përshtatur shërbimet (si infrastruktura, dietat ushqimore, apo mjediset rekreative) sipas nevojave specifike të komunitetit vendor, por gjithmonë brenda një "shiriti sanitar" standardesh të pakontestueshme që garantojnë sigurinë dhe zhvillimin njohës të fëmijës. Ky bashkëveprim garanton që pavarësisht nëse një fëmijë ndjek kopshtin në një metropol apo në një bashki të vogël, cilësia e arsimimit të jetë e garantuar dhe e mbrojtur nga institucionet shtetërore.

Në këtë mënyrë, decentralizimi shndërrohet në një histori suksesi, ku llogaridhënia vendore e bashkisë dhe ekspertiza teknike e institucioneve mbështetëse bashkohen për të siguruar mbrojtjen e interesit më të lartë: zhvillimin integral të fëmijës.

4.Marrëdhëniet ndërinstitucionale

Decentralizimi i arsimit parashkollor ka krijuar një ekosistem të ri bashkëpunimi ndërmjet institucioneve vendore dhe atyre qendrore, ku bashkërendimi është thelbësor për funksionimin e sistemit. Bashkia, si autoriteti përgjegjës për administrimin e kopshteve dhe çerdheve, ka rol kryesor në menaxhimin administrativ dhe financiar, ndërsa institucionet arsimore dhe strukturat qendrore kujdesen për zbatimin e standardeve pedagogjike dhe harmonizimin e politikave kombëtare.

Aktorët kryesorë dhe rolet e tyre:

- Bashkia: Menaxhon infrastrukturën, buxhetin, personelin dhe rregulloret vendore.
- Drejtoria e Arsimit në Bashki: Bashkërendon shërbimet e arsimit parashkollor, monitoron cilësinë dhe siguron zbatimin e standardeve.
- DRAP/ZVA-të (Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar): Sigurojnë lidhjen mes politikave kombëtare dhe zbatimit vendor, ofrojnë mbështetje teknike dhe monitorim pedagogjik.
- MAS-i (Ministria e Arsimit): Harton politikat kombëtare, strategjitë afatgjata dhe standardet e cilësisë.
- ASCAP-i (Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin Parauniversitar): Ofron instrumente për vlerësimin e cilësisë dhe udhëzime për përmirësim.

Modelet e bashkëpunimit të suksesshëm përfshijnë:

- **Takime periodike për planifikim:** Për të harmonizuar objektivat kombëtare me nevojat vendore dhe për të trajtuar sfidat praktike. Takimet e rregullta ndërmjet bashkive, DRAP/ZVA-ve, drejtorive të kopshteve dhe përfaqësuesve të MAS-it janë një mekanizëm thelbësor për harmonizimin e objektivave kombëtare me nevojat vendore. Këto takime shërbejnë për të diskutuar prioritetet, për të trajtuar sfidat praktike dhe për të përcaktuar masat konkrete për përmirësimin e shërbimit. Për shembull, gjatë këtyre takimeve mund të vendosen objektiva për zgjerimin e rrjetit të kopshteve, përmirësimin e kushteve infrastrukturore ose trajnimin e stafit. Takimet e planifikuara krijojnë një kulturë bashkëpunimi dhe transparence, duke siguruar që vendimmarrja të jetë e bazuar në të dhëna dhe konsultime.

- **Mekanizma raportimi dhe monitorimi:** Sisteme digjitale dhe raporte të rregullta për cilësinë e shërbimit, përdorimin e fondeve dhe përputhshmërinë me standardet. Raportimi i rregullt dhe monitorimi i vazhdueshëm janë elementë kyç për të garantuar cilësinë e shërbimeve të arsimit parashkollor. Bashkitë, në bashkëpunim me DRAP/ZVA-të dhe ASCAP-in, duhet të përdorin sisteme digjitale për menaxhimin e të dhënave, të cilat mundësojnë gjurmimin e treguesve si numri i fëmijëve të regjistruar, cilësia e infrastrukturës, përputhshmëria me standardet kombëtare dhe përdorimi i fondeve. Raportet periodike jo vetëm që rritin transparencën, por edhe ndihmojnë në identifikimin e mangësive dhe marrjen e masave korrigjuese në kohë. Një mekanizëm i mirë raportimi përfshin edhe publikimin e rezultateve për komunitetin, duke forcuar llogaridhënien.
- **Angazhimin e prindërve dhe komunitetit:** Përmes këshillave të prindërve, konsultimeve publike dhe projekteve gjithëpërfshirëse që rritin transparencën dhe pjesëmarrjen. Pjesëmarrja e prindërve dhe komunitetit është një element i domosdoshëm për të siguruar gjithëpërfshirje dhe cilësi. Bashkitë mund të krijojnë këshilla të prindërve pranë kopshteve, të organizojnë konsultime publike për politikat vendore dhe të nxisin projekte komunitare që mbështesin zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Për shembull, përfshirja e prindërve në vendimmarrje për menynë ushqimore, aktivitetet arsimore ose projektet e përmirësimit të mjedisit të kopshtit rrit ndjesinë e pronësisë dhe besimin tek shërbimi. Ky angazhim krijon një rrjet mbështetës që kontribuon në zhvillimin e fëmijëve dhe në forcimin e lidhjes mes institucionit dhe familjes.

Ky bashkëpunim ndërinstitucional është i domosdoshëm për të siguruar që decentralizimi të mos krijojë mangësi në cilësinë e shërbimit, por të sjellë përfitime reale për fëmijët dhe familjet. Për të qenë efektiv, ai duhet të mbështetet në protokolle të qarta komunikimi, instrumente digjitale për menaxhim të të dhënave dhe mekanizma llogaridhënieje.

5. Komponentët kryesorë të administrimit të shërbimit:

5.1 Planifikimi

Planifikimi është hapi i parë dhe më i rëndësishëm në administrimin e arsimit parashkollor. Ai përfshin:

- Analizën e nevojave vendore (numri i fëmijëve, gjendja e infrastrukturës, kërkesa për staf).
- Hartimin e planeve afatmesme dhe afatgjata për zgjerimin e rrjetit të kopshteve.
- Integrimin e objektivave kombëtare në strategjitë vendore. Shembull praktik: Bashkia mund të hartojë një plan 3-vjeçar për hapjen e kopshteve të reja në zonat rurale ku ka mungesë shërbimesh.

5.2 Financimi

Sigurimi i burimeve financiare dhe alokimi i fondeve është detyrë kyçe e bashkive. Ligji nr. 68/2017 “Për financat vendore” u jep bashkive autonomi buxhetore, por kërkon transparencë dhe llogaridhënie. Financimi përfshin:

- Hartimin e buxheteve vjetore për arsimin parashkollor.
- Përdorimin e fondeve për rikonstruksion, pajisje didaktike dhe pagesën e stafit.

- Identifikimin e burimeve shtesë (donacione, projekte të partnerëve). Shembull: Bashkia mund të aplikojë për fonde nga programet e BE-së për përmirësimin e infrastrukturës së kopshteve.

5.3 Organizimi

Organizimi lidhet me menaxhimin e stafit dhe shërbimeve. Bashkitë duhet të:

- Sigurojnë rekrutimin e personelit të kualifikuar.
- Trajnojnë stafin për metodologjitë bashkëkohore dhe gjithëpërfshirëse.
- Menaxhojnë shërbimet mbështetëse si ushqimi, transporti dhe kujdesi shëndetësor. Shembull: Organizimi i trajnimeve për mësuesit ndihmës për hartimin e Planeve Edukative Individuale (PEI).

5.4 Kontrolli administrativ dhe menaxherial

Kontrolli është mekanizmi që siguron përputhshmërinë me kuadrin ligjor dhe standardet kombëtare. Ai përfshin:

- Monitorimin e cilësisë: Përdorimi i treguesve për vlerësimin e mjediseve, kurrikulës dhe performancës së stafit.
- Raportimin e rregullt: Bashkitë duhet të raportojnë tek MAS-i dhe ASCAP-i për gjendjen e shërbimeve.
- Auditimin e fondeve: Sigurimi i transparencës në përdorimin e buxheteve.
- Inspektimet periodike: Vizita në terren për të verifikuar përputhshmërinë me standardet higjieno-sanitare dhe pedagogjike.

5.5 Instrumentet e kontrollit përfshijnë:

- Sistemet digjitale për menaxhimin e të dhënave.
- Raportet e performancës.
- Mekanizmat e llogaridhënies ndaj komunitetit (publikimi i rezultateve).

6. Instrumentet e administrimit

Për menaxhimin efektiv të arsimit parashkollor, bashkitë nuk mjaftohen vetëm me funksionet ligjore, por duhet të përdorin një sërë instrumentesh që sigurojnë planifikim strategjik, monitorim të vazhdueshëm dhe transparencë. Këto instrumente janë thelbësore për të garantuar cilësinë e shërbimeve dhe për të përmbushur objektivat kombëtare dhe vendore.

Instrumentet kryesore përfshijnë:

6.1 Planifikimin Buxhetor Afatmesëm (PBA)

Ky instrument është bazë për integrimin e objektivave arsimore në politikat vendore. PBA-ja lejon bashkitë të hartojnë plane 3-5 vjeçare që përfshijnë:

- Zgjerimin e rrjetit të kopshteve.
- Investimet në infrastrukturë.
- Trajnimin e stafit dhe përmirësimin e cilësisë. Shembull: Bashkia mund të parashikojë hapjen e 3 kopshteve të reja në zonat rurale brenda 5 viteve, duke alokuar fonde në buxhetin afatmesëm.

6.2 Rregulloret vendore

Rregulloret vendore përshtatin standardet kombëtare me realitetin vendor. Ato përfshijnë:

- Normat për numrin e fëmijëve për grup.

- Procedurat për regjistrimin e fëmijëve.
- Rregullat për sigurinë dhe higjienën. Shembull: Bashkia mund të hartojë një rregullore që përcakton kritere për përzgjedhjen e stafit dhe standardet për menynë ushqimore.

6.3 Sistemet e monitorimit dhe raportimi

Monitorimi i vazhdueshëm është thelbësor për vlerësimin e cilësisë dhe përputhshmërisë me standardet. Bashkitë duhet të:

- Përdorin tregues për cilësinë e shërbimit (p.sh., raporti fëmijë-mësues, gjendja e infrastrukturës).
- Hartojnë raporte periodike për MAS-in dhe ASCAP-in. Shembull: Një sistem raportimi online mund të gjurmojë numrin e fëmijëve të regjistruar dhe gjendjen e kopshteve në kohë reale.

6.4 Instrumentet digjitale për menaxhimin e të dhënave

Transformimi digjital është një domosdoshmëri për menaxhim efikas. Bashkitë mund të përdorin:

- Platforma për regjistrimin e fëmijëve.
- Sisteme për menaxhimin e buxhetit dhe fondeve.
- Aplikacione për komunikim me prindërit. Shembull: Një portal digjital mund të lehtësojë regjistrimin online dhe të sigurojë transparencë për prindërit.

6.5 Planet Strategjike për Përmirësimin e Shërbimit

Planet strategjike përcaktojnë vizionin afatgjatë për arsimin parashkollor. Ato duhet të përfshijnë:

- Objektiva për gjithëpërfshirje.
- Masa për përmirësimin e cilësisë.
- Strategji për bashkëpunim me partnerët dhe komunitetin. Shembull: Një plan strategjik mund të synojë rritjen e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara me 20% brenda 3 viteve.

7. Planifikimi, buxhetimi dhe alokimi i fondeve

Menaxhimi financiar është një nga funksionet më kritike të bashkive në administrimin e arsimit parashkollor. Ligji nr. 68/2017 “Për financat vendore” u jep bashkive **autonomi buxhetore**, duke i lejuar të hartojnë, menaxhojnë dhe alokojnë fondet sipas prioriteteve vendore. Megjithatë, kjo autonomi shoqërohet me detyrimin për transparencë, llogaridhënie dhe përputhshmëri me politikat kombëtare.

7.1 Burimet kryesore të financimit për arsimin parashkollor janë:

- **Buxheti i shtetit**: Transfertat nga qeveria qendrore për funksionet e deleguara dhe mbështetje për investime kapitale.
- **Taksat vendore**: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore, të cilat bashkia mund t’i përdorë për shërbimet arsimore.
- **Donacionet dhe fondet e partnerëve**: Mbështetje nga organizata ndërkombëtare, projekte të BE-së, fondacione dhe sektori privat për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë.

7.2 Procesi i planifikimit dhe buxhetimit

Planifikimi financiar nuk është thjesht një procedurë teknike, por një proces strategjik që siguron që fondet të përdoren në mënyrë efikase dhe të orientuara drejt objektivave. Ai përfshin:

- **Analizën e nevojave:** Vlerësimi i gjendjes së infrastrukturës, numrit të fëmijëve, kërkesës për staf dhe shërbime mbështetëse.
- **Hartimin e buxhetit vjetor:** Përfshirja e shpenzimeve për rikonstruksion, pajisje didaktike, ushqim dhe pagesën e personelit.
- **Integrimin në PBA (Planifikimin Buxhetor Afatmesëm):** Parashikimi i investimeve për 3-5 vitet e ardhshme, duke siguruar që objektivat strategjike të jenë të mbuluara financiarisht.

7.3 Alokimi i fondeve

Alokimi i fondeve duhet të bazohet në parimin e **efikasitetit dhe barazisë**, duke prioritetizuar:

- Zonat me mungesë shërbimesh (rurale, periferike).
- Përmirësimin e kushteve higjieno-sanitare dhe sigurisë.
- Trajnimin e stafit dhe përmirësimin e cilësisë pedagogjike. Shembull praktik: Nëse një bashki ka një buxhet prej 50 milion lekësh për arsimin parashkollor, ajo mund të ndajë 60% për rikonstruksionin e kopshteve, 25% për pajisje didaktike dhe 15% për trajnimin e stafit.

7.4 Instrumentet e Transparencës

Për të garantuar llogaridhënie, bashkitë duhet të:

- Publikojnë buxhetet dhe raportet e shpenzimeve.
- Përdorin sisteme digjitale për gjurmimin e fondeve.
- Organizojnë konsultime publike për prioritetet e investimeve.

8. Sfida dhe mundësi

Decentralizimi sjell mundësi për përshtatjen e shërbimeve sipas nevojave vendore dhe rritjen e cilësisë, por kërkon kapacitete të forta administrative, ekspertizë profesionale dhe menaxhim efikas të burimeve.

8.1 Portali “Mësues për Shqipërinë” dhe Arsimi Parashkollor

Portali “Mësues për Shqipërinë” është një instrument digjital i rëndësishëm për menaxhimin e burimeve njerëzore në sistemin arsimor parauniversitar, përfshirë arsimin parashkollor. Përmes këtij portali, bashkitë dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar mund të identifikojnë dhe emërojnë mësues ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta, duke garantuar gjithëpërfshirje dhe mbështetje individuale. Ky mekanizëm digjital lehtëson procesin e rekrutimit transparent dhe të bazuar në meritë, si dhe siguron që institucionet parashkollore të kenë staf të kualifikuar për zbatimin e planeve arsimore/edukative individuale. Për më tepër, portali shërben si një bazë të dhënash për kualifikimet e mësuesve, duke ndihmuar bashkitë të planifikojnë nevojat për trajnim dhe zhvillim profesional.

8. 2 Strategjia e digjitalizimit në Arsimin Parashkollor

Digjitalizimi është një nga prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, e cila synon modernizimin e shërbimeve arsimore dhe rritjen e efikasitetit administrativ. Në kontekstin e arsimit parashkollor, kjo strategji përfshin përdorimin e platformave digjitale për regjistrimin e fëmijëve, menaxhimin e të dhënave, monitorimin e cilësisë dhe komunikimin me prindërit. Bashkitë po aplikojnë sisteme elektronike për raportimin e treguesve të shërbimit, si numri i fëmijëve të regjistruar, gjendja e infrastrukturës dhe përputhshmëria me standardet kombëtare. Digjitalizimi mundëson transparencë, redukton burokracinë dhe krijon një mjedis më të sigurt për menaxhimin e informacionit. Për më tepër, përdorimi i mjeteve digjitale në procesin arsimor/edukativ, si aplikacionet ndërvepruese për zhvillimin e hershëm, është një hap drejt përgatitjes së fëmijëve për kompetencat e shekullit XXI.

8.3 Shkolla e Drejtorëve dhe lidershipi në Arsimin Parashkollor

Shkolla e Drejtorëve, si program kombëtar për zhvillimin e kapaciteteve drejtuese, ka një rol të rëndësishëm edhe për drejtuesit e institucioneve parashkollore. Ky program synon të forcojë aftësitë menaxheriale, planifikimin strategjik dhe llogaridhënien e drejtuesve të kopshteve, duke i pajisur ata me njohuri mbi menaxhimin financiar, përdorimin e instrumenteve digjitale dhe zbatimin e standardeve pedagogjike. Për arsimin parashkollor, lidershipi efektiv është kritik për sigurimin e cilësisë së shërbimit, gjithëpërfshirjes dhe përmbushjes së objektivave të zhvillimit të hershëm. Drejtuesit e trajnuar përmes Shkollës së Drejtorëve janë më të aftë të bashkërendojnë me bashkitë, ZVA-të dhe prindërit.

Sesioni 1.2 Menaxhimi i proceseve të shërbimit: Prioritete, plani afatmesëm i shërbimit të arsimit parashkollor, monitorimi dhe përmirësim i shërbimit

Objektivi:

Të zhvillohen njohuritë dhe aftësitë profesionale të pjesëmarrësve për menaxhimin efektiv të arsimit parashkollor në nivel vendor, duke përfshirë planifikimin, buxhetimin, organizimin institucional dhe sigurimin e cilësisë së shërbimeve. Moduli synon që pjesëmarrësit të jenë në gjendje të:

- Përcaktojnë dhe zbatojnë prioritetet për përmirësimin e shërbimit;
- Hartojnë objektiva të matshme dhe plane veprimi afatmesme;
- Monitorojnë dhe raportojnë me efektivitet zbatimin e PASH-it;
- Sigurojnë pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe cilësi në çdo aspekt të ofrimit të shërbimit.

Tematika:

1. Proceset e menaxhimit të shërbimit në arsimin parashkollor – nga planifikimi te zbatimi i PASH-it.
2. Caktimi i prioriteteve të shërbimit – identifikimi, përzgjedhja dhe klasifikimi sipas rëndësisë.
3. Hartimi i objektivave afatmesme – formulimi i qëllimeve të matshme, progresive dhe gjithëpërfshirëse.
4. Planifikimi i veprimtarive – lidhja midis objektivave, aktiviteteve dhe rezultateve të pritshme.
5. Përdorimi i instrumenteve menaxheriale
6. Përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe motivimi i stafit – nxitja e bashkëpunimit, reflektimit dhe inovacionit në procesin arsimor.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantimi në PowerPoint (Shtojca nr. 1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- ***Instrumente të përgatitura nga BtF-ja (Shtojca nr. 2)***

Instrumentet janë përzgjedhur për të nxitur diskutim të strukturuar mbi gjendjen e decentralizimit të arsimit parashkollor. Ato synojnë të lidhin përmbajtjen teorike të modulit me përvojat praktike të bashkive, duke identifikuar sfidat, praktikat e mira dhe mundësitë për përmirësim. Përmes tyre pjesëmarrësit reflektojnë mbi rolin e bashkive në administrim, financim, organizim dhe rregullim të shërbimit.

- **Përmbledhje e legjislacionit (Shtojca nr. 3)**

Hartimi i një përmbledhjeje të legjislacionit është i domosdoshëm për të siguruar qartësi dhe qasje të lehtë në rregullat që përcaktojnë funksionimin e institucioneve arsimore. Aktet si VKM 662/2014, Udhëzimi nr.25/2018 dhe Urdhri nr.31/2020 përmbajnë dispozita të rëndësishme mbi rolin e bordit të institucionit, këshillit të prindërve, etikën, raportin vjetor dhe komisionet e sigurisë. Përmbledhja e tyre ndihmon drejtuesit, stafin dhe aktorët vendorë të kuptojnë detyrimet ligjore dhe të zbatojnë praktikat e kërkuara në mënyrë të unifikuar.
Ky dokument synon të shërbejë si referencë praktike për menaxhimin e shkollave dhe kopshteve, duke përfshirë drejtuesit e institucioneve, bordet, prindërit dhe komisionet e dedikuara, për të garantuar transparencë, siguri dhe cilësi në shërbimin arsimor.

Mesazhet kyç të sesionit:

- **Menaxhimi efektiv i arsimit parashkollor kërkon identifikimin dhe kategorizimin sistematik të të gjitha proceseve** – duke dalluar proceset menaxheriale, thelbësore dhe mbështetëse për të siguruar funksionim të qartë dhe efikas.
- **Përmirësimi i vazhdueshëm operacional dhe menaxhimi strategjik** duhet të jenë pjesë e kulturës së bashkisë, duke garantuar cilësi, gjithëpërfshirje dhe mbrojtje për çdo fëmijë në institucionet parashkollore.
- **Hartëzimi i rrjedhave të punës dhe përcaktimi i roleve të qarta** (Komiteti i Proceseve, Pronari, Menaxheri dhe Ekipet) është thelbësor për mbikëqyrje, zbatim dhe përgjegjësi të dallueshme në çdo fazë të shërbimit

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Instrumente të pergatitura nga BtF-ja
- Materiale të prezantimit në PowerPoint
- Dokumenti teorik i sesionit “Menaxhimi i proceseve të shërbimit: prioritetet; plani afatmesëm i shërbimit të arsimit parashkollor; monitorimi dhe përmirësim i shërbimit”
- Përmbledhje e legjislacionit me fokus: (bordi i institucionit dhe këshilli i prindërve) (VKM 662, datë 8.10.2014), bordi i institucionit arsimor (Udhëzimi nr.25, datë.25.07.2018), Etika dhe Sjellja në Institucionin Arsimor (Urdhri 31/2020), duke hartimi i Raportit Vjetor të IA-së (Urdhri 31/2020); Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit (Urdhri 31/2020).

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar.
- Udhëzimet e MAS-it për planifikimin strategjik dhe buxhetimin afatmesëm (PBA) për arsimin parashkollor.

- Rregulloret e ASCAP-it për monitorimin e cilësisë dhe vetëvlerësimin institucional.
- Raporti Vjetor i Institucionit Arsimor (Urdhri nr. 31/2020).
- Komisionet e Sigurisë dhe Etikës.

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahen *(Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra,)*

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Zbatimi i funksioneve të bashkive në fushën e arsimit parauniversitar mbështetet në një kuadër të gjerë kushtetues, ligjor dhe politik, i cili përcakton të drejtat, detyrimet dhe kompetencat e institucioneve publike për garantimin e të drejtës për arsim. Bazën më të lartë ligjore e përbën Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ku në nenin 57, pika 1, sanksionohet e drejta për arsim për të gjithë qytetarët. Kjo e drejtë konkretizohet më tej përmes Ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar me Ligjin nr. 48/2018, i cili përcakton strukturën dhe funksionimin e arsimit në të gjitha nivelet, duke përfshirë arsimin parashkollor, bazë, të mesëm të përgjithshëm dhe profesional. Ky ligj rregullon gjithashtu standardet e cilësisë, përfshirjes, vlerësimit dhe menaxhimit të institucioneve arsimore. Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” u njeh bashkive kompetenca të plota për ndërtimin, mirëmbajtjen dhe funksionimin e çerdheve dhe kopshteve publike, si dhe role mbështetëse në arsimin bazë dhe të mesëm, përmes sigurimit të infrastrukturës, përfshirjes sociale dhe bashkërendimit me institucionet qendrore. Këto funksione financohen dhe mbështeten në përputhje me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, dhe Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor”, të cilët përcaktojnë rregullat e menaxhimit financiar në nivel vendor. Po ashtu, Ligji nr. 9632/2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, shërben si mjet për mobilizimin e të ardhurave që bashkia mund të përdorë për të mbështetur sektorin e arsimit. Në nivel zbatimi, funksionimi i institucioneve arsimore rregullohet nga një sërë aktesh nënligjore. Ndër më të rëndësishmet është Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, që miraton rregulloren e përgjithshme për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare, si dhe Udhëzimi nr. 14, datë 10.07.2023, që përcakton normat për numrin e nxënësve në klasë dhe ngarkesën mësimore për mësuesit. Po ashtu, udhëzimi i përbashkët MAS-MEKI nr. 13, datë 10.07.2024, specifikon organizimin e vitit shkollor 2024–2025, ndërsa Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton ngritjen dhe funksionimin e bordeve të institucioneve arsimore, si mekanizma pjesëmarrjeje dhe monitorimi. Një dokument me rëndësi për cilësinë e arsimit parashkollor është edhe Urdhri nr. 199, datë 07.05.2024, që miraton Kornizën e Vlerësimit të cilësisë së kopshteve.

Në përputhje me parimet e gjithëpërfshirjes dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, bashkitë udhëhiqen gjithashtu nga Ligji nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” dhe Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, të cilët kërkojnë ndërhyrje të bashkërenduara për mbështetjen e fëmijëve në nevojë dhe parandalimin e përjashtimit social.

Në këtë drejtim, udhëzime specifike si Udhëzimi nr. 21, datë 08.08.2014, për rritjen e frekuentimit të arsimit nga fëmijët romë, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021–2025, përbëjnë udhërrëfyes për politikat vendore në territorin e Bashkisë Klos. Një fushë me rëndësi të veçantë është edhe ofrimi i shërbimit psiko-social në kopshte, i cili rregullohet me Urdhrin nr. 313, datë 20.10.2020, si dhe me udhëzuesin për praktikën e punës së shërbimit psiko-social shkollor, të hartuar për stafet e bashkive dhe të zyrave vendore arsimore.

Politikat Kombëtare dhe Kuadri Ligjor për Arsimin Parashkollor në Shqipëri
Arsimi parashkollor në Shqipëri është i rregulluar nga një kuadër ligjor dhe politikash që synojnë të garantojnë qasje, cilësi dhe gjithëpërfshirje për fëmijët e moshës 3–6 vjeç. Ligji nr. 69/2012 për Sistemin Arsimor Parauniversitar vendos bazat e funksionimit të këtij niveli arsimor, duke përcaktuar parimet e decentralizimit, autonomisë institucionale dhe vlerësimit të dyfishtë – të brendshëm dhe të jashtëm. Ky ligj garanton të drejtën për arsim cilësor për të gjithë fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe nga familje në nevojë, duke e konsideruar arsimin parashkollor si një hallkë themelore për zhvillimin e hershëm.

Në vijim, Rregullorja nr. 31/2020 detajon procedurat operative për institucionet parashkollore, duke përfshirë regjistrimin e fëmijëve, organizimin e grupmoshave, hartimin e planeve vjetore mësimore dhe përfshirjen e prindërve në procesin e planifikimit. Ajo përcakton standardet e kurrikulës, vlerësimin e punës së mësuesve dhe fëmijëve, si dhe shërbimet psiko-sociale dhe masat e sigurisë brenda institucioneve.

Një element i rëndësishëm i përditësimit është Kurrikula e re e Arsimit Parauniversitar (2024), e cila sjell një qasje moderne dhe kompetencë-bazuar. Ajo fokusohet në zhvillimin e aftësive digjitale, përfshirjen e lëndëve STEM, edukimin mediatik dhe kulturor, si dhe forcimin e identitetit kombëtar. Për arsimin parashkollor, kjo kurrikulë harmonizon standardet dhe programet për grupmoshat 3–6 vjeç, duke siguruar që fëmijët të marrin një përvojë mësimore të pasur dhe të përshtatur me nevojat e kohës.

Ky kuadër ligjor dhe politik përbën bazën mbi të cilën ndërtohet çdo plan afatmesëm për shërbimin e arsimit parashkollor, duke garantuar që strategjitë e zhvillimit, monitorimit dhe përmirësimit të jenë në përputhje me standardet kombëtare dhe praktikat më të mira.

1. Proceset e menaxhimit: Nga planifikimi te zbatimi i PASH-it (Plani Afatmesëm i Shërbimit)
Menaxhimi i shërbimit parashkollor nuk duhet parë si një veprim statik, por si një cikël jetësor organik. Ky proces nis me analizën e nevojave (vlerësimi i kërkesës demografike dhe gjendjes së infrastrukturës) dhe kulmon me zbatimin e PASH-it.

- Planifikimi: Kërkon integrimin e burimeve financiare me nevojat pedagogjike.

- Zbatimi: Kalimi nga dokumenti strategjik në veprime operacionale, ku bashkia harmonizon punën e personelit arsimor, furnitorëve të shërbimeve (ushqim, mirëmbajtje) dhe strukturave monitoruese. PASH-i shërben si "busulla" që garanton që çdo investim i kryer sot, i shërben vizionit të bashkisë për 3-5 vitet e ardhshme.

2. Caktimi i prioriteteve të shërbimit – identifikimi, përzgjedhja dhe klasifikimi sipas rëndësisë. Procesi i caktimit të prioriteteve të shërbimit në kuadër të Planit Afatmesëm të Shërbimit të Arsimit Parashkollor (PASH) është themelor për orientimin efektiv të burimeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve. Ky proces përfshin tri faza kryesore:

3. Identifikimi i nevojave
Në fillim, është e domosdoshme të kuptohen mirë konteksti, sfidat dhe nevojat në nivel vendor. Kjo bazohet mbi:

- Të dhënat statistikore, si raportet së regjistrimit, përqindja e pjesëmarrjes së fëmijëve
- Analizën SWOT në nivel institucional – që ndihmon në identifikimin e pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve në çdo qendër të arsimit parashkollor.

4. Përzgjedhja e fushave kritike
Për të shmangur shpërndarje të burimeve, është vendimtare të përzgjidhen fushat me ndikim më të madh në cilësinë e shërbimit. Bazuar në analizë, mund të identifikohen çështje si:

- Rritja e qasjes në zonat rurale.
- Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kurrikulës.
- Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta dhe nga komunitete të cenueshme.

5. Klasifikimi sipas rëndësisë
Pasi përzgjidhen fushat kritike, ato renditen në bazë të:

- Ndikimit të mundshëm, si numri i fëmijëve që përfitojnë.
- Disponueshmërisë së burimeve, njerëzore dhe financiare.
- Efektive e brendshme, pas vlerësimit të proceseve dhe kapaciteteve.

6. Hartimi i objektivave afatmesme: Formula e suksesit (SMART & Progressive)
Hartimi i objektivave afatmesme është një hap kyç në procesin e menaxhimit strategjik të shërbimit parashkollor, pasi përkthen vizionin dhe prioritetet e identifikuara në rezultate konkrete dhe të matshme. Objektivat afatmesme zakonisht shtrihen në një periudhë 2–3 vjeçare dhe duhet të jenë të qarta, të realizueshme dhe të lidhura ngushtë me nevojat e fëmijëve, stafit dhe komunitetit.

Për të qenë efektive, objektivat duhet të formulohen sipas parimit SMART+I: specifike, të matshme, të arritshme, përkatëse, të kufizuara në kohë dhe gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë se çdo objektiv duhet të përshkruajë qartë çfarë do të arrihet, për kë, ku dhe kur, duke pasur tregues të qartë për matjen e progresit. Për shembull, një objektiv mund

të jetë: “Brenda dy viteve, të rritet përfshirja e fëmijëve 3–6 vjeç në kopshte publike nga 62% në 72%, duke ulur hendekun urban–rural me të paktën 5 pikë përqindjeje.”
Një element i rëndësishëm është progresiviteti, që nënkupton përmirësim gradual dhe të qëndrueshëm. Objektivat duhet të parashikojnë faza të qarta: fillimisht pilotimi, më pas shkallëzimi dhe në fund konsolidimi i praktikave. Kjo qasje lejon adaptim sipas të dhënave dhe reflektim mbi rezultatet.
Po aq e rëndësishme është gjithëpërfshirja. Objektivat nuk duhet të fokusohen vetëm tek rritja e numrave, por edhe tek barazia e qasjes dhe cilësisë për të gjithë fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara dhe nga grupet e cenueshme. Kjo kërkon tregues ndarës (p.sh., urban/rural, vajza/djem, me/pa aftësi të kufizuara) dhe masa mbështetëse si asistencë arsimore, mjedise të aksesueshme dhe materiale universale për të nxënë.
Procesi i hartimit të objektivave përfshin disa hapa praktikë: analizën e situatës dhe vendosjen e bazës (baseline), përcaktimin e rezultateve të dëshiruara, zgjedhjen e treguesve dhe burimeve të të dhënave, vendosjen e synimeve dhe afateve, si dhe planifikimin e ndërhyrjeve kyç. Çdo objektiv duhet të shoqërohet me përgjegjësitë, burimet e nevojshme dhe mekanizmat e monitorimit për të siguruar matshmërinë dhe realizueshmërinë.
Në fund, objektivat e formuluara mirë jo vetëm që orientojnë punën e institucioneve të arsimit parashkollor, por krijojnë bazën për një shërbim cilësor, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm, duke kontribuar drejtpërdrejt në zhvillimin e hershëm të fëmijëve.
Objektivat afatmesme duhet të tejkalojnë dëshirat politike dhe të shndërrohen në tregues teknikë.

- Të matshme: P.sh., "Rritja e numrit të regjistrimeve me 15% brenda 3 viteve".
- Progresive: Objektivat duhet të ndërtohen mbi njëri-tjetrin (p.sh. viti 1: trajnim i stafit; viti 2: pilotim i teknologjisë; viti 3: digjitalizim i plotë).
- Gjithëpërfshirëse: Sigurimi që objektivat të mbulojnë edhe fëmijët me nevoja të veçanta, duke mos lënë asnjë grup social jashtë vëmendjes së bashkisë.

7. Planifikimi i veprimtarive: Lidhja logjike Objektiv-Aktivitet-Rezultat
Planifikimi i veprimtarive është një element thelbësor i menaxhimit strategjik në arsimin parashkollor, pasi siguron që çdo ndërhyrje të jetë e lidhur drejtpërdrejt me objektivat e përcaktuara dhe rezultatet e pritshme. Ky proces nuk është thjesht një listë aktivitetesh, por një strukturë logjike që garanton koherencë dhe efektivitet.
Në qendër të këtij planifikimi qëndron **lidhja Objektiv–Aktivitet–Rezultat**. Çdo objektiv i hartuar në PASH duhet të përkthehet në veprimtari konkrete që kontribuojnë në arritjen e tij. Për shembull, nëse objektivi është “Rritja e cilësisë së mësimdhënies përmes metodave me bazë lojën”, aktivitetet mund të përfshijnë organizimin e trajnimeve për edukatorët, krijimin e materialeve didaktike dhe mentorimin e vazhdueshëm. Rezultati i pritshëm do të jetë rritja e përqindjes së edukatorëve që zbatojnë metoda me bazë lojën dhe përmirësimi i përvojës së fëmijëve në mësim.
Ky proces kërkon **përcaktimin e treguesve** për çdo rezultat, në mënyrë që progresi të matet dhe të raportohet. Për shembull, treguesit mund të jenë numri i edukatorëve të trajnuar, cilësia e planeve mësimore, ose vlerësimi i prindërve për përmirësimin e shërbimit. Kjo lidhje logjike siguron që burimet të përdoren në mënyrë efikase dhe që çdo aktivitet të ketë një ndikim të qartë në përmbushjen e objektivave.

Një tjetër aspekt i rëndësishëm është **koherenca kohore dhe financiare**. Aktivitetet duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që të jenë të realizueshme brenda afateve të përcaktuara dhe me burimet e disponueshme. Për këtë arsye, përdorimi i një **matrice logjike** është praktikë e rekomanduar: ajo lidh objektivat, aktivitetet, rezultatet, treguesit, burimet dhe përgjegjësit në një strukturë të qartë.
Në fund, planifikimi i veprimtarive nuk është statik. Ai duhet të jetë elastik dhe i hapur për rishikim, bazuar në të dhënat e monitorimit dhe feedback-un nga stafi, prindërit dhe komuniteti. Vetëm kështu sigurohet që PASH-i të jetë një dokument i gjallë, që përshtatet me realitetin dhe garanton përmirësim të vazhdueshëm të shërbimit parashkollor.

Kjo tematikë bazohet në Modelin e Logjikës (Logic Model). Çdo aktivitet i planifikuar nga bashkia duhet të ketë një "pse" të qartë:

- Objektivi: Përmirësimi i ushqyerjes.
- Aktiviteti: Kontraktimi i fermave vendore dhe hartimi i menyve nga nutricionistët.
- Rezultati i pritshëm: Reduktimi i mungesave për arsye shëndetësore dhe rritja e kënaqësisë së prindërve. Pa këtë lidhje zinxhir, aktivitetet mbeten thjesht shpenzime buxhetore pa ndikim real në cilësinë e jetës së fëmijës.

8. Përdorimi i instrumenteve menaxheriale
Përdorimi i instrumenteve menaxheriale është një komponent thelbësor për realizimin e një Plani Afatmesëm të Shërbimit (PASH) efektiv dhe të matshëm. Instrumentet menaxheriale nuk janë thjesht mjete teknike, por mekanizma që sigurojnë strukturë, transparencë dhe llogaridhënie në procesin e menaxhimit të arsimit parashkollor. Ato ndihmojnë në analizën e situatës, planifikimin e aktiviteteve, monitorimin e progresit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit.
Një nga instrumentet më të përdorura është analiza SWOT, e cila identifikon pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe kërcënimet e shërbimit të arsimit parashkollor. Kjo analizë është baza për vendimmarrje strategjike, pasi orienton prioritetet dhe ndihmon në parashikimin e sfidave. Për shembull, një pikë e dobët mund të jetë mungesa e edukatorëve të trajnuar, ndërsa një mundësi mund të jetë mbështetja nga partnerët vendorë për trajnime.
Një tjetër instrument i rëndësishëm është matrica logjike, e cila lidh objektivat me aktivitetet, rezultatet dhe treguesit. Kjo strukturë siguron që çdo veprim të ketë një qëllim të qartë dhe një rezultat të matshëm. Përmes matricës logjike, menaxherët mund të shohin qartë se si burimet e investuara kontribuojnë në arritjen e objektivave afatmesme.
Tabela e monitorimit është një instrument praktik për ndjekjen e progresit. Ajo përmban tregues të qartë, vlera bazë (baseline), synime dhe afate kohore. Kjo tabelë përdoret për raportim periodik dhe për të identifikuar devijimet nga plani, duke mundësuar marrjen e masave korrigjuese në kohë.
Përveç këtyre, përdorimi i raporteve periodike dhe platformave digjitale (si ASCAP-i) ndihmon në mbledhjen dhe analizimin e të dhënave në mënyrë sistematike. Këto mjete rrisin transparencën dhe lehtësojnë komunikimin mes institucioneve, bashkive dhe Ministrisë së Arsimit.

Në fund, instrumentet menaxheriale nuk janë vetëm mjete teknike, por edhe mjete për krijimin e kulturës së përmirësimit të vazhdueshëm. Ato nxisin reflektimin, bashkëpunimin dhe inovacionin, duke e bërë menaxhimin e shërbimit parashkollor më efikas, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt rezultateve.

Përdorimi i instrumenteve menaxheriale nuk kufizohet vetëm tek mjetet klasike si analiza SWOT apo tabelat e monitorimit. Menaxheri modern i arsimit parashkollor vepron me një gamë të gjerë instrumentesh që i mundësojnë menaxhim efikas, transparent dhe të orientuar drejt rezultateve. Këto instrumente përfshijnë mjete financiare, teknologjike dhe ligjore/rregullatore, të cilat krijojnë një ekosistem të integruar për menaxhimin e shërbimit.

Së pari, **instrumentet financiare** janë thelbësore për të siguruar përdorim racional të burimeve. Një praktikë e avancuar është **buxhetimi i bazuar në performancë**, ku fondet alokohen sipas rezultateve të arritura dhe jo thjesht sipas shpenzimeve të planifikuara. Kjo qasje rrit llogaridhënien dhe nxit institucionet të fokusohen tek cilësia e shërbimit dhe arritja e objektivave.

Së dyti, **instrumentet teknologjike** po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme. Sistemet e menaxhimit të informacionit (EMIS) mundësojnë ndjekjen e të dhënave kritike si frekuentimi i fëmijëve, moshat, nevojat dietike dhe tregues të tjerë që lidhen me mirëqenien dhe zhvillimin e hershëm. Këto sisteme jo vetëm që lehtësojnë raportimin dhe analizën, por edhe ndihmojnë në marrjen e vendimeve të bazuara në prova dhe të dhëna.

Së treti, **instrumentet ligjore dhe rregullatore** sigurojnë strukturë dhe qartësi në menaxhim. Kontratat e shërbimit me standarde strikte llogaridhënieje, si dhe rregulloret e brendshme të punës, përcaktojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilit aktor. Kjo qasje redukton konfliktet, rrit transparencën dhe garanton që shërbimi të ofrohet sipas standardeve kombëtare.

Në tërësi, përdorimi i këtyre instrumenteve e bën menaxhimin e arsimit parashkollor më profesional, më të qëndrueshëm dhe të orientuar drejt rezultateve. Menaxheri modern nuk është thjesht një administrator, por një lider që përdor mjetet financiare, teknologjike dhe ligjore për të krijuar një shërbim cilësor, gjithëpërfshirës dhe novator.

9. Përmirësimi i cilësisë dhe motivimi i stafit: Kultura e Inovacionit

Burimet njerëzore janë aseti më i çmuar në sistemin arsimor, veçanërisht në arsimin parashkollor, ku cilësia e shërbimit varet drejtpërdrejt nga përkushtimi dhe kompetencat e edukatorëve. Përmirësimi i cilësisë nuk mund të arrihet pa një strategji të qartë për motivimin e stafit dhe krijimin e një kulture inovacioni brenda institucioneve. Motivimi i stafit nuk është vetëm çështje financiare. Ai lidhet ngushtë me mirënjohjen profesionale, ofrimin e kushteve dinjitoze të punës dhe mundësinë për zhvillim profesional. Bashkitë dhe drejtuesit e institucioneve duhet të nxisin një sistem meritokracie, ku performanca e mirë shpërblehet dhe ku edukatorët ndihen të vlerësuar për kontributin e tyre. Njohja publike e arritjeve, mundësitë për trajnime dhe përfshirja në vendimmarrje janë elementë që rrisin motivimin dhe angazhimin.

Reflektimi dhe bashkëpunimi janë po aq të rëndësishme. Krijimi i komuniteteve të praktikës ku edukatorët ndajnë përvojat e tyre, diskutojnë sfidat dhe mësojnë nga njëri-tjetri, është një mekanizëm i fuqishëm për përmirësim të vazhdueshëm. Të nxënit mes kolegëve jo vetëm që rrit kapacitetet profesionale, por edhe krijon një kulturë bashkëpunimi dhe solidariteti mes stafit.

Inovacioni është themeli i një shërbimi cilësor dhe modern. Edukatorët duhet të inkurajohen të eksperimentojnë me metoda të reja didaktike, si mësimi përmes lojës në natyrë, përdorimi i artit digjital, apo integrimi i teknologjisë në aktivitetet e përditshme. Një element kritik i kulturës së inovacionit është normalizimi i gabimit si pjesë e procesit të të nxënit institucional. Gabimi nuk duhet parë si dështim, por si mundësi për reflektim dhe përmirësim. Kjo qasje krijon një mjedis ku stafi ndihet i sigurt për të provuar ide të reja pa frikën e penalizimit.
Në përfundim, përmirësimi i cilësisë dhe motivimi i stafit nuk janë procese të ndara, por pjesë e një strategjie të integruar që kombinon njohjen, bashkëpunimin dhe inovacionin. Vetëm përmes këtyre elementeve mund të ndërtojmë një kulturë institucionale që garanton shërbime parashkollore cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

Hartimi i PASH-it nuk është thjesht një detyrim ligjor por një instrument strategjik që garanton që decentralizimi të përkthehet në cilësi shërbimi për fëmijët. Sipas Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe Strategjisë Kombëtare të Arsimit 2021–2026, bashkitë kanë përgjegjësinë për të planifikuar shërbimet parashkollore në mënyrë të integruar dhe të qëndrueshme. Plani Afatmesëm të Shërbimit (PASH) është një proces strategjik që i lejon bashkitë të projektojnë zhvillimin e arsimit parashkollor për një periudhë zakonisht 3-vjeçare. Ky plan nuk është thjesht një listë dëshirash, por një dokument financiar dhe operacional që lidh nevojat e komunitetit me mundësitë buxhetore. Në një moment kur kërkesat për standarde të larta dhe digjitalizim janë rritur, rëndësia e PASH-it shfaqet në disa dimensione kritike:

10. Parashikueshmëria dhe Qëndrueshmëria Financiare
PASH-i shërben si urë lidhëse mes nevojave të kopshteve dhe Planit Afatmesëm Buxhetor (PAB) të bashkisë. Referencë: Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit për planifikimin buxhetor dhe standardet e shërbimit parashkollor (2021).
Pse është i rëndësishëm: Pa një plan 3-vjeçar, investimet do të ishin sporadike dhe të paorientuara. PASH-i siguron që fondet për ushqimin, pagat dhe mirëmbajtjen të jenë të garantuara dhe të mbrojtura nga luhatjet e papritura buxhetore.

11. Zhvillimi i Infrastrukturës sipas Prioriteteve
Në vend të ndërhyrjeve emergjente, PASH-i lejon një planifikim strategjik të godinave. Referencë: Standardet e infrastrukturës për arsimin parashkollor (MASR, 2022). Pse është i rëndësishëm: Ai mundëson që bashkia të parashikojë rritjen e popullsisë dhe të planifikojë ndërtimin e kopshteve të reja apo rikonstruksionin e atyre ekzistuesve përpara se të krijohet mbingarkesa.

12. Garantimi i Standardeve dhe Cilësisë
PASH-i vendos objektiva të qartë për performancën e shërbimit, jo vetëm në aspektin fizik, por edhe pedagogjik.
Referencë: Kurrikula Kombëtare për Arsimin Parashkollor (MASR, 2021). Pse është i rëndësishëm: Përmes tij planifikohen trajnimet e vazhdueshme të edukatorëve dhe pajisja me materiale didaktike bashkëkohore.

13. Përfshirja Sociale dhe Barazia

PASH-i detajon hapat konkretë për grupet e cenueshme dhe fëmijët me aftësi të kufizuara.

Referencë: Strategjia Kombëtare për Arsimin Gjithëpërfshirës (2021–2026). Pse është i rëndësishëm: Ai përcakton buxhete specifike për mësuesit ndihmës, rampat e qasjes dhe mjediset ndijore.

14. Llogaridhënia dhe Transparenca ndaj Komunitetit

PASH-i është një dokument publik që u tregon prindërve dhe taksapaguesve se ku do të shkojnë paratë e tyre. Referencë: Ligji nr. 139/2015 dhe udhëzimet për transparencën buxhetore. Pse është i rëndësishëm: Ai krijon një kontratë sociale midis bashkisë dhe prindërve, duke rritur besimin dhe monitorimin qytetar.

15. Përthithja e Investimeve të Huaja dhe Donacioneve

Donatorët ndërkombëtarë (BE, UNICEF, Banka Botërore) kërkojnë plane serioze përpara se të financojnë.

Referencë: Politikat e financimit të BE-së për arsimin parashkollor (IPA III, 2021–2027). Pse është i rëndësishëm: Një PASH i mirëhartuar rrit shanset për grante shtesë dhe partneritete strategjike.

Ja hapat kryesorë për hartimin e një PASH-i profesional

Faza 1: Analiza e Gjendjes Aktuale (Ku jemi?)

Përpara se të planifikoni, duhet të keni një pasqyrë të qartë të realitetit përmes:

- Vlerësimit të Infrastrukturës: Analiza teknike e ndërtesave (sa janë të rikonstruktuara, sa kanë nevojë për ndërhyrje emergjente).
- Analizës Demografike: Sa fëmijë të moshës 0–6 vjeç ka bashkia? Sa prej tyre janë të regjistruar? Sa është lista e pritjes?
- Burimeve Njerëzore: Raporti edukator/fëmijë dhe niveli i kualifikimit të stafit.
- Analizës SWOT: Identifikimi i Pikave të Forta, të Dobëta, Mundësive dhe Kërcënimeve (p.sh. emigrimi si kërcënim, ose grantet e huaja si mundësi).

Faza 2: Përcaktimi i Objektivave Strategjikë (Ku do të shkojmë?)

Objektivat duhet të jenë SMART (të matshme dhe të arritshme). Zakonisht ndahen në tri shtylla:

1. Qasja: P.sh., "Rritja e numrit të fëmijëve të regjistruar me 10% brenda 3 viteve".
2. Cilësia: P.sh., "Certifikimi i të gjithë edukatorëve me standardet e reja të kurrikulës brenda vitit 2026".
3. Infrastruktura: P.sh., "Ndërtimi i 2 kopshteve të reja dhe rikonstruksioni i 5 ekzistuesve".

Faza 3: Planifikimi i Veprimtarive dhe Shpenzimeve (Si do t'ia arrijmë?)

Këtu detajohet se çfarë do të bëhet konkretisht për çdo objektiv:

- Aktivitetet: Trajnime, blerje mjetesh didaktike, riparime çatish, tenderë për ushqimin.
- Kostimi: Sa kushton çdo aktivitet? Këtu bëhet lidhja me Planin Afatmesëm Buxhetor (PAB) të bashkisë.

- Burimet e Financimit: Sa mbulohen nga transferta e shtetit, sa nga të ardhurat e bashkisë dhe sa nga donatorët.

Faza 4: Përcaktimi i Treguesve Kyç të Performancës (TKP)

Si do ta dimë që kemi pasur sukses? Duhen përcaktuar treguesit:

- Numri i ndërtesave të përfunduara.
- Përqindja e fëmijëve të integruar nga familje të cenueshme.
- Rezultatet e anketave të kënaqësisë me prindërit.

Faza 5: Monitorimi dhe Rishikimi

PASH-i është një dokument "i gjallë".

- Duhet të ketë një Raport Monitorimi Vjetor.

Nëse kostot rriten (p.sh. inflacioni i ushqimeve në 2025), plani duhet të rishikohet dhe përshtatet për vitin pasardhës.

MODULI 2: IMAZHI I FËMIJËRISË SË HERSHME, FILOZOFIA DHE PRAKTIKAT ARSIMORE/EDUKATIVE DHE MIQËSORE ME FËMIJËT

Përmbledhje e modulit:
Ky modul synon të promovojë një kuptim tërësor të të drejtës së çdo fëmije për arsim, kujdes, zhvillim dhe përfshirje aktive, duke nxitur një kulturë institucionale dhe komunitare që e vendos fëmijën në qendër të politikave, praktikave dhe marrëdhënieve arsimore/edukative.
Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit zhvillojnë njohuri dhe qëndrime që reflektojnë filozofinë e fëmijërisë si periudhë unike zhvillimi dhe si themel i ndërtimit të një shoqërie të drejtë, përfshirëse dhe miqësore me fëmijët.

Qëllimi i modulit:

Të aftësohen pjesëmarrësit me një kuptim tërësor të së drejtës për arsim, kujdes dhe përfshirjen aktive e të gjithë fëmijëve.

Grupi i synuar:

Punonjës të arsimit pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues vendorë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme.

Sesioni 2.1: Njohja me kornizën rregullatore ligjore për të drejtat e fëmijëve

Objektivi: Të forcohen aftësitë profesionale të drejtuesve të institucioneve arsimore parashkollore dhe të nëpunësve bashkiakë përgjegjës për administrimin e shërbimit të arsimit parashkollor, në mënyrë që ata të kuptojnë dhe zbatojnë në praktikë parimet e filozofisë së fëmijërisë së hershme dhe të drejtave të fëmijëve, në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.
Në përfundim të këtij sesioni, pjesëmarrësit duhet të:

- Njohin dhe interpretojnë tërësinë e akteve ligjore dhe nënligjore që sanksionojnë dhe rregullojnë të drejtat e fëmijëve në arsim, kujdes dhe përfshirje sociale.
- Identifikojnë dhe kuptojnë rëndësinë e këtyre akteve në hierarkinë e burimeve ligjore, në përputhje me nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si bazë për ushtrimin e përgjegjësive institucionale në nivel shkolle dhe bashkie.

Tematika:

1. Njohja me kornizën rregullatore ligjore për të drejtat e fëmijëve
2. Aktet ndërkombëtare dhe kombëtare për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
3. Fillesat legjislative dhe historiku i rregullimeve ligjore në Shqipëri.
4. Sfidat dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor në zbatimin e këtyre të drejtave.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike
Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantimi në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup Sfidat dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor në zbatimin e të drejtave (Shtojca nr.2)**

Diskutimi dhe puna në grup mbi sfidat dhe përgjegjësitë e pushtetit vendor është përzgjedhur për të nxitur reflektim praktik dhe shkëmbim përvojash mes pjesëmarrësve, duke lidhur kuadrin ligjor me realitetin e zbatimit. Ky mjet synon të identifikojë sfidat, praktikat e mira dhe mundësitë për përmirësim në ofrimin e shërbimeve të arsimit parashkollor nga bashkitë.

- **Test para dhe pas trajnimit mbi kuadrin ligjor dhe zhvillimin e fëmijës (Shtojca nr.3)**

Testi para dhe pas trajnimit është zgjedhur për të matur nivelin e njohurive mbi kuadrin ligjor dhe zhvillimin e fëmijës, duke siguruar që pjesëmarrësit të kuptojnë detyrimet dhe standardet kombëtare. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet të përdoren për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Njohja e akteve ndërkombëtare, ligjeve kombëtare dhe rregulloreve vendore nuk është thjesht një detyrim formal, por një bazë strategjike për garantimin e të drejtave themelore të fëmijëve. Ajo siguron që çdo politikë dhe shërbim vendor të jetë në përputhje me standardet e dinjitetit, barazisë dhe mbrojtjes.
- Bashkitë nuk janë vetëm zbatues të ligjit, por aktorë aktivë në krijimin e një sistemi shërbimesh gjithëpërfshirës. Njohja e kornizës ligjore u mundëson të hartojnë politika efektive, të shmangin diskriminimin dhe të garantojnë qasje universale në arsim, shëndetësi dhe mbrojtje sociale.
- Kur pushteti vendor vepron në përputhje me standardet ligjore, sigurohet llogaridhënie dhe përfshirje, duke i dhënë komunitetit besimin se fëmijët mbrohen dhe marrin shërbimet që u takojnë. Kjo është një investim në zhvillimin e qëndrueshëm dhe në të ardhmen e komunitetit.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë**.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint.
- Dokumenti teorik i sesionit 2.1 "Njohja me kornizën rregullatore ligjore për të drejtat e fëmijëve"
- Listë me aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin vendas në lidhje me të drejat dhe mbrojtjen e fëmijëve

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (ETS No. 005: 1950/1953);
- Karta Sociale Evropiane (ETS No. 035: 1961/1965);
- Konventa e Këshillit të Europës "Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual";
- Konventa e Këshillit të Europës "Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore";
- Konventa "Mbi marrëdhëniet me fëmijët " (ETS No. 192: 2003/2005)
- Konventa "Për Krimet në Internet" (ETS No. 185: 2001/2004);
- Konventa Evropiane "Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve" (ETS No. 160: 1996/2000);
- Konventa Evropiane "Për Statusin Ligjor të Fëmijëve të Lindur jashtë Martese" (ETS No. 085: 1975/1978);
- Konventa Evropiane "Për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Kujdestarinë së Fëmijëve dhe Rivendosjen e Kujdestarisë për Fëmijët" (ETS No. 105: 1980/1983);
- Konventa Evropiane "Për Birësimin" (ETS No. 058: 1967/1968)
- Konventa "Për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996;
- Konventa e Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimi për birësimet jashtë vendit" aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 8264, datë 15.06.2000;
- Konventa Evropiane "Për marrëdhëniet me fëmijët" aderuar pas ratifikimit me ligjin nr.9359, datë 24.03.2005;
- Konventa "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr 9427, datë 13.10.2005;
- Konventa "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005;
- Protokolli opsional i Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", "Për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007;
- Protokolli opsional i Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve" "Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007.
- Kushtetuta e RSH-së e vitit 1998;
- Ligji nr. 9062 datë 08.05.2003 "Kodi i familjes"
- Ligji nr.10347, datë 04.11.2010 "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve";
- Ligji nr. 69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH";
- Kodi Penal i RSH-së;
- Kodi i Procedurës Penale të RSH-së;
- Kodi i Punës i RSH-së;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të përdoren Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra

PERMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
Lista e Akteve Ndërkombëtare që mbrojnë të drejtat e fëmijëve (përshkrim i shkurtër)

- Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (ETS No. 005: 1950/1953)

Kjo konventë e njohur si Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ / ECHR – në anglisht), mbron të drejtat qytetare dhe politike si edhe përmban vlerat thelbësore të Këshillit të Evropës. Neni 1 deklaron se nenet e konventës duhet t'i "aplikohen kujtdo brenda juridiksionit të tyre".

Edhe pse teksti i konventës i referohet specifikisht pak fëmijëve, disa prej neneve të kësaj konvente janë përdorur nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komisioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Nenet që i referohen më së shumti mbrojtjes së fëmijëve janë Neni 2 (e drejta e jetës), Neni 3 (ndalimi i torturës) Neni 4 (ndalimi i skllavërisë dhe punës së detyruar) Neni 5 (e drejta për liri dhe siguri), Neni 6 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe Neni 8 (respektimi për jetën private dhe familjare). Shumica e rasteve ligjore të përdorimit të Konventës përsa i përket dhunës kundër fëmijëve është qendërzuar në dënimin fizik, por lidhet drejtëpërsëdrejti me të gjithë llojet e dhunës kundër fëmijëve.

- Karta Sociale Evropiane (ETS No. 035: 1961/1965)

Karta Sociale Evropiane e plotëson Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në fushën e të drejtave ekonomike dhe sociale. Karta përbën një traktat kryesor evropian i cili siguron të drejtat e fëmijëve dhe në shumë raste garanton të drejtat e tyre nga lindja deri në moshën e rritur.

- Karta Sociale Evropiane e Rishikuar (ETS No. 163: 1996/1999)

Karta e rishikuar po zëvendëson gradualist Kartën Sociale Evropiane. Shumë prej neneve lidhen drejtëpërsëdrejti me fëmijët, për shembull, neni 16 (e drejta e familjes për mbrojtje sociale, ligjore dhe ekonomike) mbron të drejtat e fëmijëve si anëtarë të familjes, dhe neni 11 (e drejta për mbrojtje të shëndetit).

Të drejtat që lidhen vetëm për vetëm me fëmijët janë: neni 7 (e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje) and neni 17 (e drejta e fëmijëve dhe të rinjve për mbrojtje sociale, ligjore dhe ekonomike). Neni 17.1 integron të drejtat e garantuara në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve në kartën e rishikuar.

- Konventa e Këshillit të Europës “Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual” (CETS No. 201: 2007/....)

Kjo konventë përbën traktatin e parë ndërkombëtar që bën të ndëshkueshëm abuzimin seksual. Masat parandaluese përfshijnë ekzaminimin, rekrutimin dhe trajnimin e njerëzve që punën e kanë në kontakt të drejtëpërdrejtë me fëmijët, ndërgjegjësimin e fëmijëve për rreziqet dhe mësimin e vetëmbrojtjes nga ata, si edhe masa vëzhguese për shkelësit e ligjit apo ata me potencial për të shkelur ligjin. Konventa krijon edhe programe në mbështetje të viktimave si edhe linja telefonike të ndihmës dhe këshillimit për fëmijët. Ajo garanton se lloje të veçanta të sjelljes klasifikohen si krime dhe bën të ndëshkueshëm përdorimin e teknologjive të reja për të dëmtuar apo abuzuar seksualisht fëmijët. Për të luftuar turizmin seksual me fëmijë, konventa vendos se individët mund të hetohen për vepra penale të kryera jashtë shtetit, kur autori kthehet në vendin e tij/saj pas udhëtimit të rregullt jashtë vendit.

- Konventa e Këshillit të Europës “Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore” (CETS No. 197: 2005/2008)

Kjo konventë bën me dije se të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore përbëjnë shkelje të të drejtave të njeriut dhe iu kërkon shteteve të mbrojnë viktimat, qofshin burra, gra apo fëmijë. Ajo aplikohet për të gjitha format e shfrytëzimit të fëmijëve dhe nevojat e tyre për ndihmë dhe mbrojtje më të veçantë: seksual, punë e detyruar apo shërbime të tjera.

- Konventa “Për Marrëdhëniet me Fëmijët” (ETS No. 192: 2003/2005)

Kjo konventë përcakton parimet e përgjithshme që duhen vënë në zbatim kur bëhen apo amendohen urdhër takimet apo marrëveshjet dhe siguron garancitë e nevojshme për të siguruar ushtrimin e duhur të takimeve dhe kthimin e menjëhershëm të fëmijës në fund të kohës së takimit, veçanërisht në rastet e takimit ndërkufitar.

- Konventa “Për Krimet në Internet” (ETS No. 185: 2001/2004)

Hyrja në këtë konventë i referohet Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve and Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO) për Format më të Këqija të Punës së Fëmijëve.
Neni 9 i referohet veprave penale që lidhen me pornografinë me fëmijë dhe thekson se palët do të marrin “masa legjislative si dhe masa të tjera që i bëjnë të ndëshkueshme përdorimet e specifikuara të kompjuterëve në pornografinë me fëmijë".

- Konventa Evropiane “Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve” (ETS No. 160: 1996/2000)

Kjo konventë synon të promovojë të drejtat e fëmijëve dhe të mbrojë interesat e tyre. Ajo siguron masa proceduriale për të lejuar ushtrimin e të drejtave nga fëmijët, duke

përfshirë detyrimin për t'u siguruar atyre informacionet e duhura për të bërë këtë gjë, veçanërisht në seanca gjyqësore për çështje të familjes përballë autoriteteve ligjore.
Mes llojeve të seancave gjyqësore të familjes me interes të veçantë për fëmijët janë ato që kanë të bëjnë me kujdestarinë, banimin, lejimin, çështjet e prindërimit, kujdestaria ligjore, mbrojtja nga trajtimi i egër dhe degradues, etj.
Komiteti i Qëndrueshëm i dalë nga Konventa (T-ED) merr në konsideratë çështje mbi interpretimin dhe vënien në zbatim, propozon amendime dhe jep ndihmë për institucionet kombëtare që kryejnë funksionet e përmendura në nenin 12.2.

- Konventa Evropiane "Për Statusin Ligjor të Fëmijëve të Lindur jashtë Martese" (ETS No. 085: 1975/1978)

Objekti i kësaj konvente është që të përvetësojë statusin ligjor të një fëmije të lindur jashtë martese me atë të një fëmije të lindur brenda martesës, dhe të japë kontribut në harmonizimin e ligjeve të shteteve në këtë fushë.

- Konventa Evropiane "Për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve në Lidhje me Kujdestarinë së Fëmijëve dhe Rivendosjen e Kujdestarisë për Fëmijët" (ETS No. 105: 1980/1983)

Kjo konventë synon të sigurojë zgjidhje për çështjen e kujdestarisë së fëmijëve kur fëmijët jetojnë në shtete të ndryshme evropiane dhe të sigurojë në të njëjtën kohë zbatimin e vendimeve që kanë lidhje me kujdestarinë dhe takimet me fëmijët.

Autoritetet Qendrore të shteteve kontraktuese (sipas nenit 2) përbëjnë një element kyç në vënien në zbatim të kësaj konvente.

- Konventa Evropiane "Për Birësimin" (ETS No. 058: 1967/1968)

Një version i rishikuar i kësaj konvente që do të reflektojë ndryshimet si ligjore dhe të shoqërive po punohet nga Grupi i Punës për Birësimet (CJ-FA-GT1), nënkomitet i Komitetit Europian për Bashkëpunimin Ligjor.
Ky grup ka propozuar që çështjet e mëposhtme që kanë lindur së fundi të merren në konsideratë në konventën që po rishikohet: eliminimi i dallimeve në trajtim mes fëmijëve të lindur brenda dhe jashtë martesës; lejen prindërore; konsultimin me fëmijën që do të birësohet kurdo që mundësohet, mosha minimale për birësuesin; e drejta e personave për të ditur identitetin apo origjinën e tyre; pezullimin e procedurave të birësimit kur vendosja e atësisë është e pazgjidhur.
Ky grup pune po finalizon konventën e rishikuar të birësimit e cila do t'i dërgohet Komitetit të Ministrave gjatë 2007.

AKTET NDERKOMBËTARE NË TË CILAT KA ADERUAR RSH-JA

- Konventa "Për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996;

- Konventa e Hagës “Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimi për birësimet jashtë vendit” aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 8264, datë 15.06.2000;
- Konventa Evropiane “Për marrëdhëniet me fëmijët” aderuar pas ratifikimit me ligjin nr.9359, datë 24.03.2005;
- Konventa “Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve”, aderuar pas ratifikimit me ligjin nr 9427, datë 13.10.2005;
- Konventa “Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”, aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005;
- Protokolli opsional i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve”, “Për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”, aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007;
- Protokolli opsional i Konventës së OKB-së “Për të drejtat e fëmijëve” “Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë”, aderuar pas ratifikimit me ligjin nr 9834, datë 22.11.2007.

FILLESAT LEGJISLATIVE PËR SANKSIONIMIN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE

Në fillesat e saj, nevoja për t’i dhënë një mbrojtje të posaçme fëmijës është theksuar në:

- Deklaratën e Gjenevës “Për të Drejtat e Fëmijës” të vitit 1924;
- Është njohur në Deklaratën Universale “Për të Drejtat e Njeriut” miratuar nga OKB-ja, datë 10.12.1948;
- Deklaratën “Për të Drejtat e Fëmijës” të miratuar nga Kombet e Bashkuara më 20 nëntor të vitit 1959; dhe
- Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike të OKB-së (në veçanti në nenet 23 dhe 24),
- Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Shoqërore dhe Kulturore të OKB-së;

për të arritur te

- Konventa “Për të drejtat e fëmijës” miratuar dhe hapur për nënshkrim, për ratifikim dhe për aderim nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së me Rezolutën e saj 44/25 të datës 20 nëntor 1989 (hyrë në fuqi në datën 02.09.1990).

HISTORIKU i RREGULLIMEVE LIGJORE NË SHQIPËRI

Ne fillesat e saj, nevoja e shtetit shqiptar për të sanksionuar një mbrojtje të posaçme për fëmijët është theksuar në :

- Kodi Civil i vitit 1929;
- Ligji nr. 601, datë 18.05.1948 “Për martesën”;
- Ligji nr. 602, datë 19.05.1948 “Për birësimin”;
- Ligji nr. 603, datë 20.05.1948 “Për kujdestarinë”;

- Ligji nr. 604, datë 20.05.1948 “Për marrëdhëniet mes prindërve dhe fëmijëve”;
- Ligji nr. 4020, datë 23.06.1965 “Kodi i familjes”;
- Ligji nr. 6599, datë 29.06.1982 “Kodi i familjes”.

Në kuadër të mundësimit të realizimit në praktikë teë këtyre të drejtave dhe me qëllimin e shmangies së çdo pengese, si dhe në kuadër të respektimit të detyrimeve që shteti shqiptar ka në bazë të ratifikimit të konventave ndërkombëtare në të cilat ka aderuar, janë marrë masat e nevojshme legjislative nëpërmjet garantimit me rregullime të përgjithshme e të veçanta ligjore si p.sh.:

Sanksionojnë të drejtat e fëmijëve:

- Kushtetuta e RSH-së e vitit 1998;
- Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 “Kodi i familjes”
- Ligji nr.10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve”;
- Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në RSH”.

Mundësojnë garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave të sanksionuara:

- Kodi Penal i RSH-së;
- Kodi i Procedurës Penale të RSH-së;
- Kodi i Punës i RSH-së;
- Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”;

Sesioni 2.2: Katalogu i të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit për të njohur dhe kuptuar tërësinë e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve, siç përcaktohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës dhe në legjislacionin shqiptar në fuqi.

Në fund të kësaj seance, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përkufizojnë konceptin e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve, në kuadër të parimeve themelore të shtetit të së drejtës dhe të barazisë para ligjit.
- Njohin kategoritë kushtetuese të të drejtave dhe lirive – personale, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore – që garantojnë zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.
- Dallojnë fëmijët si subjekte të veçanta të të drejtave, duke kuptuar mbrojtjen e posaçme që u ofrohet për shkak të moshës, varësisë dhe nevojës për kujdes të shtuar.
- Njohin garancitë kushtetuese dhe mekanizmat institucionalë kombëtarë e vendorë që sigurojnë zbatimin dhe mbrojtjen efektive të të drejtave të fëmijës (p.sh. Avokati i Popullit, Mekanizmi i Koordinuar Vendor, strukturat bashkiake të mbrojtjes së fëmijës).

Tematika:

1. Kuptimi i të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve
2. Fëmijët si subjekte të veçanta të të drejtave dhe lirive themelore
3. Garancitë kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore
4. Katalogu i të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve
5. Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup mbi Kuptimin e të drejtave dhe lirive themelore të fëmijëve (Shtojca nr.2)**

Diskutimi synon të sqarojë konceptin e të drejtave themelore dhe rëndësinë e tyre për zhvillimin e fëmijës. Pjesëmarrësit analizojnë si këto të drejta zbatohen në praktikë në institucionet arsimore.

- **Rast Studimor (Shtojca nr.3) Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës**

Ky rast studimor është përzgjedhur për të ilustruar në mënyrë praktike funksionimin e mekanizmave institucionalë që garantojnë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, si bordet

e institucionit, komisionet e sigurisë dhe këshillat e prindërve. Ai synon të lidhë kuadrin ligjor me situata reale, duke nxitur analizën e sfidave dhe zgjidhjeve konkrete për përmirësimin e shërbimit arsimor. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, drejtuesit e institucioneve arsimore dhe ekipi i projektit, me qëllim që diskutimi të shërbejë si bazë për forcimin e kapaciteteve dhe harmonizimin e praktikave me standardet kombëtare.

Mesazhet kyç të sesionit:

- "Fëmijët nuk janë thjesht përfitues të shërbimeve, por subjekte me të drejta të plota dhe të veçanta. Si punonjës të bashkive, ju keni një rol kyç në garantimin e respektimit të këtyre të drejtave, duke u mbështetur te parimet kushtetuese dhe mekanizmat institucionalë që sigurojnë mbrojtje të barabartë dhe gjithëpërfshirëse."
- "Njohja e kategorive kushtetuese të të drejtave dhe lirive themelore, si dhe e mekanizmave për zbatimin e tyre, ju mundëson të dalloni nevojat e veçanta të fëmijëve dhe të ofroni mbrojtje efektive. Kjo është thelbësore për të ndërtuar një sistem vendor që respekton standardet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e fëmijëve."

Kohëzgjatja e sesionit:
Sesioni do të zgjasë **2 orë**.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit
Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint
- Dokumenti teorik i sesionit 2.2 "Katalogu i të drejtave themelore të fëmijëve"
- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"

Listë leximesh për pjesëmarrësit:
Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërise
- Politika Kombëtare për Mbrojtjen e Fëmijëve (Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijës 2021–2026)
- Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021–2026
- Ligji nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahen *(Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra,)*

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
Të gjithë të drejtat që përfitojnë një mbrojtje kushtetuese ose ndërkombëtare janë të drejta themelore, pavarësisht nga përmbajtja e tyre. Ndërmjet tyre nuk ka vend për hierarki.

Një konceptim tjetër i rëndësishëm i konsideron të drejtat dhe liritë themelore si të drejta të individit të marra në thelbin e tyre universal abstrakt, të cilat në raport me të drejtën pozitive të shtetit, janë pararendëse dhe eprore. Në këtë mënyrë ato shndërrohen në të drejta dhe liri themelore të sanksionuara në Kushtetutë apo në akte ndërkombëtare duke përcaktua në këtë mënyrë kufijtë e pushtetit legjitim.

Kushtetuta nëpërmjet ndarjes në disa krerë ka afirmuar disa kategori të të drejtave dhe lirive themelore :

- Liritë dhe të drejtat vetjake (kreu II);
- Liritë dhe të drejtat politike (kreu III);
- Liritë dhe të drejtat ekonomike dhe social kulturore (kreu IV)

Në kushtetutë është përcaktuar tërësisht gjithë hapësira e nevojshme që do të garantonte realizimin dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore. Kjo është arritur nëpërmjet sanksionimeve kushtetuese :

- Dinjiteti i njeriut e të drejtat dhe liritë e tij janë baza mbi të cilën ndërtohet i gjithë rendi juridik, (neni3);
- Karakteri i patjetërsueshëm, i pandashëm dhe i padhunueshëm i të drejtave dhe lirive themelore(neni 15/1);
- Detyrimi i organeve të pushtetit publik për të mbrojtur dhe garantuar ushtrimin e këtyre të drejtave (neni 15/2);
- Barazia e shtetasve dhe mosdiskriminimi (neni 18);
- Rezerva ligjore duke u shprehur qartë se kufizimet e të drejtave mund të bëhen vetëm me ligj (neni 17)

FËMIJËT SI SUBJEKT i POSAÇËM I TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE

Subjektet e të drejtave dhe lirive themelore mund t'i ndajmë:

- të përgjithshme :
    - individë (shtetas shqiptarë, të huaj, persona pa shtetësi);
    - persona juridikë.
- të posaçme
    - personat që u përkasin pakicave kombëtare;
    - fëmijët;
    - gratë shtatëzëna dhe nënat e reja.

Nga klasifikimi i mësipërm fëmijët evidentohen si subjekte të posaçme të të drejtave dhe lirive themelore. Specifika e subjekteve të posaçme në krahasim me subjektet e përgjithshme konsiston në faktin se fëmijët kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti (neni 54). Kategorizimi i tyre në mënyrë të posaçme, për të pasur një mbrojtje të veçantë nga ana e shtetit, përcakton detyra sidomos për pushtetin legjislativ dhe ekzekutiv për të marrë masa të posaçme e të domosdoshme për mbrojtjen e fëmijëve. Në rastin e fëmijëve Kushtetuta shkon edhe më tej në krahasim me subjektet e tjera të posaçme kur sanksionon kuptimin e mbrojtjes nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë.

GARANCITË KUSHTETUESE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE

Garancitë kushtetuese janë të ndara në dy grupe :

1. Garancitë bazë, që përbëjnë kushtet apo instrumentet për vetë ekzistencën e të drejtave dhe lirive themelore të cilat ofrohen nëpërmjet:
   - zbatimi i drejtëpërdrejtë i normave kushtetuese që sanksionojnë të drejtat dhe liritë themelore;
   - rezerva ligjore (vetëm ligjvënësi mund të marrë vendimet në fushën e të drejtave)
   - moscenimi i thelbit të të drejtave dhe lirive;
   - karakteri i kushtëzuar dhe në mënyrë përjashtimore i pezullimit të garancive (neni 175/1/2);
   - rregullimi i procedurave për rishikimin e Kushtetutës;
   - garancitë me karakter ndërkombëtar (aktet e ndryshme ndërkombëtare në të cilat ka aderuar RSH-ja) të cilat realizohen në dy mënyra:
     - referimi i drejtpërdrejtë i KEDNJ-së në Kushtetutë;
     - mbrojtja që ofrojnë marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara të cilat kanë fuqi mbiligjore.
2. Garancitë juridike, kanë të bëjnë me sanksionimin nga Kushtetuta të institucioneve përmes të cilave do të garantohen të drejtat themelore dhe përmbajtjen e rregullave që krijojnë institucione juridike e juridiksionale autonome me qëllim që të garantojnë në praktikë zbatimin e të drejtave të shpallura. Këto garanci përfitohen si nga drejtësia e zakonshme (vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm) ashtu edhe nga drejtësia kushtetuese (vendimet e Gjykatës Kushtetuese). Megjithatë, këto lloj garancish mund të plotësohen në çdo rast përmes garancive të veçanta (Avokati i Popullit) dhe në tërësinë e tyre ofrohen nëpërmjet :
   - garancia e siguruar nga Avokati i popullit;
   - garancia e siguruar nga vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm;
   - garancia e siguruar nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese; dhe
   - garancia e siguruar nga vendimet e Gjykates Evropiane e të Drejtave te Njeriut, në Strasburg.

KATALOGU I TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE

Liritë dhe të drejtat vetjake

1. E drejta për jetën (neni 21);
2. Liria e shprehjes (neni22);
3. E drejta e informimit (neni 23);
4. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë (neni 24);
5. Liria dhe siguria personale (nenet 27 e vijim);
6. E drejta për të gëzuar jetën private (nenet 35,36,37);

7. E drejta e pronës private (neni 41);
8. E drejta për një proces të rregullt ligjor (neni 42);

Liritë dhe të drejtat politike

1. E drejta për t'u zgjedhur (neni 45) (shtetasit nën 18 vjeç nuk e gëzojnë këtë të drejtë);
2. E drejta për t'u organizuar kolektivisht (neni 46);

Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore

1. E drejta për një jetë familjare normale (neni 53);
2. E drejta për t'u arsimuar (neni 57);
3. E drejta për punë (nenet 49,50, 51);
4. E drejta për kujdes shëndetësor (neni 55)

MEKANIZMAT INSTITUCIONALË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

Ligji parashikon një sërë mekanizmash institucionalë.

Mekanizmat institucionalë për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në përputhje me fushën e ushtrimit të veprimtarisë së tyre, janë në nivel qendror dhe vendor.

Mekanizmat në nivel qendror janë:

a) Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;

b) Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;

c) Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Mekanizmat në nivel vendor janë:

a) njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut;

b) njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki/komunë

Mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Bashkërendimi i veprimtarisë së tyre për çështje që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, të parashikuara në këtë ligj, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Këta mekanizma bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, në bazë të rregullave të hollësishme, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sesioni 2.3: Korniza për mbështetjen e integrimit në sistemet e fëmijërisë së hershme: vlerat dhe parimet, faktorët kyç dhe praktika e cilësisë

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit, drejtues vendorë, administratorë institucionesh të arsimit parashkollor dhe specialistë bashkiakë, për të kuptuar dhe zbatuar parimet e integrimit dhe bashkëpunimit ndërsektorial në zhvillimin e sistemeve të fëmijërisë së hershme.

Ky sesion synon të nxisë një mirëkuptim të përbashkët ndërmjet vendimmarrësve vendorë dhe palëve të interesuara mbi vlerat, mekanizmat e bashkërendimit dhe praktikat bashkëpunuese që forcojnë sistemet e fëmijërisë së hershme në përputhje me kuadrin ligjor kombëtar, standardet e cilësisë dhe objektivat e zhvillimit gjithëpërfshirës.

Në përfundim të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Njohin dhe shpjegojnë vlerat dhe parimet që mbështesin integrimin në sistemet e fëmijërisë së hershme (bashkëpunim, gjithëpërfshirje, kohezion ndërsektorial, përgjegjshmëri institucionale).
- Analizojnë faktorët kyç që ndikojnë në integrimin dhe bashkërendimin efektiv të shërbimeve për fëmijët dhe familjet.
- Identifikojnë dhe promovojnë praktikat cilësore që mund të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve arsimore, sociale dhe shëndetësore në nivel vendor.
- Diskutojnë rolin dhe përgjegjësitë e secilit aktor në hartimin dhe zbatimin e një sistemi të integruar për fëmijërinë e hershme.
- Zhvillojnë plane konkrete të veprimit ose projektpolitika për integrimin dhe cilësinë e shërbimeve në kontekstin e bashkisë së tyre.

Tematika:

1. Kuadri ligjor dhe parimet mbështetëse të fëmijërisë së hershme
2. Vlerat dhe parimet në sistemet e fëmijërisë së hershme
3. Faktorët kyç për integrimin e shërbimeve
4. Praktikat cilësore dhe bashkëpunimi ndërsektorial
5. Roli i fuqisë punëtore dhe lidershipit
6. Komunikimi dhe ndarja e informacionit në sistemet e integruara
7. Koha dhe procesi i ndërtimit të sistemeve të qëndrueshme

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup mbi parimet dhe vlerat kryesore- barazia, gjithëpërfshirja, respektimi i diversitetit, pjesëmarrja aktive e fëmijëve dhe familjeve (Shtojca nr. 2)**

Ky mjet është përzgjedhur për të nxitur reflektim dhe diskutim mbi parimet themelore të barazisë, gjithëpërfshirjes, respektimit të diversitetit dhe pjesëmarrjes aktive të fëmijëve dhe familjeve në procesin arsimor. Ai synon të lidhë kuadrin teorik me praktikat konkrete, duke identifikuar sfidat dhe mundësitë për përmirësim në nivel vendor. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e diskutimit të përdoren për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe garantimin e një shërbimi arsimor gjithëpërfshirës dhe të drejtë**.**

- **Ushtrim në grupe (Shtojca nr 3)**

Ky ushtrim në grupe është përzgjedhur për të nxitur analizën kritike dhe bashkëpunimin mes pjesëmarrësve mbi vlerat dhe parimet që duhet të udhëheqin sistemin e kujdesit dhe arsimit/edukimit në fëmijërinë e hershme. Ai synon të lidhë teorinë me praktikën përmes ndërtimit të një tabele që identifikon faktorët kyç të cilësisë dhe masat konkrete për zbatimin e tyre në Shqipëri, si dhe përmes përgatitjes së një skenari që ilustron një praktikë të suksesshme. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e ushtrimit të përdoren për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të arsimit parashkollor.

Mesazhet kyç të sesionit:

- **Siguroni barazi dhe gjithëpërfshirje**. Kopshtet duhet të ofrojnë mundësi të barabarta për çdo fëmijë, duke respektuar diversitetin dhe duke përfshirë grupet më të cenueshme.
- **Ndërtoni marrëdhënie cilësore dhe bashkëpunim**. Sistemet funksionale kërkojnë besim, respekt dhe bashkërendim mes bashkive, profesionistëve dhe familjeve për të garantuar cilësi.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **4 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit
- Materiali teorik i sesionit 2.3 “Korniza për mbështetjen e integrimit në sistemet e fëmijërisë së hershme: Vlerat dhe Parimet, Faktorët Kyç dhe Praktika e Cilësisë”

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- “Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Praktika të Mira”, Save the Children
- “Udhëzues mbi Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta”, Save the Children
- Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor-ASCAP &UNICEF
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Kopshtit-ASCAP& UNICEF
- Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Një Qasje e Re-ASCAP&UNICEF

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahen (Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra.)

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Mbështetja e vlerave dhe parimeve

Sistemet e fëmijërisë së hershme janë sisteme dinamike që krijohen dhe ndryshojnë vazhdimisht bazuar në bashkëveprimin midis vlerave të vjetra dhe të reja, njohurive të së kaluarës dhe të tashmes, kuptimeve të konteksteve dhe diversitetit të tyre, veprimeve dhe provave. Si në çdo sistem të gjallë, të gjithë individët (ndërveprimet midis tyre, grupeve dhe ndërveprimeve midis grupeve, proceseve dhe veprimeve) kanë rëndësi pasi krijojnë dinamika të shumëfishta në sisteme. Të parit të potencialit unik të secilit aktor dhe secilit grup aktorësh thekson rëndësinë e kultivimit të marrëdhënieve njerëzore si themel dhe nxitës për krijimin e sistemeve funksionale dhe të drejta.

Roli kryesor i shërbimeve të fëmijërisë së hershme është të sigurojnë që të drejtat e secilit fëmijë të përmbushen dhe që atyre t'u ofrohen kushtet dhe mbështetja më e mirë për të arritur potencialin e tyre unik, pavarësisht nga prejardhja, statusi socio-ekonomik, feja, gjinia, raca ose botëkuptimi i tyre, dhe gjithashtu pavarësisht nga lloji i shërbimit. Ndarja e të njëjtave vlerave dhe parimeve mund të kontribuojë në një qëllim të përbashkët në të gjitha shërbimet dhe profesionistët dhe në një bashkërendim të përsosur.

Fëmijët dhe familjet në qendër

Integrimi njeh qëllimin kryesor arritjen e rezultateve më të mira për fëmijët dhe familjet e tyre gjatë hartimit, planifikimit, ofrimit dhe vlerësimit të shërbimeve të fëmijërisë së hershme. Prandaj, të gjitha vendimet duhet të fillojnë dhe të merren duke pranuar dhe siguruar kolektivisht që kërkesat e fëmijëve dhe familjeve të tyre të përmbushen, duke i parë ata si aktorë dhe partnerë në proces.

Qasja tërësore

Qasja ndaj fëmijës, familjes, profesionistit, shërbimit dhe komunitetit në një mënyrë tërësore siguron që diversiteti i nevojave dhe pikave të tyre të forta të merret në konsideratë dhe veprimet që ndikojnë në to të jenë të harmonizuara dhe sinergjike. Kjo gjithashtu nënkupton që si proceset ashtu edhe rezultatet të marrin në konsideratë dimensionet intelektuale, socio-emocionale, fizike dhe shpirtërore të atyre që janë të përfshirë. Të gjitha këto dimensione duhet të merren në konsideratë kur angazhohemi me aktorët.

Marrëdhëniet cilësore

Marrëdhëniet cilësore dhe gjeneruese midis individëve dhe ekipeve, midis agjencive, midis profesionistëve dhe përfituesve, si dhe niveleve të ndryshme të qeverisjes, janë

thelbësore. Ato duhet të bazohen në besim, respekt të ndërsjellë, përgjegjësi të përbashkëta, marrëveshje të ndërsjellë dhe angazhim të përbashkët.

Qasjet sistemike

Të gjithë elementët në sistem ndikojnë mbi njëri-tjetrin vertikalisht dhe horizontalisht, duke ndikuar në tranzicionet përgjatë moshës, sektorit, shërbimeve, por edhe nga ofrimi i shërbimeve në politika. Prandaj, ndryshimet duhet të shihen përmes kompleksitetit të ndikimit të tyre brenda një sistemi. Një ndryshim i nismëtuar në një pjesë të sistemit do të ndikojë në pjesët e tjera. Prandaj, ndryshimet duhet të shihen në një mënyrë sistemike.

Diversiteti dhe barazia

Diversiteti si shoqëror dhe kulturor përfaqësojnë përbërës themelorë në punën e përbashkët për hartimin, planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për fëmijët dhe familjet. Çdo aktor vlerësohet; çdo veprim është i ndjeshëm ndaj sigurimit të mundësive të barabarta për ata që kanë më shumë nevojë. Përfaqësuesit e grupeve të cenueshme përfshihen; ata kanë një zë, shihen, mendimi i tyre respektohet dhe ata kanë një ndikim në procesin e vendimmarrjes.

Pjesemarrja

Dëgjimi i zërave të aktorëve të shumtë (duke përfshirë fëmijët dhe familjet e tyre) në krijimin e shërbimeve që u përgjigjen nevojave, janë elastike, të dobishme dhe efikase është thelbësor, që nga faza e planifikimit deri te ofrimi i shërbimeve dhe vlerësimi për përmirësim. Bashkëpunimi bazohet në vlera të përbashkëta, qëllime të përbashkëta dhe veprime të artikuluara, por edhe në një ndjenjë të përbashkët pronësie. Për më tepër, shërbimet krijohen për t'u shërbyer më së miri fëmijëve dhe familjeve. Prandaj, fëmijët dhe familjet marrin pjesë në vendimmarrje dhe në krijimin e përbashkët të shërbimeve që janë të rëndësishme për ta.

Pyetje për reflektim ne grup

1. Çfarë mendoni për këto vlera dhe parime? A janë ato në përputhje me atë që keni diskutuar në grupet tuaja? Çfarë përmendët dhe çfarë nuk përmendët (vlerat dhe parimet)? A ka diçka në listën tuaj që ne nuk e përmendëm?
2. Si do ta shpjegonit rëndësinë e vlerave dhe parimeve specifike nga perspektiva e sektorit/shërbimit tuaj?
3. Si përfaqësues të sektorëve/shërbimeve dhe niveleve të ndryshme të sistemit, a mendoni se këto vlera dhe parime do të ishin të kuptueshme për kolegët tuaj dhe të tjerët me të cilët po punoni? A janë ato po aq të rëndësishme për të gjithë ju? Pse?
4. Po prindërit? Si i shihni këto vlera dhe parime? A është e rëndësishme t'i promovoni ato? A është e kuptueshme që nëse ato janë zbatohen, cilësia e shërbimeve do të përmirësohet dhe se fëmijët do të përfitojnë?
5. Si mund të promovohen këto parime dhe vlera në të gjitha aspektet e shërbimeve (në vijën e parë, menaxhim, trajnim profesional, etj.)?

Material per lexim
Faktorët kryesorë dhe disa fusha praktike janë identifikuar si thelbësore për krijimin e themeleve për integrimin brenda sistemeve të fëmijërisë së hershme.

Faktorët kryesorë mund të mbështesin ose pengojnë bashkërendimin dhe integrimin në nivel të lartë, varësisht nga vlerat dhe parimet që i udhëheqin ata, si dhe nga lloji i praktikave që kultivohen midis individëve: në nivelin e shërbimit, midis shërbimeve/institucioneve dhe midis niveleve të ndryshme të qeverisjes në nivel vendor.
Më poshtë, do të gjeni një përshkrim të shkurtër të secilit prej shtatë faktorëve kryesorë. Në lidhje të ngushtë me secilin prej tyre, theksohen praktikat e bazuara në vlera cilësore, të cilat e bëjnë faktorin një mundësues të integrimit.

FAKTORI KYÇ 1: VIZIONI Vizioni është një nxitës themelor në ofrimin e shërbimeve cilësore dhe të barabarta në vitet e para dhe për komunitetet. Mënyra se si i shohim dhe i vlerësojmë fëmijët, familjet dhe komunitetet përcakton shumë dëshirat që kemi për ta. Veprimet e vazhdueshme, të qëllimshme dhe shumë angazhuese që sjellin ndryshime janë gjithmonë të frymëzuara nga një vizion i qartë.

Praktikat e mira
Vendet me shërbime të integruara tashmë të zhvilluara kanë përjetuar që, kur zhvillojnë një vizion të përbashkët midis palëve të ndryshme të interesuara, atyre u është dashur të kapërcejnë sfidën e të pasurit shërbime dhe kultura profesionale të bazuara në sektor, dallimet në kërkesat dhe ligjërimet profesionale, pikëpamjet e ndryshme mbi prindërit dhe fëmijët, si dhe një skemë financimi të bazuar në sektor dhe përgjegjësitë politike të shpërndara. Investimi në dialog të vazhdueshëm në shumë nivele të ndryshme është një hap fillestar thelbësor. Për të lidhur ligjërimet e ndryshme drejt kuptimeve dhe qëllimeve të përbashkëta, duhet të krijohen vende dhe hapësira dialogu për politikëbërësit, vendimmarrësit, profesionistët, prindërit dhe komunitetet.

FAKTORI KYÇ 2: FUQIA PUNËTORE E FËMIJËRISË SË HERSHME Në një farë mase, shërbimet janë fuqia punëtore. Cilësia e shërbimeve ka shumë të bëjë edhe me cilësinë e fuqisë punëtore: sa më e përgatitur dhe e mbështetur të jetë, aq më të mira janë shërbimet. Fuqia punëtore është çelësi për ofrimin cilësor, nga roli menaxhues deri te ndërveprimet e drejtpërdrejta me kolegët profesionistë, me familjet, me komunitetet dhe, së fundmi, por jo më pak e rëndësishme, me fëmijët.

Praktikat e mira
Një punë shumë e bashkërenduar kërkon kompetenca profesionale që lidhen me detyrën specifike. Gjithashtu kërkon një qëndrim të caktuar që lidhet me gatishmërinë për të bashkëpunuar, besimin tek organizatat partnere, të qenit mendjehapur ndaj të nxënit të përbashkët, ndërgjegjësimin (dhe njohurinë se si të shmanget) rreziku i stigmatizimit. Puna në një mënyrë të integruar me prag të ulët, veçanërisht për dhe me familjet e vështira për t'u arritur, kërkon qëndrime dhe vlera specifike nga profesionistët dhe një qasje holistike. Prindërit dhe fëmijët duhet të marrin shërbimet që u nevojiten në të vërtetë, jo atë që profesionistët mendojnë se u nevojiten. Kjo do t'i bënte

shërbimet më të arritshme dhe do t'i motivonte njerëzit të punonin së bashku. Për këtë, është e nevojshme të ofrohen vazhdimisht udhëzime dhe trajnime për të gjithë anëtarët e stafit dhe të bashkohen sektorë të ndryshëm në ngjarje të përbashkëta. Praktika reflektuese, mentorimi nga kolegët, komunitetet e të nxënit dhe aktivitetet në grup mund t'i mbajnë të gjithë punonjësit të lidhur, të motivuar dhe të përkushtuar ndaj bashkëpunimit të tyre.

FAKTORI KYÇ 3: LIDERSHIPI Asnjë plan i suksesshëm nuk mund të realizohet pa lidership. Sa më komplekse dhe sfiduese të jenë çështjet që duhen trajtuar, aq më e fortë është nevoja për lidership. Lidership do të thotë të menduarit strategjik, menaxhimi i burimeve, marrja e përgjegjësisë, marrja e vendimeve, drejtimi i proceseve, marrja përsipër e rreziqeve, kërkimi i përgjigjeve dhe zgjidhjeve, të qenit i përgjegjshëm, por edhe ndërtimi dhe kultivimi i një kulture kolektive, katalizimi i energjive, angazhimi dhe puna me njerëzit, mundësimi dhe menaxhimi i ndryshimeve. Lidershipi zbaton vizionin dhe drejton një qasje strategjike për të punuar së bashku.

Praktikat e mira
Lidershipi i fortë në shërbimet e integruara ka të bëjë më pak me hierarkitë rigoroze, por më tepër me aftësinë për t'u lidhur, për të motivuar dhe fuqizuar stafin, për të zhvilluar dhe zbatuar një vizion të qartë në një mënyrë pjesëmarrëse (duke përfshirë familjet dhe komunitetet), për të qëndruar në rrugën e duhur, për të komunikuar mirë dhe për të mbështetur stafin në zhvillimin e tyre drejt më shumë bashkëpunimit. Lidershipi në këtë kontekst ka të bëjë me krijimin e një kulture bashkëpunimi, lehtësimin dhe formësimin e vlerave të punës bashkëpunuese, respektit të ndërsjellë dhe solidaritetit, vendimmarrjes demokratike, organizimin e praktikës së përbashkët dhe zhvillimit profesional dhe ndërmjetësimin midis aktorëve të ndryshëm. Ky lloj lidershipi kërkon që "drejtuesit" jo vetëm të jenë kompetentë dhe të përkushtuar, por edhe të jenë të njohur me shërbimet dhe profesionistët e ndryshëm dhe të jenë shumë të besueshëm.

FAKTORI KYÇ 4: OFRIMI I SHËRBIMEVE Mënyra se si ofrohen shërbimet pasqyron mënyrën se si perceptohet roli i tyre nga ata që janë përgjegjës për menaxhimin dhe ofrimin e tyre. Aksesueshmëria, disponueshmëria, përballueshmëria, përdorshmëria dhe gjithëpërfshirja e shërbimeve tregojnë shkallën në të cilën ato përfaqësojnë një përgjigje ndaj një kërkese reale që vjen nga familjet dhe komunitetet në të cilat ato operojnë. Shërbimet mund të ofrohen në "izolim" ose duke krijuar një "rrjet" bashkëpunimi.

Praktikat e mira
Në përgjithësi, shërbimet duhet të jenë të arritshme për të gjithë, të përballueshme, të dobishme, të disponueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ofrimet duhet të jenë falas, mikpritëse dhe përkatëse për të gjithë (jo vetëm për grupe specifike 'të synuara'). Puna në terren duhet të merret në konsideratë për të arritur të gjitha familjet, veçanërisht ato që shihen ose etiketohen si 'të vështira për t'u arritur'. Shërbimet duhet të ndërtohen së bashku me familjet, gjë që nga ana tjetër kërkon një model elastik dhe strategji të vazhdueshme, afër vendit ku jetojnë, punojnë ose takohen familjet. Shumë shembuj

tregojnë minimumin e shërbimeve brenda ofrimit shumë të bashkërenduar: arsimimi dhe kujdesi i hershëm, mbështetja prindërore, shëndetësia (parandaluese) dhe puna sociale. Por integrimi mund të zhvillohet edhe midis kujdesit për fëmijët dhe arsimit parashkollor ose midis kopshteve dhe bibliotekës, etj. Ajo që është e rëndësishme është që rrjeti i shërbimeve të përmbajë shërbime të mjaftueshme kryesore, me prag të ulët dhe universal, që ato të jenë mikpritëse dhe të ofrojnë vende takimi ku familjet mund të lidhen me njëra-tjetrën. Ofrimi i shërbimeve të integruara cilësore është thellësisht i rrënjosur në komunitet, i përgjegjshëm ndaj këtyre komuniteteve. Është gjithashtu shumë elastik, pasi komuniteti është në ndryshim të vazhdueshëm.

FAKTORI KYÇ 5: KOMUNIKIMI DHE NDARJA E INFORMACIONIT Planifikimi dhe puna e përbashkët varen nga komunikimi i qetë dhe efikas, si dhe nga qasja në informacion dhe ndarja e tij. Sistemet efikase dhe të sigurta të informacionit dhe protokollet e qarta për komunikim krijojnë një platformë të fortë për bashkëpunim të fortë. Besimi është një komponent kyç në proceset e komunikimit dhe ndarjes së informacionit dhe në marrëdhënien prind-shërbim.

Praktikat e mira

Për familjet e cenueshme, pengesat në qasje shpesh lidhen me mungesën e informacionit. Familjet duhet të dinë qartë se çfarë ofrohet, cilat janë kushtet dhe pasojat e mundshme. Duhet të ketë strategji të qarta mbi komunikimin, informacionin dhe kodet deontologjike. Këto informojnë se si përdoret dhe ndahet informacioni familjar: çfarë informacioni mblidhet, nga kush dhe pse; kanalet e komunikimit midis profesionistëve dhe shërbimeve; kush ka qasje në cilin informacion; rregullat për zbulimin e informacionit të ndjeshëm; si informohen njerëzit për këto rregulla dhe si mund të kundërshtojnë. Këto janë disa nga aspektet kritike që duhen marrë në konsideratë kur ngrihet një sistem komunikimi dhe ndarjeje informacioni në nivel vendor. Një sistem elektronik për komunikim dhe ndarje informacioni është një mjet i dobishëm, për sa kohë që siguron mbrojtjen e të dhënave, protokollet e qasjes, protokollet e ngarkimit të të dhënave dhe informacion të saktë dhe të plotë. Për integrimin funksional, po aq të rëndësishëm janë komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit në nivel profesional (midis profesionistëve në të njëjtin shërbim ose në shërbime të ndryshme), në nivel institucional (midis profesionistëve dhe menaxherëve), në nivel menaxherial (midis menaxherëve të shërbimeve të ndryshme dhe vendimmarrësve vendorë) dhe në nivel komuniteti (midis përfaqësuesve dhe shërbimeve të ndryshme të komunitetit). Duhet të ketë kanale të dakordësuara dhe efikase që u përgjigjen kontekseve specifike. Strategjitë dhe protokollet e komunikimit janë të nevojshme për sqarimin e roleve, përgjegjësive dhe procedurave.

FAKTORI KYÇ 6: KOHA Krijimi i kushteve për integrim të suksesshëm kërkon kohë: kohë për ndërtimin e partneriteteve dhe angazhimin e komunitetit; kohë për krijimin e një kulture bashkëpunimi (normash dhe praktikash) midis profesionistëve; kohë për planifikim të përbashkët nëpër sektorë; kohë për pjesëmarrje kuptimplote në vendimmarrje; dhe përshtatje reflektive përgjatë procesit. Përfshirja e një sasie të përshtatshme kohe në proceset e ndryshimit është thelbësore. Sa më i madh të jetë ndryshimi, aq më shumë kohë nevojitet.

Praktikat e mira

Bërja e një ndryshimi drejt më shumë bashkëpunimi kërkon kohë. Në varësi të kontekstit, traditat dhe kultura ekzistuese në shërbime dhe sektorë mund të mbështesin ose të jenë rezistente ndaj ndryshimit. Besimi i kërkuar midis njëri-tjetrit, angazhimi ndaj konceptit të punës së integruar ka nevojë për kohë të mjaftueshme për t'u rritur, zhvilluar dhe thelluar. Është e rëndësishme të lejohen proceset të zhvillohen me shpejtësinë e partnerëve të interesuar. Gjithashtu, do të duhet pak kohë që prindërit të kuptojnë se si po ndryshojnë disa shërbime të njohura, në lidhje me shërbimet e tjera. Edhe ata do të duhet të njihen dhe të mësohen me ofrimin e shërbimeve në ndryshim. Po aq e rëndësishme për të punuar në një mënyrë të integruar është të sigurohet kohë për dialog midis palëve të interesuara (partnerë, përfaqësues të komunitetit, familje, profesionistë, etj.). Kjo është thelbësore për harmonizimin e qasjeve dhe veprimeve, për planifikimin së bashku, për kalibrimin e punës së përbashkët, për përfitimin e aktiviteteve të përbashkëta të zhvillimit të vazhdueshëm profesional, si dhe për të reflektuar mbi rregullimet e mëvonshme të nevojshme për një integrim më funksional.

FAKTORI KYÇ 7: FINANCIMI Shërbimet shumë të bashkërenduara kërkojnë një ndryshim në mënyrën se si ndahen, planifikohen dhe përdoren financat. Efikasiteti i kostos përmendet si një atribut i ofrimit të bashkërenduar të shërbimeve.

Praktikat e mira

Bashkërendimi dhe integrimi i lartë i shërbimeve kërkon një kuptim të fortë të mënyrës se si hartohen dhe ndahen buxhetet. Arsyeja kryesore për promovimin e integrimit është t'i mundësohet më mirë çdo fëmije dhe familjeje të përmbushë nevojat e tyre specifike, duke zvogëluar çdo mangësi në qasje dhe rezultate. Kjo nënkupton identifikimin e fushave ku ekzistojnë kosto të mbivendosura midis sektorëve të ndryshëm dhe gjetjen e mënyrave për t'i zvogëluar ato, si dhe fushat në të cilat nevojiten fonde shtesë dhe gjetja e burimeve të ndryshme të financimit.

Ekzistojnë një sërë burimesh, nga ato vendore në ato kombëtare, nga ato publike në ato private. Rishikimi i literaturës ka treguar se kërkohen investime të konsiderueshme financiare për të mbështetur procesin e bashkërendimit të lartë. Investimet duhet të bëhen në fushat e mëposhtme: trajnim; mbledhje dhe menaxhim të të dhënave; mbështetje teknike; zhvillim politikash; planifikim i përbashkët; infrastrukturë, etj. Në shumë raste, kostot mund të tejkalojnë kostot e shërbimeve të fragmentuara, por vetëm në fillim. Nga një perspektivë afatgjatë, një sistem i integruar duhet të ofrojë një kthim të mirë të investimit duke zvogëluar tepricat, duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve dhe duke ofruar ndërhyrje më efikase. Në opsionet e financimit, është e rëndësishme të shkohet përtej qasjes tradicionale të rrjedhave të financimit të bazuara në probleme/çështje (domethënë, duke u përqendruar në arsimimin e hershëm) dhe të shkohet drejt mbështetjes dhe krijimit të zgjidhjeve shumëdimensionale (domethënë, duke u përqendruar në parandalimin e braktisjes së hershme të kopshtit, të cilat do të merrnin në konsideratë situatën e familjes, shëndetin, ushqyerjen, etj.). Kjo mund të trajtohet në mënyra të ndryshme (të cilat zakonisht janë specifike për vendin)

MODULI 3: BARAZI DHE GJITHËPËRFSHIRJE

Përmbledhje e modulit:

Moduli 2 fokusohet në zhvillimin e kapaciteteve të institucioneve arsimore dhe strukturave vendore për të siguruar qasje të barabartë dhe gjithëpërfshirëse në shërbimet e zhvillimit dhe edukimit/arsimimit të fëmijërisë së hershme. Ai trajton mënyrat për të identifikuar dhe trajtuar pengesat sistemike që pengojnë përfshirjen, si dhe për të forcuar bashkërendimin ndërsektorial ndërmjet arsimit, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale.

Pjesëmarrësit udhëhiqen drejt një kuptimi të thelluar të diversitetit dhe nevojave vendore, duke zhvilluar aftësi për të planifikuar, organizuar dhe zbatuar politika e praktika gjithëpërfshirëse në institucionet e arsimit parashkollor. Nëpërmjet sesioneve të modulit, ata do të mësojnë të kontekstualizojnë strategjitë kombëtare për të drejtat e fëmijëve dhe shëndetin publik në nivel vendor, të bashkëpunojnë me prindërit, mësuesit dhe aktorët vendorë për të mundësuar tranzicione të suksesshme nga kopshti në shkollë, si dhe të hartojnë plane arsimore/edukative individuale që garantojnë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara apo në situata të vështira sociale. Moduli synon të krijojë një kulturë institucionale që vlerëson diversitetin, nxit pjesëmarrjen aktive të të gjithë fëmijëve dhe i sheh shërbimet arsimore si pjesë e një sistemi më të gjerë zhvillimi dhe mbrojtjeje të fëmijës.

Qëllimi i modulit:

Të aftësohen pjesëmarrësit për të siguruar qasje të barabartë dhe gjithëpërfshirëse në shërbimet e zhvillimit dhe edukimit/arsimimit të fëmijërisë së hershme, në mënyrë që ato të jenë ndjeshme ndaj diversitetit, tranzicioneve dhe nevojave vendore.

Në përfundim të modulit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Kontekstualizojnë strategjitë ndërsektoriale për të kapërcyer pengesat e qasjes dhe të hartojnë plane tranzicioni nga arsimi parashkollor në arsimin fillor, duke përfshirë prindërit dhe mësuesit.
- Bashkërendojnë veprimet me sektorët e shëndetit dhe mbrojtjes së fëmijëve, në përputhje me Strategjinë Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve (2021–2026) dhe Strategjinë e Sektorit të Shëndetësisë.
- Prioritizojnë grupet e margjinalizuara – si fëmijët romë dhe egjiptianë, fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët që jetojnë në varfëri apo në zona të izoluara – në hartimin dhe zbatimin e shërbimeve arsimore dhe mbështetëse.

Grupi i synuar

Punonjës të arsimit pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, drejtues vendorë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme.

Sesioni 3.1: Konceptet kyç: krijimi terminologjisë për përfshirje

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë përgjegjësitë dhe hapësirat ligjore që mbështesin përfshirjen në arsimin parashkollor, duke zhvilluar njohuri mbi konceptet themelore të gjithëpërfshirjes si proces dinamik që garanton pjesëmarrjen aktive dhe të barabartë të çdo fëmije.

Sesioni synon të rrisë ndërgjegjësimin për rëndësinë e zvogëlimit të pengesave në të nxënit, të nxisë reflektimin mbi rolin e diversitetit dhe të forcojë kuptimin e ekuilibrit ndërmjet qasjeve sociale dhe mjekësore ndaj vështirësive të fëmijëve.
Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përkufizojnë konceptin e përfshirjes në arsim dhe të dallojnë ndryshimin nga mospërfshirja;
- Shpjegojnë pengesat që ndikojnë në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive;
- Analizojnë rolin e diversitetit dhe të burimeve mbështetëse për përfshirjen efektive.
- Reflektojnë mbi diskriminimin institucional dhe ndikimin e tij në mundësitë e barabarta për zhvillim.

Tematika:

1. Kuptimi i përfshirjes dhe mospërfshirjes.
2. Pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive.
3. Burimet për përkrahjen e procesit mësimor.
4. Përkrahja e diversitetit dhe roli i qasjeve gjithëpërfshirëse

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup (Shtojca nr.2)**

Ky seksion është përzgjedhur për të analizuar konceptin e përfshirjes dhe mospërfshirjes në arsimin parashkollor, duke identifikuar pengesat dhe burimet që ndikojnë në cilësinë e shërbimit. Ai synon të nxisë reflektim mbi praktikat reale, përfshirë shembuj të diskriminimit institucional dhe mënyrat për ta adresuar atë, duke e lidhur teorinë me situata konkrete. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e analizës të përdoren për përmirësimin e politikave vendore dhe garantimin e një shërbimi gjithëpërfshirës dhe të drejtë për çdo fëmijë. Reflektim mbi shembuj nga praktika që lidhen me diskriminimin institucional dhe përfshirjen

- **Sesion me Pyetje e Përgjigje (Shtojca nr.3)**

Ky sesion me pyetje dhe përgjigje është përzgjedhur për të nxitur reflektim dhe analizë mbi pengesat që ndikojnë në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive të fëmijëve. Ai synon të identifikojë faktorët që krijojnë pengesa, të eksplorojë burimet ekzistuese dhe të diskutojë mënyrat për mobilizimin e burimeve shtesë, duke e lidhur teorinë me praktikat konkrete në institucionet e arsimit parashkollor. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e sesionit të përdoren për përmirësimin e qasjes gjithëpërfshirëse dhe rritjen e cilësisë së shërbimit arsimor.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Mospërfshirja shpesh vjen nga pengesa kulturore dhe institucionale. Bashkitë kanë rol kyç në krijimin e politikave dhe praktikave që eliminojnë këto pengesa dhe garantojnë qasje të barabartë për çdo fëmijë.
- Mospërfshirja shpesh vjen nga pengesat kulturore dhe institucionale. Bashkitë kanë rol kyç në krijimin e politikave dhe praktikave që eliminojnë këto pengesa dhe garantojnë qasje të barabartë për çdo fëmijë

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit 3.1 “Konceptet kyç: krijimi terminologjisë për përfshirje”.

Korniza ligjore dhe dokumentet bazë për gjithëpërfshirjen në arsimin parashkollor dhe fillor

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”
- Udhëzimi Nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”
- Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020)
- Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Një Qasje e Re”- Udhëzues praktik për përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse në kopshtet.
- “Zbatimi i Kurrikulës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara” (ASCAP, 2024) Udhëzues për planifikimin e mësimdhënies dhe hartimin e PEI-it.
- Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të shpërndahen: Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Përfshirja

Të gjithë kanë mendimet e tyre rreth idesë aq komplekse siç është ajo e përfshirjes. Dimensionet, seksionet, treguesit dhe pyetjet jepin një këndvështrim më të hollësishëm. Për shumë njerëz termi përfshirje bëhet më i qartë me rastin e leximit të materialeve.

Përfshirja nënkupton ndryshimin dhe është një proces i vazhdueshëm i rritjes së nivelit të të nxënit dhe të pjesëmarrjes së të gjithë nxënësve. Kjo është një ide drejt së cilës

kopshti aspiron por që kur nuk arrihet plotësisht. Përfshirja ndodh në momentin kur fillon procesi i pjesëmarrjes së rritur në të nxënit. Në këtë moment, është femije përfshirëse ajo që ec përpara.

Përfshirja në sistemin edukativo-arsimor

- Vlerësimi i barabartë i të gjithë nxënësve dhe punonjësve.
- Rritja e nivelit të pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor të nxënësve dhe zvogëlimi i mospërfshirjes së tyre në kulturat, planprogramet dhe në bashkësitë e kopshtive.
- Ristrukturimi i kulturave, politikave dhe praktikave nëpër kopshti, në mënyrë që ato t'i përgjigjen diversitetit të nxënësve në vendoritet.
- Zvogëlimi i pengesave në të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive në procesin mësimor për të gjithë femijet, pra jo vetëm për ata me pengesa apo ata që kategorizohen si " nxënës me nevoja të posaçme në arsim".
- Marrja e përvojave nga përpjekjet për tejkalimin e pengesave në qasjen dhe pjesëmarrjen e disa nxënësve në krijimin e ndryshimeve në të mirë të nxënësve në përgjithësi.
- Të kuptuarit e dallimeve mes nxënësve si burim për përkrahjen e të nxënit e jo si probleme që duhet të zgjidhen.
- Pranimi i së drejtës së femijet për tu edukuar e arsimuar në vendin ku jeton.
- Përmirësimi i kopshtive si për punëtorët e arsimit ashtu edhe për femijet.
- Theksimi i rolit të kopshtit në ndërtimin e komunitetit apo të komunitetit dhe në krijimin e vlerave, si dhe në rritjen e rezultateve.
- Avancimi i marëdhënieve të ndërsjella mes kopshtive dhe bashkësive.
- Pranimi i faktit se përfshirja në sistemin edukativo-arsimor është një aspekt i përfshirjes në shoqëri.

Pjesëmarrja aktive në procesin mësimor do të thotë të mësosh përkrah të tjerëve dhe të bashkëpunosh me ta në ndarjen e përvojave të të nxënit. Kjo kërkon një angazhim aktiv në të nxënit dhe në vendimmarrje në lidhje me përvojat në sistemin edukativo-arsimor. Pjesëmarrja nga aspekti më i thellë kuptimor, ka të bëjë me të qenit i njohur, i pranuar dhe i vlerësuar për atë se kush je.

Zhvillimi i procesit të përfshirjes nënkupton zvogëlimin e trysnive për mospërfshirje. "Mospërfshirja disiplinore" është përjashtimi i përkohshëm apo i përhershëm i nxënësit për shkelje të rregullave të kopshtit. Kjo vjen si rezultat i trysnive për mospërfshirje. Sikurse përshirja, edhe mospërfshirja kuptohet në aspektin më të gjerë. Pra, u referohet të gjitha trysnive të përkohshme apo atyre që zgjasin më shumë, të cilat e pengojnë pjesëmarrjen e plotë në sistemin edukativo-arsimor. Kjo mund të vjen si rezultat i vështirësive në krijimin e raporteve, në lëndët mësimore dhe nga ndjenjat e vlerësimit të pamjaftushëm. Përfshirja në sistemin edukativo-arsimor ka të bëjë me minimizimin e të gjitha pengesave për femijët.

Përfshirja në sistemin edukativo-arsimor fillon me pranimin e ekzistimit të dallimeve mes nxënësve. Zhvillimi i qasjeve përfshirëse në mësimdhënie dhe të nxënit i respekton dhe i shfrytëzon këto dallime si bazë. Kjo mund të nënkuptojë ndryshime të mëdha në klasa, salla të mësuesve dhe punonjësve të tjerë, oborre të kopshteve dhe

në marrëdhëniet me prindërit apo kujdestarët. Për të përfshirë cilindo fëmijë apo person, ne duhet të merremi me tërë personalitetitn e tij. Kjo mund të shpërfillet në rastin kur përfshirja është e përqendruar vetëm në një aspekt, siç është p.sh. aftësia e kufizuar apo nevoja për të mësuar gjuhën angleze si gjuhë të dytë. Trysnitë për mospërfshirje te fëmija me aftësi të kufizuara mund të jetë kryesisht të orientuara në të kaluarën e tij apo mund të dalin si rezultat i mungesës së interesimit të tij në planprogram. Fëmijët që mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të dytë mund të ndjehen të zhvendosur nga kultura e tyre. Por, ne duhet t'i shmangemi të menduarit në mënyrë stereotipe. Nganjëherë këta fëmijë mund të kenë më shumë gjëra të përbashkëta, qoftë edhe në këto aspekte, me fëmijët gjuha amtare e të cilëve është anglishtja se sa me ata për të cilët kjo gjuhë nuk është amtare.

Puna në identifikimin dhe zvogëlimin e vështirësive të një femije mund të jetë e dobishme për shumë nxënës të tjerë, të cilët fillimisht të nxënit nuk e kanë patur prioritet. Kjo paraqet një mënyrë sipas së cilës dallimet mes interesave, diturisë, aftësive, biografisë, gjuhës amtare, arritjeve dhe pengesave të nxënësve mund të jenë burime në përkrahjen e të nxënit.

Fëmijët vazhdojnë të mospërfshihen në rrjedhat kryesore të sistemit edukativo-arsimor për shkak të paaftësisë së tyre apo për shkak të asaj që konsiderohen se "kanë vështirësi në të nxënit". Ky proces duhet të vështirësohet nga Ligji për nevoja të posaçme edukativo-arsimore dhe për aftësitë e kufizuara, kodi i praktikës në kopshte për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara dhe Udhëzimi statutor për arsimin përfshirës, i ndërlidhur me këtë ligj. Ky udhëzim statutor vë në pah se përfshirja në arsim nganjëherë "bllokohet" për shkaqe "të parëndësishme dhe jo të duhura". Nëse prindërit kanë dëshirë, kopshtet dhe ALA-të janë të detyruara me ligj të punojnë për ta bërë të mundshme që fëmija me aftësi të kufizuara të vijojë arsimin e rregullt dhe të marrë pjesë aktivisht në të. Megjithatë, kjo është më pak se pranimi i së drejtës së fëmijës në arsimin e rregullt.

Përfshirja në arsim ka të bëjë me shndërrimin e kopshteve në vende përkrahëse dhe nxitëse për punonjësit e arsimit dhe fëmijët. Ka të bëjë me ndërtimin e komuniteteve, të cilat nxitin dhe kremtojnë arritjet e tyre. Përveç kësaj, përfshirja në arsim ka të bëjë edhe me ndërtimin e komunitetit apo komunitetit në aspektin më të gjerë. Kopshtet mund të punojnë me agjencitë dhe bashkësitë e tjera për t'i përmirësuar mundësitë për arsim dhe kushtet sociale në vendet e tyre.

Pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive në procesin mësimor

Koncepti "pengesat në të nxënit dhe në pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor" ofron një alternativë për konceptin "nevojat e posaçme në arsim". Ideja që vështirësitë në arsim mund të zgjidhen duke i identifikuar disa fëmijë si "me nevoja të posaçme për arsim" ngërthen në vete kufizime të konsiderueshme. Kjo ide nënkupton një etiketim, që mund të çojë në pritshmëri më të ulta dhe gjithashtu të shmangë vëmendjen nga fëmijët e tjerë, të cilët nuk e kanë këtë etiketim, si dhe nga burimet e vështirësive në krijimin e raporteve, kulturave, planprogrameve, qasjeve të mësimdhënies dhe të nxënit, organizimit të kopshtit dhe politikën e saj të punës. Gjithashtu, kjo ide kontribuon në fragmentarizimin e përpjekjeve të kopshteve në reagimin pozitiv ndaj diversitetit të nxënësve të grupuar nën kategoritë e ndryshme, siç janë "nevojat e posaçme në arsim", "anglishtja si gjuhë e dytë" "pakicë etnike", " me prirje dhe i talentuar", etj.

Nocioni “pengesat në të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive në procesin mësimor” mund të shfrytëzohet për të drejtuar vëmendjen në atë se çka duhet të bëhet në përmirësimin e arsimit të secilit fëmijë. Fëmijët ballafaqohen me veshtirësi kur përjetojnë pengesa në të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive. Pengesat mund të paraqiten në të gjitha aspektet shkollore dhe po ashtu edhe në kuadër të bashkësive, si dhe në politikat vendore e kombëtare. Pengesat gjithashtu shkaktohen në ndërveprimet mes nxënësve dhe të asaj çka mësojnë dhe si mësohen ata. Pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje mund të parandalojnë qasjen në kopshte apo ta kufizojnë pjesëmarrjen aktive në to.
Edhe pse, termi “nxënës me nevoja të veçanta/ me aftësi ndryshe” mund të jetë pengesë në zhvillimin e praktikës përfshirëse në kopshte, ai mbetet pjesë e kulturës dhe kornizës së politikave në të gjitha kopshtet dhe ndikon në një sërë praktikash. Ky term përdoret në kuadër të identifikimit të vështirësive të nxënësve dhe gjatë realizimit të planeve individuale edukativo-arsimore dhe në informacionin që duhet t’u ofrojnë kopshteve për të panifikuar shpenzimet. Shumica e kopshteve e bëjnë këtë dhe inkurajohen në këtë aspekt.. Terma të tilla inkurajojnë një përkrahje më të gjerë, e cila e ndërlidh punën e kryer me femijet që hasin në vështirësi dhe me ndryshimet e nevojshme për ta.
Ndryshimi i mënyrës së të menduarit lidhur me vështirësitë në arsim krijon një ndërlikueshmëri, pasi që për arritjen e disa qëllimeve ne duhet të punojmë me termat ekzistuese. Por ata që zbatojnë koncepte alternative kuptojnë kontributin e tyre në ofrimin e mundësive të tjera për identifikimin e tejkalimin e vështirësive në kopsht.

Burimet për përkrahjen e mësimdhënies dhe pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor

Minimizimi i pengesave në të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive në procesin mësimor nënkupton mobilizimin e burimeve në kuadër të kopshtit dhe të bashkësive të tij. Në çdo vend, gjithmonë ekzistojnë më shumë burime për përkrahjen e mësimdhënies dhe të pjesëmarrjes aktive sesa që përdoren aktualisht. Burimet nuk kanë të bëjnë vetëm me paratë. Sikurse pengesat, burimet mund të gjenden në çdo aspekt shkollor: te femijët, prindërit apo kujdestarët, bashkësitë dhe mësuesit; në ndryshime të kulturave, politikave të punës dhe të praktikave. Në veçanti, burimet e vetë nxënësve dhe kapaciteti i tyre për të drejtuar dhe përkrahur të nxënit e njëri-tjetrit mund të mos shfrytëzohen sa duhet, siç mund të jetë rasti edhe me potencialin e punonjësve të arsimit për të përkrahur zhvillimin e njëri-tjetrit. Në kopsht ekzistojnë njohuri të gjëra për pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive të nxënësve, e cila jo gjithmonë shfrytëzohet deri në maksimum. Udhëzuesi i ndihmon kopshtet të shfrytëzojnë këtë njohuri për të pasur një zhvillim të kopshtit të bazuar në të dhëna.

Tabela e mëposhtme ofron disa pyetje që mund të përdoren për pasqyrimin e njohurive ekzistuese për kulturat, politikat e punës dhe praktikat nëpër kopshte.

Trajtimi i pengesave dhe burimeve në kopshte

- Cilat janë pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive?
- Kush ballafaqohet me pengesa në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive?
- Si mund të minimizohen pengesat në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive?
- Cila burime për përkrahjen e të nxënit dhe pjesëmarrjes aktive janë në dispozicion?
- Si mund të vëhen në lëvizje burimet shtesë në të nxënit dhe pjesëmarrje aktive?

Përkrahja e diversitetit

Me rastin e krijimit të vështirësive nga "nevojat e posaçme për arsim" të fëmijëve dhe të rinjve, duket e natyrshme që të mendohet për përkrahje në kuptim të ofrimit të personelit shtesë që të punojnë me fëmijët e caktuar. Udhëzuesi ngërthen një qasje shumë më të gjerë të përkrahjes së të gjitha aktiviteteve, të cilat e rrisin kapacitetin e kopshtit në aspektin e diversitetit të nxënësve. Ofrimi i përkrahjes për fëmijët e caktuar është vetëm pjesë e përpjekjes për ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes aktive të nxënësve në procesin mësimor. Përkrahja gjithashtu ofrohet kur mësuesit i planifikojnë mësimet duke i marrë parasysh të gjithë fëmijët e klasës dhe duke i pranuar pikënisjet, përvojat dhe stilet e ndryshme të të nxënit. Kjo përkrahje mund të ofrohet edhe kur fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin. Kur aktivitetet e të nxënit planifikohen me qëllim të përkrahjes së pjesëmarrjes aktive të të gjithë nxënësve, nevoja për përkrahje individuale zvogëlohet. Në mënyrë të ngjashme me këtë, përvoja në përkrahjen e individit mund të çojë në rritje të të nxënit aktive dhe të pavarur, si dhe mund të kontribuojë në përmirësime të mësimdhënies për një grup më të madh të nxënësve. Në përkrahje përfshihen si mësimdhënësit ashtu edhe fëmijët. Përgjegjësia kryesore për bashkërenditjen e përkrahjes mund të mbartet nga një numër i kufizuar i njerëzve, mirëpo gjatë analizës së bashkërendimit të përkrahjes është shumë e rëndësishme që të bëhet ndëlidhja mes përkrahjes për individët dhe grupet me aktivitetet zhvillimore të punonjësve të arsimit dhe të planprogramit.

Modeli shoqëror i vështirësive dhe i aftësive të kufizuara në arsim

Përdorimi i konceptit "pengesat në të nxënit dhe në pjesëmarrje akive në procesin mësimor", me të cilat fëmijët ballafaqohen, e jo i termit "nevojat e posaçme në arsim", është pjesë e modelit shoqëror të vështirësive në të nxënit dhe në aftësi të kufizuara. Në dallim prej kësaj, në modelin mjekësor, vështirësitë në arsim shihen si rezultat i mungesave patologjike apo pengesave tek fëmija apo tek i riu. Sipas modelit shoqëror, pengesat në të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive mund të ekzistojnë në mjedis apo dalin si rezultat i ndërveprimit mes nxënësve dhe mjedisit të tyre, pra, njerëzve, politikave, institucioneve, kulturave dhe rrethanave ekonomiko-shoqërore që ndikojnë në jetën e tyre.

Aftësitë e kufizuara shkaktojnë pengesa në pjesëmarrjen aktive për femijet me paaftësi apo me sëmundje kronike. Paaftësitë mund të krijohen në mjedis apo me ndërveprimin

e qendrimeve, veprimeve, kulturave, politikave dhe praktikave institucionale diskriminuese me paaftësi, dhimbje, apo me sëmundje kronike. Paftësia mund të përkufizohet si “kufizim afatgjatë i funkcionit fizik, intelektual apo shqisor,1 edhe pse nocioni i kufizimit të aftësisë intelektuale është problematik dhe mund të nënkuptojë një arsye të pabazuar fizike për vështirësitë. Derisa kopshtit mund të bëjnë shumë pak në shërimin e paaftësive fizike, ato mund t’i zvogëlojnë në masë të konsiderueshme paaftësit që rrjedhin prej qendrimeve dhe veprimeve diskriminuese, si dhe prej pengesave institucionale.

Diskriminimi institucional

Diskriminimi institucional është thellë i rrënjosur brenda kulturave dhe ndikon në mënyrën se si njerëzit perceptohen, si dhe në reagimet ndaj tyre, duke përfshirë edhe mënyrën e emërimit të punonjësve në vendet e tyre të punës. Diskriminimi institucional është shumë më i përhapur se racizimi. Ky diskriminim përfshinë mënyrat se si institucionet mund të mos u ofrojnë mundësi njerëzve për shkak të gjinisë, aftësisë së kufizuar, shtresës shoqërore, përkatësisë etnike apo për shkak të orientimit seksual të tyre. Kjo paraqet një pengesë në pjesëmarrjen aktive në procesin edukativo-arsimor dhe mund të ndikojë negativisht edhe në të nxënit. Për shkak se njerëzit janë më shumë të familiarizuar me diskutimet rreth racizimit apo seksizmit se sa me diskutimet rreth aftësisë së kufizuar, ata mund të jenë më pak të njohur me përfshirjen e njerëzve dhe të institucioneve në krijimin e aftësisë së kufizuar. Racizimi, seksizmi, ndarja në klasa shoqërore, homofobia dhe aftësitë e kufizuara si emërues të përbashkët kanë jotolerancën ndaj dallimeve dhe shpërdorimin e pushtetit për krijimin dhe përjetësimin e pabarazive. Rritja e nivelit të përfshirjes në arsim mund t’i fusë njerëzit në një proces të vështirë të sfidimit të praktikave dhe qëndrimeve të tyre diskriminuese.

[1] Marrë nga Diasbled People’s International, 1981.

Sesioni 3.2 Procese per realizimin e nje qasjeje gjithëpërfshirëse në institucionet e arsimit parashkollor.

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të shndërrojnë konceptin e përfshirjes në praktikë institucionale të qëndrueshme, duke e lidhur me kornizat ligjore dhe mekanizmat vendorë të zbatimit.

Sesioni synon të forcojë aftësitë e drejtuesve të kopshteve, edukatorëve dhe specialistëve **vendorë** të mundësojnë ndërtimin e një procesi gjithëpërfshirës në institucionet e arsimit parashkollor, duke u pajisur me njohuri, mjete praktike dhe qasje bashkëpunuese që mbështesin qasjen, pjesëmarrjen dhe arritjet e të gjithë fëmijëve, në partneritet me prindërit, komunitetin dhe autoritetet vendore.

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë rëndësinë e përfshirjes si proces institucional dhe shoqëror;
- Njohin kornizën për shqyrtim të përfshirjes bazuar në tri dimensionet kryesore: kultura, politikat dhe praktikat;
- Përshkruajnë dhe zbatojnë fazat e procesit të Udhëzuesit për përfshirje (nga vlerësimi fillestar deri te rishikimi i përmirësimeve);
- Identifikojnë pengesat dhe burimet që ndikojnë në nivel institucioni;
- Zbatojnë metoda pjesëmarrëse për planifikimin dhe zhvillimin gjithëpërfshirës në kopshtet dhe institucionet e tyre.

Tematika:

1. Koncepti i përfshirjes në arsimin parashkollor.
2. Korniza për shqyrtim: kultura – politikat – praktikat.
3. Përshkrimi i fazave të Udhëzuesit:
    a. Fillimi i punës me udhëzuesin
    b. Marrja e informacioneve për institucionin
    c. Hartimi i planit për përfshirje
    d. Përkrahja e zhvillimit
    e. Rishikimi i procesit të udhëzuesit
4. Roli i grupit planifikues dhe “mikut kritik”.
5. Identifikimi i pengesave dhe burimeve.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t’u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Puna në grupe mbi Udhëzuesin (Shtojca nr.2)**

Ky ushtrim është përzgjedhur për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë në mënyrë praktike procesin e Udhëzuesit për përfshirje në institucionet e arsimit parashkollor dhe për të identifikuar prioritetet që dalin nga ky proces. Ai synon të lidhë parimet e gjithëpërfshirjes me veprimet konkrete që mund të ndërmerren në nivel institucional, duke nxitur analizën dhe bashkëpunimin për zbatimin e standardeve kombëtare. Në

këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e punës në grup të përdoren për përmirësimin e praktikave vendore dhe forcimin e kapaciteteve për menaxhimin e shërbimeve të arsimit parashkollor.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Mospërfshirja shpesh vjen nga pengesa kulturore dhe institucionale. Bashkitë kanë rol kyç në krijimin e politikave dhe praktikave që eliminojnë këto pengesa dhe garantojnë qasje të barabartë për çdo fëmijë.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

Materialet e prezantimit në PowerPoint të sesionit 3.1 “Konceptet kyç: krijimi i terminologjisë për përfshirje”.

Korniza ligjore dhe dokumentet bazë për gjithëpërfshirjen në arsimin parashkollor dhe fillor.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Ligji Nr. 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar”
- Udhëzimi Nr. 26, datë 25.11.2019 “Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”
- Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020)
- Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Një Qasje e Re”- Udhëzues praktik për përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse në kopshte.
- “Zbatimi i Kurrikulës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara” (ASCAP, 2024) Udhëzues për planifikimin e mësimdhënies dhe hartimin e PIE.
- Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të shpërndahen: Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Qasja gjithëpërfshirëse në arsimin parashkollor është një filozofi dhe praktikë që synon të garantojë pjesëmarrjen e barabartë dhe zhvillimin e çdo fëmije, pavarësisht prejardhjes, aftësive apo statusit social. Ky proces nuk është një veprim i vetëm, por një rrugëtim i vazhdueshëm që kërkon angazhim institucional, bashkëpunim ndërsektorial dhe përshtatje të vazhdueshme ndaj nevojave të fëmijëve dhe komunitetit.

Realizimi i kësaj qasjeje fillon me **analizën e kontekstit** dhe identifikimin e pengesave që kufizojnë pjesëmarrjen. Institucionet duhet të ristrukturojnë politikat, kulturat dhe praktikat e tyre për t'iu përgjigjur diversitetit, duke e parë atë si një vlerë dhe jo si pengesë. Ky proces përfshin **përdorimin e burimeve mbështetëse**, si trajnimi i stafit, hartimi i Planeve Edukative Individuale (PEI), sigurimi i materialeve të përshtatura dhe teknologjive ndihmëse.

Një element thelbësor është **bashkëpunimi i ngushtë mes kopshtit, prindërve, bashkive dhe shërbimeve sociale**, për të garantuar mbështetje të plotë dhe bashkërendim efektiv. Përfshirja nuk mund të arrihet pa **monitorim dhe *feedback* të vazhdueshëm**, që ndihmojnë në përshtatjen e strategjive dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve.

Në thelb, qasja gjithëpërfshirëse synon **eliminimin e pengesave**, **përdorimin e diversitetit si burim për të pasuruar të nxënit**, dhe **krijimin e një mjedisi ku çdo fëmijë merr pjesë aktivisht dhe zhvillohet në mënyrë të barabartë**. Ky session do t'ju udhëheqë përmes parimeve, proceseve dhe praktikave më të mira për ta bërë këtë vizion realitet në institucionet e arsimit parashkollor.

Ky modul është konceptuar si një udhëzues i cili do të udhëheqë drejtues dhe punonjës të arsimit parashkollor drejt një rrugëtimi i cili kërkon bashkëpunim me institucione në nivel qendror, vendor dhe bashkëpunim me prindër dhe komunitetin. I konceptur si një metodologji që kombinon leksionin me aktivitete dhe punë në grup pjesëmarrësit do të mund të kuptojne hapat për realizimin e procesit dhe burimet të ciliat duhet të perfshijnë drejt realizimit te tij.

Korniza për shqyrtim: dimensionet dhe seksionet

Përfshirja dhe mospërfshirja shqyrtohen përmes tri dimensioneve të ndërlidhura për përmirësimin e kopshtit. Këto tri dimensione janë: krijimi i kulturave gjithëpërfshirëse, i politikave gjithëpërfshirëse dhe zhvillimi i praktikave gjithëpërfshirëse. Këto dimensione janë zgjidhur për të orientuar mendimet lidhur me ndryshimin në kopshti. Përvoja nga përdorimi i Udhëzuesit tregon se këto dimensione shihen nga shumë njerëz si mënyra të rëndësishme për strukturimin e zhvillimit të kopshtit.

Të tria dimensionet janë të nevojshme për zhvillimin e gjithëpërfshirjes në kopsht dhe çfarëdo plani për ndryshimin e kopshtit duhet t'u kushtojë vëmendje që të triave.

Tri dimensionet e Udhëzuesit

Dimensioni i “krijimit të kulturave gjithëpërfshirëse” vendoset me qëllim në bazën e trekëndëshit. Nganjëherë, shumë pak vëmendje i kushtohet potencialit të kulturave shkollore për përkrahjen apo shkatërrimin e zhvillimeve në mësimdhënie dhe të nxënit, edhe pse ato janë fuqia motorike për përmirësimin e kopshteve. Zhvillimi i vlerave të përbashkëta lidhur me përfshirjen dhe marrëdhëniet bashkëpunuese mund të çojnë në ndryshime të dimensioneve të tjera. Pra, përmes kulturave përfshirëse shkollore punonjësit e rinj të arsimit dhe fëmijët mund t’i jetësojnë ndryshimet në politika dhe në praktika.

Për të përqendruar edhe më shumë vëmendjen në detyrat për përmirësimin e mësimdhënies dhe të pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor, çdo dimension ndahet në dy pjesë. Dimensionet dhe pjesët e tyre janë të paraqitura në tabelën 4. Së bashku, ato paraqesin kornizën për shqyrtim lidhur me strukturimin e planit për zhvillimin e kopshteve dhe mund të bëhen si udhërrëfyes të tij. Pra, kopshtet do të dëshironin që të jenë të sigurura në shkuarjen përpara në të gjitha këto fusha.

Dimensionet dhe pjesët e Udhëzuesit
DIMENSIONI A Krijimi i kulturës për gjithëpërfshirje në arsimin fillor
Pjesa A.1 Ndërtimi i komunitetit (komunitetit)
Pjesa A.2 Krijimi i vlerave të përfshirjes në arsim
Ky dimension krijon një bashkësi të sigurtë, pranuese, bashkëpunuese dhe nxitëse, ku secili vlerësohet si bazë për arritjen e rezultateve më të larta të të gjithëve. Gjithashtu, ky dimension zhvillon vlerat e përbashkëta të përfshirjes në arsim, të cilat i mbarten punonjësve të rinj të arsimit, nxënësve, drejtorëve dhe prindërve apo kujdestarëve. Parimet dhe vlerat në kulturën e gjithëpërfshirjes në arsimin fillor janë udhërrëfyese të vendimeve për politikat e punës dhe për praktikën e përditshme në klasë, në mënyrë që zhvillimi i kopshtit të jetë një proces i vazhdueshëm.
DIMENSIONI B Krijimi i politikave të gjithëpërfshirjes në arsim
Pjesa B.1 Krijimi i kopshtit për të gjithë
Pjesa B.2 Organizimi i përkrahjes për diversitetin
Ky dimension siguron që gjithëpërfshirja të jetë pjesë përbërëse e të gjitha planeve të kopshtit. Gjithashtu siguron që politikat e punës të inkurajojnë pjesëmarrjen aktive të nxënësve dhe të punonjësve të arsimit prej momentit të fillimit të arsimit, të krijojnë kontakte me të gjithë fëmijët në vendoritet dhe të minimizojnë trysnitë për mospërfshirje. Të gjitha politikat e punës duhet të kenë strategjinë e qartë për ndryshime. Përkrahja duhet të jepet për të gjitha aktivitetet, të cilat e ngrenë kapacitetin e kopshtit në lidhje me diversitetin e nxënësve. Për më tepër, ky dimension parashikon që të gjitha format e përkrahjes të zhvillohen në përputhje me parimet e përfshirjes në arsim dhe të bashkohen në një kornizë të vetme.
DIMENSIONI C Zhvillimi i praktikave të përfshirjes në arsim
Pjesa C.1 Organizimi i të nxënit
Pjesa C.2 Mobilizimi i burimeve
Ky dimension i zhvillon praktikat shkollore, të cilat pasqyrojnë kulturat dhe politikat e punës gjithëpërfshirëse në kopsht. Njësitë mësimore i përshtaten diversitetit të

nxënësve. Fëmijët inkurajohen të marrin pjesë aktivisht në të gjitha aspektet e arsimit të tyre që rrjedhin nga njohuritë dhe përvojat e tyre jashtë kopshtit. Punonjësit e arsimit i identifikojnë burimet materiale, fëmijët, prindërit apo kujdestarët dhe bashkësitë e vendoritetit, që mund të mobilizohen në përkrahje të të nxënit dhe të pjesëmarrjes aktive në procesin mësimor.

Procesi i Udhëzuesit për përfshirje në institucionet e arsimit parashkollor

Faza 1 Fillimi i punës me Udhëzues

- Krijimi i grupit planifikues;
- Shqyrtimi i qasjes në planifikim;
- Ndërgjegjësimi për Udhëzuesin;
- Shtjellimi i njohurive ekzistuese duke i përdorur konceptet kyç dhe kornizën për shqyrtim;
- Thellimi i analizës duke i përdorur treguesit dhe pyetjet dhe
- Përgatitja për të punuar me grupet e tjera

Faza 2 Marrja e informacionit për institucionin

- Shtjellimi i njohurive dhe ideve të edukatorëve dhe të drejtorisë apo drejtorëve;
- Shtjellimi i njohurive dhe ideve të fëmijëve dhe të të rinjve;
- Shtjellimi i njohurive të prindërve apo kujdestarëve dhe anëtarëve të bashkësive vendore dhe
- Caktimi i prioriteteve për zhvillim.

Faza 3 Hartimi i planit për gjithëpërfshirje

- Shqyrtimi i prioriteteve me anë të kornizës së planifikimit;
- Futja e prioriteteve në planin zhvillimor.

Faza 4 Përkrahja e zhvillimit

- Zbatimi i prioriteteve në praktikë;
- Zhvillimi i qëndrueshëm.

Faza 5 Rishikimi i procesit të Udhëzuesit

- Vlerësimi dhe regjistrimi i zhvillimeve;
- Rishikimi i punës me Udhëzues dhe Vazhdimi i procesit të Udhëzuesit.

Udhëzuesi nuk ka të bëjë vetëm procesin gradual dhe të planifikuar me kujdes të identifikimit dhe të zbatimit të prioriteteve për ndryshime, procesi i zhvillimit është gjithnjë e më i ndërlikuar. Trajtimi i ndryshimeve të vlerave në Udhëzues mund t'i nxisë edukatorët dhe fëmijët të bëjnë përshtatje të kulturave, politikave të punës dhe të praktikave, të cilat janë shumë më të paparashikueshme se sa puna në çfarëdo prioriteti të identifikuar. Kjo mund të nënkuptojë ndryshime të mëdha në mënyrën e

ndërveprimit të edukatorëve apo ndryshime të vogla në mënyrën se si ndonjë edukator krijon raporte me fëmijët.
Me vazhdimin e hulumtimit të kulturave, politikave të punës dhe të praktikave të institucionit, mundësitë për zhvillimin gjithëpërfshirës mund të dalin në pah, edhe pse më parë ndoshta nuk janë vërejtur.
Edukatorët mund të shohin se në disa aspekte institucioni është më pak përfshirës sesa që fillimisht kanë menduar. Kjo do të ekuilibrohet me zbulimin e burimeve për përkrahjen e lojës, të nxënit dhe të pjesëmarrjes aktive të edukatorëve, fëmijëve, prindërve apo kujdestarëve, drejtorisë apo drejtorëve dhe të bashkësive përreth.

Koha që nevojitet për procesin e Udhëzuesit
Për shkak të mënyrave të ndryshme të përdorimit të Udhëzuesit, është vështirë që të caktohet koha e nevojshme për shtjellimin e këtyre mënyrave. Nëse institucioni e zbaton ciklin vjetor të planifikimit, i cili zgjat prej shtatorit deri në korrik, atëherë pesë fazat e Udhëzuesit duhet t'i përshtaten këtij planifikimi. Kjo do të thotë se faza e parë, e cila trajtohet si shtesë e ciklit planifikues, për shkak të familiarizimit të grupit planifikues me materialet do të duhej të kryhet para shtatorit. Pra, puna përgatitore e grupit dhe puna me Udhëzuesin do të mund të fillonin në verë dhe pastaj konsultimet dhe planifikimi më i hollësishëm do të fillonin prej shtatorit deri në dhjetor, ndërsa procesi i zbatimit dhe rishikimit do të zgjasnin prej janarit deri në korrik.

Mënyra e organizimit të procesit të Udhëzuesit		
Faza 1	Fillimi i punës me Udhëzues	qershor-korrik
Faza 2	Marrja e informacionit për institucionin	shtator-dhjetor
Faza 3	Krijimi i planit gjithëpërfshirës	
Faza 4	Përkrahja e zhvillimit	janar-korrik
Faza 5	Rishikimi i procesit të Udhëzuesit	

Puna me të tjerët
Edhe pse Udhëzuesi mund të shfrytëzohet nga institucionet në mënyrë vetjake, shumica prej tyre do ta mirëprisnin përkrahjen nga jashtë, posaçërisht në fazat fillestare të punës. Një seminar me njerëzit përgjegjës të institucionit të arsimit parashkollor i udhëhequr nga personi i familiarizuar me Udhëzuesin, mund të ndihmojë në futjen e proceseve në lëvizje.

<u>Faza 1: Fillimi i punës me Udhëzuesin për përfshirje në institucionet e arsimit parashkollor</u>

- Krijimi i grupit planifikues
- Rishikimi i qasjes në planifikim
- Ndërgjegjësimi për Udhëzuesin
- Shtjellimi i njohurive ekzistuese duke përdorur konceptet dhe kornizën për shqyrtim
- Thellimi i studimit duke i përdorur treguesit dhe pyetjet
- Përgatitja e punës me grupet e tjera të punës



Faza e parë e Udhëzuesit fillon me caktimin e një grupi njerëzish, të cilët do ta udhëheqin procesin e vetëshqyrtimit. Anëtarët e grupit rrisin ndërgjegjësimin për Udhëzuesin në institucion, e informojnë njëri-tjetrin për materialet dhe përgatiten t'i shfrytëzojnë ato për analizën e gjendjes aktuale në institucionin e arsimit parashkollor së bashku me edukatorët, drejtoritë apo drejtorët, prindërit apo kujdestarët dhe fëmijët. Kjo fazë mund të përfundohet gjatë një periudhe dymujore.

Për të strukturuar dhe përkrahur punën e grupit bashkërendues, në këtë fazë mund të përfshihen gjithsej 11 aktivitete. Në kryerjen e këtyre aktiviteteve supozohet se anëtarët e grupit e kanë lexuar pjesën e parë. Çdo aktivitet duhet të jetë i kufizuar në kohë dhe duhet të zbatohet nga nëngrupet e përbëra prej jo më shumë se 4 anëtarëve. Gjithashtu, këto aktivitete mund të shfrytëzohen në seminare për të familiarizuar grupet e tjera me materialet dhe për t'iu ndihmuar të vendosin se si do t'i shfrytëzojnë ato.

Themelimi i grupit planifikues

Grupi planifikues duhet të zgjidhet në mënyrë strategjike ashtu që të ketë gjasat më të mira për të zbatuar përfshirjen në praktikë. Përbërja e tij do të varet nga madhësia dhe karakteri i institucionit të arsimit parashkollor. Ky grup mund të jetë përgjegjës për një numër të institucioneve të vogla, që në mënyrë të kombinuar do ta rishikonin zhvillimin

e njëri-tjetrit. Nëse kjo nuk do të ishte e mundshme, atëherë do të ishte shumë e rëndësishme që edukatorët në institucionet e vogla të punojnë me dikë jashtë institucionit, që ndoshta do të mund ta luajë rolin e “mikut kritik”, siç përshkruhet në vijim të tekstit. Në institucionet më të mëdha të arsimit parashkollor, në grupin planifikues gjithmonë duhet të jetë një edukator me përvojë dhe bashkërenduesi për të nxënit dhe përkrahje apo bashkërenduesi për përfshirje.
Është me rëndësi që grupi ta pasqyrojë përbërjen gjinore dhe etnike të institucionit dhe gjithashtu mund të ketë në përbërjen e tij edhe përfaqësues të prindërve a kujdestarëve, të komunitetit vendore dhe të këshillit drejtues apo të drejtorëve. Materialet duhet të jenë në dispozicion për të tërë grupin planifikues dhe fotokopjimi i çfarëdo materiali për përdorim duhet të inkurajohet. Këto materiale mund të përmbajnë tregues dhe pyetje shtesë, analiza të konsultimeve me të tjerët dhe kopjet e temave që duhet të prezantohen.

Angazhimi i “mikut kritik”

Përfshirja e “mikut kritik” shpesh ka qenë e dobishme për bashkërendimin e grupeve. Ky person nuk duhet të jetë punonjës i institucionit të arsimit parashkollor, por megjithatë duhet të ketë njohuri mjaft të mira për të, duhet të jetë përkrahës i proceseve dhe i përkushtuar në çuarjen e tyre deri në fund. Ky person duhet të gëzojë besimin e grupit dhe të institucionit, si dhe të respektojë natyrën e ndjeshme të disa diskutimeve, në të cilat ai do të përfshihet. Ky person mund të jetë një njeri që tanimë është familiarizuar me Udhëzuesin dhe i cili mund të ndihmojë në marrjen e informacioneve të hollësishme për kopshtin dhe mbledhjen e analizën e këndvështrimeve të edukatorëve, këshillit drejtues apo drejtorëve dhe fëmijëve. Ky person mund të jetë profesionalisht i përfshirë në institucion apo kolegu nga institucioni tjetër, ndoshta dikush që gjithashtu është duke punuar me Udhëzues. Roli i “mikut kritik’ mund të ndihmojë në krijimin e bashkëpunimit.

Miku kritik mund të ndihmojë që të mos shmanget trajtimi i çështjeve të diskutueshme. Gjithashtu, te të gjithë anëtarët e grupit duhet të ekzistojë dëshira për një sfidim të kolegëve për të ofruar dëshmi lidhur me mendimet dhe përfundimet e tyre. Partneriteti me miqtë kritikë mund të jetë model për krijimin e marrëdhënieve profesionale.

Puna gjithëpërfshirëse

Grupi planifikues duhet të bëhet një model për praktikën përfshirëse. Kjo bëhet duke bashkëpunuar dhe duke u siguruar që të gjithë të dëgjohen me kujdes pavarësisht nga përkatësia gjinore, racore, fetare dhe nga shtresa sociale e tyre. Anëtarët e grupit duhet ta kenë ndjenjën e besimit në njëri-tjetrin dhe të kenë mundësinë të flasin lirshëm e me konfidencialitet. Secili anëtar i grupit duhet të jep mendimet e veta me qëllim të nxitjes së dialogut. Dallimet në mendime duhet të jenë si një burim për avancimin e mendimeve të grupit.

Shqyrtimi i qasjes në planifikim

Puna me Udhëzuesin ofron mundësinë për të shqyrtuar mënyrën e planifikimit. Institucionet e arsimit parashkollor dallojnë shumë në qasjen e tyre lidhur me planifikimin e zhvillimit. Disa përfshijnë një grup të gjerë të njerëzve, të cilët punojnë së

bashku në një mënyrë relativisht sistematike ashtu si në procesin e përshkruar këtu. Në institucionet e tjera, dokumenti i shkruar mund të jetë hartuar si përgjigje ndaj kërkesave të inspektorëve dhe mund të ketë përfshirë shumë pak anëtarë të kopshtit. Udhëzuesi mund t'i ndihmojë të gjitha këto qasje në planifikim. Në disa institucione planifikimi sistematik mund të kufizohet për shkak të buxhetit. Udhëzuesi mund të ndihmojë në përvetësimin e qasjeve të ndryshme në planifikim dhe mund t'i çojë institucionet prej një procesi relativisht mospërfshirës në atë më përfshirës.

Ne e mendojmë planin zhvillimor si një grup të parimeve dhe tregues të përgjithshëm për ndryshimet e planifikuara për tri deri në pesë vitet pasuese dhe, më pastaj, si një shpjegim të hollësishëm për detyrat që duhet të përmbushen në vitin e ardhshëm. Disa njerëz e quajnë të njëjtin dokument si plan të veprimeve, edhe pse ne mendojmë për planin e veprimit si një dokument që përmban hollësitë rreth ndryshimeve që duhet të bëhen në fushën përkatëse. Pra, një plan zhvillimor mund të ketë disa plane të veprimeve. Ndryshimi mund të konsiderohet si zhvillim vetëm atëherë kur bëhet sipas vlerave të shprehura qartë, për të cilat është arritur pajtimi.

Anëtarët e grupit planifikues mund t'i shfrytëzojnë pyetjet nga aktiviteti 1 për të strukturuar rishikimin e qasjes në në zhvillimin e planifikimit.

Aktiviteti 1 Shqyrtimi i hartimit të planifikimit
(koha e sugjeruar: 1 orë)

- Çfarë lloj planifikimi zbatohet?
- Deri në çfarë mase ndikon planifikimi ndaj trysnive apo sa është sistematikisht i ndërlidhur me parimet?
- Cila është përmbajtja e çfarëdo plani formal?
- Si është hartuar plani?
- Si zbatohet plani?
- Cilat aktivitete të tjera zhvillimore ndërmerren jashtë procesit formal të planifikimit?
- Si bashkërendohen aktivitetet zhvillimore?
- Si mund të përmirësohet procesi i planifikimit dhe përmbajtja e planit?

Rritja e ndërgjegjësimit për Udhëzuesin

Para marrjes së çfarëdo vendimi specifik për planifikim, është me rëndësi që edhe personat e tjerë të përfshirë në këtë punë të informohen për Udhëzuesin. Ndërgjegjësimi mund të përfshijë persona që nuk vijnë nga institucioni, ndoshta ndonjë edukator nga jasht apo dikë nga autoritetet vendore të arsimit, siç është kryesuesi i grupit bashkërendues, i cili është i familiarizuar me materialet e Udhëzuesit. Gjithashtu, ky proces mund të udhëhiqet nga kryesuesi i grupit planifikues, i cili është i familiarizuar me materialet e Udhëzuesit. Këto diskutime mund të shërbejnë për të shtuar numrin e anëtarëve të grupit bashkërendues.

Analizimi i njohurive ekzistuese me anë të koncepteve dhe të kornizës për shqyrtim

Anëtarët e grupit punues duhet të krijojnë një mendim të përbashkët për Udhëzuesin para se t'ua prezentojnë të tjerëve. Shpesh ata që punojnë në institucion apo që e

përkrahin atë kanë shumë ide lidhur me atë se çfarë duhet të bëhet dhe si mund të vëhen ndryshimet në jetë, por nuk kanë mundësi që ta shprehin këtë. Ata mund t'ia fillojnë duke i këmbyer njohuritë ekzistuese me anë të koncepteve të Udhëzuesit dhe të kornizës për shqyrtim, para se të fillojnë shqyrtimin e çështjeve të tjera të dala pas zbatimit të treguesve dhe parashtrimit të pyetjeve. Aktivitetet 2, 3 dhe 4 mund të ndihmojnë në strukturimin e njohurive ekzistuese. Koha e propozuar mund të duket e shkurtër po është realiste dhe i mundëson grupit ta kryejë detyrën e caktuar. Grupi duhet ta mbajë në mend se në këtë fazë çdo ide duhet të konsiderohet si e përkohshme derisa të merren parasysh të gjitha opinionet në kopsht dhe derisa të bazohen të gjitha hulumtimet në analizat e hollësishme të treguesve dhe pyetjeve.

Aktiviteti 2 Çfarë do të thotë përfshirja në institucionet e arsimit parashkollor? (30 minuta)

Grupi i Udhëzuesit për përfshirje në institucionet e arsimit parashkollor duhet t'i diskutojë qëndrimet e veta për temat si në vijim:

- Deri në çfarë mase përfshirja shihet si e ndërlidhur me "fëmijët me nevoja të posaçme edukativo-arsimore"?
- Deri në çfarë mase përfshirja në arsim identifikohet me femijet, sjellja e të cilëve konsiderohet si problematike?

Më pastaj ata duhet ta shikojnë tabelën 1, ku pasqyrohet përfshirja në institucionet parashkollore. Idetë e paraqitura në tab.1 përmbledhin qasjen e Udhëzuesit në procesin e përfshirjes ku çdo element i saj duhet të diskutohet shkurtimisht. Përvoja nga ky aktivitet tregon se nuk do të ishte mirë që të humbet shumë kohë me të në këtë fazë. Diskutimet për përfshirje shpesh zbulojnë qëndrimet, prapa të cilave njerëzit fuqimisht mbesin. Pra, nuk është e nevojshme të ketë pajtim për të gjithë fëmijët që ballafaqohen me pengesa në lojë, të nxënit dhe pjesëmarrje aktive që vjen si rrjedhojë e çfarëdo arsyeje. Gjatë përdorimit të Udhëzuesit, njerëzit kanë kuptuar se qasja e tyre në gjithëpërfshirjen në arsim është ndryshuar dhe zhvilluar gjatë punës me Udhëzues.

Aktiviteti 3 Pengesat dhe burimet (20 minuta)

Grupi bashkërendues duhet ta përkujtojë diskutimin rreth pengesave dhe burimeve nga pjesa 1 dhe përshkrimin e dimensioneve dhe pjesëve në tabelën 4. Më pastaj, ata mund t'i shfrytëzojnë këta tregues për t'i strukturuar mendimet e tyre për pengesat dhe burimet gjatë dhënies së përgjegjës në pyetjet vijuese:

- Cilat pengesa në lojë, të nxënit dhe në pjesëmarrje dalin nga kulturat, politikat dhe nga praktikat e institucionit?
- Kush i përjeton pengesat në lojë, të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive?
- Si mund të minimizohen pengesat në lojë, të nxënit dhe pjesëmarrje aktive?
- Cilat burime e përkrahin lojën, të nxënit dhe pjesëmarrjen?
- Cilat burime shtesë mund të vihen në lëvizje për të ndihmuar të nxënit dhe pjesëmarrjen dhe për të zhvilluar kulturat, politikat dhe praktikat në kopsht?

Aktiviteti 4 Çfarë është përkrahja? (20 minuta)

Një kuptim i gjerë i nocionit të përkrahjes është dhënë në pjesën 1, ku thuhet se përkrahja nënkupton " të gjitha aktivitetet, të cilat e rrisin kapacitetin e kopshtit për të reaguar ndaj dallimeve të nxënësve". Grupi bashkërendues mund të konsideroj shtjellimin e pyetjeve si në vijim:

- Cilat aktivitete llogariten si përkrahëse në kopësht?
- Cilat janë ndikimet e përkufizimit të përkrahjes në Udhëzues për punën e edukatorëve?
- Cilat janë ndikimet e Udhëzuesit në zhvillimin profesional?
- Cilat janë ndikimet e përkufizimeve të përkrahjes në Udhëzues në lidhje me bashkërendimin e punës me të?

Thellimi i analizës duke i shfrytëzuar treguesit dhe pyetjet

Grupi bashkërendues duhet të njihet me treguesit dhe pyetjet dhe me mënyrën e përdorimit të tyre për hulumtimin e kulturave, politikave dhe të praktikave. Përdorimi i treguesve dhe i pyetjeve bazohet në njohuritë ekzistuese dhe në inkurajimin e hulumtimit të hollësishëm të kopshtit, si dhe e drejton vëmendjen në çështjet, të cilat më parë ndoshta nuk janë marrë parasysh.

Aktiviteti 5 Shfrytëzimi i treguesve për të identifikuar shqetësimet e përkohshme (25 minuta)

Qëllimi këtij aktiviteti është që t'i identifikojë shqetësimet që mund të kërkojnë shqyrtim të mëtejshëm dhe të ngrejë të tjerat me ndihmën e treguesve. Këto shqetësime mund të shtjellohen qoftë me pyetsorë (pyetësori 1) apo me përdorimin e kartelave, ku secila përmban nga një tregues. Përgjigja në pyetësorë mund të jepet nga individi dhe pastaj të krahasohet me përgjigjet e të tjerëve në grup në mënyrë që të diskutohen dallimet. Si alternativë tjetër është se grupi mund t'i grumbullojë kartelat në katër vende në bazë të asaj se cila deklaratë në kartelë e përshkruan më mirë institucionin. Përgjigja në secilin tregues jepet në njëren nga katër mënyrat vijuese: "pajtohem plotësisht", "pajtohem deri diku", "nuk pajtohem" dhe "kam nevojë për më shumë informacion". Gjatë renditjes, kartelat me mbishkrime të njëjta duhet të vendosen së bashku. Kartela "kam nevojë për më shumë informacion" zgjidhet kur domethënia e treguesit është e paqartë apo kur informacioni për marrjen e vendimit nuk është i mjaftueshëm. Dallimet në pikëpamje mund të diskutohen gjatë procesit të renditjes. Domethënia e treguesit mund të qartësohet duke e gjetur atë në pjesën 3 dhe duke i shikuar pyetjet lidhur me të.

Në fund të pyetsorit është rubrika për shënimin e deri në pesë prioriteteve për zhvillim. Pyetësori apo metoda e kartelave përqendrohen në aspekte të ndryshme të institucionit në mënyrë që identifikimi i prioriteteve të jetë më i lehtë.

Nëse pyetsorët shfrytëzohen së bashku me metodat e tjera është me rëndësi të mbahet mend se janë prioritetet ato që duhet të analizohen e jo pyetësori në terësi. Analiza e hollësishme e pyetësorëve, përpilimi i grafikëve dhe i tabelave mund të marrë shumë kohë dhe mund të vonojë fillimin e punës zhvillimore.

Aktiviteti gjithashtu ofron mundësinë për të menduar për dobishmërinë e pyetësorëve. Të gjithë treguesit janë të përpiluar në mënyrë që pajtueshmëria me ta të sugjerojë një vlerësim pozitiv. Kjo mund t'i inkurajojë njerëzit ta paraqesin kopshtin e tyre më gjithëpërfshirës sesa është. Grupi duhet ta marrë parasysh këtë dhe duhet të sfidojnë njëri-tjetrin për të ofruar fakte në lidhje qëndrimet e tyre.

Në versionet e mëparshme të Udhëzuesit mundësitë e përgjigjes në pyetje ishin “pajtohem plotësisht”, “pajtohem deri diku”, “nuk pajtohem” dhe “ më nevojitet më shumë informacion”. Ne e zëvendësuam përgjigjen e dytë me “pajtohem dhe nuk pajtohem”, sepse erdhëm në përfundim pas krahasimit të rezultateve se njerëzit shumë e shpesh e interpretojnë përgjigjen “pajtohem deri diku” që nënkuptonte se nuk ka nevojë për asnjë ndryshim. Në të kundërtën, kjo do të thotë se ka gjasa të ekzistojnë disa pyetje të ndërlidhura me treguesin që vënë në pah fushat, të cilat do të mund të trajtoheshin.
Pas krahasimit të rezultateve të këtij aktiviteti, grupi duhet të diskutojë për aktivitetet e përkohshme.

Aktiviteti 6 Diskutimi i fakteve (20 minuta)
Për shkak të asaj që njerëzit kanë shumë arsye për minimizimin apo rritjen e problemeve, anëtarët e grupit duhet ta sfidojnë njëri-tjetrin butësisht për të ofruar fakte për pikëpamjet e tyre, pra për atë çka kanë lexuar, parë apo dëgjuar që do të ishte në favor të mendimeve të tyre. Grupi duhet të pajtohet për treguesin, për të cilin mendojnë se institucioni është duke punuar mirë dhe për treguesin ku mendohet se ka vend për përmirësime. Për çdo rast, ata duhet të jepin dëshmi për pikëpamjet e veta, duke marrë parasysh si në vijim:

- Cila është shkalla e pajtueshmërisë për atë tregues?
- Çfarë faktesh ekzistojnë në përkrahje të pikëpamjeve për atë tregues?
- Çfarë faktesh ekzistojnë për treguesit e tjerë, të cilët në dimensione të njëjta apo të ndryshme e fuqizojnë këtë pikëpamje?
- Cilat informacione të tjera mund të jenë të dobishme?

Aktiviteti 7 Lidhja e treguesve dhe e pyetjeve: kulturat, politikat dhe praktikat (35 minuta)
Gjatë përdorimit të materialeve të Udhëzuesit, treguesit duhet gjithmonë të ndërlidhen me pyetjet, të cilat e përkufizojnë domethënien e tyre. Anëtarët e grupit të ndarë në çifte duhet të zgjedhin një tregues në çdo dimension ku mund të ketë vend për zhvillim të mëtejshëm dhe treguesin tjetër ku mendojnë se institucioni është duke punuar mirë. Këtu duhet të përfshihet treguesi nga aktiviteti 6. Pastaj analizohen pyetjet nën tregues. Edhe pse, për arsye stilistike, çdo pyetje është e parashikuar në atë mënyrë që të ketë përgjigje të thjeshtë me “po” ose “jo”, ato duhet të konsiderohen si pyetje të natyrës “deri në çfarë mase”. Përgjigjet në ato pyetje mund të jenë të stilit të njëjtë si ato të dhëna për treguesit: “pajtohem plotësisht”, “pajtohem deri diku”, “nuk pajtohem” dhe “kam nevojë për më shumë informacion”. Përkatësisht, këto opsione mund të paraqiten me simbolet: +, +/-, -, dhe ?. Anëtarët e grupit inkurajohen që të angazhohen në mënyrë aktive me pyetjet, duke i ndryshuar dhe duke shtuar pyetje të tjera për t’ua përshtatur rrethanave të caktuara. Treguesit e zgjedhur dhe pyetjet e tyre duhet të shqyrtohen duke i marrë parasysh pyetjet si në vijim:

- Cilat fusha të reja të zhvillimit sugjerohen përmes pyetjeve?
- Cilat pyetje duhet të shtohen apo të hiqen për t'iu përshtatur rrethanave të caktuara të institucionit të arsimit parashkollor?

Aktiviteti 8 Rishikimi i të gjithë treguesve dhe pyetjeve (1 orë)

Ky aktivitet mund të realizohet gjatë periudhës në mes të takimeve. Anëtarët e grupit duhet të punojnë individualisht, duke i lexuar të gjithë treguesit dhe pyetjet. Qëllimi i këtij veprimi është familiarizimi me materiale e jo një hulumtim i plotë i institucionit të arsimit parashkollor. Ata duhet t'i përgjigjen secilës pyetje duke i shënuar çështjet e ngritura dhe, sipas nevojës, të sugjerojnë pyetje të reja. Në takimin tjetër, anëtarët e grupit duhet t'i ndajnë mes tyre njohuritë e fituara. Nganjëherë, pyetjet përqendrohen në një aspekt të institucionit, i cili mund të ndryshohet lehtë, ndërsa pyetjet e tjera mund të nxisin mendimet për ndryshimet rrënjësore dhe të gjëra që duhet të ndodhin.

Aktiviteti 9 Përdorimi i kornizës për planifikim dhe i fletës përmbledhëse (30 minuta)

Grupi duhet të zgjedhë prioritetin zhvillimor të marrë nga një dimension dhe të merr parasysh se cilat zhvillime duhet të ndodhin në dimensione të tjera që do ta mbështesnin zbatimin e atij prioriteti. Prioriteti mund të futet në kuadër të një treguesi apo të një grupi treguesish, të një pyetjeje apo grupi pyetjesh apo në kuadër të një çështjeje të rëndësishme për institucionin, e cila nuk është e përfshirë në tregues dhe pyetje të Udhëzuesit. Për shembull, nëse përmirësimi i bashkëpunimit mes fëmijëve dhe mes edukatorëve konsiderohet si prioritet i punës zhvillimore në dimensionin A (treguesit A. 1.2, A.1.3 dhe A.1.4), atëherë ky prioritet duhet të ndërlidhet me politikën kundër ngacmimit (treguesi B.2.9), me zhvillimin e aktiviteteve bashkëpunuese në dimensionin C (treguesi C.1.7) dhe me të bazuarit në konceptin ku fëmijët konsiderohet si burim i njëri-tjetrit (treguesi C.2.3). Përdorimi i fletës përmbledhëse të kornizës për planifikim në pjesën 4 për shënimin e prioriteteve dhe përgjigjeve në pyetjet vijuese mund të jetë një ndihmë në realizimin e kësaj detyre:

- Cilat ndryshime duhet të bëhen në dimensionet e tjera për tu siguruar që zhvillimi në lidhje me treguesin e zgjedhur të përkrahet?
- Si mund të shfrytëzohen pyetjet për të analizuar edhe më tej problemin e zgjedhur?
- Si mund të përkrahen zhvillimet në lidhje me treguesin?

Aktiviteti 10 Përmbledhja e punës së grupit (20 minuta)

Anëtarët e grupit mund të diskutojnë lidhur me nivelin, në të cilin analizimi i treguesve dhe pyetjeve ka përmirësuar njohuritë për kulturat, politikat dhe praktikat në kopsht që janë analizuar në aktivitetet 2, 3 dhe 4. Grupi mund ta bëje këtë duke i marrë parasysh pyetjet si në vijim:

- Çka ndërmerret për t'i kaluar pengesat në lojë, të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive?
- Çka nevojitet të përpunohet?
- Ku kërkohen analiza të mëtejshme?
- Cilat nisma të reja duhet të trajtohen?

Aktiviteti 11 Identifikimi dhe tejkalimi i pengesave në përdorimin e Udhëzuesit (20 minuta)

Pas shqyrtimit të hollësishëm të materialeve, grupi mund të ketë ide lidhur me futjen e Udhëzuesit në përdorim në mënyrën më të mirë të mundshme dhe lidhur me problemet që mund të shfaqen. Gjatë këtij aktiviteti, grupi duhet t'i merr parasysh pyetjet si në vijim:

- Cilat pengesa mund të shfaqen gjatë fillimit të punës me Udhëzues?
- Si mund të tejkalohen këto pengesa?
- Si mund të paraqitet Udhëzuesi në mënyrën më të mirë të mundur?

Përgatitja e punës me grupe të tjera

Grupi duhet t'i lexojë dhe diskutojë udhëzimet për fazat 2, 3, 4 dhe 5 para se të fillojë punën me grupe të tjera.

<u>Faza 2 Marrja e informacionit për institucionin e arsimit parashkollor</u>

- Hulumtimi i njohurive dhe ideve të edukatorëve dhe
- këshillave drejtues apo drejtorëve
- Hulumtimi i njohurive të fëmijëve
- Hulumtimi i njohurive dhe ideve të prindërve
- /kujdestarëve dhe të anëtarëve
- të komunitetit
- Caktimi i prioriteteve zhvillimore

Grupi planifikues i shfrytëzon njohuritë e veta për procesin e Udhëzuesit për të punuar me të tjerët në kopsht, këshillat drejtues apo drejtorët, prindërit a kujdestarët, dhe me anëtarët e tjerë përkatës të komunitetit. Ata i marrin parasysh rezultatet e këtyre konsultimeve dhe nisin hulumtime të tjera të nevojshme për të përfunduar analizën. Pastaj ata arrijnë dakordësinë e edukatorëve të tjerë lidhur me prioritetet zhvillimore.

Zbatimi i kësaj faze ndryshon prej një institucioni të arsimit parashkollor në tjetrin, sikurse që ndryshojnë edhe punët e tjera rreth Udhëzuesit. Grupi planifikues është përgjegjës për gjetjen e mënyrës më të mirë për zbatimin e procesit në rrethanat e caktuara.

Hulumtimi i njohurive të edukatorëve dhe të këshillave drejtues apo drejtorëve

Grupi i përmbahet procesit të njëjtë me atë të fazës 1, pra të shtjellimit të njohurive ekzistuese duke shfrytëzuar konceptet kyç dhe kornizën për shqyrtim, dhe pastaj duke përpunuar këto të dhëna me anë të treguesve dhe pyetjeve me qëllim identifikimin e prioriteteve zhvillimore.

Udhëzuesi

"E nxiti diskutimin, i cili përndryshe nuk do të bëhej".

Pikëpamjet e shprehura gjatë konsultimeve duhet të shfrytëzohen si mundësi për debate dhe për analiza të mëtejme.

Qëllimi është që të sigurohet një pjesëmarrje maksimale përmes mundësive të ndryshme të mbledhjes së informacionit, në mënyrë që individët, të cilët nuk mund të marrin pjesë në takime apo të cilët ngurrojnë të flasin në takime të grupeve të mëdha,

të jepin mendimet e tyre. Gjithashtu ata mund të inkurajojnë dhënien individuale të përgjigjeve në treguesit dhe pyetjet, të cilat do të duhet të dorëzoheshin veçmas.

Dita e ngritjes profesionale e edukatorëve dhe e drejtorëve

Dita e ngritjes profesionale është një mënyrë për fillimin e mbledhjes së informacionit. Në këtë ditë mund të përfshihen më shumë se një institucion i arsimit parashkollor që do të punonin bashkërisht dhe gjithashtu do të mund të përfshiheshin ata që tanimë kanë punuar me Udhëzuesin. Nëse kjo punë bëhet mirë, edukatorët do t'i shohin përparësitë e një përvoje në procesin e përfshirjes në institucionet e arsimit parashkollor dhe të nxitjes për avancimin e kësaj përfshirjeje. Pasqyrimi i një ngjarjeje të tillë është e paraqitur në tabelën 9, në të cilën janë marrë parasysh aktivitete të fazës

1. Aktivitete mund të zhvillohen gjatë një sesioni apo edhe gjatë një numri sesionesh. Para kësaj ngjarjeje, aktivitetet do të duhet të përzgjedhen dhe të përshtaten. Gjithashtu duhet të merret vendimi për mënyren e hulumtimit të treguesve dhe nëse duhet të bëhen kopjet e pyetësorit për tregues. Pikëpamjet e grupeve të ndryshme duhet të shënohen dhe të mblidhen në fletët përmbledhëse.

Nga përvoja me materialet, grupi planifikues do të jetë në gjendje të vlerësojë se sa kohë do t'u nevojitet të tjerëve për t'i kryer detyrat e njëjta. Pra, grupi duhet ta mbajë dinamikën e punës së individëve gjatë përmbushjes së aktiviteteve.

Disa njerëz ndjejnë se janë të stërngarkuar me materiale, posaçërisht gjatë kohës së familiarizimit me to, dhe mendojnë se nga ata pritet të ndryshojnë çdo gjë në kopësht. Duhet të theksohet se qëllimi i shqyrtimit është caktimi i prioriteteve zhvillimore e jo ndryshimet rrënjësore. Materialet duhet të jenë gjithëpërfshirëse në mënyrë që çështjet e rëndësishme të çfarëdo aspekti të institucionit të arsimit parashkollor të dalin në pah.

Fushat e përkohshme për zhvillim dhe për hulumtime të mëtejshme

Në parim, në momentin kur individët i futen punës me tregues dhe pyetje ata e ndjejnë vetën të aftë t'i identifikojnë fushat specifike ku mendojnë se ka nevojë për zhvillim. Para marrjes së vendimit, mund të identifikohen disa fusha ku nevojiten hulumtime të mëteshjme. Mund të ekzistojnë çështje, për të cilat arrihet dakordësia e përgjithshme dhe të cilat edukatorët dëshirojnë t'i trajtojnë menjëherë. Megjithatë, disa prioritete do të dalin në pah vetëm me sjelljen e informacionit nga grupet e ndryshme dhe pas përfundimit të kosultimeve të gjera.

Planifikimi i hapave të ardhshëm

Në fund të ditës për ngritjen profesionale, kryesuesi i grupit planifikues duhet të nënvizojë se çka do të ndodh me informacionin e mbledhur dhe me pikëpamjet e shprehura. Grupi duhet ta përfundojë mbledhjen e informacionit nga edukatorët dhe drejtorët dhe t'i krahasojë ato. Fushat ku ka nevojë për më shumë informacion mund të identifikohen nga fëmijët, prindërit apo kujdestarët dhe anëtarët e tjerë të komunitetit. Grupi duhet të planifikojë se si t'i marrë mendimet e atyre, të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë ngjarje.

Hulumtimi i njohurive dhe ideve të fëmijëve

Personat që e përdorin Udhëzuesin arrijnë në përfundim se konsultimet me fëmijë mund të jenë shumë të dobishme në zbulimin e pengesave dhe të burimeve. Të gjithë fëmijëve duhet t'u jepet mundësia të kontribuojnë. Edhe fëmijët shumë të vegjël mund të kenë ide të shumta për interesat dhe shqetësimet e tyre. Fëmijët më të rritur mund të ofrojnë ide për pengesat dhe burimet për zhvillim. Të gjithë pjesëmarrësit në konsultime duhet të inkurajohen për të dhënë pikëpamje të sinqerta e jo pikëpamje që do t'i kënaqnin të rriturit apo fëmijët e tjerë.

Në parim, informacioni duhet të mblidhet spontanisht përmes bisedave, lojës dhe ndjekjes së aktiviteteve e jo në ndonjë mënyrë formale. Është me rëndësi që institucioni të shikohet nga këndvështrimi i fëmijëve dhe që të ekzistojë interesimi për ndjekjen dhe dëgjimin e tyre të kujdesshëm, e posaçërisht për aspektet e mëposhtme:

- Si reagojnë fëmijët ndaj aktiviteteve të ndryshme?
- Çfarë marrëdhëniesh krijojnë me fëmijët e tjerë dhe me të rriturit?
- Si reagojnë ndaj ndryshimeve që kanë për qëllim rritjen e pjesëmarrjes së tyre në lojë dhe në të nxënit?

Pyetjet apo pyetësorët e përgatitur (shih pjesën 4) duhet të përdoren me fëmijët e vegjël vetëm si nxitje për diskutim me një individ apo në kuadër të një grupi të vogël. Edukatorët do të dinë se si ta angazhojnë fëmijën në një bisedë të lirshme. Kjo më së miri do të mund të realizohej me ndihmën e prindërve apo kujdestarëve. Pyetësori 4 i jep disa ide për pyetjet që do të mund të nxisnin shprehjen e pikëpamjeve të fëmijëve. Gjithashtu, për të ndihmuar këtë proces mund të përdoren edhe fotografitë, pikturat, vizatimet dhe kukullat. Ilustrimet me një fytyrë të buzëqeshur, të trishtuar apo me shprehje asnjanëse të fytyrës mund të ndihmojnë në shprehjen e ideve dhe mendimeve.

Me fëmijët më të rritur, shpesh është e udhës që të përdoren pyetësorët vetëm si bisedë paraprake që i nxjerr çështjet e caktuara në pah. Shpeshherë, pyetësorët mund të përdoren për të konfirmuar pikëpamjet e shprehura. Pyetësori 2 përmban një listë të shkurtuar të treguesve. Edhe këtu, edukatorët do të mund të gjykojnë nga bisedat me fëmijët se kur ata janë të gatshëm të kuptojnë terminologjinë e pyetësorëve dhe kur duhet që pyetjet t'ju lexohen atyre nga ndonjë i rritur apo nga fëmija tjetër. Nëse puna kryhet në mënyrë të kujdesshme, përpjekja për marrjen e mendimit të fëmijës mund të ndihmojë në të kuptuarit e nevojave të tyre nga ana e edukatorëve dhe t'i inkurajojnë fëmijët që të ndihen më shumë si në shtëpi. Konsultimet me prindërit apo kujdestarët dhe me anëtarët e tjerë të komunitetit mund të ndihmojnë në përmirësimin e komunikimit mes institucioneve dhe familjeve të fëmijëve. Pyetësorët për prindërit apo kujdestarë mund të përpilohen nga lista e shkurtuar e treguesve së bashku me pyetjet e tjera specifike.

Gjithashtu, grupi planifikues mund ta shqyrtojë mundësinë e organizimit të mbledhjeve me prindër në ndonjë vend tjetër jashtë institucionit të arsimit parashkollor nëse ka gjasa që pjesëmarrja të jetë më e madhe apo që marrëdhëniet mes edukatorëve dhe prindërve apo kujdestarëve të përmirësohen. Në këtë rast, do të duhet të krijoheshin një sërë mundësish që secili pjesëmarrës ta jepë kontributin e tij. Pyetësori mund të përdoret pas temave të diskutuara ose si mënyrë për mbledhjen e informacionit për ata që nuk kanë marrë pjesë në takim.

Gjatë diskutimeve mund të analizohen pyetjet vijuese:

- Çfarë vlerësoni më së tepërmi në këtë institucion të arsimit parashkollor?
- Çfarë mund të bëhet që fëmijët tuaj të jenë më të gëzuar në këtë kopsht?
- Çfarë do të mund të bëhej për përmirësimin e lojës, të të nxënit dhe marrëdhënieve të fëmijëve tuaj?

Përveç punës me prindër apo kujdestarë, do të ishte e dobishme të merren pikëpamjet e të tjerëve nga rradhët e bashkësive që jetojnë në afërsi. Fëmijët në institucion mund të mos e pasqyrojnë përbërjen e popullatës në atë vend në kuptim të përkatësisë etnike, të aftësive të kufizuara apo të shtresës shoqërore. Të kuptuarit e pikëpamjeve të anëtarëve të komunitetit mund ta ndihmojë institucionin në përpjekjet e tij për rritjen e reputacionit të kopshtit.

Caktimi i prioriteteve zhvillimore

Çfarë mund të ndryshohet në kulturat, politikat dhe në praktikat për të përmirësuar lojën, të nxënit dhe pjesëmarrjen aktive?

Analiza e fakteve

Për të caktuar prioritetet e përgjithshme zhvillimore, grupi planifikues duhet t'i shqyrtojë dhe analizojë prioritetet zhvillimore, të cilat janë përzgjedhur nga të gjithë personat e konsultuar. Në këtë analizë duhet të kenë qasje të gjithë në kuadër të institucionit. Në përmbushjen e kësaj detyre, duhet të përfshihen më shumë persona meqenëse në kopshte të mëdha mund të ketë shumë punë për të bërë. Gjithashtu, "Miku Kritik" mund të ofrojë ndihmën e tij në këtë proces. Meqë konsultimet bëhen gjatë një periudhe kohore, është e mundur që të bëhet sistemimi i pikëpamjeve të çdo grupi gjatë procesit të dëgjimit të tyre. Fillimisht, informacioni i nxjerrë nga fëmijët, prindërit apo kujdestarët, edukatorët dhe drejtorët duhet të mbahen veçmas. Në këtë mënyrë mund të zbulohen dallimet në pikëpamjet e ndryshme. Gjithashtu, mund të jetë i rëndësishëm edhe shqyrtimi i mendimeve të nëngrupeve siç janë vullnetarët ose prindërit a kujdestarët e fëmijëve më të vegjël apo të atyre më të rritur.

Mbledhja e informacioneve të tjera

Para grupit planifikues mund të shfaqet nevoja e mbledhjes së informacioneve të tjera para përcaktimit përfundimtar të prioriteteve. Gjatë konsultimeve, çështjet e identifikuara mund të qartësohen duke mbledhur informacion shtesë. Mbledhja e informacionit shtesë mund të bëhet pas procesit të konsultimeve ku njëri grup i identifikon pyetjet që duhet t'u drejtohen grupeve të tjera. Për shembull, atyre që sapo kanë ardhur në institucion mund t'u parashtrohet pyetja sa kanë qenë të përkrahur në ditët e para të punës së tyre. Kjo pyetje mund të parashtrohet edhe nëse edukatorët që janë aty për një kohë më të gjatë mendojnë se procesi i prezantimit me punën e re është i mire.

Mbledhja e informacioneve të tjera mund të shkrihet në një punë zhvillimore. Për shembull, vlerësimi i prioriteteve të ndërlidhura me dimensionin C mund t'i përfshijë edukatorët në trajtimin dhe pasqyrimin e mënyrës së zbatimit të aktiviteteve. Vetë fakti i angazhimit në këtë punë mund të çojë në një bashkëpunim më të mirë dhe në përmirësime të mësimdhënies.

Faza 3 Krijimi i një plani për gjithëpërfshirje në institucionet e arsimit parashkollor

- Shqyrtimi i prioriteteve me anë të kornizës planifikuese
- Futja e prioriteteve në planin zhvillimor

Faza e tretë e Udhëzuesit, e cila mund të ketë nevojë për mbajtjen e mbledhjeve të fokusuara, përfshin anëtarët e ekipit për planifikimin në hartimin e planit zhvillimor. Korniza planifikuese e Udhëzuesit përdoret për caktimin e asaj se çfarë duhet të ndodhë me kulturat, politikat dhe praktikat e institucionit të arsimit parashkollor.

Rishikimi i prioriteteve me anë të kornizës për planifikim
Rishikimi i prioriteteve ekzistuese

Grupi duhet t'i shqyrtojë prioritetet e tjera që tanimë janë në kuadër të planit, duke përfshirë edhe ato që kanë dalë si rezultat i inspektimit. Ata duhet të marrin parasysh nëse duhet të modifikohen këto prioritete ashtu që të kontribuojnë në një zhvillim përfshirës të institucionit të arsimit parashkollor në terësi.
Caktimi i prioriteteve në planin zhvillimor
Çdo prioritet duhet të analizohet në hollësi, duke përfshirë analizën e implikimeve të afateve kohore, të burimeve dhe të ngritjes së aftësive të edukatorëve. Përparimet në disa prioritete mund të arrihen brenda disa javësh apo muajsh. Megjithatë, prioritetet e tjera lidhur me ndërtesat e reja apo me ndryshimet rrënjësore në kultura apo në mënyra të të punuarit mund të zgjasin më shumë. Qëllimet afatshkurtëra, afatmesme dhe afatgjata mund ta mbajnë në rrugën e duhur një prioritet të caktuar.

Mobilizimi i burimeve

Shumica e veprimeve kërkojnë burime njerëzore dhe materiale, të cilat mund të jenë apo të mos jenë të disponueshme. Plani duhet të parashikojë edhe mënyrën e vlerësimit të suksesit. Kriteri i suksesit ndoshta do të duhej të caktohet duke shfrytëzuar pyetjet e Udhëzuesit me qëllim të qartësimit të synimeve. Një anëtar i grupit planifikues duhet ta ketë përgjegjësinë për të kontrolluar përparimet e bëra në çdo prioritet, ndonëse, nëse procesi shkon në rregull, të gjithë punonjësit e institucionit të arsimit parashkollor do ta ndajnë përgjegjësinë për futjen e planit në veprim. Pasi propozimet të jenë caktuar nga anëtarët e grupit punues, atëherë ata duhet t'i diskutojnë ato me edukatorët dhe me drejtorinë.
Për institucionet e arsimit parashkollor që nuk janë të mësuara të planifikojnë në këtë mënyrë, do të ishte e udhës të kërkojnë këshilla nga ndonjë profesionist apo nga "Miku Kritik". Institucioni i arsimit parashkollor i East Sussex inkurajon përdorimin e mënyrës së thjeshtë të planifikimit të veprimeve. Një shembull i mënyrës së tillë të planifikimit është dhënë në tabelë.

Faza 4 Përkrahja e zhvillimit

- Vënia e prioriteteve në praktikë
- Zhvillimi i vazhdueshëm

Pjesa e katërt e Udhëzuesit ka të bëjë me vënien e prioriteteve në praktikë. Kjo fazë parashikon marrjen e informacioneve të tjera në kopsht dhe mund të bëhet mënyrë e hulumtimit të veprimeve.

Udhëzuesi në vepër

“Vendosëm që të përqendrohemi në shndërrimin e politikave “për nevojat e veçanta në arsim”në politika të përfshirjes. Tani e kemi bashkërenduesin e përfshirjes e jo “bashkërenduesin për nevoja të veçanta në arsim”, por çfare ka rëndësi, tani është se puna ka ndryshuar dhe janë identifikuar nevojat e të gjithë fëmijëve.”

Vënia e prioriteteve në praktikë

Një mënyrë e hulumtimit të veprimeve parashikon një sërë pyetjesh të ngjashme me procesin e Udhëzuesit, siç janë:

- Çfarë po ndodh?
- Si e kuptoni se çfarë po ndodh?
- Çfarë duhet të ndodhë?
- Si e vini në praktikë atë që duhet të ndodhë?

Analiza e institucionit të arsimit parashkollor me anë të Udhëzuesit mund të ketë nxitur grupin planifikues dhe edukatorët e tjerë për t’i kushtuar më shumë vëmendje asaj që po ndodh. Përcjellja dhe përshkrimi i praktikave, posaçërisht kur ngërthen përpjekjen për të parë institucionin e arsimit parashkollor nga perspektiva e fëmijëve, mund të jetë mënyra e duhur për fillimin e ndryshimeve.

Qëndrueshmëria e zhvillimit

Përkushtimi i të gjithë individëve të përfshirë në këtë proces duhet të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës së përmbushjes së tij.

Aktivitete në krijimin e kulturave më gjithëpërfshirëse mund të vazhdojnë për disa vite. Këto ndryshime mund të përfshijnë edukatorët, drejtorinë, fëmijët dhe prindërit apo kujdestarët në krijimin e ndryshimeve të hollësishme të politikave dhe praktikave. Në institucionin ku ekziston bashkëpunimi i mirëfilltë, edukatorët bazohen në përvojën e njëri-tjetrit dhe i japin përkrahje njëri-tjetrit.

Në rastet kur prioritetet i sfidojnë bindjet dhe vlerat e rrënjosura thellë, mund të nevojitet një përpjekje e konsiderueshme për ta kapërcyer rezistencën. Disa edukatorë, fëmijë dhe prindër apo kujdestarë mund të mos pajtohen me ndonjë zhvillim të caktuar. Grupi planifikues ndoshta do të duhet të inkurajojë theksimin e dallimeve dhe t’i përpunojë zhvillimet në mënyrë që ato të bëhen të rëndësishme për sa më shumë njerëz që të jetë e mundshme.

<u>Faza 5 Shqyrtimi i procesit të Udhëzuesit</u>

- Vlerësimi dhe regjistrimi i zhvillimeve
- Shqyrtimi i punës me Udhëzues
- Vazhdimi i procesit të Udhëzuesit

Ekipi e shqyrton përparimin e gjithanshëm të planit. Ata analizojnë çfarëdo përparimi në ndryshimin e kulturave, të politikave të punës dhe të praktikave. Gjithashtu, ekipi i diskuton modifikimet që duhet t’i bëhen procesit të Udhëzuesit. Treguesit e pyetjet, të përshtatura nga kopshti i caktuar, përdoren për shqyrtimin e shkallës së ndryshimeve në kopsht dhe për formulimin e prioriteteve të reja të planit zhvillimor të kopshtit për vitin pasardhës.

Faza 5 bashkohet me fazën 2 dhe paraqet vazhdimësinë e ciklit zhvillimor të planifikimit.

Shqyrtimi dhe regjistrimi i zhvillimeve

Përparimi në planin zhvillimor duhet që rregullisht të shqyrtohet në bazë të kritereve të cekura në fazën 3. Anëtari i grupit planifikues që ka përgjegjësinë për prioritetin e caktuar do të sigurohet që të vlerësohen dhe regjistrohen përparimet e arritura, si dhe të bëhen përshtatjet e duhura në plan.

Këtu mund të organizohen diskutime me edukatorë, fëmijë, drejtorinë dhe me prindër apo kujdestarë dhe të analizohen dokumentet e politikave të institucionit të arsimit parashkollor, si dhe të ndiqen aktivitetet.

Rezultatet e këtij shqyrtimi duhet të diskutohen nga grupi planifikues, i cili më pastaj mund ta modifikojë planin zhvillimor sipas nevojës.

Njohja e të gjithëve me rezultatet

Grupi planifikues duhet të sigurohet që të gjithë të njihen me përparimet e arritura. Kjo mund të bëhet përmes takimeve, manifestimeve për ngritjen profesionale, ekspozitave, buletineve informative, organizimeve të ndryshme të komunitetit, etj. Përveç ofrimit të informacionit, grupi duhet të japë një sërë mendimesh në lidhje me përparimet zhvillimore.

Rishikimi i punës me Udhëzues

Puna në procesin e Udhëzuesit gjithashtu kërkon një vlerësim. Ekipi planifikues duhet ta rishikojë mënyrën e përdorimit të Udhëzuesit dhe të vendosë mënyrën më të mirë të përdorimit të materialeve gjatë viteve të ardhshme. Ata duhet të vlerësojnë shkallën e ndihmës së Udhëzuesit që kopshti të ketë një përkushtim më të madh në mënyrën gjithëpërfshirëse të punës.

Grupi po ashtu do të duhej të rishqyrtojë përbërjen e tij dhe sa kanë qenë anëtarët e tij të përgatitur për detyrat, mënyrën e konsultimet me grupet e tjera dhe suksesin e tij në ndarjen e përgjegjësive me të tjerët.

Ndihma e “Mikut Kritik” në këtë proces mund të jetë e dobishme. Megjithatë, për të arritur sukses në vetëvlerësim kërkohet që të gjithë anëtarët e grupit të jenë të gatshëm për t’i sfiduar praktikat e veta. Tabela 15 përbëhet prej pyetjeve që mund t’i ndihmojnë ekipit gjatë punës së tyre.

Rishikimi i punës me Udhëzues

- Në çfarë niveli të cilësisë ka qenë puna e grupit planifikues në aspektin e përbërjes, ndarjes së detyrave në kuadër të grupit, konsultimeve me të tjerët dhe të mbartjes së përgjegjësive për punën zhvillimore?
- Deri në çfarë mase është ndryshuar përkushtimi për mënyrat më gjithëpërfshirëse të punës?
- Deri në çfarë mase janë futur konceptet kyç të Udhëzuesit në të menduarit për politikat e punës dhe praktikat e kopshtit? Duke ditur se konceptet kyç janë: përfshirja, pengesat ndaj të nxënit dhe në pjesëmarrje në arsim, burimet për përkrahjen e të nxënit dhe të pjesëmarrjes dhe përkrahja për diversitet.

- Deri në çfarë mase ka qenë gjithëpërfshirës procesi i konsultimeve dhe kush mund t'i kontribuojë në vitet e ardhshme?
- Deri në çfarë mase kanë qenë të dobishme dimensionet dhe seksionet e Udhëzuesit në strukturimin e planit zhvillimor?
- Deri në çfarë mase kanë ndihmuar treguesit dhe pyetjet në identifikimin e prioriteteve, të cilat fillimisht nuk kanë mundur të identifikohen?
- Deri në çfarë mase ka qenë përfshirës procesi konsultativ dhe kush mund të kontribuojë gjatë viteve të ardhshme?
- Deri në çfarë mase është bërë vlerësimi i përparimeve zhvillimore në bazë të shqyrtimit të hollësishëm të ndryshimeve që duhet të bëhen?
- Si është krijuar zhvillimi i qendrueshëm dhe si mund të përmirësohet ky proces?

Vazhdimi i procesit të udhëzuesit

Në të ardhmen, ekipi planifikues do të jetë në pozitë më të mirë për të vendosur rreth rikonsultimit të materialeve dhe të procesit të Udhëzuesit. Me përfundimin e këtij procesi, në shumë institucione të arsimit parashkollor, pjesa më e madhe e edukatorëve do të jenë të familiarizuar me Udhëzuesin, ndërsa edukatorëve të sapoardhur duhet t'u shpjegohet ky proces në kuadër të programit hyrës (fillestar). Shqyrtimi i treguesve dhe i pyetjeve në kuadër të rishikimit të përparimeve të arritura mund të çojë në hulumtimin e mëtejshëm të punës në institucionin e arsimit parashkollor. Më pastaj, ky hulumtim mund të çojë në identifikimin e mënyrave, me anë të të cilave kultura përfshirëse kontribuon në ndryshimin pozitiv edhe përtej planit të parashikuar. Në rastet kur krijohen kultura të qëndrueshme të përfshirjes, fëmijët dhe prindërit apo kujdestarët e tyre do të rrënjosin në vetvete një qasje gjithëpërfshirëse në lojë, të nxënit dhe në pjesëmarrje aktive.

Sesioni 3.3: Planifikimi dhe organizimi i Kopshtit për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara.

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë dhe zbatojnë procesin e planifikimit dhe organizimit të kopshtit në funksion të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara, duke u pajisur me njohuri praktike, qasje institucionale dhe mekanizma bashkëpunues që garantojnë pjesëmarrjen e barabartë dhe zhvillimin gjithëpërfshirës të çdo fëmije.

Sesioni synon të theksojë rëndësinë e politikave dhe praktikave gjithëpërfshirëse në nivel institucioni, përmes angazhimit të drejtuesve, edukatorëve, prindërve dhe komunitetit në ndërtimin e një mjedisi arsimor mbështetës dhe të përshtatur me nevojat individuale të fëmijëve.

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë dallimin ndërmjet kopshtit integrues dhe kopshtit gjithëpërfshirës;
- Përshkruajnë procedurat dhe strategjitë për regjistrimin, përshtatjen dhe mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Identifikojnë mënyrat për përfshirjen e prindërve dhe komunitetit në procesin e planifikimit dhe vendimmarrjes;
- Hartojnë elementet kryesore të planeve vjetore apo afatmesme për gjithëpërfshirjen institucionale;
- Përdorimi i instrumenteve menaxheriale –tabela klasifikimi, plane pune dhe mekanizma të monitorimit;-mbikëqyrja dhe raportimi-roli i ekipit të vetëvlerësimit, metoda e vëzhgimit dhe formatet e raportimit
- Reflektojnë mbi praktikat aktuale dhe propozojnë përmirësime konkrete për një kopsht më gjithëpërfshirës dhe miqësor me çdo fëmijë.

Tematika:

1. Kuptimi i kopshtit gjithëpërfshirës dhe dallimi nga modeli integrues.
2. Procedurat e regjistrimit dhe kalimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
3. Rregullorja e brendshme e kopshtit dhe përfshirja e saj në planifikimin gjithëpërfshirës.
4. Plani vjetor dhe afatmesëm i kopshtit për përfshirje.
5. Identifikimi i fushave që kërkojnë rregullime (mjedisi fizik, PIE, mbështetja pedagogjike, përfshirja e prindërve, bashkëpunimi me komunitetin).

- Mbështetja dhe ndërhyrja e hershme (tri fazat: klasa, mbështetja nga kopshti, vlerësimi nga profesionistët).
- Procedurat për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Strategjitë për përshtatjen e mjedisit fizik sipas parimeve të Dizajns Universale.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për

pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- ***Diskutim/Punë në grup (Shtojca nr.2)***

Ky mjet është përzgjedhur për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë dallimin mes integrimit dhe gjithëpërfshirjes, duke e lidhur teorinë me shembuj praktikë. Ai synon të zhvillojë aftësi për hartimin e një plani gjithëpërfshirës për regjistrimin dhe përshtatjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe për identifikimin e ndryshimeve të nevojshme në mjedisin fizik dhe rregullat e brendshme të institucionit. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e punës në grup të përdoren për përmirësimin e praktikave vendore dhe garantimin e qasjes së barabartë në arsimin parashkollor.

- ***Ushtrim (Shtojca nr.3).***

Hartimi i një plani të shkurtër gjithëpërfshirës për regjistrimin dhe përshtatjen e një fëmije me aftësi të kufizuara në kopsht. Ai synon të lidhë parimet e gjithëpërfshirjes me veprimet konkrete, duke trajtuar nevojat individuale të fëmijës dhe përshtatjet e mjedisit fizik, rregullave dhe praktikave institucionale. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e ushtrimit të përdoren për forcimin e kapaciteteve vendore dhe garantimin e qasjes së barabartë në arsimin parashkollor.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Një kopsht gjithëpërfshirës nuk kufizohet në integrim, por kërkon ndryshim të politikave, rregullave dhe praktikave për të siguruar arsim cilësor për çdo fëmijë. Gjithëërfshirja e mirëpret diversitetin dhe e konsideron përshtatjen e mjedisit fizik e pedagogjik si një të drejtë themelore.
- Suksesi i gjithëpërfshirjes varet nga bashkëpunimi i stafit, prindërve dhe komunitetit, si dhe nga ndërhyrja e hershme për të parandaluar përjashtimin dhe për të nxitur zhvillimin e plotë të fëmijës.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Material i prezantimit në PowerPoint i sesionit 3.3 “Planifikimi dhe organizimi i Kopshtit për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara.”
- Planifikimi për gjithëpërfshirje në nivel kopshti
- Hartimi i planit gjithëpërfshirës të kopshtit për femijet me aftësi të kufizuar.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- “Udhëzues mbi Praktikat e Mira të Arsimit Gjithëpërfshirës” (Save the Children, 2022)

- “Standardet për Projektimin e Kopshteve” (MASR, 2016)
- “Inspektimi dhe Vlerësimi i Brendshëm i Kopshtit”
- “Zbatimi i Kurrikulës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara”
- “Udhëzues mbi Mbështetjen e Nxënësve me Aftësi të Kufizuara”

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të përdoren Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Kjo teme do të fokusohet në prezantimin, sqarimin dhe shpjegimin e hollësishëm të hapave dhe strategjive, të cilat duhen ndërmarrë në nivel shkolle për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
Planifikim në nivel kopshti do të thotë se çfarë politikash dhe praktikash të nevojshme duhet të hartojë shkolla, për lehtësimin e përfshirjes së nxënësve me nevoja të veçanta/ me aftësi ndryshe në jetën e kopshtit. Më konkretisht, përfshin informacion të nevojshëm sesi kopshti të përfshijë në planin dhe dokumentet e saj bazë, procedura për arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara duke filluar nga momenti i regjistrimit të fëmijës deri në kalimin për në kopsht. Në këtë kuadër, ofrohen udhëzime rreth: hapave/procedurave që duhet të ndërmerren për regjistrimin e fëmijës me aftësi të kufizuara, kodin e sjelljes së stafit, procesin e transferimit të fëmijës me aftësi të kufizuara, përshtatjen e mjedisit fizik, përfshirjen e prindërve, mënyrën e përzgjedhjes së klasës, kërkesën për vlerësim te fëmijët etj.
Ç'do të thotë kopsht gjithëpërfshirës?
Kopsht gjithëpërfshirës është ai kopsht, në të cilën ndryshimet mes nxënësve dhe diversiteti janë të mirëpritura dhe merren masat e nevojshme për ta realizuar këtë. Kur theksojmë ndryshimin mes fëmijeve nuk nënkuptojmë vetëm fëmijët me aftësi të kufizuar por të gjithë ata që kanë ndryshime a specifika në të nxënë, si p.sh. fëmijë nga komuniteti rom, fëmijët me të ardhura të pakta, apo të natyrës gjinore, etj.
Në thelb, një kopsht gjithëpërfshirës nuk synon të fshijë ndryshimet mes individëve, por zbaton të drejtën për arsim cilësor.
Në këtë aspekt, gjithëpërfshirja është një koncept shumë më i gjerë se koncepti i integrimit. Në një kopsht integrues barra e përshtatjes i bie fëmijës, i cili mëson dhe zhvillohet ndryshe nga shumica. Ndërsa gjithëpërfshirja kërkon që nevojat e ndryshme të të gjithë fëmijët të gjejnë mundësi të realizohen e për këtë shkolla ndërmerr organizimin e strukturave dhe ndryshimeve të nevojshme për t'i mundësuar çdo fëmije arritjen e maksimumit të përfitimit nga pjesëmarrja në kopshte. Për këtë është i nevojshëm zhvillimi i politikave dhe praktikave në nivel kopshte për të lehtësuar përfshirjen e të gjithë nxënësve në të gjitha aspektet e jetës arsimore. Në këto kopshte, drejtuesi, bordi i kopshtit, stafi pedagogjik dhe ai ndihmës kanë përgjegjësitë të përcaktuara qartë për realizimin e këtij synimi.
Planifikimi për gjithëpërfshirje në nivel kopshti
Planifikimi në nivel kopshti për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara duhet të pasqyrohet së pari në planin e kopshtit, si atë vjetor, ashtu edhe atë afatmesëm. Hartimi dhe zbatimi i një plani koherent të kopshtit për përfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara siç kërkohet në ligj, mund të pengohet nga faktorë të tillë si: ngarkesa e

programit mësimor, organizimi i klasave, orari mësimor, provimeve shtetërore e prioriteteve të tjera të kopshtit që kufizojnë planifikimin dhe bashkëpunimin që është thelbësor në gjithëpërfshirje. Pavarësisht nga vështirësitë që mund të hasni, duhet që këto sfida të zgjidhen në nivel shkolle ndaj dhe duhen ngritur strukturat e nevojshme për planifikimin, bashkëpunimin dhe konsultimin mes palëve në dobi të përfshirjes.
Para se të ndërtojë një plan për gjithëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara, çdo kopsht duhet që së pari të marrë në konsideratë kushtet dhe mundësitë që ofron. Ndaj sugjerimet e mëposhtme mund t'ju vijnë në ndihmë përpara se të hartoni planin në kopshtin tuaj:
Hartimi i planit vjetor/afatmesëm të kopshtit për fëmijët me aftësi të kufizuar
Plani vjetor i kopshtit duhet të përcaktojë qartë se cilat do të jenë synimet dhe objektivat e kopshtit për të gjithë fëmijët. Këto synime frymëzohen dhe lidhen ngushtësisht me deklaratën e misionit dhe vizionit të kopshit. Përvec objektivave në planin e kopshtit duhet të përfshihen edhe procedurat, rregulloret dhe strukturat përgjegjëse për fëmijët me aftësi të kufizuara.
Disa rregulla dhe procedura në planin e kopshtit (si dhe rregulloren e saj) mund të jenë të njëjta si për fëmijt e tjerë (p.sh. pranimi në kopsht, disiplinimi, shëndeti dhe siguria, supervizimi, vlerësimi etj.) ndërsa pjesë të tjera të këtij plani mund të jenë specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara (p.sh. roli i komisionit të kopshtit për fëmijët me aftësi të kufizuar, PEI-t, pajisjet ndihmëse etj). Për kopshtet që hasin vështirësi në hartimin e këtij plani mund të kërkohet ndihma edhe e drejtorisë arsimore rajonale përgjegjëse si dhe të kërkohet inspektim për të vlerësuar nivelin e shërbimeve dhe mundësive të kopshtit kundrejt fëmijëve me aftësi të kufizuara. Inspektimi dhe vlerësimi mund të identifikojë nevojën për rishikimin e rregulloreve dhe politikave aktuale të kopshtit ose ndërtimin e strukturave të reja pranë kopshtit. Ky ekip inspektues është më i vlefshëm, kur e bën këtë vlerësim, si pjesë të një shqyrimi më të gjerë të misionit, vlerave dhe programit të kopshtit. Ekipi inspektues mund të vlerësojë mjedisin fizik të kopshtit, kapacitetin e pjesëtarëve të stafit që do të punojnë me nxënës me aftësi të kufizuara, çështjet proceduriale që lidhen me përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, përbërjen e popullatës së nxënësve të kopshtit, duke përfshirë këtu edhe numrin e nxënësve me aftësi të kufizuar dhe llojet e aftësisë së kufizuar. Në bazë të këtyre vlerësimeve mund të merren edhe vendime dhe të përcaktohen prioritetet e nevojshme.

Në planin vjetor të kopshtit duhet të përfshihen fushat/çështjet e mëposhtme që lidhen me arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuar në kopësht:

- procedurat e regjistrimit të nxënësve në kopsht, duke përfshirë këtu edhe pranimin e nxënësve me aftësi të kufizuara
- procedurat për kalimin/transferimin e fëmijëtve nga kopshti në kopsht
- masat për ndryshimet e nevojshme për lehtësimin e transferimit
- procedurat për identifikimin e fëmijëve me nevoja të tjera të veçanta/ me aftësi ndryshe, të cilët duhen referuar në institucione të specializuara për vlerësim;
- strukturat mbështetëse për lehtësimin dhe përfshirjen dhe komunikimin me prindërit
- rregullimet e nevojshme për përshtatjen e mjediseve fizike të kopshtit për të akomoduar femijet me aftësi të kufizuara

- lidhjet me agjencitë dhe shërbimet e tjera në bashki/komunitet;
- politikat, rregullat dhe procedurat e vlerësimit;
- hartimin, zbatimin dhe rishikimin e planit individual të edukimit;
- qartësimin e roleve dhe përgjegjësive të anëtarëve të stafit pedagogjik në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara;
- procedurat, sipas të cilave do të kryhen provimet shtetërore për fëmijët;

Si mund të kuptojmë se, planifikimi në nivel kopshti përfshin dhe merr në konsideratë nevojat e të gjithë fëmijëve duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara.
Planifikimi në nivel kopshti siguron:

- vazhdimësi të kurrikulës për të gjithë fëmijët, duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara, gjatë gjithë viteve dhe niveleve të arsimit;
- zhvillim të proceseve të qarta dhe delegim të përgjegjësive që bëjnë të mundur punë optimale të mësuesit dhe ndihmon proceset dhe procedurat bashkëpunuese;
- ndërtimin e praktikave të përshtatshme pedagogjike, duke siguruar dije dhe përmbajtje pedagogjike nga çdo fushë e të nxënit;
- kulturë vlerësimi që u mundëson të gjithë nxënësve me aftësi të kufizuara përfshirje në detyra sfiduese;
- burime të mjaftueshme që u mundësojnë nxënësve me aftësi të kufizuara të tregojnë atë cfarë kanë mësuar;

Rregullorja e brendshme e kopshtit
Një tjetër dokument me rëndësi i institucionit arsimor është edhe rregullorja e brendshme. Edhe ky dokument, në kuadër të përmirësimit të ligjit duhet të pasqyrojë ndryshimet e nevojshme edhe në lidhje me arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Si procedurë, rregullorja e brendshme hartohet dhe ndryshohet me propozimin dhe nën drejtimin e drejtorit të institucionit arsimor, nga grupe të gjera pune që përbëhen nga mësues, nxënës, prindër dhe përfaqësues të tjerë nga komuniteti; paraqitet për shqyrtim nga drejtori i institucionit arsimor te bordi i institucionit; paraqitet për miratim nga drejtori i institucionit arsimor te titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse. Fëmijët dhe prindërit e tyre kanë të drejtë të informohen për rregulloren e brendshme të institucionit arsimor. Drejtori i institucionit ka për detyrë të organizojë informimin e tyre.
Procedurat e regjistrimit të fëmijës me aftësi të kufizuara në kopsht
Sipas Dispozitave Normative, kopshtet janë të detyruara që për fëmijët me aftësi të kufizuara të ndiqen të njëjtat procedura regjistrimi, si për të gjithë fëmijët e tjerë. Mosha e pranimit të nxënësve me aftësi të kufizuar në kopshte është 3 vjeç. Për fëmijët me aftësi të kufizuar të vlerësuar nga KMCAP-i ose komisioni pranë Drejtorisë Arsimore Rajonale për aftësinë e kufizuar, prindi dorëzon edhe dokumentin e hartuar nga ky komision.

Në nenin nr. 13 të dispozitave normative shkollat gjejnë pikat e mëposhtme në lidhje me këtë procedurë:

1. Regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të shkollave publike bëhet në dy javët e fundit të muajit qershor.

2. Në gjashtë ditët e para kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e parë të një shkolle publike vetëm fëmijët që i përkasin zonës së kopshtit. Kur largesa e banesës së fëmijës nga dy shkolla publike është e diskutueshme, prindi zgjedh njërën nga të dyja shkollat. Në katër ditët pasuese kanë të drejtë të regjistrohen edhe nxënës që u përkasin shkollave të zonave të tjera.
3. Regjistrime të veçanta pranohen deri ditën para fillimit të vitit shkollor.
4. Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë bëhet me këto dokumente: a) Certifikata e lindjes e fëmijës. b) Vërtetimi i vaksinimeve nga qendra shëndetësore. b) Raporti nga okulisti. c) Adresa e fëmijës; ç) Vërtetimi i ndjekjes së kopshtit sipas grupeve, i firmosur nga drejtoresha e kopshtit. (nëse ka)
5. Në raste të veçanta, kur prindi dëshiron të regjistrojë fëmijën në klasë e parë, por nuk disponon certifikatën e lindjes ose/dhe vërtetimin e vaksinimeve veprohet si në rastet analoge me kopshtet.

Stafi i kopshtit duhet të vihet në dijeni mbi çdo faktor që mund të vërë në rrezik jetën e fëmijës me aftësi të kufizuara ose fëmijëve të tjerë. Për këtë arsye shkollat udhëzohen të strukturojnë me kujdes procedurat e regjistrimit që të sigurohen se prindërit kanë mundësi të informojnë stafin e kopshtit për këta faktorë, pa shkelur privatësinë e individit dhe familjes.

Procedurat e fillimit të kopshtit

Kopshtet këshillohen të vendosin në rregulloret e tyre masa/procedura për lehtësimin dhe monitorimin e kujdesshëm të ditëve dhe javëve të para të fëmijës me aftësi të kufizuar në kopsht. Strategjitë dhe masat që duhet të propozojë kopshti me qëllim që fëmija të jetë pjesëmarrës aktiv e të inkurajohet të ndjekë rregullisht kopshtin, duhet të bazohen në praktikat më të mira dhe legjislacion. Pjesëmarrja jo e mirë në ditët e javët e para është tregues se fëmija po has vështirësi me përshtatjen në kopësht. Në këtë kuadër kopshti duhet të marrë në konsideratë:

- Hartimin e një plani të hershëm ndërhyrjeje për të lehtësuar procesin e përshtatjes së fëmijës në kopsht;
- Marrë masa për të parandaluar që herët cenimin fizik, psikologjik dhe emocional të fëmijës.

Shkolla merr të gjitha masat që çdo cenim i fëmijëve me aftësi të kufizuara të ndëshkohet nga komisioni i disiplinës në kopsht, me qëllim mospërsëritjen.

Dështimi i kopshtit në marrjen e masave të mësipërme parandaluese, duke përfshirë këtu edhe rishikimin e planit, rregullores së brendshme dhe procedurave e dokumenteve të tjera të kopshtit, mund të çojë në dështim të përfshirjes së fëmijës dhe në vlerësim negativ të kopshtit.

Ndërhyrja dhe mbështetja e hershme

Kopshtet këshillohen të zbatojnë një plan ndërhyrje për mbështetjen e nxënësve me vështirësi të ndryshme, e që dyshohet të kenë aftësi të kufizuara. Bazuar në modelet ndërkombëtare sugjerojmë këto faza për mbështetjen e hershme të femijet.

<u>Faza e parë</u> – faza e klasës në tërësi – vihen re vështirësitë për të nxënë te femijet, informohen prindërit dhe kryhet një ndërhyrje e parë nga vetë mësuesi i klasës.

Faza e dytë – faza e mbështetjes nga kopshti – përveç ndihmës së dhënë nga mësuesi, prindi dhe femije mbështeten si nga një mësues i specializuar në arsimin special, mësuesi ndihmës dhe psikologu.
Faza e tretë – faza e këshillimit dhe vlerësimit – bëhet një vlerësim në kopsht nga profesionistë të kopshtit si psikologu e mund të hartohet një plan edukimi paraprak.
Më pas fëmija referohet për vlerësim pranë komisionit të vlerësimit në DAR.

Hapat për identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopësht
Kur mësuesja dyshon se fëmija shfaq vështirësi dhe ka pengesa në mësim dhe jetën e klasës ajo fillimisht

1. bën një vlerësim joformal të të mësuarit të fëmijët (sipas modelit në shtojcën nr.4).
2. thërret komisionin e kopshtit.
3. Komisioni vendos për një strategji afatshkurtër, duke përdorur burimet ekzistuese në kopsht.
4. Nëse strategjia nuk funksionon, mësuesja e drejton fëmijën në komisionin e vlerësimit pranë DAR-it, me të dhënat në vijim:

- Detajet identifikuese (emri, mbiemri, ditëlindja, adresa, numri i telefonit,emrat e prindërve, etj);
- Sa kohë e njeh mësuesja fëmijën;
- Sa orë në javë ajo mësuese e mëson këtë fëmijë;
- Pikët e forta në mësime, në sport, fushën sociale/ndërpersonale, etj;
- Nga kush ka marrë fëmija ndërhyrje para se të referohej? (didaktik, paramjekësor, etj);
- Arsyeja e referimit;
- Problemet funksionale dhe të përshtatjes;
- Çfarë është bërë deri tani për të ndihmuar fëmijën? Cilat kanë qenë rezultatet?
- Raportet nga vizitat shtëpiake;
- Profili didaktik i fëmijës (kush e ka bërë testin?);
- Raporti nga drejtori rreth rezultateve nga vëzhgimet në klasë, vullneti i prindërve për të bashkëpunuar;
- Protokollet e komisionit të kopshtit.

Përshtatjet e mjedisit fizik
Pjesë e përshtatjes së kopshtit për fëmijët me aftësi të kufizuar është edhe përshtatja e mjediseve fizike, me qëllim bërjen sa më pak penguese. Rregulloret e ndërtimit të godinave të kopshteve dhe shkollave duhet të udhëhiqen nga parimet e Dizajns Universale.

Sesioni 3.4: Partneriteti në shkollë në ndihmë të arsimimit të fëmijës me aftësi të kufizuara (rolet dhe funksionet e personave përgjegjës).

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë, rolet dhe përgjegjësitë ligjore të aktorëve të përfshirë në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara, si dhe të zhvillojnë aftësi bashkëpunimi ndërmjet institucioneve, prindërve dhe komunitetit për të garantuar përfshirje të plotë dhe arsimim cilësor.

Sesioni synon të theksojë partneritetin si mekanizëm kyç për funksionimin efektiv të institucioneve të arsimit parashkollor dhe shkollave, duke vënë në pah rëndësinë e bashkërendimit ndërmjet strukturave të brendshme (drejtoria, mësuesit, shërbimi psiko-social, mësuesit ndihmës) dhe strukturave mbështetëse të jashtme (ZVA-ja, bashkia, prindërit, organizatat e shoqërisë civile).

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë rolet dhe përgjegjësitë e secilit aktor në procesin e përfshirjes dhe mbështetjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara;
- Përshkruajnë mekanizmat e bashkëpunimit ndërmjet shkollës, familjes dhe institucioneve mbështetëse;
- Njihen me rolin dhe funksionet e bordit të institucionit arsimor, këshillit të prindërve, drejtorit, mësuesve, mësuesit ndihmës, shërbimit psiko-social, komisioneve pranë shkollës/ZVA-së dhe prindërve.
- Kuptojnë rëndësinë e rregullores së brendshme dhe planeve zhvillimore si instrumente që garantojnë përfshirjen.
- Kuptojnë se si bordi, këshillat e prindërve, drejtoria, mësuesit dhe komuniteti kontribuojnë në arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.
- Kuptojnë rëndësinë e rregulloreve të brendshme dhe planeve zhvillimore si instrumente për garantimin e përfshirjes;
- Reflektojnë mbi praktikat aktuale të bashkëpunimit dhe të propozojnë mënyra konkrete për përmirësimin e tyre;
- Zhvillojnë ide për rritjen e partneritetit me komunitetin dhe strukturat mbështetëse për një sistem arsimor më gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues.

Tematika:

1. Rëndësia e partneritetit në arsimin gjithëpërfshirës.
2. Organizmat brenda kopshti: Bordi i institucionit arsimor, Këshilli i prindërve, Komisioni i institucionit.
3. Roli i drejtorit dhe menaxhimit të procesit gjithëpërfshirës.
4. Roli i mësuesve dhe mësuesit ndihmës në mbështetje të PIE-s dhe procesit mësimor.
5. Funksioni i punonjësit psiko-social dhe bashkëpunimi me familjen.
6. Roli i prindërve dhe komunitetit në forcimin e klimës përfshirëse.
7. Bashkëpunimi me ZVA-në, pushtetin vendor, shërbimet shëndetësore dhe sociale.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1).**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup (Shtojca nr.2)**

Mbi identifikimin e aktorëve kryesorë dhe përgjegjësive të tyre në arsimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Hartimi i një harte partnerësh për një kopsht/shkollë gjithëpërfshirëse (brenda dhe jashtë institucionit). Diskutim mbi praktikat ekzistuese dhe sugjerime për forcimin e bashkëpunimit në nivel vendor.

- **Analizim rasti (Shtojca nr.3).**

Ky aktivitet është përzgjedhur për të analizuar shembuj konkretë të partneriteteve të suksesshme dhe sfidave që hasen në zbatimin e tyre, duke nxitur reflektim mbi faktorët që kontribuojnë në bashkëpunim efektiv ndërmjet institucioneve arsimore, pushtetit vendor dhe komunitetit. Ai synon të identifikojë praktikat e mira, pengesat dhe mundësitë për përmirësim, duke e lidhur teorinë me situata reale. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e analizës të përdoren për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe zhvillimin e strategjive për partneritete të qëndrueshme.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Përfshirja e nxënësve me aftësi të kufizuara është një përgjegjësi e përbashkët e gjithë aktorëve të shkollës, jo vetëm e mësuesit.
- Suksesi i përfshirjes varet nga bashkëpunimi i strukturave të shkollës, prindërve, komunitetit dhe institucioneve mbështetëse si ZVA-ja, pushteti vendor dhe shërbimet sociale e shëndetësore.
- Planet zhvillimore dhe rregullorja e brendshme duhet të përfshijnë masa konkrete për fëmijët me aftësi të kufizuara, duke krijuar një klimë bashkëpunuese që nxit pjesëmarrjen aktive të çdo fëmije.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit 3.4 "Partneriteti në shkollë në ndihmë të arsimimit të fëmijës me aftësi të kufizuara (rolet dhe funksionet e personave përgjegjës)"

- Shembull *harte partnerësh për një kopsht/shkollë*

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

- Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:
- “Udhëzues mbi Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta”, MASHT, Handikos & Save the Children (2020)
- “Një Shkollë për të Gjithë – Përvojë pune me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme”, Save the Children (2010)
- “Partneriteti Shkollë-Familje”, CSL & OSFA (2015)
- “Moduli 3 – Gjithëpërfshirja në Arsim”, MASHT & GIZ (2020)
- “Guidë Udhëzuese mbi të Drejtën për Arsimim”, FSHDPAK (2007)

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahen: Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Në temen paraardhëse theksuam nevojën e hartimit dhe rishikimit të planit dhe rregullores së brendshme në të cilin përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara. Kjo rregullore duhet të tregojë gjithashtu edhe përfshirjen e kontributin e të gjitha institucioneve të tjera si ZVA-ja, Shërbimi Shëndetësor, Bashkia, shërbimet psiko-sociale etj.
Në bazë të Dispozitave Normative përshkruhen dhe jepet informacion i mjaftueshëm mbi rolet dhe përgjegjësitë e bordit të shkollës, drejtorit, mësuesit dhe mësuesit ndihmës, ekipit të kopshtit dhe komisionit pranë ZVA-së, stafit mbështetës dhe shërbimeve të tjera pranë kopshtit (si psikologu, punonjësi social, terapisti) dhe prindërit. I gjithë ky informacion mund të merret në konsideratë kur të hartohen politikat dhe rregulloret që lidhen me mirëpërfshirjen e nxënësve me aftësi të kufizuara me të cilat u njohët në temën “Organizimi i kopshtit për gjithëpërfshirjen e nxënësve”.

Mekanizmat e përfshirjes në kopshtet shqiptare funksionojnë nëpërmjet organeve të brendshme dhe roleve të qarta përgjegjësie. Bordi i institucionit arsimor garanton misionin, mbarëvajtjen administrative e financiare dhe përfaqësimin e aktorëve kryesorë (prindër, mësues, përfaqësues të pushtetit vendor dhe komunitetit), duke vepruar sipas parimeve të ligjshmërisë, paanësisë dhe transparencës; përbërja dhe procedurat e ngritjes së tij përcaktohen nga Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, si dhe nga rregulloret model të bashkive që zbatojnë ligjin nr. 69/2012 dhe Urdhrin nr. 31/2020 për funksionimin e institucioneve parauniversitare. Përkrah bordit, Këshilli i prindërve shërben si hallkë bashkëpunimi me institucionin për çështje të cilësisë, qasjes dhe pjesëmarrjes, ndërsa komisionet e brendshme—veçanërisht Komisioni i Shëndetit, Sigurisë, Mirëmbajtjes dhe Mjedisit—kujdesen për standardet e mjedisit fizik, sigurinë dhe mirëmbajtjen, sipas rregullores së miratuar me Urdhrin nr. 31/2020, që detajon organizimin e brendshëm të kopshtit, rolet, raportet vjetore dhe mekanizmat e llogaridhënies.

Në këtë arkitekturë, drejtori i kopshtit ka rolin kyç të liderit institucional që e përkthen vizionin gjithëpërfshirës në politika, rregullore dhe praktika konkrete. Ai/ajo udhëheq zhvillimin profesional të stafit, menaxhon burimet njerëzore dhe financiare, mbikëqyr

zbatimin e kurrikulës me fëmijën në qendër, si dhe garanton partneritetet kopsht–familje–komunitet. Standardet profesionale për drejtuesit (IZHA/ASCAP, të miratuara me mbështetje të UNICEF-it) e përshkruajnë këtë rol në dimensione të qarta: udhëheqje e ndryshimit, zbatim i kurrikulës, menaxhim burimesh dhe komunikim i institucionit—që të gjitha të lidhura me kulturën dhe praktikat e përfshirjes në nivel kopshti. Në të njëjtën linjë, programet e fundit të Shkollës së Drejtorëve për arsimin parashkollor, të nisura nga MAS-i më 17 janar 2025, konsolidojnë aftësitë menaxheriale e lidershipin e 539 drejtueseve të çerdheve/kopshteve dhe ekipeve mbështetëse, duke e bërë gjithëpërfshirjen kompetencë të domosdoshme në menaxhimin ditor të institucionit.

Mësuesit dhe mësuesit ndihmës janë aktorët praktikë të përfshirjes në klasë. Mësuesi përshtat metodologjitë (Universal Design for Learning, mësim me bazë lojën, ritme të personalizuara) dhe vlerëson progresin përmes PEI-së (Plani Edukativ Individual), ndërsa mësuesi ndihmës siguron akomodime, mbështetje një-më-një, komunikim alternativ dhe bashkëplanifikim të veprimtarive. ASCAP-i ka përcaktuar standardet profesionale të mësuesit ndihmës në tetë fusha (politikat arsimore për AK-në, zhvillimi i fëmijës, mjedisi i të nxënit, njohuritë kurrikulare, vlerësimi, planifikimi dhe strategjitë, komunikimi e bashkëpunimi, zhvillimi profesional), duke i lidhur drejtpërdrejt me hartimin/zbatimin e PEI-së dhe me klimën e klasës; këto standarde janë shoqëruar nga udhëzues praktikë dhe reflektime profesionale mbi rolin e mësuesit ndihmës në rritjen e përfshirjes, por edhe mbi sfidat e trajnimit dhe burimeve në terren.
Punonjësi psiko-social (psikologu/punonjësi social) ushtron funksione të integruara ndërmjet fëmijëve, stafit dhe familjes: identifikon faktorë rreziku, ofron ndërhyrje psiko-edukative, lehtëson komunikimin me prindërit dhe referon te shërbimet e komunitetit kur nevojitet. Manualet e punës për njësitë psiko-sociale në sistemin parauniversitar theksojnë planifikimin e ndërhyrjeve, etikat e punës me fëmijët, bashkëpunimin me mësuesit dhe institucionet, si dhe instrumentet praktike të monitorimit të mirëqenies dhe përfshirjes, duke vendosur fëmijën në qendër të veprimit shumaktorësh. Kjo punë lidhet drejtpërdrejt me rolet e prindërve dhe komunitetit, të cilët jo vetëm përfaqësohen në bord e këshilla, por edhe kontribuojnë në kultura gjithëpërfshirëse (ditë kulture/gjuhe, feedback periodik, bashkë-edu kim), duke rritur ndjeshmërinë ndaj diversitetit dhe duke e bërë pjesëmarrjen e prindërve komponent të llogaridhënies institucionale.
Së fundi, bashkëpunimi ndërinstitucional është kusht për qëndrueshmërinë e përfshirjes. ZVA/DRAP-i ofrojnë mbështetje teknike, monitorim pedagogjik dhe trajnime, pushteti vendor siguron infrastrukturë dhe rregullore vendore në përputhje me standardet kombëtare, ndërsa shërbimet shëndetësore dhe sociale mundësojnë diagnostikim, terapi dhe mbështetje familjare. Raportet sektoriale dhe udhëzuesit praktikë të arsimit parashkollor për Shqipërinë nënvizojnë se përfshirja efektive kërkon zinxhir bashkëpunimi mes këtyre aktorëve, me protokolle të qarta referimi dhe mekanizma të përbashkët monitorimi, në mënyrë që politika-kultura-praktika të përforcohen në mënyrë të qëndrueshme në kopshtet e vendit.

Bordi i institucionit arsimor

Çdo institucion arsimor ka bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues dhe përfaqësues të qeverisë vendore e të komunitetit. Bordi kontribuon për mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit. Ky organizëm krijon mundësinë edhe për vendimmarrje nga prindërit, sepse është organ kolegjial dhe si rregull drejtohet nga një prind. Bordi ka si mision të sigurojë që shërbimi shkollor të kryhet sipas politikave arsimore kombëtare e vendore, dhe interesave të komunitetit të kopshtit/shkollës dhe përbën hapin e parë drejt decentralizimit të arsimit. Për nga mënyra e kompozimit, jo vetëm krijon përshtypjen por, dhe ka mundësinë që të njohë në hollësi problemet e shkollës, t'i zgjidhë ose t'i trajtojë ato për zgjidhje. Kjo përbërje krijon hapësirë bashkëpunimi me disa nga partnerët kryesore në fushën e arsimit, brenda e jashtë shkollës ku Bordi, shumë mirë, mund të luajë rolin e koordinatorit. Ai ka kompetenca për të zbatuar detyrat e ngarkuara brenda shkollës dhe për të informuar apo paraqitur shqetësimet deri në Pushtetin Vendor dhe ZVA.

Roli dhe funksionet e këtij bordi janë përshkruar në një udhëzim të vecantë, në bazë të këtij udhëzimi roli dhe përgjegjësitë e bordit të kopshtit janë si më poshtë:

Roli dhe përgjegjësitë e bordit të kopshtit në lidhje me nxënësit me aftësi të kufizuara

- Merr pjesë në hartimin e planit afatmesëm dhe vjetor të institucionit arsimor (së bashku me personat/njësitë e tjera të përshkruara më pas) (bën kujdes që të përfshijë në objektivat e këtyre dokumentave si prioritet arsimimin e nxënësve me aftësi të kufizuara që bëjnë të mundur përfshirjen e tyre në të gjithë aspektet e jetës në kopsht)
- Merr pjesë në hartimin e rregullores së brendshme të kopshtit.
- Miraton kurrikulën duke marrë në konsideratë edhe fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollë.
- Miraton buxhetin e kopshtit (krijon mundësi për mbështetje financiare për persona e shërbime edhe në ndihmë të nxënësve me aftësi të kufizuara. Përpiqet të krijojë kontribute të komunitetit, biznesit dhe të qeverisë vendore në mbarëvajtjen e kopshtit).
- Sigurohet dhe merr masa që kopshti të bëjë përshtatjet e nevojshme për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Kontribuon në zhvillimin e ndërgjegjes për përgjegjësitë e veçanta kundrejt nxënësve me aftësi të kufizuara, si tek mësuesit edhe pjesëtarëve të tjerë të kopshtit, duke nxitur një klimë gjithëpërfshirëse në kopësht.
- Duke qenë i lidhur me burimet në komunitet dhe bizneset në veçanti, mundëson praktikimin e aftësive për jetën dhe aftësive për punë për nxënësit me aftësi të kufizuara.
- Sigurohet që raportet vjetore të kopshtit janë reale dhe pasqyrojnë gjendjen dhe nevojat reale të nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Sigurohet se burimet (e ardhura nga MAS-i) si mësuesi ndihmës, mjetet ndihmëse etj përdoren si duhet në dobi të nxënësve me aftësi të kufizuara.
- Siguron që stafi i shkollës dhe këshillat e prindërve janë konsultuar mbi planet dhe rregulloret që lidhen me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkollë.

Roli dhe përgjegjësitë e Këshillit të prindërve të institucionit arsimor në lidhje me fëmijët me aftësi të kufizuara

Është përgjegjësi e këtij këshilli të sigurojë se të drejtat e prindërve duke përfshirë këtu edhe prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar zbatohen siç janë përshkruar në legjislacion. Ai sigurohet që prindërit e fëmijës me aftësi të kufizuar:

- Informohen për nevojat arsimore të fëmijës dhe mënyrës sesi janë përmbushur këto nevoja në kopësht
- Kanë mundësi të marrin pjesë në vendimet që ndikojnë arsimimin e fëmijës.
- Kanë qasje në dokumentacionin e fëmijës (dosjen e fëmijës, ditarin e mësuesit, ecurinë e progresin e fëmijës me AK, etj.)

Roli dhe përgjegjësitë e Këshillit të prindërve të klasës në lidhje me nxënësit me aftësi të kufizuara.

Ky këshill ka të njëjtat përgjegjësi si këshilli i mësipërm por në nivel klase. Sipas LAPU-t dhe DN-ve ky këshill:

- jep ndihmesën në përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor për nxënësit e klasës.
- për çdo klasë, brenda 10 ditëve, që nga data e fillimit të vitit shkollor, mblidhet një herë në dy muaj, dhe a) i propozon mësuesit kujdestar përmirësime në mbarëvajtjen e nxënësve të klasës; b) dëgjon parashtrimet e mësuesit kujdestar dhe i jep këshilla ose ofron bashkëpunim;
- komunikon me prindër të nxënësve që rrezikojnë braktisjen e shkollës, ose mbetjen në klasë, ose që kryejnë shkelje të disiplinës;
- nxit prindërit të japin ndihmesën e tyre vullnetare: a) për të punuar me nxënës me vështirësi në të nxënë; b) për të hartuar ose/dhe venë në jetë lëndë ose module me zgjedhje; c) për të bashkëpunuar në projekte kurrikulare.

Roli dhe përgjegjësitë e Komisionit të institucionit arsimor të zakonshëm

Dispozitat normative kanë parashikuar ndërtimin e një komisioni të veçantë pranë kopshtit, në mbështetje të nxënësve me aftësi të kufizuara. Ky komision lehtëson punën dhe udhëzon shkollën në të gjithë procesin e përfshirjes së fëmijës me aftësi të kufizuara në kopsht, që nga momenti i regjistrimit e deri në largimin apo transferimin nga kopshti. Ky komision që ngrihet nga drejtori i kopshti drejtohet nga punonjësi i shërbimit psiko-social dhe të paktën një nga mësuesit e nxënësit me aftësi të kufizuara. Në planin vjetor të kopshit duhet përcaktuar qartë roli i secilit anëtar të këtij komisioni. Përgjegjësitë e këtij komisioni janë:

- udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton
- ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve
- ndjek ecurinë e fëmijëve me AK
- paraqet pranë komisionit të ZVA-së, raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni pranë ZVA-së.

Roli dhe përgjegjësitë e Drejtorit të institucionit arsimor

Drejtori është figura kyç për menaxhimin e kopshtit dhe zbatimin e politikave gjithëpërfshirëse. Detyrat e tij përfshijnë:

1. **Lidership dhe Vizion Strategjik**
    - Përkthimi i misionit dhe vizionit të kopshtit në politika dhe plane konkrete.

- Hartimi dhe miratimi i planit vjetor dhe afatmesëm, duke përfshirë masat për gjithëpërfshirje.

2. **Menaxhimi i Burimeve**
   - Sigurimi i buxhetit dhe mobilizimi i burimeve për përshtatje fizike dhe materiale didaktike.
   - Organizimi i stafit pedagogjik dhe ndihmës sipas nevojave të fëmijëve.
3. **Zbatimi i Politikave dhe Rregulloreve**
   - Hartimi dhe rishikimi i rregullores së brendshme për të reflektuar parimet e gjithëpërfshirjes.
   - Mbikëqyrja e procedurave të regjistrimit dhe transferimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara.
4. **Bashkërendimi i Strukturave të Brendshme**
   - Drejtimi i Bordit të Institucionit, Këshillit të Prindërve dhe Komisioneve (siguri, shëndet, etikë).
   - Sigurimi i funksionimit të komisioneve për vlerësim dhe mbështetje.
5. **Mbështetja e Procesit Edukativ**
   - Monitorimi i zbatimit të PEI-ve (Planeve Edukative Individuale).
   - Sigurimi i trajnimeve për stafin mbi metodologjitë gjithëpërfshirëse.
6. **Komunikimi dhe Bashkëpunimi**
   - Ndërtimi i marrëdhënieve me prindërit dhe komunitetin.
   - Bashkëpunimi me ZVA/DRAP-in, pushtetin vendor dhe shërbimet shëndetësore/sociale.
7. **Monitorimi dhe Vlerësimi**
   - Vlerësimi i progresit të fëmijëve dhe efektivitetit të masave gjithëpërfshirëse.
   - Raportimi periodik tek autoritetet arsimore dhe bordi i institucionit.

Roli dhe përgjegjësitë e mësuesit në arsim parashkollor

Roli dhe përgjegjësitë e mësuesit të kopshteve në Shqipëri përqendrohen në krijimin e një mjedisi të sigurt, stimulues dhe gjithëpërfshirës ku çdo fëmijë—pavarësisht aftësive, gjuhës, kulturës apo statusit social—ka qasje të barabartë në të nxënë dhe zhvillim. Në përputhje me rregulloren kombëtare të funksionimit të institucioneve parauniversitare, mësuesi planifikon dhe zbaton veprimtari me bazë lojën e të integruara me kurrikulën parashkollore, vlerëson vazhdimisht progresin përmes vëzhgimit formues dhe dokumentimit, respekton kodin e etikës dhe protokollet e sigurisë, si dhe bashkëpunon me strukturat e brendshme të institucionit (drejtorin, komisionet e sigurisë, këshillin e prindërve) për të garantuar cilësinë dhe mirëqenien e fëmijëve në jetën e kopshtit. Në dimensionin e përfshirjes, mësuesi punon me PEI-n (Planin Edukativ Individual) kur është e nevojshme, përshtat mjedisin dhe materialet (vizuale, sensoriale, dygjuhëshe) sipas parimit të Universal Design for Learning, dhe bashkëplanifikon me mësuesin ndihmës për akomodime, komunikim alternativ e mbështetje një-më-një; standardet profesionale të përcaktuara nga ASCAP-i kërkojnë njohjen e kurrikulës, vlerësimit, planifikimit dhe komunikimit efektiv me prindërit e specialistët, duke e pozicionuar mësuesin si aktorin kryesor që lidh pedagogjinë me praktikat gjithëpërfshirëse në klasë. Përmes zhvillimit profesional të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me familjet e komunitetin, mësuesit e kopshteve po adoptojnë

metodologji inovative për t'u përgjigjur diversitetit të nevojave dhe ritmeve të të nxënit, gjë që forcon kulturën e përfshirjes dhe rrit efektivitetin e mësimdhënies në praktikat e përditshme të arsimit parashkollor në Shqipëri.

Roli dhe përgjegjësitë e mësuesit të lëndës

Mësuesi i lëndës ka një rol kyç në suksesin e përfshirjes së nxënësve me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme. Ai duhet të jetë në dijeni të të gjithë raporteve dhe vlerësimeve të bëra fëmijës dhe dokumenteve të tjerë konfidencialë. Ai ka përgjegjësinë të sigurojë se të gjithë nxënësit, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara e nevoja të tjera të veçanta kanë programin mësimor dhe mjedisin e nevojshëm që i lejon të kenë qasje në kurrikulë dhe të përparojnë në marrjen e dijeve. Roli i tyre është parësor në identifikimin e fëmijëve me risk dhe tërheqjen e vëmendjes edhe pjesës tjetër përgjegjëse të stafit të shkollës kundrejt nevojave të këtyre nxënësve. Nëse dyshimet e tij për një nxënës nuk kalojnë edhe pasi ai ka aplikuar disa strategji e ka bërë përshtatjet e nevojshme në klasë, ai duhet të konsultohet si me prindërit edhe me ekipin e shkollës dhe mësues të tjerë të trajnuar në fushën e arsimit special për të parë se për çfarë ka nevojë më shumë fëmija. Nëse ekipi i ngritur pranë shkollës pas vlerësimeve të para vlerëson se është i nevojshëm kërkimi i ndihmës nga burime jashtë shkollës, atëherë ai krijon lidhjen dhe koordinohet me të gjitha njësitë e shërbimet e nevojshme, duke filluar së pari me komisionin e vlerësimit pranë DAR-it. Mësuesit luajnë dhe japin kontribut madhor përmes krijimit të një mjedisi mbështetës për nxënësit me AK me anë të të cilit këta nxënës afirmojnë aftësitë e tyre për të marrë pjesë në jetën e përgjithshme të shkollës. Mësuesi i lëndës duhet të përshtatë mësimin me nevojat individuale të nxënësve me aftësi të kufizuara për të arritur objektivat e vendosura në planin edukativ individual. Në këtë detyrë ai bashkëpunon ngushtë me mësues të tjerë të ekipit të shkollës, mësuesin ndihmës dhe prindin. Në mjediset e klasës mësuesi realizon aktivitete mësimore të përshtatshme që i lejojnë nxënësit të arrijnë objektivat e veta. Ai kontribuon në rishikimin e PEI-t duke dhënë informacion mbi ecurinë e fëmijës, duke bashkëpunuar ngushtë me komisionin e shkollës. Ai i informon vazhdimisht prindërit mbi ecurinë e fëmijës me aftësi të kufizuar, me anë të takimeve dhe mënyrave të tjera formale dhe informale. Në mungesë të mësuesit ndihmës ai merr përgjegjësi për të gjitha detyrat që Dispozitat Normative ia kanë ngarkuar mësuesit ndihmës.

Roli dhe përgjegjësitë e mësuesit ndihmës në institucionet arsimore

Figura e mësuesit ndihmës është një ndër risitë e LAPU-s dhe Dispozitave Normative. Për këtë arsye, në dispozita i janë deleguar një sërë funksionesh me rëndësi mësuesit ndihmës. Mësuesi ndihmës emërohet në shkollë në bazë të numrit të nxënësve me aftësi të kufizuara.

Në kontekstin e arsimit parashkollor roli dhe përgjegjësitë e mësuesit ndihmës në institucionet e arsimit parashkollor në Shqipëri janë të lidhura ngushtë me mbështetjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe zbatimin e praktikave gjithëpërfshirëse. Ky profesionist punon në bashkëpunim të ngushtë me mësuesin e klasës për të siguruar që çdo fëmijë të ketë qasje të barabartë në procesin mësimor dhe të përfitojë nga pjesëmarrja aktive në aktivitetet e kopshtit.

Mësuesi ndihmës ka përgjegjësi për zbatimin e PEI-t (Planit Edukativ Individual), duke përshtatur materialet didaktike, metodologjitë dhe mjedisin e të nxënit sipas nevojave specifike të fëmijës. Ai ofron mbështetje individuale, ndihmon në menaxhimin e sjelljes, përdor strategji komunikimi alternativ (piktograma, gjuhë e thjeshtuar) dhe siguron që fëmija të marrë pjesë në lojëra dhe veprimtari edukative. Një pjesë e rëndësishme e rolit të tij është bashkëpunimi me prindërit dhe specialistët (psikologë, punonjës socialë, terapistë), për të garantuar që ndërhyrjet janë të bashkërenduara dhe efektive. Gjithashtu, mësuesi ndihmës kontribuon në përshtatjen e mjedisit fizik (mobilie të aksesueshme, zona qetësie, pajisje ndihmëse) dhe në zbatimin e protokolleve të sigurisë për fëmijët me nevoja të veçanta. Ai merr pjesë në takimet e komisioneve të kopshtit, raporton progresin e fëmijës dhe sugjeron masa për përmirësim. Përveç mbështetjes direkte, mësuesi ndihmës ka detyrë të ndjekë zhvillimin profesional të vazhdueshëm, duke u trajnuar për metodologjitë gjithëpërfshirëse, menaxhimin e diversitetit dhe përdorimin e teknologjive asistive.

Në thelb, mësuesi ndihmës është një aktor kyç për realizimin e gjithëpërfshirjes, duke e bërë kopshtin një mjedis ku çdo fëmijë ndihet i pranuar, i mbështetur dhe i aftë të arrijë potencialin e tij maksimal.

Në kontekstin e arsimit të detyrueshëm detyra kryesore e tij është mësimi i nxënësit me aftësi të kufizuara si në nivel individual (vetëm me fëmijën me AK) si në grupe të vogla, si në klasa të veçanta ashtu edhe në bashkëpunim me mësues të tjerë të shkollës. Këtë detyrë ai e zbaton përmes rrugëve të mëposhtme:

- Duke u përfshirë në mësimdhënie në bashkëpunim me mësuesin e lëndës
- Duke qëndruar me nxënësit me aftësi të kufizuara në orë të vecanta ku ka më shumë nevojë për ndihmë.
- Duke dhënë ndihmë specifike edhe në fusha të tjera të nevojshme për nxënësit me aftësi të kufizuara sic janë aftësitë sociale dhe aftësitë për jetën

Detyra të tjera specifike me rëndësi të mësuesit ndihmës të përcaktuara në DN janë:

- Pjesëmarrja në ekip për hartimin e PEI-t.
- Pjesëmarrja në vlerësimin e fëmijës me aftësi të kufizuara.
- Rishikimi i PEI-t dhe takimi i përjavshëm me ekipin e PEI-t.
- Këshillimi dhe mbështetja e mësuesve të lëndës në lidhje me fëmijën me AK (strategjitë mësimore, materialet për mësim, teknologjinë dhe mjetet ndihmëse, strategjitë për menaxhimin e sjelljes, etj.).
- Shënimin në planin ditar të aspekteve të ecurisë së fëmijës me AK.
- Dhënie e ndihmës në detyrat e shtëpisë dhe planifikim.
- Përzgjedhjen dhe mirëmbajtjen e materialeve mësimore.
- Përshtatjen e provimeve.
- Zbatimin e një sistemi monitorimi të ecurisë dhe përfshirjes së nxënësve me AK
- Dhënie informacioni për nevojat mësimore specifike, aftësitë dhe arritjet e nxënësit me AK

Roli dhe përgjegjësitë e punonjësit të njësisë së shërbimit psiko-social

Roli dhe përgjegjësitë e punonjësit të njësisë së shërbimit psiko-social në kopshtet parashkollore janë të lidhura ngushtë me mbështetjen e fëmijëve, familjeve dhe stafit për të siguruar një mjedis të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të shëndetshëm. Ky

profesionist është pjesë e strukturës së brendshme të institucionit dhe vepron sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe standardeve të ASCAP-it.

Detyrat kryesore përfshijnë:

- **Identifikimin e nevojave psiko-sociale** të fëmijëve, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara ose që përballen me vështirësi emocionale, sociale apo të sjelljes.
- **Hartimin dhe zbatimin e planeve mbështetëse individuale**, në bashkëpunim me mësuesit, mësuesit ndihmës dhe prindërit, duke integruar ndërhyrje psiko-edukative dhe strategji për menaxhimin e sjelljes.
- **Mbështetje për stafin pedagogjik**, përmes këshillimit dhe trajnimit mbi menaxhimin e diversitetit, stresit dhe situatave të vështira në klasë.
- **Bashkëpunimin me familjen**, duke ofruar këshillim, orientim dhe përfshirje aktive në procesin e edukimit dhe mirëqenies së fëmijës.
- **Bashkërendimin me shërbimet e jashtme** (shëndetësore, sociale, ZVA/DRAP) për referime dhe ndërhyrje shumëdisiplinore kur nevojitet.
- **Monitorimin e klimës psikologjike** në institucion, parandalimi i bullizmit, dhunës dhe cenimit emocional, si dhe zbatimi i protokolleve të mbrojtjes së fëmijëve.
- **Raportimi dhe dokumentimi** i rasteve, progresit dhe rekomandimeve për përmirësim, duke respektuar privatësinë dhe etikën profesionale.

Ky rol është thelbësor për krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse, ku fëmijët ndihen të sigurt, të mbështetur dhe të aftë të arrijnë potencialin e tyre maksimal. Punonjësi psiko-social është ura lidhëse mes kopshtit, familjes dhe komunitetit, duke garantuar që përfshirja nuk mbetet vetëm një parim, por një praktikë e përditshme.

Roli dhe përgjegjësitë e prindit në institucionet arsimore parashkollore

Roli dhe përgjegjësitë e **prindit në institucionet arsimore parashkollore** në Shqipëri janë të lidhura ngushtë me pjesëmarrjen aktive dhe bashkëpunimin për të siguruar një mjedis gjithëpërfshirës dhe cilësor për fëmijët. Prindi është partner i rëndësishëm në procesin edukativ dhe ka detyrën të kontribuojë në vendimmarrje, komunikim dhe mbështetje të vazhdueshme.

Prindërit marrin pjesë në Këshillin e Prindërve dhe shpesh përfaqësohen në Bordin e Institucionit, duke dhënë mendime për politikat e kopshtit, rregulloret dhe praktikat që lidhen me mirëqenien e fëmijëve. Ata kanë përgjegjësi për të ofruar informacion të saktë mbi nevojat e fëmijës, veçanërisht kur bëhet fjalë për fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe për të bashkëpunuar në hartimin e PEI-t (Planit Edukativ Individual). Prindërit duhet të marrin pjesë në takimet e rregullta me stafin pedagogjik, të japin feedback mbi progresin e fëmijës dhe të ndihmojnë në zbatimin e strategjive mbështetëse edhe në shtëpi.

Gjithashtu, prindërit kanë rol në forcimin e klimës gjithëpërfshirëse, duke promovuar respektin për diversitetin dhe duke kontribuar në aktivitete kulturore, ditë tematike dhe projekte komunitare. Ata janë përgjegjës për të respektuar rregulloren e brendshme të institucionit, për të siguruar pjesëmarrjen e rregullt të fëmijës dhe për të bashkëpunuar me punonjësit psiko-socialë dhe mësuesit për çdo problem që mund të ndikojë në zhvillimin e fëmijës.

Në thelb, prindi nuk është vetëm kujdestar, por partner strategjik në edukimin e hershëm, duke ndihmuar në ndërtimin e një kopshti ku çdo fëmijë ka mundësi të arrijë potencialin e tij maksimal.

Roli dhe përgjegjësitë e komunitetit të kopshtit

Roli dhe përgjegjësitë e komunitetit të kopshtit janë të lidhura me krijimin e një mjedisi mbështetës, gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues për zhvillimin e hershëm të fëmijëve. Komuniteti përfshin prindërit, organizatat vendore, pushtetin vendor, shërbimet shëndetësore dhe sociale, si dhe aktorë të tjerë që kontribuojnë në mirëqenien e fëmijëve.

Komuniteti ka detyrën të mbështesë politikën e gjithëpërfshirjes së institucionit, duke ofruar burime, ekspertizë dhe pjesëmarrje aktive në vendimmarrje. Përmes këshillave të prindërve dhe aktiviteteve komunitare, ai ndihmon në forcimin e klimës pozitive, promovimin e diversitetit kulturor dhe gjuhësor, si dhe organizimin e aktiviteteve që rrisin ndërgjegjësimin për të drejtat e fëmijëve. Komuniteti luan rol në mobilizimin e burimeve për përshtatjen e mjedisit fizik, sigurimin e pajisjeve ndihmëse dhe mbështetjen e shërbimeve psiko-sociale.

Gjithashtu, komuniteti bashkëpunon me ZVA/DRAP-in, pushtetin vendor dhe shërbimet shëndetësore për të garantuar qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shërbime shumëdisiplinore, duke siguruar që ndërhyrjet të jenë të bashkërenduara dhe efektive. Përmes partneriteteve me organizata joqeveritare dhe projekte sociale, komuniteti kontribuon në trajnimin e stafit, ofrimin e materialeve didaktike dhe zhvillimin e programeve për gjithëpërfshirje.

Në thelb, komuniteti është partner strategjik i kopshtit, duke e kthyer gjithëpërfshirjen nga një parim teorik në një praktikë të përditshme që garanton barazi, respekt dhe mundësi të barabarta për çdo fëmijë.

Sesioni 3.5: Plani Edukativ Individual mjet për gjithëpërfshirjen

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë, funksionin dhe procesin e hartimit të Planit Edukativ Individual (PEI) si një mjet thelbësor për garantimin e përfshirjes efektive dhe zhvillimit personal të fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore parashkollore dhe shkollore.

Sesioni synon të pajisë pjesëmarrësit me njohuri praktike, mjete metodologjike dhe aftësi bashkëpunimi për hartimin dhe zbatimin e PEI-t, duke theksuar rëndësinë e përfshirjes së prindërve, stafit mësimor, specialistëve mbështetës dhe vetë fëmijës në këtë proces.

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë konceptin e PEI-t si dokument planifikimi dhe si proces bashkëpunimi;
- Përshkruajnë hapat kryesorë për hartimin dhe zbatimin e tij në praktikë;
- Identifikojnë rolet dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë në proces;
- Ndërtojnë objektiva realiste dhe të arritshme të përshtatura me nevojat e fëmijës;
- Hartojnë një projektPEI përmes një ushtrimi praktik, duke reflektuar mbi përfitimet që sjell për fëmijën, mësuesin dhe institucionin.

Tematika:

1. Koncepti i PEI-t: dokument apo proces?
2. Arsyet pse PEI është i domosdoshëm.
3. Struktura e PEI-t dhe elementët kryesorë.
4. Hapat e procesit të hartimit (identifikimi i nevojave, përcaktimi i objektivave, zbatimi, monitorimi, rishikimi).
5. Roli i drejtorit, mësuesve, prindërve dhe profesionistëve të tjerë.
6. Përfitimet e PEI-t për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe gjithë shkollën.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1).**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup (Shtojca nr.2).**

Hartimi i një projektPEI-je mbi bazën e një rasti studimor.

Diskutimi mbi rolet e aktorëve në hartimin dhe zbatimin e PEI-t. Si mjet është përzgjedhur për të ndihmuar pjesëmarrësit të kuptojnë në mënyrë praktike procesin e hartimit të një Plani Edukimi Individual (PEI) mbi bazën e një rasti studimor. Ai synon të zhvillojë aftësi për përshtatjen e shërbimeve arsimore sipas nevojave individuale të fëmijës, duke integruar parimet e gjithëpërfshirjes dhe bashkëpunimit ndërinstitucional. Diskutimi mbi rolet e aktorëve në hartimin dhe zbatimin e PEI-t është thelbësor për të sqaruar përgjegjësitë e mësuesve, prindërve, specialistëve mbështetës dhe drejtuesve të institucionit, me qëllim që plani të jetë i realizueshëm dhe efektiv. Në këtë proces

përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, duke e kthyer ushtrimin në një mjet praktik për forcimin e kapaciteteve institucionale.

Mesazhet kyç të sesionit:

PEI është një proces bashkëpunimi që ndërton gjithëpërfshirje reale në shkollë. Cilësia e tij varet nga përfshirja aktive e prindërve, stafit dhe nxënësit, ndërsa objektivat duhet të jenë SMART – specifike, të matshme, të arritshme, të përshtatshme dhe të kufizuara në kohë

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë**.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit 3.5 “Plani Edukativ Individual mjet për gjithëpërfshirjen”.
Rast studimor mbi të cilin do të hartohet një PEI
Hartimi i Planit Edukativ Individual

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- “Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta – Material burimor për mësuesit ndihmës”, Save the Children, ASCAP
- “Plani Individual i Arsimit (PIA) dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore” Save the Children
- “Hartimi dhe Zbatimi i Planit Edukativ Individual (PEI)” MAS

Gjatë sesionit do të përdoren (Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra,)

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Hartimi i Planit të Personalizuar (PEI)

Plani Edukativ Individual (PEI) është një dokument strategjik që synon të garantojë përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore parashkollore, duke lidhur parimet e gjithëpërfshirjes me veprime konkrete. Ky plan hartohet nga një ekip multidisiplinar që përfshin drejtorin e kopshtit, mësuesin e grupit, mësuesin ndihmës, punonjësin psiko-social dhe prindin, duke siguruar që vendimet të bazohen në vlerësime profesionale dhe nevojat individuale të fëmijës.

Procesi fillon me identifikimin e fëmijës dhe mbledhjen e informacionit bazë, përfshirë të dhënat personale, historikun shëndetësor dhe vlerësimet funksionale. Ky hap është i domosdoshëm për të kuptuar profilin e fëmijës, forcat dhe sfidat e tij, si dhe për të përcaktuar akomodimet e nevojshme.

Më pas, ekipi harton objektivat SMART (Specifike, të Matshme, të Arritshme, të Rëndësishme dhe të Kufizuara në kohë), të cilat fokusohen në fusha kyç si zhvillimi

gjuhësor, aftësitë socio-emocionale, motorike dhe njohëse. Për çdo objektiv përcaktohen strategjitë, akomodimet, përgjegjësit dhe afatet kohore.
Një komponent i rëndësishëm i PEI-t është përshtatja e mjedisit fizik dhe materialeve didaktike. Kjo përfshin instalimin e rampave, mobilieve të rregullueshme, sinjalistikës vizuale, si dhe përdorimin e materialeve vizuale, sensoriale dhe dygjuhëshe. Gjithashtu, PEI parashikon akomodime në ritmin e mësimit, komunikimin (piktograma, gjuhë e thjeshtuar) dhe ndërveprimin social përmes lojërave të strukturuara.
Në këtë sesion do të jepen udhëzime të qarta mbi të gjithë hapat e nevojshëm në hartimin e një PEI. Në të ka informacion, sesi ndërtohet PEI dhe si bashkëpunojnë të gjithë personat përgjegjës në këtë proces.

Po le të kuptojmë se çfarë është Plani Edukativ Individual:

- një dokument i shkruar, i cili përshkruan programet edukative të veçanta dhe /apo shërbime që i nevojiten një nxënësi, bazuar në vlerësimin e përgjithshëm të nevojave dhe aftësive që ai ka; nevoja dhe aftësi të cilat ndikojnë në mundësitë e tij për të nxënë dhe për shprehur atë që ka nxënë;
- dokumentim i ndërhyrjeve të programuara, për të ndihmuar nxënësin të rritë pritshmëritë në të nxënë dhe të identifikojë pikat e forta dhe nevojat që ai ka në procesin e të nxënit;
- një dokument pune ku identifikohen përshtatjet e nevojshme të rezultateve të të nxënit në dallim nga ato rezultate që parashikohen dhe hartohen për nivelin arsimor tipik, bazuar në standartet e arritjeve të kompetencave sipas shkallëve (IZHA; MAS, 2016).
- një instrument, për nxënësit, për prindërit e nxënësve dhe për të gjithë ata të cilët kanë përgjegjësi për edukimin formal, informal dhe joformal të nxënësve.(Ministry of Education, Ontario CA, 2004)

Plani edukativ individual është një dokument i shkruar i përgatitur për një nxënës i cili specifikon qëllimet mësimore që duhet të arrihen nga nxënësi gjatë një periudhe të caktuar kohore, si dhe strategjitë e mësimdhënies, burimet dhe ndihmën e nevojshme për të arritur këto qëllime.
Edhe pse shihet si mjet a produkt, plani edukativ individual është më shumë një proces, e është cilësia e këtij procesi të hartimit të tij që përcakton cilësinë dhe efektivitetin e planit. Ai ndërtohet falë bashkëpunimit mes shkollës, prindërve, nxënësit (kur është e mundur) dhe shërbimeve, agjencive dhe profesionistëve të tjerë jashtë shkollës. Plani thekson aspektet e programit mësimor të nevojshme për përshtatje dhe modifikim e fokusohet në nevojat më parësore mësimore të nxënësit, edhe pse ai mund të ketë edhe nevoja të tjera në të nxënë që nuk do të marrin kaq prioritet në planifikim dhe monitorim. Në të përshkruhen hapat që merren për të ndihmuar fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, që vijnë si rezultat i aftësive të kufizuara që kanë fëmijët e i ndihmon ata në mënyrë të posaçme të arrijnë objektivat akademike dhe shoqërore. Në plan nuk modifikohen të gjitha aspektet e kurrikulës apo nevojave të tjera në jetën e shkollës, por vetëm ato fusha të nevojave të identifikuara si të para, nga vlerësimi i fëmijës. Përshtatja dhe ndihma e dhënë do të jetë në varësi të nevojave mësimore të çdo nxënësi. Jo çdo nxënës me aftësi të kufizuara mund të ketë nevojë për një plan të tillë. Ndërsa të tjerë mund të kenë nevojë për modifikime të ndjeshme mësimore. Roli i stafit

është i qartë: mësuesi i grupit planifikon dhe zbaton aktivitetet sipas parimeve të Universal Design for Learning (UDL), mësuesi ndihmës siguron mbështetje individuale dhe dokumenton akomodimet, ndërsa punonjësi psiko-social ofron vlerësime dhe këshillim për fëmijën dhe familjen. Drejtori koordinon procesin dhe siguron burimet e nevojshme, ndërsa prindi kontribuon me informacion dhe zbaton strategjitë mbështetëse në shtëpi.

Monitorimi dhe vlerësimi janë pjesë integrale e PEI-t. Përmes vëzhgimeve, rubrikave dhe portofolit të fëmijës, ekipi analizon progresin dhe bën rishikime mujore për të përshtatur objektivat dhe akomodimet. Raportimi i rregullt tek komisioni i kopshtit dhe ZVA-ja siguron transparencë dhe përputhje me standardet kombëtare.

Në thelb, PEI nuk është thjesht një dokument, por një mjet praktik për realizimin e së drejtës për arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës, duke e kthyer vizionin e politikave arsimore në veprime konkrete që garantojnë zhvillimin maksimal të çdo fëmije.

Sipas Dispozitave Normative drejtori i institucionit shkollor është personi përgjegjës për përgatitjen dhe vënien në jetë të planit edukativ individual, për çdo nxënës me aftësi të kufizuar në shkollën e tij. Ai duhet që të lehtësojë dhe të përfshijë pjesëmarrjen e prindërve në të gjithë procesin e hartimit dhe zbatimit të PEI-t dhe u jep një kopje të këtij plani edhe prindërve.



KUR HARTOHET DHE PSE ËSHTË E RËNDËSISHME NDJEKJA E FËMIJËS ME PLAN EDUKIMI INDIVIDUAL Plani Edukativ Individual (PEI) është një dokument i detajuar që hartohet për çdo fëmijë me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta, për të cilin komisioni i vlerësimit pranë ZVA/DRAP-it ka vendosur ndjekjen me plan të personalizuar. Ky plan është i domosdoshëm për të garantuar që fëmija të ketë qasje

të barabartë në edukim/arsim dhe të përfitojë nga një mjedis gjithëpërfshirës, duke marrë mbështetjen e nevojshme për zhvillimin e tij.

Procesi i trajtimit përfshin:

- Hartimin e PEI-t nga ekipi multidisiplinar (drejtori, mësuesi i grupit, mësuesi ndihmës, psikologu/punonjësi social dhe prindi), duke analizuar forcat dhe nevojat e fëmijës.
- Përshtatjen e mjedisit fizik (rampë, mobilie të rregullueshme, sinjalistikë vizuale) dhe materialeve didaktike (vizuale, sensoriale, dygjuhëshe).
- Zbatimin e metodologjive gjithëpërfshirëse si Universal Design for Learning (UDL), lojëra të strukturuara dhe komunikim alternativ (piktograma, gjuhë e thjeshtuar).
- Mbështetjen individuale nga mësuesi ndihmës për pjesëmarrje aktive, menaxhim sjelljeje dhe ndihmë në aktivitetet e përditshme.
- Monitorimin e progresit përmes vëzhgimeve, rubrikave dhe portofolit të fëmijës, me rishikim mujor të PEI-t dhe përshtatje sipas nevojës.
- Bashkëpunimin me prindin për zbatimin e strategjive mbështetëse edhe në shtëpi dhe për *feedback* të vazhdueshëm.
- Bashkërendimin me shërbimet e jashtme (shëndetësore, sociale) për ndërhyrje shumëdisiplinore kur nevojitet**.**

SI GËRSHETOHET PLANI EDUKATIV INDIVIDUAL ME KURRIKULËN NË ARSIMIN PARASHKOLLOR?

Plani Edukativ Individual (PEI) nuk e zëvendëson kurrikulën kombëtare të arsimit parashkollor, por e përshtat atë sipas nevojave individuale të fëmijës. Kurrikula parashkollore është e bazuar në kompetenca dhe synon zhvillimin e aftësive njohëse, gjuhësore, motorike, sociale dhe emocionale për të gjithë fëmijët. PEI ndërhyn për të siguruar që këto objektiva të realizohen edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara ose me nevoja të veçanta, duke ofruar akomodime dhe strategji të personalizuara.

Gërshetimi ndodh në disa nivele:

- **Planifikimi i veprimtarive**: Mësuesi dhe mësuesi ndihmës përshtatin aktivitetet e lojës, ritmin e mësimit dhe materialet didaktike (vizuale, sensoriale, dygjuhëshe) për të përmbushur objektivat e kurrikulës.
- **Objektivat e PEI-t**: Lidhen drejtpërdrejt me fushat e kurrikulës (gjuhë, matematikë, zhvillim motorik, social-emocional), por përcaktohen në formë **SMART** (Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, i Rëndësishëm, i Kufizuar në kohë).
- **Metodologjia**: Përdoren qasje gjithëpërfshirëse si **Universal Design for Learning (UDL)**, lojëra të strukturuara, komunikim alternativ dhe teknologji asistive për të siguruar pjesëmarrje aktive.
- **Monitorimi dhe vlerësimi**: Përveç vlerësimit sipas kurrikulës, PEI parashikon rubrika dhe portofol individual për të matur progresin e fëmijës në raport me objektivat e personalizuara.

Pse është i rëndësishëm ky gërshetim?

- Siguron që fëmijët me nevoja të veçanta/ aftësi ndryshe të mos përjashtohen nga kurrikula kombëtare.

- Mundëson zhvillim të barabartë dhe pjesëmarrje aktive në grup.
- Forcon bashkëpunimin mes stafit, prindërve dhe specialistëve për të realizuar standardet kombëtare.

PEI është dokument që përcakton:
PEI hartohet nga një ekip multidisiplinar (drejtori, mësuesi i grupit, mësuesi ndihmës, punonjësi psiko-social dhe prindi) pas vendimit të komisionit pranë ZVA/DRAP-it.
Elementet kryesore që përcakton PEI:

- **Profili funksional i fëmijës**: Forcat, nevojat, vështirësitë dhe rekomandimet nga vlerësimet profesionale.
- **Objektivat e zhvillimit**: Të formuluara sipas parimit SMART (Specifik, i Matshëm, i Arritshëm, i Rëndësishëm, i Kufizuar në kohë) në fusha si gjuhë, motorikë, aftësi sociale dhe emocionale.
- **Strategjitë dhe akomodimet**: Përshtatje të mjedisit fizik (rampe, mobilie të rregullueshme), materiale didaktike (vizuale, sensoriale, dygjuhëshe), ritmi i mësimit, komunikimi alternativ (piktograma, gjuhë e thjeshtuar).
- **Roli i stafit**: Detyrat e mësuesit, mësuesit ndihmës, psikologut dhe prindit në zbatimin e planit.
- **Monitorimi dhe vlerësimi**: Frekuenca e vëzhgimeve, treguesit e progresit, raportimi mujor dhe rishikimi i PEI.
- **Bashkërendimi me shërbimet e jashtme**: Referime tek shërbimet shëndetësore, sociale dhe ZVA-ja për mbështetje shtesë.

CILAT JANË HAPAT KRYESORE NË NDËRTIMIN E PEI-t?

Hapi 1-Referimi/raportimi në Komisionin e Vlerësimit pranë DRAP/ZA (ose institucionit
arsimor të zakonshëm). Prindi, drejtori i shkollës ose persona të tjerë të autorizuar në Dispozita Normative, dërgojnë pranë DRAP/ZA-së një kërkesë për vlerësim të nevojave të nxënësit. Kjo kërkesë tregon se personat e mësipërm besojnë se nxënësi mund të ketë AK, që mund të ndikojë në arritjet mësimore. Pëlqimi i prindërve duhet të merret para se të bëhet vlerësimi i tij. Vlerësimi duhet të përfundojë brenda një kohe të arsyeshme, pas marrjes së pëlqimit të prindërve.
Nëse besohet se fëmija/nxënësi ka një vështirësi në të nxënë, vendimin për vlerësimin e tij mund ta bëjë Komisioni në bazë institucioni arsimor (kopshti/shkolle).

Hapi 2-Vlerësimi i nxënësit nga Komisioni i Vlerësimit pranë DRAP/ZA-së (ose institucionit arsimor të zakonshëm) Komisioni multidisiplinar kryen identifikimin e nevojave funksionale arsimore dhe ndërton profilin dinamik funksional të nxënësit, bazuar në raportin e paraqitur nga Komisioni për Vlerësimin e Aftësisë së Kufizuar dhe nevojave për ndihmë dhe mbështetje për nxënësin në fjalë.

Hapi 3-Fitimi i së drejtës për marrjen e shërbimeve
Nëse shihet që nxënësi paraqet nevoja të veçanta, ai/ajo ka të drejtë të marrë shërbimin arsimor, bazuar në nevojat e tij, nëpërmjet hartimit të ndërhyrjeve edukative-individuale të parashikuara sipas dispozitave normative.

Hapi 4-Hartimi i PEI-t
Komisioni i shkollës i ngritur me qëllim hartimin e PEI-t, në bazë të vlerësimit dhe udhëzimit të dhënë nga DAR/ZA-ja, harton PEI-n. Prindërit dhe nxënësi (kur është e përshtatshme) janë pjesë e ekipit. Takimi për ta shkruar PEI-n duhet të mbahet brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni vlerësues, pas marrjes së vendimit nga ky i fundit.

Hapi 5-Zbatimi i PEI-t
Të gjithë personat përgjegjës për zbatimin e PEI-t, duke përfshirë edhe prindërit, pajisen me një kopje të tij në mënyrë që të njohin përgjegjësitë e veta në plan. Pjesëtarë të komisionit takohen periodikisht për të parë ecurinë e zbatimit të PEI-t, bazuar në vendimet e komisionit vlerësues.

Hapi 6-Rishikimi i PEI-t
Komisioni i shkollës vlerëson se sa janë arritur objektivat e PEI-t në fund të çdo periudhe 3 mujore të parashikuar në planin PEI. Në bazë të arritjeve, ai bën rishikimin dhe përshtatjen e këtyre objektivave. Ekipi i PEI-t mund të bëjë rishikim të objektivave të planit, kur e sheh të nevojshme, me qëllim përshtatjen sa më të mirë të ndërhyrjeve edukative drejtuar nxënësit/ fëmijës.

Hapi 7-Rivlerësimi i nxënësit/fëmijës Komisioni i vlerësimit duhet të rivlerësojë nxënësin/fëmijën në përfundim të çdo cikli shkollor. Rivlerësime mund të kryhen edhe më herët me kërkesë të prindit dhe komisionit të institucionit arsimor. Arritjet që ka patur nxënësi ose fëmija gjatë kësaj periudhe komunikohen me prindërit.

MODULI 4: PËRFSHIRJA E PRINDËRVE DHE KOMUNITETIT

Përmbledhje e modulit:

Ky modul trajton rëndësinë e përfshirjes aktive të prindërve dhe komunitetit në procesin e zhvillimit dhe edukimit të fëmijëve në fëmijërinë e hershme, duke synuar forcimin e partneriteteve ndërmjet stafit arsimor, familjeve dhe aktorëve vendorë për ndërtimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Ai thekson vendimmarrjen bashkëpunuese dhe ndarjen e burimeve si bazë për cilësinë e shërbimeve, duke i pajisur pjesëmarrësit me njohuri dhe mjete praktike për zbatimin e Planeve të Zhvillimit të Shkollës, përdorimin e Udhëzuesit për Përfshirje dhe funksionalizimin e bordeve të kopshteve.

Qëllimi i modulit:

Moduli synon të aftësojë punonjësit e arsimit pranë njësive të pushtetit vendor, drejtuesit vendorë dhe aktorët e tjerë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme, për të forcuar partneritetet ndërmjet prindërve, stafit arsimor dhe komuniteteve në funksion të ndërtimit të shërbimeve të qëndrueshme, cilësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin e fëmijëve.
Moduli synon të krijojë një kuptim të përbashkët të rolit të familjes dhe komunitetit si partnerë aktivë në procesin arsimor dhe kujdesin ndaj fëmijës, duke promovuar vendimmarrje të përbashkët, ndarje të burimeve dhe përgjegjësive ndërmjet institucioneve, prindërve dhe aktorëve vendorë.
Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit aftësohen të:

- Lehtësojnë bashkëpunimin prind–staf nëpërmjet Planeve të Zhvillimit të institucionit arsimor dhe mekanizmave ligjorë të pjesëmarrjes;
- Angazhojnë organizatat vendore, OJF-të dhe grupet komunitare për të mbështetur zhvillimin e fëmijëve përmes programeve prindërimi, shkrim-leximi dhe shërbimeve shëndetësore;
- Zbatojnë mjetin “Udhëzues për përfshirje” për të integruar politika dhe praktika gjithëpërfshirëse në nivel institucional dhe komunitar;
- Ngrenë borde aktive të kopshteve, që lidhin familjet me shërbimet arsimore, shëndetësore dhe sociale.

Grupi i synuar

Punonjës të arsimit pranë njësive të pushtetit vendor, drejtues vendorë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme.

Sesioni 4.1: Përfshirja dhe bashkëpunimi prindër- mësues

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë, funksionin dhe mënyrat praktike të bashkëpunimit ndërmjet prindërve, mësuesve dhe fëmijëve si element thelbësor për zhvillimin gjithëpërfshirës dhe mirëqenien e fëmijës në institucionet arsimore parashkollore.
Sesioni synon të pajisë pjesëmarrësit me njohuri teorike dhe qasje bashkëpunuese, të mbështetura në parimet e teorive kryesore pedagogjike (Dewey, Piaget, Vygotsky,

Gardner, Bruner, Malaguzzi), për të ndërtuar marrëdhënie efektive partneriteti ndërmjet familjes dhe institucionit arsimor.
Përmes diskutimeve, reflektimeve dhe shembujve praktikë, pjesëmarrësit do të mësojnë si të nxisin dialogun, pjesëmarrjen aktive të prindërve dhe zhvillimin e një komuniteti edukativ bashkëpunues që mbështet rritjen dhe të nxënit e çdo fëmije.
Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë rëndësinë e bashkëpunimit prind–mësues–fëmijë për zhvillimin e plotë të fëmijës;
- Reflektojnë mbi rolin e prindërve si aktorë aktivë dhe bashkë-ndërtues në procesin arsimor;
- Identifikojnë forma konkrete të përfshirjes së prindërve në jetën e institucionit arsimor parashkollor;
- Aplikojnë strategji për ndërtimin e marrëdhënieve të qëndrueshme dhe të besueshme me prindërit;
- Promovojnë dialogun dhe shkëmbimin e ideve si mjete për ndërtimin e një kulture të përbashkët bashkëpunimi në shërbim të fëmijës.

Tematika:

1. Roli ndërveprues i fëmijëve, prindërve dhe mësuesve si bashkëndërtues të dijes.
2. Ndërvarësia e të nxënit individual dhe shoqëror.
3. Imazhi i fëmijës si qytetar kompetent dhe aktiv.
4. Praktikat e përfshirjes së prindërve: takime, mbrëmje tematike, festa, bordi i prindërve, grupe projektesh.
5. Demokracia si mënyrë jetese në institucionin parashkollor.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup (Shtojca nr.2)**

Si mjet do të shërbejë për të diskutuar mbi rolin e prindërve si aktorë aktivë në arsimin parashkollor dhe për të zhvilluar strategji konkrete për përfshirjen e tyre në aktivitete dhe vendimmarrje. Ai synon të nxisë bashkëpunimin midis institucioneve arsimore dhe familjeve, duke analizuar funksionin e bordit të prindërve dhe grupeve të projekteve si mekanizma për rritjen e transparencës dhe cilësisë së shërbimit. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit, trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e punës në grup të përdoren për forcimin e partneritetit shkollë-familje dhe përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Fëmijët duhet të shihen si qytetarë kompetentë me të drejta, ndërsa prindërit si partnerë aktivë në jetën e institucionit, duke kontribuar përmes takimeve, projekteve dhe aktiviteteve që e bëjnë demokracinë një mënyrë jetese në arsimin parashkollor.
- Arsimin parashkollor është një proces demokratik dhe bashkëpunues ku fëmijët, prindërit dhe mësuesit janë bashkëndërtues të dijes. Dialogu dhe pjesëmarrja aktive e të gjithëve fuqizon edukimin

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **2 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:
Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit 4.1 “Përfshirja dhe bashkëpunimi prindër- mësues”

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- **“**Udhëzues për prindërit – Roli i institucioneve dhe i mësuesve në mbështetje të prindërve për të krijuar partneritet në zhvillimin tërësor të fëmijëve”, Save the Children (2014)
- “Si të ndihmojmë prindërit për t’u kujdesur për zhvillimin dhe edukimin cilësor të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme”, MASR & UNICEF (2022)

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të përdoren (Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra).

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Ky sesion fokusohet në rolin ndërveprues të fëmijëve, prindërve dhe mësuesve si bashkëndërtues të dijes, duke theksuar se procesi i të nxënit nuk është i izoluar, por i lidhur ngushtë me marrëdhëniet sociale dhe bashkëpunimin. Ndërvarësia mes të nxënit individual dhe atij shoqëror krijon mundësi për zhvillim të plotë, ku çdo fëmijë kontribuon dhe përfiton nga përvoja e grupit. Në këtë kuadër, imazhi i fëmijës shihet si qytetar kompetent dhe aktiv, i aftë për të marrë vendime, për të shprehur mendime dhe për të ndikuar në jetën e përditshme të institucionit arsimor parashkollor.
Praktikat e përfshirjes së prindërve janë një tjetër element kyç, duke përfshirë takime të rregullta, mbrëmje tematike, festa, pjesëmarrje në bordet e prindërve dhe grupe projektesh që i japin familjes një rol aktiv në procesin edukativ. Këto praktika jo vetëm që forcojnë lidhjen shkollë-familje, por krijojnë një kulturë bashkëpunimi dhe transparence. Demokracia si mënyrë jetese në institucionin arsimor parashkollor është parimi që e mbështet këtë qasje, duke u dhënë fëmijëve hapësirë për të marrë pjesë në vendimmarrje, për të respektuar rregullat dhe për të ndërtuar marrëdhënie të

bazuara në respekt dhe barazi. Ky sesion synon të tregojë se përfshirja e të gjithë aktorëve nuk është vetëm një strategji, por një filozofi që e bën institucionin më të hapur, më gjithëpërfshirës dhe më demokratik.
Arsimi parashkollor është një sistem kompleks që mbështetet në parimet e pedagogëve si Dewey, Piaget, Vygotsky, Gardner, Bruner dhe Malaguzzi. Ai e koncepton edukimin si një proces bashkëpunues ku fëmijët, prindërit dhe mësuesit janë bashkëndërtues të dijes, duke respektuar ndërvarësinë mes të nxënit individual dhe shoqëror. Në qendër të këtij sistemi është imazhi i fëmijës si qytetar kompetent, aktiv dhe plot potencial, i aftë për të krijuar teoritë e veta dhe për të marrë pjesë në ndërtimin e identitetit dhe autonomisë përmes marrëdhënieve dhe përvojave reale e imagjinare. Edukimi në arsimin parashkollor është një proces kolektiv që kërkon pjesëmarrjen aktive të të gjithë komunitetit për të ndërtuar qytetarë të ndërgjegjshëm dhe një kulturë bashkëpunimi të qëndrueshme.
Një element i rëndësishëm i këtij bashkëpunimi është Bordi i Prindërve, i cili u jep prindërve mundësinë të marrin pjesë në administrimin e institucionit arsimor parashkollor. Bordi mund të aktivizojë grupe projektesh ose grupe tematike për qëllime të caktuara, duke angazhuar prindër të motivuar për të kontribuar në zgjidhjen e çështjeve konkrete. Këto grupe janë një strategji efikase për të arritur rezultate, pasi punojnë me fokus dhe përkushtim. Gjatë planifikimit të pjesëmarrjes, është thelbësore të sigurohet që të gjitha grupet e interesit të kenë mundësi të kontribuojnë, duke respektuar diversitetin e ideve dhe duke i kthyer ato në burim vlerash për projektin edukativ. Ky bashkëpunim, i mbështetur nga takime, mbrëmje tematike, festa dhe projekte të përbashkëta, e bën arsimin parashkollor një hapësirë demokratike dhe gjithëpërfshirëse, ku prindërit njihen si ekspertë të fëmijërisë dhe partnerë aktivë në edukimin e fëmijëve.

Roli ndërveprues i fëmijëve, prindërve dhe mësuesve si bashkëndërtues të dijes. Procesi edukativ në institucionin arsimor parashkollor nuk është linear, por ndërveprues. Fëmijët, prindërit dhe mësuesit janë partnerë aktivë në ndërtimin e dijes, duke kontribuar me përvoja, ide dhe perspektiva të ndryshme. Ky bashkëpunim krijon një mjedis ku mësimi nuk është vetëm transferim informacioni, por një proces i përbashkët kërkimi dhe eksplorimi. Mësuesi nuk është autoritet absolut, por udhëheqës i dialogut, ndërsa prindërit sjellin njohuri praktike dhe kulturën familjare, duke e pasuruar përvojën e fëmijës.
Ndërvarësia e të nxënit individual dhe shoqëror. Të nxënit individual nuk mund të shkëputet nga konteksti shoqëror. Fëmijët mësojnë përmes ndërveprimeve me bashkëmoshatarët, mësuesit dhe prindërit, duke ndarë ide dhe duke ndërtuar kuptime të reja. Ky proces i dyanshëm fuqizon aftësitë njohëse dhe sociale, duke i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë mendim kritik, empati dhe aftësi bashkëpunimi. Ndërvarësia e këtyre dy formave të të nxënit është themel për një edukim gjithëpërfshirës dhe demokratik.

Imazhi i fëmijës si qytetar kompetent dhe aktiv. Fëmija nuk duhet parë si një enë e zbrazët që pret të mbushet me informacion, por si një individ kompetent, aktiv dhe plot potencial. Ai ka të drejtë të marrë pjesë në vendimmarrje, të shprehë mendime dhe të kontribuojë në jetën e institucionit. Ky imazh i ri i fëmijës si qytetar i vogël nxit

respektimin e të drejtave të tij dhe e vendos atë në qendër të procesit edukativ, duke e fuqizuar për të ndërtuar identitetin dhe autonominë e vet.

Praktikat e përfshirjes së prindërve: takime, mbrëmje tematike, festa, bordi i prindërve, grupe projektesh. Pjesëmarrja e prindërve është një element kyç për cilësinë e arsimit parashkollor. Ajo realizohet përmes takimeve të rregullta informuese, mbrëmjeve tematike ku diskutohen çështje të fëmijërisë, festave që forcojnë lidhjet sociale dhe aktiviteteve praktike si ndërtimi i projekteve për institucionin. Bordi i prindërve luan rol të rëndësishëm në administrimin e kopshtit, duke aktivizuar grupe projektesh për qëllime specifike. Këto forma bashkëpunimi e bëjnë prindin jo thjesht vëzhgues, por aktor aktiv në procesin edukativ/arsimor.

Demokracia si mënyrë jetese në institucionin arsimor parashkollor. Demokracia në arsimin parashkollor nuk është vetëm një koncept teorik, por një praktikë e përditshme që shprehet përmes pjesëmarrjes, dialogut dhe respektimit të diversitetit. Fëmijët mësojnë të marrin vendime, të respektojnë rregullat dhe të bashkëpunojnë, duke e përjetuar demokracinë si një mënyrë jetese. Ky model i edukimit demokratik krijon një kulturë ku çdo zë ka vlerë dhe ku bashkëpunimi është themel.
Arsimi parashkollor është një sistem kompleks që mbështetet mbi:

- rolin bashkëpunues midis fëmijëve, mësuesve dhe prindërve i konsideruar si i ndërvarur;
- rolin e fëmijëve dhe mësuesve (por gjithashtu prindërve) si bashkëndërtues të dijes;
- ndërvarësinë e të nxënit individual dhe shoqëror, i konsideruar si fuqizim i dyanshëm;
- rolin e kulturës në të kuptuarin e kësaj ndërvarësie.

Në zemër të këtij sistemi ne dëshirojmë të kemi një imazh të fuqishëm të fëmijës. Në themel të udhëzimeve tona duhet të jetë një imazh i fëmijëve që nuk konsiderohen si enë të zbrazëta që duhet të mbushen me fakte. Ne i shohim fëmijët plot me potencial, kompetentë dhe të aftë për të krijuar teoritë e tyre në lidhje me jetën. Fëmijët kanë të drejtë të njihen si qytetarë, duke i dhënë fjalës qytetar kuptimin e plotë që ajo ka për një të rritur. Fëmijët janë objekt i të drejtave individuale, ligjore, civile dhe shoqërore dhe në këtë fushë veprimi Save the Children është shembull. Fëmijët janë si burimi ashtu edhe ndërtuesit e përvojës së tyre dhe si të tillë, pjesëmarrës aktiv në ndërtimin e identitetit, aftësive dhe autonomisë së tyre nëpërmjet marrëdhënieve dhe ndërveprimit me bashkëmoshatarët, edukatorët, dhe prindërit e tyre si dhe me idetë, objektet dhe me ngjarjet reale dhe imagjinare të botëve ndër-komunikuese. Ne dëshirojmë të marrim pjesë në qëllimin e përgjithshëm për krijimin e qytetarëve të ndërgjegjshëm, duke përmirësuar cilësinë e ndërveprimit njerëzor. Kjo është e mundur duke u njohur fëmijëve, dhe çdo fëmije individual, një pasuri të jashtëzakonshme aftësish dhe potencialesh, fuqish dhe krijimtarish të lindura.
Duke filluar nga kjo pikë referimi, ne njohim të drejtën e fëmijëve për të përmbushur dhe zhvilluar potencialin e tyre, duke u përqendruar në aftësinë për t'u shoqëruar, për të marrë dashuri dhe besim, dhe për të përmbushur nevojat dhe dëshirat për të mësuar.

Kjo gjë vihet konkretisht në zbatim kur fëmijëve u sigurohet një aleancë efikase midis të rriturve në jetën e tyre, duke vlerësuar më lart kërkimin e një strategjie konstruktive mendimi.
Strategjia është e orientuar drejt zhvillimit të inteligjencës krijuese, mendimit kritik, individualitetit të ndjeshëm dhe të ndërgjegjshëm, nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm dallimi nga dhe integrimi me njerëz dhe përvoja të tjera.
Dialogu me familjet është një element i fuqishëm i projektit edukativ në kopsht dhe, më në përgjithësi, i kulturës së fëmijërisë.
Në arsimin parashkollor, marrëdhëniet midis fëmijëve, prindërve dhe mësuesve zhvillohen dhe fuqizohen në mënyrë të ndërsjelltë me dialog si dhe duke shkëmbyer ide dhe burime: arsimi parashkollor është një vend i evoluimit dhe komunikimit kolektiv midis individëve, grupeve dhe shoqërisë. ECCD është një komunitet njerëzish që jetojnë së bashku për një numër të madh orësh në javë (mesatarisht 30 orë në Shqipëri), duke ndarë një proces rritjeje personale dhe të përbashkët midis fëmijëve, prindërve dhe profesionistëve.
Arsimi parashkollor duhet të shihet si një sistem, një rrjet në të cilin komunikimi dhe shkëmbimi midis fëmijëve, mësuesve dhe prindërve janë të thellë dhe të afërt, duke krijuar bashkëndërtim dijesh dhe bashkedukim.
Parashkollori duhet të shihet si një hapësirë edukative që bazohet në një marrëdhënie bashkë përgjegjësie në mbështetje të rritjes së fëmijëve që bëhet e mundur duke njohur rolin aktiv dhe përgjegjësinë e çdo familje në edukimin e fëmijëve të tyre.
Parashkollori duhet të njohë prindin si “ekspert” të fëmijërisë. Veçanërisht gjatë periudhës fillestare, kur fëmijët fillojnë të ndjekin parashkollorin, konsiderata e prindërve si ekspertë do të thotë që t’u japësh atyre rolin e përgjegjësisë për shoqërimin dhe sigurimin e fëmijëve, por duke u mundësuar fëmijëve gjithashtu një vetëdecentralizim gradual, me përfitime të forta për zhvillimin e tyre emocional.
Duke përdorur një metaforë teatri, të flasësh rreth përfshirjes prindërore në këtë kontekst do të thotë t’u kërkosh prindërve të bëhen aktorë aktivë, jo vetëm “interpretues”, në procesin edukativ brenda institucionit (dhe jo nga jashtë). Shkëmbimi dhe bashkëndërtimi i të kuptuarit midis prindërve dhe mësuesve do të thotë t’u japësh vlerë pikëpamjeve të gjithsecilit, duke u përballur me rrezikun e lindjes së konflikteve që mund të krijohen nga perceptimi i ndryshimit. Të dëgjosh ide të ndryshme për të ndërtuar dhe ndarë një projekt të përbashkët nuk është e lehtë dhe kërkon që gjithsecili të bëjë përpjekje për të kuptuar dhe pranuar pikëpamjet e të tjerëve dhe për t’i konsideruar ato si një burim dhe jo si një kufizim. Pjesëmarrja në jetën shkollore shpreh konceptin e demokracisë si një mënyrë jetese, si një akt themelor për të ndërtuar të ardhmen.

Malaguzzi thoshte: “Arsimi, kërkon shumë solidaritet, krahasime të shumta, ka disa vende dhe zgjedhje të shoqërizuara, shumë grupe interesi dhe që veçanërisht kanë shumë aftësi”.

Pjesëmarrja ka rrënjë të thella historike dhe kulturore, por është gjithashtu e vërtetë që sistemi familiar është ende në transformim të vazhdueshëm dhe gradual. Bashkëpunimi me familjet nuk është i ngrirë në kohë, është duke evoluar vazhdimisht sipas ndryshimeve të shoqërisë.

Bërja e propozimeve të mira për mundësitë për ndërveprim dhe shkëmbim është hapi i parë në parashkollor, dhe zhvillohet ditë pas dite. Ndërgjegjësimi i prindërve, gjithashtu rritet dhe evoluon me fëmijën në arsimi parashkollor.

Edukimi është një veprim që duhet të kryhet nga i gjithë komuniteti.
Prindërit duhet të kenë një rol kryesor në këtë proces, sepse ata janë psikologjikisht thelbësorë për fëmijët, por edhe sepse ata shpenzojnë shumë kohë me fëmijët.
Kështu që ne duhet të krijojmë një aleancë me ta për të krijuar të ashtuquajturin komunitet edukativ.
Ne mund të ndajmë me ta mundësi të ndryshme. Ndër këto mund të jetë një takim hapës, i cili e përshkruan parashkollorin për familjet dhe jep informacion për organizatën, filozofinë e edukimit, dhe mjediset e ofruara. Në përgjithësi është e rëndësishme të ketë edhe një zyrtar të bashkisë për të përforcuar marrëdhënien me Institucionet.
Takimi hapës mbahet zakonisht midis javës së fundit të gushtit dhe mesit të shtatorit. Gjatë vitit ka të paktën tre takime të përgjithshme me të gjithë prindërit e çdo klase, me pjesëmarrjen e mësuesve dhe një përfaqësues nga stafi mbështetës (pastrues, kuzhinier dhe kështu me radhë). Në këto takime ne ndajmë me njëri-tjetrin hartimin e projekteve/programeve/arritjes në mësime, dhe situatën e përgjithshme në klasë.
Ne mund të organizojmë gjithashtu një ose më shumë takime pune me prindërit, gjatë të cilave mund të punojmë së bashku për të ndërtuar sende për institucionet arsimore parashkollore (si mobilie, lodra dhe nevoja të tjera).
Është e nevojshme që të organizohen mbrëmje tematike me prindërit, gjatë të cilave të diskutojmë me prindërit rreth temave të ndryshme që lidhen me fëmijërinë e hershme, si veprimtaria prindërore ose jeta e përditshme në kopsht. Dhe më pas janë festat, të cilat kanë një vlerë të madhe për takimet dhe miqësinë e përbashkët. Prindërit duhet të punojnë së bashku me mësuesit për të organizuar këtë festë. Bordi i prindërve i institucionit arsimor parashkollor është gjithashtu shumë i rëndësishëm për t'u dhënë mundësinë e pjesëmarrjes prindërve në administrimin e ECCD-së. Bordi mund të aktivizojë të ashtuquajturit grupet e projektit, grupe tematike që mund të aktivizohen për një qëllim të caktuar me pjesëmarrjen e prindërve të interesuar. Grupet e projekteve janë një strategji shumë efikase për të arritur disa rezultate në çështje të caktuara sepse zakonisht ato ndiqen nga një grup i vogël njerëzish, që shpesh është shumë i motivuar. Është e rëndësishme që, ndërsa planifikohet pjesëmarrja, të këtë një vëmendje të madhe për t'u mundësuar të gjitha grupeve të interesit të ndajnë kontributin e tyre, duke i dhënë kuptim interesave të tyre.

Sesioni 4.2: Roli i Bordit të kopshtit dhe komunitetit si pjesë aktive e në rritjen e pjesëmarrjes dhe cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë, funksionin dhe mënyrat e organizimit të Bordit të institucionit arsimor si një strukturë vendimmarrëse dhe bashkëpunuese që kontribuon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor.
Sesioni synon të pajisë pjesëmarrësit me njohuri ligjore, organizative dhe praktike mbi krijimin, përbërjen dhe rolin e Bordit të shkollës/kopshtit, në përputhje me Ligjin për Arsimin Parauniversitar dhe udhëzimet përkatëse të MAS-it.
Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë hapat dhe procedurat për ngritjen e Bordit të shkollës/kopshtit;
- Përshkruajnë strukturën, përbërjen dhe parimet e përfaqësimit në Bord;
- Kuptojnë rolin, funksionet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit, përfshirë raportin me drejtorin e institucionit;
- Analizojnë mënyrat se si Bordi kontribuon në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve arsimore dhe në forcimin e lidhjeve me komunitetin;
- Reflektojnë mbi sfidat dhe mundësitë për rritjen e efikasitetit dhe gjithëpërfshirjes në funksionimin e Bordit.

Tematika:

1. Hapat për krijimin e Bordit të institucionit arsimor.
2. Përbërja e Bordit dhe parimet e përfaqësimit.
3. Roli dhe funksionet e Bordit sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe udhëzimeve të MAS-it.
4. Roli i prindërve, mësuesve, përfaqësuesve të komunitetit dhe pushtetit vendor në Bordin e kopshtit.
5. Detyrimet e drejtorit të shkollës në raport me Bordin.
6. Sfida dhe mundësi në funksionimin e Bordit.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim/Punë në grup (Shtojca nr.2)**

Ky ushtrim është përzgjedhur për të theksuar rëndësinë e pjesëmarrjes aktive të prindërve dhe komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucioneve arsimore, si një element kyç për transparencë dhe cilësi në shërbimin e arsimit parashkollor. Ai synon të sqarojë të drejtën ligjore të prindërve për të formuar bordet e tyre, hapat për krijimin e Bordit të shkollës, rolin, objektin e punës dhe veprimtaritë që sigurojnë bashkëpunim efektiv. Në këtë proces përfshihen pjesëmarrësit e modulit,

trajnerët dhe ekipi i projektit, me qëllim që rezultatet e punës në grup të përdoren për forcimin e partneritetit shkollë-familje-komunitet dhe përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Bordi i institucionit arsimor është një mekanizëm demokratik dhe kolegjial që garanton funksionimin cilësor të shkollës/kopshtit, duke rritur transparencën, përmirësuar shërbimet dhe forcuar lidhjen mes shkollës dhe komunitetit.
- Prindërit dhe komuniteti nuk janë thjesht mbështetës, por partnerë aktivë në vendimmarrje, ndërsa drejtori ka rol lehtësues dhe garantues, jo dominues, duke siguruar që procesi të jetë gjithëpërfshirës dhe i ekuilibruar.

Kohëzgjatja e sesionit:
Sesioni do të zgjasë **120 minuta.**

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit 4.2 “Roli i Bordit të kopshtit dhe komunitetit si pjesë aktive e në rritjen e pjesmarrjes dhe cilësisë së shërbimeve në arsimin parashkollor”**.**
- Fletë për punën në gupe sipas tematikave

1. Grupi i – Identifikon detyrat kryesore të Bordit sipas ligjit dhe udhëzimeve.
2. Grupi II – Diskuton për sfidat që mund të hasen në funksionimin e Bordit në praktikë.
3. Grupi III – Propozon mënyra konkrete për rritjen e bashkëpunimit të Bordit me prindërit dhe komunitetin.

- Përmbledhje Udhezimi për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”

Listë leximesh për pjesëmarrësit:
Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018 “Për ngritjen dhe funksionimin e bordit të institucionit arsimor”
- Partneriteti Shkollë-Familje-Komunitet-OFSA
- Inspektimi dhe Vlerësimi i Brendshëm i Kopshtit-MAS
- Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Kopshtit

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahen: Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
Bordi i institucionit arsimor është një strukturë vendimmarrëse e krijuar për të garantuar funksionimin demokratik dhe gjithëpërfshirës të shkollës apo kopshtit, sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. Procesi i ngritjes së Bordit përfshin hapat e përcaktuara nga njësia arsimore vendore, duke siguruar

përfaqësim të balancuar nga mësuesit, prindërit, nxënësit, komuniteti dhe pushteti vendor. Përbërja e Bordit bazohet në parimet e transparencës, barazisë gjinore dhe përfaqësimit të grupeve të veçanta, ndërsa drejtori i institucionit nuk është anëtar, por ka detyrimin të raportojë rregullisht mbi planin vjetor, buxhetin, rregulloren e brendshme dhe arritjet e shkollës.
Funksionet e Bordit përfshijnë miratimin e planeve zhvillimore, buxhetit, rregullores së brendshme, si dhe mbikëqyrjen e zbatimit të politikave arsimore dhe cilësisë së shërbimit. Prindërit, mësuesit dhe përfaqësuesit e komunitetit luajnë rol aktiv në vendimmarrje, duke sjellë perspektiva të ndryshme për përmirësimin e kushteve të të nxënit. Sfida kryesore mbetet sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë dhe shmangia e konfliktit të interesit, ndërsa mundësitë lidhen me forcimin e partneritetit shkollë-familje-komunitet dhe rritjen e transparencës. Një Bord funksional është një mekanizëm i fuqishëm për të ndërtuar një institucion arsimor demokratik, gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt cilësisë.

Hapat për krijimin e Bordit të institucionit arsimor. Krijimi i Bordit të institucionit arsimor është një proces i strukturuar që fillon me miratimin e rregullores për funksionimin e tij, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit dhe Ligjit për Arsimin Parauniversitar. Hapat përfshijnë: njoftimin e komunitetit shkollor për procesin, organizimin e zgjedhjeve për përfaqësuesit e prindërve dhe mësuesve, përzgjedhjen e anëtarëve nga pushteti vendor dhe komuniteti, si dhe konstituimin e Bordit me mbledhjen e parë ku përcaktohen rolet dhe përgjegjësitë. Ky proces duhet të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës, duke respektuar parimet e barazisë dhe përfaqësimit.

Përbërja e Bordit dhe parimet e përfaqësimit. Bordi përbëhet nga përfaqësues të prindërve, mësuesve, komunitetit dhe pushtetit vendor, sipas përqindjeve të përcaktuara nga ligji. Parimet e përfaqësimit bazohen në transparencë, barazi gjinore dhe përfshirjen e grupeve të interesit. Përbërja e ekuilibruar siguron që vendimmarrja të reflektojë nevojat e të gjithë aktorëve dhe të shmangë dominimin e një grupi të vetëm.

Roli dhe funksionet e Bordit sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar dhe udhëzimeve të MAS. Bordi ka funksione strategjike dhe mbikëqyrëse: miraton planin vjetor dhe afatmesëm, rregulloren e brendshme, buxhetin e institucionit, si dhe monitoron zbatimin e politikave arsimore. Ai luan rol në përmirësimin e cilësisë së shërbimit, transparencës financiare dhe përfshirjes së komunitetit në jetën e shkollës/kopshtit. Vendimet e Bordit janë të detyrueshme për institucionin dhe duhet të bazohen në ligj dhe udhëzimet e MAS-it.

Roli i prindërve, mësuesve, përfaqësuesve të komunitetit dhe pushtetit vendor në Bordin e shkollës/kopshtit. Prindërit sjellin perspektivën e familjes dhe nevojat e fëmijëve, mësuesit kontribuojnë me ekspertizën pedagogjike, ndërsa përfaqësuesit e komunitetit dhe pushtetit vendor ofrojnë mbështetje për burime dhe politika sociale. Ky bashkëpunim e kthen Bordin në një mekanizëm të fuqishëm për ndërtimin e një mjedisi gjithëpërfshirës dhe demokratik.

Detyrimet e drejtorit të shkollës në raport me Bordin. Drejtori nuk është anëtar i Bordit, por ka detyrimin të raportojë rregullisht mbi planin vjetor, buxhetin, arritjet dhe sfidat e institucionit. Ai siguron zbatimin e vendimeve të Bordit dhe koordinon komunikimin mes stafit dhe strukturave vendimmarrëse.

Sfida dhe mundësi në funksionimin e Bordit. Sfida kryesore lidhet me sigurimin e pjesëmarrjes aktive dhe shmangien e konfliktit të interesit. Gjithashtu, mungesa e njohurive për rolin e Bordit mund të pengojë efektivitetin e tij. Megjithatë, mundësitë janë të mëdha: rritja e transparencës, forcimi i partneritetit shkollë-familje-komunitet dhe përmirësimi i cilësisë së edukimit përmes vendimmarrjes së përbashkët.

Në kontekstin shqiptar, roli i Bordit të kopshtit dhe komunitetit si pjesë aktive në rritjen e pjesëmarrjes së prindërve dhe cilësisë së shërbimeve arsimore parashkollore është i përkufizuar dhe i detyrueshëm nga kuadri ligjor dhe nënligjor: Ligji nr. 69/2012 për sistemin arsimor parauniversitar përcakton parimin e gjithëpërfshirjes, transparencës dhe të drejtën e prindërve për të shprehur pikëpamjet e tyre mbi cilësinë e shërbimit, duke e konsideruar interesin e fëmijës si parësor dhe rolin e prindit si pjesë e qeverisjes së institucionit (nenet 5–6; përkufizimet mbi parashkollorin dhe këshillin e prindërve). Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018 e konkretizon këtë rol, duke kërkuar që bordi të përbëhet nga prindër, mësues, përfaqësues të komunitetit dhe të vetëqeverisjes vendore (bashkia), si dhe të funksionojë në bashkëpunim me njësinë arsimore vendore (ZVAP) për të garantuar që shërbimi arsimor zhvillohet sipas politikave kombëtare dhe interesave të komunitetit, me procesverbale dhe vendimmarrje të dokumentuara. Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, i ndryshuar me Urdhrin nr. 300, datë 19.06.2024) e vendos parashkollorin brenda një sistemi të qartë përgjegjësish ku drejtori, ZVAP/DRAP (tani AKAP dhe ZVAP pas ndryshimeve të vitit 2024), shërbimi psiko-social dhe bordi veprojnë në marrëdhënie të strukturuara për planin e institucionit, vlerësimin e brendshëm, raportimin vjetor, dokumentacionin dhe pjesëmarrjen prindërore; kjo rregullore sanksionon edhe shërbimin psiko-social si mekanizëm për nxitjen e mirëqenies dhe përfshirjes, duke e lidhur bashkëpunimin me familjen me cilësinë e mësimdhënies dhe të nxënies në kopsht. Rregulloret model të bashkive (p.sh., Dropull) e zbërthejnë në nivel vendor: bordi ngrihet me pjesëmarrje të prindërve, përfaqësuesve të pushtetit vendor, përfaqësuesit të ZVAP-it dhe komunitetit, me parime të ligjshmërisë, barazisë dhe transparencës, duke e lidhur funksionimin e tij me Udhëzimin nr. 25/2018 dhe Urdhrin nr. 31/2020; ky dimension vendor është kritik për të siguruar që vendimmarrja, financat dhe logjistika e shërbimeve (qasje fizike, sinjalistikë, materiale) të pasqyrojnë realitetin e komunitetit specifik të kopshtit. Standardet profesionale të drejtuesve të institucioneve arsimore parashkollore (ASCAP, tetor 2021) e përforcojnë pritshmërinë që drejtori të udhëheqë partneritetin kopsht-familje-komunitet dhe të mobilizojë burime e bashkëpunime për cilësinë e shërbimit; po ashtu, standardet e mësuesit ndihmës (ASCAP, 2022) kërkojnë komunikim dhe bashkëpunim sistematik me prindërit në zbatimin e akomodimeve dhe planeve individuale, duke e lidhur praktikën didaktike me pjesëmarrjen e familjes në vendimmarrje për fëmijën. Në praktikë, këto dispozita dhe standarde e kthejnë bordin dhe komunitetin në “motorë” të pjesëmarrjes: me takime periodike (përfshirë takime

hapëse të fillim-vitit), mbrëmje tematike, festa bashkëkrijuese, grupe projektesh (p.sh., akses & materiale gjithëpërfshirëse), buletinë dhe publikim të procesverbaleve, të mbështetura nga ZVAP/AKAP-i dhe nga shërbimi psiko-social; përmes treguesve të matshëm si % e pjesëmarrjes, numri i nismave të realizuara, cilësia e *feedback-ut* prindëror dhe përmirësimet në cilësinë e shërbimit, institucionet raportojnë progresin sipas rregullores dhe standardeve, duke e lidhur kulturën e bashkëvendimmarrjes me rritjen e cilësisë dhe barazinë në qasje në arsimin parashkollor në Shqipëri.

Në Shqipëri, krijimi dhe funksionimi i Bordit të institucionit arsimor (përfshirë kopshtet) udhëhiqet nga kuadri ligjor dhe nënligjor: fillimisht, njësia arsimore vendore (ZVAP) ndërmerr hapat për ngritjen e bordit, duke thirrur këshillin e mësuesve për zgjedhjen e përfaqësuesit të mësuesve dhe duke organizuar përfshirjen e pjesëtarëve nga komuniteti; paralelisht, këshilli i prindërve zgjedh me votim të fshehtë përfaqësuesit e prindërve, ndërsa qeveria e nxënësve zgjedh përfaqësuesit e nxënësve, dhe bashkia dërgon përfaqësuesin e saj sipas listes zyrtare, pas së cilës ZVAP-i emëron me urdhër përbërjen e plotë të bordit dhe ky bord, në mbledhjen konstituive, zgjedh kryetarin dhe sekretarin dhe miraton rregulloren e vet (me mandat tipik trevjeçar) duke përcaktuar ritmin e mbledhjeve, rolet dhe mënyrën e dokumentimit të vendimeve; të gjitha këto procedura, përfshirë kërkesat për proces-verbale dhe bashkëpunim sistematik me partnerë brenda/jashtë institucionit, burojnë nga Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, i cili e përkufizon qartësisht misionin e bordit si garant të mbarëvajtjes së institucionit dhe përputhjes së shërbimit arsimor me politikat kombëtare e vendore dhe interesat e komunitetit, si dhe nga Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (Urdhri nr. 31, datë 28.01.2020, i përditësuar me Urdhrin nr. 300, datë 19.06.2024), që vendos parimet e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes prindërore në qeverisjen e institucionit; në nivel vendor, projektrregulloret e bashkive e zbërthejnë më tej përgjegjësinë për ngritjen e bordit nga përfaqësuesi i njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe parimet e veprimtarisë (ligjshmëria, barazia, pavarësia, paanësia, profesionalizmi, konfidencialiteti, shmangia e konfliktit të interesit) [Udhëzimi 25/2018; Urdhri 31/2020 & ndryshimet 2024; rregullore bashkish]. Përbërja standarde është zakonisht 7 anëtarë: 2 prindër (të zgjedhur nga këshilli i prindërve), 1 mësues (i zgjedhur nga këshilli i mësuesve), 2 nxënës (të zgjedhur nga qeveria e nxënësve; ose 1 nxënës + 1 përfaqësues komuniteti kur nuk ka nxënës), 1 përfaqësues i bashkisë dhe 1 përfaqësues i komunitetit (biznes/OJF/figurë vendore), me drejtorin e institucionit që nuk bën pjesë në bord për të ruajtur pavarësinë kolegjiale; përbërja respekton parimet e barazisë gjinore, përfaqësimit të pakicave dhe grupeve të veçanta, si dhe mund të përshtatet në bashki pilot ku parashikohet pjesëmarrje më e gjerë e vetëqeverisjes vendore, gjithnjë në përputhje me shtesat të miratuara nga MAS [Udhëzimi 25/2018; shtesat 2025]. Në këtë mënyrë, bordi përfaqëson kanalin kryesor të bashkëvendimmarrjes mes prindërve, komunitetit dhe institucionit, duke rritur pjesëmarrjen dhe cilësinë e shërbimit në arsimin parashkollor përmes një arkitekture të qartë roli, përfaqësimi dhe llogaridhënieje të sanksionuar ligjërisht.

Bordi i kopshtit dhe funksioni i tij janë përcaktuar qartë në kuadrin ligjor dhe nënligjor shqiptar për arsimin parashkollor. Udhëzimi nr. 25, datë 25.07.2018, përcakton se procesi fillon me trajtimin nga ZVAP-i (Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar), i cili thërret këshillin e mësuesve për të zgjedhur përfaqësuesin e mësuesve dhe ndërthur përzgjedhjen e prindërve, nxënësve, përfaqësuesit të bashkisë, dhe përfaqësuesit të

komunitetit (biznes, OJF, figura vendore) me votim të fshehtë. Do të përbëhet zakonisht nga 7 anëtarë – përfshirë 2 prindër, 1 mësues, 2 nxënës (ose 1 nxënës + 1 përfaqësues komuniteti kur nuk ka nxënës), 1 përfaqësues i bashkisë dhe 1 përfaqësues i komunitetit; drejtori nuk është anëtar për të ruajtur pavarësinë kolegjiale. Bordet duhet të zbatojnë parimet e barazisë gjinore, përfaqësimit të pakicave dhe grupeve të veçanta, ligjshmëri, paanësi, pavarësi, profesionalizëm, konfidencialitet dhe shmangie të konfliktit të interesit.
Ligji nr. 69/2012 përcakton rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve, mësuesve dhe vetë nxënësve në vendimmarrje si pjesë e demokracisë dhe transparencës në arsim. Bordi është përgjegjës për miratimin e politikave dhe planeve vjetore, mbikëqyrjen administrative dhe financiare, garantimin e përmbushjes së misionit institucional në përputhje me standartet kombëtare dhe interesat e komunitetit. Urdhri nr. 31/2020 kërkon që institucionet parauniversitare të krijojnë mekanizma mbikëqyrës dhe llogaridhënieje ku bordi është instrumenti kryesor për transparencën dhe pjesëmarrjen.

Në praktikë, bordi zbaton:

- **Mbledhje konstituive**, zgjedhje kryetari/sekretarit dhe miraton rregulloret e zotërimit intern,
- **Mbledhje periodike** për diskutim dhe vendimmarrje mbi financat, buxhetin, mjedisin, cilësinë e shërbimit, marrëdhëniet me komunitetin dhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta,
- **Dokumenton vendimmarrjet në procesverbale** dhe publikon këto informacione për komunitetin si pjesë e angazhimit për llogaridhënie.

Ky model ofron një arkitekturë efektive qeverisëse, ku roli dhe funksionet e bordit kontribuojnë drejtpërdrejt në rikuperimin e pjesëmarrjes, forcimin e cilësisë së shërbimeve, promovimin e bashkëpunimit institucional dhe krijimin e një mjedisi gjithëpërfshirës, duke e pozicionuar bordin si aktor kryesor në përmirësimin e arsimit parashkollor në Shqipëri.

Më poshtë është një tabelë e roleve dhe funksioneve të Bordit të institucionit arsimor (kopsht), e harmonizuar me Ligjin nr. 69/2012 dhe Udhëzimin nr. 25, datë 25.07.2018, si dhe me Rregulloren e funksionimit të institucioneve parauniversitare (Urdhrin nr. 31, datë 28.01.2020, i ndryshuar me Urdhrin nr. 300, datë 19.06.2024)

Burime kryesore: Ligji nr. 69/2012 (parimet e pjesëmarrjes, transparencës, gjithëpërfshirjes); Udhëzimi nr. 25/2018 (ngritja, përbërja, mandati, veprimtaria e bordit); Rregullorja e IAP-it (Urdhri nr. 31/2020, ndryshuar 2024)—strukturat, dokumentacioni, llogaridhënia, roli me ZVAP/AKAP dhe Bashki.

Fusha	Roli / Çfarë bën Bordi	Baza ligjore / udhëzuese	Tregues praktikë
Qeverisje & politika	Miraton planin vjetor dhe rregulloren e brendshme; siguron përputhje me politikat kombëtare dhe interesat e komunitetit.	Ligji nr. 69/2012; Udhëzimi nr. 25/2018	Plan vjetor i miratuar; rregullore e bordit e miratuar.
Transparencë & llogaridhënie	Publikon procesverbale; informon prindërit dhe komunitetin për vendimet.	Udhëzimi nr. 25/2018; Urdhri nr. 31/2020	PV mujore të afishuara; raport vjetor i publikuar.
Pjesëmarrje prindërore	Organizon takime hapëse, mbrëmje tematike; garanton përfaqësim të prindërve.	Ligji nr. 69/2012; Udhëzimi nr. 25/2018	% pjesëmarrjes në takime; feedback i strukturuar.
Bashkëpunim me ZVAP & Bashki	Koordinon me ZVAP/AKAP dhe bashkinë për projekte dhe përfaqësim.	Udhëzimi nr. 25/2018; Rregullorja IAP	Projekte të përbashkëta; memorandume bashkëpunimi.
Financa & burime	Mbikqyr përdorimin e fondeve; mobilizon burime nga komuniteti.	Urdhri nr. 31/2020; Udhëzimi nr. 25/2018	Raporte financiare; lista donatorësh.
Mjedis & qasje	Siguron përmirësime të mjedisit fizik dhe materialeve UDL.	Ligji nr. 69/2012; Rregullorja IAP	Auditim mjedisi; masa aksesueshmërie të zbatuara.
Cilësia & vlerësimi	Kontribuon në vlerësimin e brendshëm dhe raportin vjetor.	Rregullorja IAP (Kreu XI)	Raport vjetor i miratuar; masa për përmirësim.
Gjithëpërfshirje & AK	Mbështet përfshirjen e fëmijëve me AK dhe zbatimin e PEI-ve.	Ligji nr. 69/2012; Rregullorja IAP	Politika për akses; raport mbi PEI.
Etikë & konflikt interesi	Zbaton parime etike; shmang konfliktin e interesit.	Ligji nr. 69/2012; Rregullore bashkie	Deklarata interesi; kod etik i miratuar.

Ky modul trajton konceptin e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në veprimtarinë e institucionit arsimor. Në këtë pjesë theksohet dhe diskutohet me pjesëmarrësit se pjesëmarrja e prindërve dhe komunitetit u referohet mekanizmave të ndryshme që

përdoren me qëllim që ata të shprehin opinionet e tyre dhe mundësisht të ndikojnë mbi vendimet e marra brenda institucionit. Materiali i shkruar e përkufizon pjesëmarrjen e prindërve si një proces përmes të cilit ata veprojnë në përgjigje të shqetësimeve të tyre, shprehin opinionet e tyre mbi vendimet që ndikojnë mbi ta dhe marrin përgjegjësi për të sjellë ndryshime në të mirë të komunitetit të shkollës.

Roli i prindërve, mësuesve, përfaqësuesve të komunitetit dhe pushtetit vendor në Bordin e kopshtit

Bordi i institucionit arsimor është një organ kolegjial që garanton pjesëmarrjen e aktorëve kryesorë në qeverisjen e kopshtit. Prindërit kanë rol vendimmarrës për politikat që ndikojnë në cilësinë e shërbimit dhe përfshirjen e fëmijëve, duke sjellë perspektivën familjare dhe duke kontribuar në transparencë. Mësuesit ofrojnë ekspertizë pedagogjike dhe sigurojnë që vendimet e bordit të jenë të harmonizuara me kurrikulën dhe praktikat edukative. Përfaqësuesit e komunitetit (biznese, OJF) sjellin burime dhe ide inovative për projekte që përmirësojnë mjedisin dhe aksesin. Pushteti vendor (bashkia) garanton lidhjen me politikat vendore, mbështetjen financiare dhe logjistike, si dhe zbatimin e standardeve kombëtare. Ky bashkëpunim ndër-sektorial është i sanksionuar nga Ligji nr. 69/2012 dhe Udhëzimi nr. 25/2018, duke e kthyer bordin në një mekanizëm për demokraci, gjithëpërfshirje dhe cilësi.

Detyrimet e drejtorit të kopshtit në raport me Bordin

Drejtori nuk është anëtar i bordit, por ka detyrime të qarta për të siguruar funksionimin e tij. Ai duhet të:

- **Organizojë mbledhjet** e bordit sipas kalendarit dhe të sigurojë dokumentacionin e nevojshëm.
- **Raportojë periodikisht** mbi zbatimin e planit vjetor, buxhetin, cilësinë e shërbimeve dhe masat për gjithëpërfshirje.
- **Sigurojë transparencë** duke vënë në dispozicion proces-verbale dhe raportet e bordit për komunitetin.
- **Koordinojë me ZVAP/AKAP-in dhe pushtetin vendor** për zbatimin e vendimeve të bordit. Këto detyrime burojnë nga Rregullorja e funksionimit të institucioneve parauniversitare (Urdhri nr. 31/2020) dhe standardet profesionale të drejtuesve (ASCAP, 2021).

Sfida dhe mundësi në funksionimin e Bordit

Sfida kryesore lidhet me:

- Pjesëmarrjen e ulët të prindërve për shkak të orareve të punës dhe mungesës së ndërgjegjësimit.
- Konfliktet e perspektivave midis prindërve dhe stafit pedagogjik.
- Mungesën e burimeve financiare dhe logjistike për zbatimin e vendimeve. Mundësitë për përmirësim përfshijnë:
- Përdorimin e komunikimit multikanal (newsletter, platforma online) për transparencë.
- Organizimin e mbrëmjeve tematike dhe grupeve të projekteve për të rritur angazhimin.
- Bashkëpunimin me pushtetin vendor dhe OJF-të për mobilizimin e burimeve.

- Trajnimin e anëtarëve të bordit për menaxhimin e konflikteve dhe vendimmarrje të bazuar në evidenca. Këto praktika janë të rekomanduara nga MAS-i dhe përputhen me filozofinë e bashkë-ndërtimit të dijes (Dewey, Vygotsky, Malaguzzi), duke e kthyer bordin në një instrument për cilësi dhe gjithëpërfshirje.

Rëndësia e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit arsimor. E drejta e prindërve për të formuar bordin e tyre.

Qëllimi: Të njihen pjesëmarrësit me rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në veprimtarinë e institucionit arsimor.

Kohëzgjatja: **45 minuta.**

Metodologjia: Leksion, diskutim dhe rrahje mendimesh, punë në grupe

Hapat:

1. U kërkohet pjesëmarrësve të kujtojnë një nga veprimtaritë e fundit të institucionit të tyre ku duhet të kenë qenë pjesë apo të kryejnë punën.
2. Prezantohen të drejtat dhe detyrimet e prindërve në lidhje me pjesëmarrjen në veprimtaritë e kopshtit, dispozitat normative dhe prindërit.
3. Pjesëmarrësit diskutojnë dhe në grup përcaktojnë detyrimet e tyre në lidhje me veprimtaritë e institucionit arsimor.

Përmbajtja:
Sot kërkohet që çdo shkollë në qytet apo në fshat të hartojë një politikë të caktuar për përfshirjen e prindërve në edukim. Hartimi i një politike dhe një plani për përfshirjen e prindërve në edukim si dhe zbatimi i tyre ka shumë rëndësi, sepse nga kjo gjë përfitojnë fëmijët, shkolla dhe prindërit. Sidoqoftë edhe në rastet kur në shkollë ekziston një politikë dhe plan zhvillimi për partneritetin shkollë-familje, ajo që ka rëndësi është se çfarë ndodh aktualisht në këtë shkollë.

Për të hartuar një plan për zhvillimin e partneritetit kopsht-familje:

- Komunikoni me gojë ose me shkrim me çdo prind për të parë se çfarë mendojnë ata për shkollën dhe se çfarë do të pëlqenin të përmbanin programet e përfshirjes së tyre në edukim.
- Mësoni sesi e kuptojnë anëtarët e bordit dhe vetë stafi përfshirjen e prindërve në edukim.
- Vlerësoni programet aktuale që ka kopshti për përfshirjen e prindërve në shkollë dhe mënyrën sesi funksionojnë ato, duke i vendosur veprimtaritë në një plan për zhvillimin e partneritetit kopsht - familje.

Grumbulloni informacion për t'u përgjigjur pyetjeve të mëposhtme:

- A ka organizuar kopshti juaj një politikë apo strategji për përfshirjen e prindërve në edukim?

- A ka programi juaj një shpërndarje të barabartë të mundësive për të përfshirë të gjitha kategoritë e prindërve në edukim? Në qoftë se jo cila nga kategoritë e prindërve kërkon më shumë mbështetje?
- A janë përfshirë në programin tuaj prindër që përfaqësojnë çdo grup të madh familjar të komunitetit të shkollës ?
- A janë përfshirë në programin tuaj prindër që kanë fëmijë në klasa të ndryshme apo prindër vetëm nga një klasë?

Për të ndihmuar në formimin e partneritetit kopësht-familje:

1. Punoni për hartimin e një politike për përfshirjen e prindërve në edukim/arsim. Ndihmoni që politika e përfshirjes së prindërve në edukim të zbatohet në shkollën tuaj.
2. Bëni një fushatë për përfshirjen e prindërve në edukim. Përfshini në këtë fushatë prindër dhe fëmijë.
3. Pyesni prindërit se çfarë programesh ose seminaresh kanë interes të ndjekin. Kini parasysh që problemi qendror është të ndihmohet prindi për t'u bërë më efektivë në punën me fëmijët. Programet mund të përfshijnë veprimtari që ndihmojnë prindërit për të rritur aftësitë e tyre në rolin e prindit apo për të siguruar informacione rreth çështjeve, të cilat kanë lidhje me komunitetin e prindërve.
4. Siguroni libra me temë për punën me prindërit dhe vendosi këto libra në bibliotekë ose në klasat e shkollës. Ftoni prindërit që të marrin lirisht libra ose të kërkojnë materiale të tjera.
5. Në qoftë se ka mjedise fizike në shkollë, hapni një dhomë për prindërit dhe vendosni literaturën për ta, siç u tha më sipër. Ftoni njerëz nga shkolla apo komuniteti për t'u lidhur me veprimtaritë e edukimit të prindërve Përdoreni dhomën si një vend që u shërben nevojave të prindërve.
6. Mendoni mënyra për të tërhequr të gjithë prindërit në shkollë. Përdorni prezantimet verbale dhe vizuale për të qartësuar informacionin teorik.

Kur prindërit përfshihen në edukimin e fëmijëve, atëherë fëmijët kanë rezultate më të mira në mësime. Nuk ka nevojë që prindërit të kenë një arsim të lartë. Ajo që nevojitet është që ata të krijojnë një atmosferë familjare, që u thotë fëmijëve të tyre se arsimi është i rëndësishëm dhe se ata kërkojnë që fëmijët të mësojnë mirë, për këtë ata do t'í ndihmojnë në shkollë dhe në shtëpi.
Çfarë mund të bëni ju si mësues që shkolla dhe prindërit të komunikojnë vazhdimisht me njëri tjetrin?
Kërkoni nga prindërit që:

- Kur ka ndonjë kërkesë nga shkolla ta plotësojnë atë dhe ta dërgojnë përsëri në shkollë. Stafi i shkollës ka nevojë të dëgjojë mendimet e prindërve.
- Të informojnë shkollën për gjërat, që u ndodhin në shtëpi dhe që mund ta bëjnë fëmijën të jetë i mërzitur apo i zemëruar në shkollë.
- Jepini prindit informacion rreth veprimtarive që bëhen në shkollë. Tregoni se kur bëhen ato dhe për çfarë bëhen.

Çfarë mund të bëjë prindi për fëmijën dhe për shkollën?

- Krijoni kushte për një zhvillim të mirë fizik dhe emocional të fëmijës suaj.
- Krijoni një mjedis të tillë në shtëpi që të tregoni se arsimi vlerësohet dhe inkurajoni procesin e të mësuarit.
- Krijoni në shtëpi një atmosferë që inkurajon respektin e dyanshëm dhe komunikimin.
- Merrni pjesë si vullnetarë në shkollë ose në klasën e fëmijës tuaj në veprimtari të ndryshme.
- Ndiqni të gjitha veprimtaritë e shkollës.

Çfarë mund të bëni ju si mësues?
Ndihmoni prindërit:

- Të njohin programin e shkollës: çfarë mëson fëmija në shkollë, pse dhe si si funksionon sitemi shkollor, si mund ta ndihmojë fëmijën të mësojë dhe të njohë të drejtat, si dhe përgjegjësitë prindërore.
- Të mësojnë sesi ndodh zhvillimi fizik, mendor dhe social i fëmijës nga foshnjëria gjer në moshën e rritur.
- Të kenë të qartë se çfarë presin nga fëmijët e tyre dhe si do të njoftohen për përparimin e tyre.
- U kujtoni prindërve se ata janë mësuesit e parë dhe më të rëndësishëm që i pajisin fëmijët me shprehitë që u duhen atyre në jetën e përditshme si: përgjegjësia, vendosmëria, shprehitë për t'u shoqëruar me të tjerët etj.
- Kërkoni nga prindërit që t'ju japin informacion për fëmijët e tyre si dhe për përvoja të tjera që mund t'ju interesojnë.
- U kërkoni prindërve që t'ju bëjnë të qarta nevojat që ata kanë.
- Inkurajojini prindërit që të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve dhe në zgjidhjen e problemeve që ka shkolla. Në qoftë se zëri i prindërve nuk dëgjohet shumë në shkollë dhe prindërit e interesuar nuk kanë mundësinë të marrin pjesë në mënyrë efektive në punët e saj bisedoni me drejtorin për të iniciuar veprimtari, që çojnë në një përfshirje më të madhe të prindërve në punët e shkollës.

Seanca II
Hapat për krijimin e Bordit të shkollës. Roli i tij, objekti i punës dhe veprimtaritë

Qëllimi: Të njihen pjesëmarrësit me veçoritë kryesore të ngritjes dhe funksionimit të një Bordi shkolle efektiv dhe që bashkëpunon e luan rol në veprimtarinë e institucionit arsimor

Kohëzgjatja: 60 minuta

Metodologjia: Leksion, diskutim dhe rrahje mendimesh, punë në grupe

Hapat:
1. Zhvillohet një brainstorming (rrahje mendimesh) me pjesëmarrësit mbi faktin se cili është roli i bordit të shkollës në institucionin arsimor. Mendimet e pjesëmarrësve shënohen në tabakë muri dhe qëndrojnë ne mjedisin e trajnimit.

2. Prezantohen ngritja dhe funksionimi i Bordit të shkollës duke iu referuar ligjit për arsimin parauniversitar si dhe dispozitave normative.
3. Pjesëmarrësit diskutojnë dhe në grup përcaktojnë detyrimet e anëtarëve të bordit në lidhje me veprimtaritë e shkollës si qendër komunitare.

Përmbajtja:

Ndryshimi i sistemit solli, rrjedhimisht, dhe ndryshimin e botëkuptimit të prindërve e komunitetit mbi arsimimin e edukimin. Kjo bëri që të ndryshojnë raportet e marrëdhënieve midis prindërve, por dhe midis tyre, shkollës e qeverisë. Në këto raporte morale, shoqërore, politike dhe ligjore, duhen parë dhe përgjegjësitë e arsimit. Përgjegjësi që e kanë burimin në përcaktimin se kush vendos për qëllimet e edukimit dhe drejtimet e tij, për programet e tekstet mësimore, kush vendos për metodat e zbatimit të tyre apo ku dhe si, në ç'kushte do të realizohen. Në marrëdhënien e krijuar duhen përcaktuar dhe rolet; cili është roli i qeverisë, i prindërve dhe komunitetit, i mësuesve dhe shkollës. Pasi dihet se, sfida që has çdo shoqëri është të përcaktojë ekuilibrin e saktë të autoritetit dhe kontrollit të secilit
Shkolla, më shumë se çdo institucion tjetër e ka të domosdoshëm reformimin dhe ndryshimin. Që ndryshimi të ketë vlerë ose kahe pozitive duhen angazhuar të gjithë "aktorët " e jetës shkollore. Vitet e fundit të gjitha urdhrat, udhëzimet apo përparësitë në sistemin arsimor kanë patur në fokus të tyre krijimin e një shkolle me frymë realisht demokratike dhe bashkëkohore. Disa prej tyre i kanë dhënë hapësira dhe kompetenca organeve kolegjiale në shkollë. Kështu është bërë më aktiv senati i shkollës, funksionimi i të cilit i bën nxënësit më të përgjegjshëm në liritë dhe të drejtat e tyre . Me të njëjtën cilësi mund të flasim edhe për Bordin e shkollës, Këshillin e prindërve të klasave, Këshillin e prindërve të shkollës etj.
I vetmi organ kolegjial që ka në përbërjen e tij të gjithë "grupet e interesit" në shkollë është bordi i saj. Pas viteve ´90 u formatuan dhe u ngritën bordet nëpër të gjitha shkollat sipas rregullave që përcaktonin Dispozitat Normative. Me gjithë arritjet pozitive, sërish bordet ishin larg asaj që duhej të arrinin në dobi të shkollës. Suksesi i një bordi filloi të matej me kontributet monetare që siguroheshin për shkollën. "Të preferuarit" në përbërje të bordit ishin kryesisht afaristët. Sponsorizimet dhe donacionet e tyre ishin vërtet të nevojshme për shkollën, por u anashkaluan dhe u harruan funksionet e tjera të bordit si: bashkëpunimi me pushtetin vendor dhe komunitetin, mbështetja në realizimin e objektivave themelore të veprimtarisë së shkollës dhe problemeve që shqetësojnë shkollën etj. Kësisoj ndjehej e nevojshme një formatim dhe konceptim më bashkëkohor i bordit të shkollës. Pas diskutimesh me mësues, prindër, drejtues shkolle dhe specialistë në arsim si dhe studimi i përvojave botërore me datë 17.10.2007 doli udhëzimi nr. 40 i MASH-it "Për ngritjen e funksionimin e bordit të shkollës".

Në Ligjin Nr. 69/2012 datë 26.06.2012, në nenin 34,lidhur me Bordin e institucionit arsimor është shkruar:

1. Çdo institucion arsimor ka bordin e tij të përbërë nga prindër, nxënës, mësues, përfaqësues të qeverisë vendore dhe të komunitetit. Bordi kontribuon për

mbarëvajtjen e institucionit arsimor dhe i raporton për veprimtarinë e tij këshillit të prindërve të institucionit.

2. Detyrat kryesore të bordit janë:
    a. miraton planin afatmesëm dhe atë vjetor të institucionit;
    b. miraton planin e shpenzimeve të institucionit arsimor për fondet, të cilat sigurohen nga institucioni;
    c. miraton kurrikulën e hartuar nga institucioni arsimor;
3. ç) merr pjesë në procedurat e emërimit e të largimit të drejtorit të institucionit arsimor dhe të mësuesit.
4. Përbërja e bordit, të drejtat, detyrat e tjera dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve përcaktohen në udhëzimin e ministrit.

Përbërja e bordit

Bordi i shkollës është ngritur për të ndikuar që shkolla ta bëjë më mirë punën e saj.

- Prindërit janë në bord që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshirojnë prindërit për fëmijët e tyre.
- Nxënësit janë në bord që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshirojnë nxënësit.
- Përfaqësuesi i DAR-it është aty që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshiron Ministria.
- Përfaqësuesi i qeverisë vendore është aty që shkolla ta bëjë punën aq mirë sa ç'dëshiron bashkia.

Sipas Udhëzimit Nr.27, datë 02.08.2013 përbërja e bordit është:

Bordi	Mësues		Nxënës		Prind	Komunite Vendor
>24 klasa	5	1	1	1	1	1
<24 klasa	7	1	2	2	1	1

Ndodh rëndom që risitë (edhe kur këto janë të domosdoshme) priten me dyshim e më së pakti me frikë. Ky ishte reagimi i "bazës" pas daljes së udhëzimit. Ajo që u duk pak më e vështirë për tu përtypur ishte mungesa e drejtorit të shkollës në bord. Për shumëkënd drejtori është kryefjala në çdo veprimtari të shkollës, është motori që vë në lëvizje të gjithë mekanizmat e tjerë. Kjo ishte kthyer në metodë pune ose mendësi edhe tek disa drejtorë. Jo për të patur gjithçka nën kontroll, por më shumë nga shqetësimi që vetëm duke qenë vetë në krye mund të mirëfunksiononte bordi. E njëjta gjë ka ndodhur edhe kur në shkollë u "instalua" senati i shkollës. Me logjikë të ftohtë kupton që mospërfshirja e drejtorit sipas udhëzimit në përbërjen e bordit bën të mundur një vendimmarrje më të paanshme, shmang gabimet e mundshme njerëzore (duke e copëzuar pushtetin) dhe i bën më të besueshme vendimet dhe të gjithë veprimtaritë e bordit. Megjithatë titullari i shkollës nuk është krejtësisht i zhveshur nga detyrimet kundrejt bordit. Roli i tij është shumë i rëndësishëm, gati vendimtar, në krijimin e terrenit të përshtatshëm për krijimin e bordit. Është detyrë, dhe në interes të tij të kujdeset për zgjedhjen e mësuesit nga Këshilli pedagogjik, të informojë Senatin dhe çdo nxënës e prind të shkollës për funksionet e bordit të shkollës.

Disa nga detyrimet e drejtorit të shkollës ndaj bordit janë:

- T'i paraqesë bordit për miratim:

- planin vjetor të shkollës,
- planin financiar,
- rregulloren e shkollës.

 T'i raportojë bordit për aspekte të veprimtarisë së shkollës kur këtë e kërkon bordi;

 T'i dorëzojë bordit nga një kopje të:
- planit vjetor,
- planit të shpenzimeve vjetore,
- rregullores së shkollës,
- udhëzimeve të Ministrit ose të DAR-it ose të qeverisë vendore,
- raporteve të inspektimit,
- dokumenteve të tjera, që bordi mund të kërkojë, si p.sh. raportin e analizës vjetore të shkollës.

 Të marrë pjesë në mbledhjet e bordit sa herë bordi ta kërkojë këtë;
 Të sigurojë mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e mbledhjeve të bordit;
 Të sigurojë ruajtjen e arkivës së bordit;
 Të ftojë kryetarin e bordit dhe anëtarët e tij në ceremoni ose veprimtari të të gjithë shkollës.
 Të ftojë kryetarin e bordit në analizën semestrale dhe vjetore të shkollës etj

Seanca III
Rëndësia e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në vendimmarrjen dhe menaxhimin e institucionit arsimor.

Qëllimi: Të njihen pjesëmarrësit me rolin e pjesëmarrjes së prindërve dhe komunitetit në shndërrimin e shkollës si qendër komunitare

Kohëzgjatja: 60 minuta

Metodologjia: Leksion, diskutim dhe rrahje mendimesh, punë në grupe

Hapat:
1. Prezantohet koncepti i shkollës si qendër komunitare.. Standardet e saj si dhe llojet e veprimtarive në këtë kuadër
2. Pjesëmarrësit sjellin shembuj dhe diskutojnë për lloje veprimtarish të zhvilluara në shkollë kua ata kanë qenë pjesëmarrës apo kanë patur rol aktiv.
3. Hartimi i planit të veprimtarive të shkollës në kuadrin e shkollës qendër komunitare. Roli i prindërve dhe llojet e veprimtarive që zhvillohen më prindërit dhe përfaqësuesit e komunitetit.

Përmbajtja:

Kërkimet dhe përvojat e praktikat e suksesshme kanë provuar se përfshirja e prindërve është çelësi për të ndihmuar fëmijët të jenë të suksesshëm në shkollë. Ata bëhen më të mirë atëherë kur prindërit e tyre kujdesen rreth asaj që ata janë duke bërë në shtëpi, në komunitet dhe në shkollë.

Përfshirja e prindërve në të gjitha aspektet e jetës së fëmijës është shumë e rëndësishme. Fëmijët mund të arrijnë të shfaqin plotësisht potencialin e tyre në shkollë ose në jetë vetëm kur plotësohen nevojat e tyre fizike dhe emocionale. Ata kanë nevojë

që të mësojnë të ndihen mirë me veten e tyre, të mësojnë sesi të marrin vendime dhe të jenë përgjegjës për rezultatet e këtyre vendimeve.
Çfarë është përfshirja e prindërve në shkollë

Në kuptimin e gjerë të fjalës, përfshirja e prindërve në edukim ka për qëllim të ndihmojë prindërit që të kuptojnë më mirë se çfarë është :

- Prindërimi (të qenit prind)- shprehitë që përdorin prindërit për të rritur dhe edukuar fëmijët e tyre.
- Edukimi i prindërve - informacioni rreth çështjeve që mund të ndikojnë në jetën e fëmijëve të tyre.
- Përfshirja e prindërve në procesin mësimor - rrugët e ndryshme për të mbështetur fëmijët e tyre në shkollë, si dhe për të ndikuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me procesin mësimor dhe të funksionimit të shkollës

Përfshirja e prindërve në edukim është një koncept i gjerë, sepse shfaqet në shumë forma dhe realizohet në shumë mënyra. Mjaft materiale teorike përshkruajnë role të ndryshme që prindërit mund të luajnë në edukimin e fëmijëve të tyre:
Prindërit si partnerë
Që në momentin e lindjes së fëmijës prindërit dhe anëtarët e tjerë të familjes janë edukatorët e parë dhe kryesorë të tij. Në shtëpi fëmijët mësojnë si të bisedojnë dhe të zhvillojnë aftësitë gjuhësore, mësojnë vlerat, shprehitë sociale si dhe njohuri për shoqërinë.
Prindërit kanë përgjegjësi ligjore për regjistrimin e fëmijëve të tyre në shkollë si dhe për frekuentimin e rregullt të saj. Ata duhet t'u përgjigjen kërkesave dhe informacioneve të ndryshme që vijnë nga shkolla.

Prindërit kanë të drejtë ligjore të njihen me të gjitha rezultatet shkollore të fëmijëve të tyre, të ndjekin sjelljen e fëmijëve dhe të përfshihen në vendimet që merren për edukimin e tyre.

Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Ndihmon prindërit për të kuptuar përgjegjësitë dhe të drejtat e tyre.
- Jep informacion për:
  - rëndësinë që ka ndjekja e shkollës rregullisht nga fëmija;
  - rregullat dhe procedurat shkollës, duke treguar edhe mënyrat sesi zbatohen ato;
  - programet e shkollës dhe përmbajtjen e fushave të ndryshme kurrikulare.

Prindërit si partnerë dhe zgjidhës të problemeve të shkollës
Prindërit mbështesin punën që bën shkolla me fëmijët e tyre dhe ndihmojnë në zgjidhjen e problemeve. Prindërit mund të demonstrojnë sesa e rëndësishme është shkolla nëpërmjet disa lloj angazhimesh dhe shfaqje interesash:

- Reagimit të tyre ndaj mungesave, sëmundjeve të lehta të fëmijëve si dhe braktisjeve të shkollës.
- Rregullave që ata vendosin për fëmijët e tyre rreth kohës së gjumit dhe asaj për të shikuar televizorin.
- Vlerësimit të rëndësisë së detyrave të shtëpisë.
- Mënyrave sesi ata mbështesin përpjekjet e fëmijëve për të dhënë maksimumin në shkollë.
- Inkurajimit të sjelljeve pozitive të fëmijëve.

Shumë rrallë ndodh që shkolla të zgjidhë e vetme problemet e të nxënit ose të sjelljes së fëmijëve. Në shumicën e rasteve ju dhe prindërit punoni së bashku për të zgjidhur problemet aktuale që kanë fëmijët në shkollë.
Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Të sigurojë materiale dhe të iniciojë programe apo trajnime, që ndihmojnë prindërit të kuptojnë rregullat dhe procedurat shkollore.
- Të vërë në dukje rëndësinë e komunikimit të prindërve me mësuesit.
- Të vlerësojë rëndësinë e pjesëmarrjes së prindërve në mbledhjet që organizon shkolla.
- Të iniciojë programe për t'u mësuar prindërve sesi t'i ndihmojnë fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë.

Prindërit si vëzhgues
Në këtë rol prindërit ndjekin dhe vlerësojnë veprimtaritë e shkollës dhe të fëmijëve. Veprimtaritë shkollore dhe pas shkolle, si: lojërat, shfaqjet artistike, koncertet, aktivitetet sportive, veprimtaritë letrare, shkencore, etj. janë elemente, të cilat mbushin hendekun ndarës që ekziston midis shtëpisë dhe shkollës. Vizitat në klasë i njohin prindërit më mirë me punën që bën mësuesi me nxënësit, me atmosferën e klasës dhe shokët me të cilët kanë miqësi fëmijët e tyre. Në kohën që prindërit qëndrojnë në shkollë për të dëgjuar dhe vëzhguar fëmijët e tyre ata mund edhe të mbledhin informacion për veprimtaritë e shkollës dhe njerëzit me të cilët fëmijët e tyre harxhojnë një pjesë të kohës. Me rëndësi është fakti që në këto vizita fëmijët në përgjithësi dhe ata me rezultate të ulta në veçanti, ndihen mirë që prindërit e tyre tregojnë interes për shkollën, mësuesit dhe klasën e tyre.
Çfarë mund të bëjë shkolla dhe mësuesi që prindërit të përmbushin këtë rol?

- Merr pjesë në planifikimin dhe njoftimin e veprimtarive të shkollës, duke ua bërë të njohura prindërve.
- Bën prindërit pjesë të veprimtarive si dhe takimeve që zhvillon stafi mësimor ose klasa.
- Organizon veprimtari të ndryshme duke vendosur një plan të alternuar për orarin, ditët e pushimit dhe pasditet për t'u dhënë mundësi të gjithë prindërve të ndjekin këto veprimtari.

Prindërit si vullnetarë
Në këtë rol prindërit punojnë si vullnetarë në ndihmë të shkollës, mësuesve, bordit të shkollës, këshillit të prindërve,etj. Në shumë praktika të suksesshme ka një traditë që prindërit të punojnë vullnetarisht në ndihmë të mësuesve të fëmijëve të tyre dhe të shkollës në tërësi.

Prindërit si këshillues dhe partnerë në vendimmarrje
Prindërit japin ndihmesën e tyre në politikën e shkollës dhe planet e programet shkollore nëpërmjet pjesëmarrjes si në bordin e shkollës dhe në institucionet ato vendimmarrëse. Shumë prindër marrin pjesë në bordin e shkollës, këshillin e mësuesve duke krijuar mundësinë që të lidhen me problemet e shkollës dhe veprimtaritë që realizohen aty. Kjo i bën që të kenë një autoritet real në vendimmarrje. Sot ka një prirje për t'i përfshirë prindërit në bordet e shkollës me synimin që ata të marrin vendime për çështje të ndryshme të shkollës si dhe për emërimin e stafit mësimor.
Kur prindërit kalojnë nga roli i një këshilluesi në atë të një vendimmarrësi atëherë ata kanë nevojë për më shumë informacion. Ata kanë nevojë të mësojnë teknika për të bërë pjesë të vendimmarrjes problemet që janë ngritur në komunitet nga prindërit.

Trajnimet e prindërve janë të vlefshme, sepse ata do të njohin më mirë programet edukative të shkollës dhe do të jenë të ndjeshëm ndaj nevojave arsimore të fëmijëve dhe prindërve në komunitetin e tyre shkollor.

MODULI 5: SIGURIA, MBROJTJA, MIRËQENIA DHE SHËNDETI I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET E ARSIMIT PARASHKOLLOR

Përmbledhje e modulit:

Ky modul trajton rolin dhe përgjegjësitë profesionale të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) dhe synon të rrisë kapacitetet e pjesëmarrësve në zbatimin e parimeve filozofike, etike dhe ligjore të mbrojtjes së fëmijës. Moduli pajis pjesëmarrësit me njohuri dhe aftësi praktike për identifikimin, investigimin dhe menaxhimin e rasteve të abuzimit apo neglizhencës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe të hartimit të Planeve Individuale të Mbrojtjes (PIM) në përputhje me nevojat e çdo fëmije. Ai gjithashtu sugjeron dhe thekson përdorimin e procedurave miqësore me fëmijët gjatë gjithë procesit të mbrojtjes dhe rehabilitimit, si dhe rëndësinë e ribashkimit të sigurt dhe të qëndrueshëm të fëmijës me familjen e tij.

Qëllimi i modulit:

Moduli synon të aftësojë punonjësit e arsimit pranë njësive të pushtetit vendor, drejtuesit vendorë dhe aktorët e tjerë institucionalë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme, për të forcuar kuptimin dhe zbatimin e rolit të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në përputhje me parimet filozofike, etike dhe ligjore të mbrojtjes së fëmijës.

Moduli synon të krijojë një kuptim të përbashkët ndërinstitucional mbi procesin e identifikimit, investigimit dhe menaxhimit të rasteve të abuzimit, neglizhencës apo rrezikut, duke nxitur bashkëpunimin dhe bashkërendimin efektiv ndërmjet strukturave vendore dhe kombëtare për garantimin e sigurisë dhe mirëqenies së fëmijës.

Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit aftësohen të:

- Kuptojnë rolin, përgjegjësitë dhe parimet etike të Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Identifikojnë, analizojnë dhe dokumentojnë rastet e fëmijëve në rrezik sipas standardeve ligjore dhe profesionale;
- Hartojnë dhe zbatojnë Plane Individuale të Mbrojtjes (PIM) në bashkëpunim me institucionet përkatëse dhe familjet;
- Zbatojnë procedura miqësore me fëmijët gjatë intervistimit dhe procesit të mbrojtjes;
- Ndjekin dhe monitorojnë procesin e rehabilitimit dhe ribashkimit të fëmijës me familjen e origjinës, duke siguruar një qasje të integruar dhe të qëndrueshme për mbrojtjen e tij.

Grupi i synuar

Punonjës të arsimit pranë njësive të pushtetit vendor, drejtues vendorë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme.

Sesioni 5.1: Bazat teorike dhe praktike të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë parimet filozofike, teoritë kryesore dhe praktikat efektive që udhëheqin sistemin e mbrojtjes së fëmijëve, duke zhvilluar një kuptim të thelluar dhe kritik mbi bazat teorike dhe etike që mbështesin ndërhyrjet profesionale në këtë fushë.

Sesioni synon të pajisë pjesëmarrësit me aftësi analitike dhe reflektuese për të interpretuar modelet dhe përqasjet e mbrojtjes së fëmijëve, për të trajtuar dilemat etike në praktikë dhe për të ndërtuar qasje të integruara që garantojnë siguri, mirëqenie dhe respekt për dinjitetin e çdo fëmije.

Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Identifikojnë parimet filozofike dhe etike që udhëheqin mbrojtjen e fëmijëve;
- Përvetësojnë teoritë dhe modelet kryesore që japin rezultate të mira në ndërhyrjet për mbrojtjen e fëmijëve;
- Reflektojnë në mënyrë kritike dhe krahasuese mbi përqasjet e ndryshme të përdorura në praktikë;
- Analizojnë dilemat etike dhe profesionale që lindin gjatë menaxhimit të rasteve dhe sugjerojnë mënyra për t'i trajtuar ato;
- Hartojnë në mënyrë ushtrimore plane individuale të mbrojtjes, të bazuara në nevojat dhe interesin më të lartë të fëmijës;
- Identifikojnë mekanizmat dhe institucionet që ofrojnë shërbime mbështetëse për fëmijët në rrezik;
- Aplikojnë konceptin e procedurave miqësore me fëmijët në kontekstin e mbrojtjes dhe rehabilitimit;
- Kuptojnë rëndësinë e bashkëpunimit ndërinstitucional në procesin e mbrojtjes dhe ribashkimit të fëmijës me familjen.

Tematika:

1. Parimet filozofike të mbrojtjes së fëmijëve – diskutim i hapur me pjesëmarrësit për të eksploruar përvojat, mendimet dhe mënyrat se si këto parime zbatohen në praktikë.
2. Reflektimi mbi përvojat profesionale – punë në grupe për të analizuar raste konkrete nga praktika, duke identifikuar situata ku janë aplikuar parimet e mbrojtjes.
3. Përqasjet kryesore teorike në mbrojtjen e fëmijëve – prezantim i shkurtër mbi modelet dhe teoritë që udhëheqin ndërhyrjet efektive në fushën e mbrojtjes së fëmijës.
4. Korniza e integruar e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve – shpjegimi i pesë perspektivave themelore: a) Perspektiva ekologjike
   b) Perspektiva e bazuar tek potencialet/pikat e forta
   c) Perspektiva zhvillimore
   d) Orientimi i planifikuar i vendosjes së qëndrueshme
   e) Perspektiva kulturore
5. Roli dhe përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) – analiza e rolit unik të PMF-së në zbatimin e këtyre perspektivave dhe në ndërhyrjet shumëdisiplinore.

6. Çështjet etike në praktikën profesionale të mbrojtjes së fëmijëve – diskutim mbi dilemat etike dhe rëndësinë e vendimmarrjes etike në menaxhimin e rasteve.
7. Përmbledhje dhe reflektim – rishikim i parimeve teorike dhe përqasjeve të prezantuara, me fokus në mënyrën se si ato mund të aplikohen në kontekstin e punës së përditshme të pjesëmarrësve.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1**)

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime/Punë në grup- (Shtojca nr 2)**

Këto aktivitete kanë për qëllim që pjesëmarrësit të kuptojnë dhe praktikojnë parimet që udhëheqin mbrojtjen e fëmijëve në punën e tyre të përditshme. Përmes diskutimeve dhe punës në grupe, ata ndajnë përvoja konkrete, identifikojnë se si parimet si interesi më i lartë i fëmijës, mos-diskriminimi, pjesëmarrja dhe mbijetesa e zhvillimi zbatohen në situata reale dhe cilat janë efektet e tyre tek fëmijët. Studimet rastore dhe analizat e dilemave etike u ndihmojnë të shohin situata komplekse, të reflektojnë mbi vendimet profesionale dhe të gjejnë zgjidhje që mbrojnë më mirë të drejtat dhe nevojat e fëmijëve. Prezantimet teorike mbështesin praktikën, duke treguar se kombinimi i teorisë me përvojën konkrete ndihmon në marrjen e vendimeve më të mira në punën me fëmijët.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Parimet filozofike dhe etike janë themeli i mbrojtjes së fëmijëve dhe udhëheqin vendimmarrjen e PMF-së në çdo hap të procesit.
- Roli i Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve është thelbësor dhe kërkon aftësi për të reflektuar, analizuar dhe përshtatur parimet në praktikat konkrete, duke balancuar situatat e vështira dhe dilemat etike.
- Ndërthurja e teorive me praktikën përmes pesë perspektivave kryesore (ekologjike, e bazuar në pikat e forta, zhvillimore, planifikimi i vendosjes së qëndrueshme dhe kulturore) është thelbësore për ndërhyrje të efektshme dhe për garantimin e sigurisë, zhvillimit dhe mirëqenies së fëmijës.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **4 orë**.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Parimet filozofike të Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve

Parimet e mbrojtjes së fëmijëve përbëjnë bazën filozofike për ngritjen e shërbimeve të mbrojtjes dhe përcaktojnë qëllimin e punës të cdo profesionisti. Parimet e mbrojtjes së

fëmijëve gjenden në Ligjin “Për Mbrojtjen e Fëmijëve”1 si dhe në Strategjinë Kombëtare për Fëmijët2. Parimet për mbrojtjen e fëmijëve janë:

1. Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve bëhet duke garantuar Interesin më të lartë të fëmijës, si konsideratë mbizotëruese, në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra nga ofruesit publikë apo privatë të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore, gjykatat, autoritetet administrative ose legjislative.
“Të kuptuarit dhe të zbatuarit e parimit të interesit më të lartë të fëmijëve është kryesisht detyrë e prindërve, sepse në jetën e përditshme janë ata aktorët/faktorët kryesorë në përmbushjen e detyrimeve në raport me fëmijët dhe në realizimin me përkushtim të të drejtave të fëmijëve. Asnjë autoritet nuk mund të zëvendësojë prindërit në këtë çështje. Nëse ndërmjet prindërve ka kontradikta thelbësore, dhe kërkohet ndërhyrja e një organi kompetent, kjo nuk bëhet për të zëvendësuar prindërit si të tillë, por për të mbajtur nën kontroll respektimin dhe realizimin e interesit më të mirë të fëmijës në kushtet e reja të krijuara. Në këtë vendimmarrje fëmijët duhet të kenë ndikimin e vet në vendimet gjyqësore dhe administrative që ndikojnë në jetën e tyre, siç janë pasojat e zgjidhjes së martesës, kujdestarisë, birësimit etj.”3

2. Barazia dhe asnjë lloj dallimi, pavarësisht nga raca, ngjyra, gjinia, gjuha, feja, opinioni politik ose çdo lloj opinioni tjetër, origjina kombëtare, etnike apo shoqërore, pasuria, paaftësia, prejardhja familjare a çdo gjendje tjetër e fëmijës ose e prindërve/përfaqësuesve ligjorë të tij.
Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve si dhe punonjësit e tyre duhet të jenë të përgjegjshëm për dallimet dhe t’I respektojnë ato. Punonjësit e shërbimeve të mbrojtjes duhet të punojnë duke u bazuar mbi potencialet dhe faktorët mbrojtës që ekzistojnë brenda çdo familjeje dhe komuniteti.

3. Eliminimin e të gjithave formave të diskriminimit ose të ndëshkimit të fëmijës, për shkak të pozitës, të veprimtarive, të opinioneve të shprehura apo të bindjeve të prindërve/përfaqësuesve ligjorë ose të anëtarëve të familjes së tij.
Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve ndërhyjnë atëherë kur prindërit e kanë të pamundur të mbrojnë fëmijët e tyre, është e drejta e këtyre shërbimeve që të ndërhyjnë në interest ë fëmijës. Në rastet kur fëmija nuk është i sigurt në familjen e tij, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve i drejtohen gjykatës.

4. Respektimin e përgjegjësive, të të drejtave dhe të detyrave që kanë prindërit/përfaqësuesit ligjorë për fëmijën.
Familja është vendi më i sigurt dhe më i mirë për rritjen e një fëmije.Çdo fëmijë ka të drejtë të rritet nën kujdesin e prindërve, në mjedis familjar dhe të sigurt si dhe të mos i nënshtrohet abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit. Plotësimi i nevojave fizike,

---

[1]Ligji ‘Për Mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës”, Nr.10 347, datë 4.11.2010, miratuar nga Kuvendi i RSH
[2] VKM “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Fëmijët 2005-2010” Nr. 368, dt.31.05.2005
[3] Mandro. A, “Parimi i interesit më të lartë të fëmijës-rëndësia dhe sfidat e zbatimit të tij” Revista Jeta Juridike,2008,

mendore, emocionale, arsimore dhe mjekësore të fëmijëve është përgjegjësi e prindërve. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve ndërhyjnë kur prindërit kërkojnë ndihmë ose dështojnë në plotësimin e nevojave të fëmijëve të tyre.

5. Krijimin e kushteve për mbijetesë maksimale dhe për zhvillim.
Është përgjegjësi e prindërve të sigurojnë kushte maksimale për ushtrimin e kujdesit prindëror. Prindërit/përfaqësuesit ligjorë kanë detyrimin t'i sigurojnë fëmijës mirëqenien emocionale, fizike, sociale dhe materiale, duke u kujdesur për të dhe duke marrë masat e nevojshme për ushtrimin e të gjitha të drejtave të parashikuara në Ligjin “Për mbrojtjen e të drejtave të Fëmijës”.
Prindërit apo përfaqësuesit ligjorë, për ushtrimin e përgjegjësive prindërore, kanë të drejtë t'u kërkojnë autoriteteve shtetërore përgjegjëse asistencë dhe ndihmë të specializuar për mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor e administrimin e pasurisë së fëmijës. Në kushtet e neglizhimit, abuzimit apo dhe pamundësisë për ushtrimin e kujdesit prindëror, shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve janë përgjegjëse për sigurinë e fëmijëve, performancën dhe mirëqënien e familjes. Në përmbushjen e kësaj detyre PMF-të duhet të përfshihen në identifikimin e shërbimeve në mbështetje të familjeve apo burimeve të tjera në komunitet. Shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe punonjësit e tyre duhet të tregojnë mirëkuptim për vështirësitë ekonomike, aftësitë e kufizuara fizike, mendore apo dhe problemet e tjera me të cilat përballen prindërit në rritjen e fëmijëve. Ata duhet t’i inkurajojnë prindërit dhe fëmijët të marrin pjesë në vlerësimin e rastit, planifikimin e ndërhyrjes apo trajtimit si dhe në çdo vendim tjetër të rëndësishëm.

6. Parimin e respektimit të mendimit të fëmijës, në përputhje me moshën dhe pjekurinë e tij.
E drejta e çdo fëmije për t’u dëgjuar sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijëve dhe Kodit të Familjes, kjo është një e drejtë që duhet të respektohet në çdo procedurë. E drejta e respektimit të mendimit të fëmijës lidhet me të drejtën e të miturit për t’u dëgjuar dhe për marrjen pjesë të tij/saj në procedurat administrative dhe ato gjyqësore. E drejta e dëgjimit të fëmijës duhet të jetë në balancë me moshën dhe me aftësinë e tij për të kuptuar atë që po ndodh dhe atë që do të vendoset, në mënyrë që ai të japë pëlqimin ose mospëlqimin e tij.

Përqasjet teorike të Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Kjo pjesë shpjegon sesi praktikuesit aplikojnë parimet filozofike të mësipërme në praktikë. Studiuesit e çështjeve të familjeve dhe fëmijës bien dakord që një qasje teorike e përqëndruar tek familja dhe me fëmijën në qendër që merr në konsideratë edhe kulturën e vendit është më e përshtatshme për të arritur rezultatet më të mira për fëmijën. Kjo qasje e integruar bazohet në pesë përspektivat teorike:

1. Përqasja ekologjike;
2. Përqasja e bazuar tek potencialet/pikat e forta;
3. Përqasja e zhvillimit;
4. Orientimi për Planifikim në Vazhdimësi/të përhershëm.
5. Përqasja për njohjes së Kulturës

Shpeshherë në modelet e sistemeve të mbrojtjes së fëmijës si dhe në praktikën e shërbimeve perspektivat i gjejmë të kombinuara me njëra-tjetrën. Parimet mbi të cilat janë ndërtuar këto teori janë parimet që i shërbejnë interesit më të lartë të fëmijës dhe familjes (të përmendura në pjesën e parë të sesionit).

Perspektiva ekologjike. Kjo perspektivë e koncepton sjelljen njerëzore dhe funksionimin social brenda një konteksti mjedisor. Faktorët personalë, faktorët familjarë dhe faktorët e mjedisit ndërveprojnë me njëri-tjetrin dhe e ndikojnë familjen dhe gjithë anëtarët e saj. Keqtrajtimi dhe neglizhimi i fëmijëve shihet nga kjo perspektivë si pasojë e "lojës" së një grupi faktorësh risku dhe mbrojtjeje të cilët veprojnë në nivel individual, familjar komunitar dhe shoqëror.

Perspektiva e bazuar tek potencialet. Kjo perspektivë i referohet metodologjive dhe strategjive që ndërtohen bazuar në potencialet apo pikat e forta të fëmijëve, familjeve dhe komuniteteve. Praktika e bazuar në këtë perspektivë lëviz nga një qasje teorike që tenton të theksojë problemet dhe patologjinë tek një tek një qasje tjetër që i jep rëndësi partneritetit pozitiv me familjen. Vlerësimet që bëhen bazuar në këtë perspektivë fokusohen në ndërveprimin e risqeve dhe potencialeve të cdo individi në familje, të familjes si një njësi e tërë dhe më gjërë të komunitetit dhe mjedisit.

Perspektiva e zhvillimit. Kjo perspektivë i referohet rritjes dhe zhvillimit individual si dhe zhvillimit të familjes nga perspektiva e jetës njerëzore dhe i vlerëson individët dhe familjet duke ndërvepruar me mjedisin rreth tyre gjatë gjithë ciklit të jetës. Planifikimi efektiv i rastit kërkon marrjen në konsideratë të atyre ndërhyrjeve tek një fëmijë apo familje që janë efektive në një mjedis specific dhe në një fazë specifike të zhvillimit.

Orientimi për Planifikim në Vazhdimësi/të përhershëm. Kjo perspektivë teorike ka në qendër të saj paradigmën që të gjithë fëmijët kanë të drejtën për një shtëpi në mënyrë të qëndrueshme. Shërbimet për mirrërritjen e fëmijëve duhet të fokusohen në krijimin e kushteve të sigurta për fëmijët në shtëpitë e tyre dhe vetëm nëse është e pamundur të arrihet t'i vendosin fëmijët në kujdestari të familjeve të tjera, por në mënyrë të qëndrueshme. Këto ndërhyrje duhet të përfshijnë një grup aktivitetesh të orientuara drejt qëllimit për të ndihmuar fëmijët të jetojnë në familje të sigurta që iu ofrojnë një ndjenjë përkatësie dhe lidhje familjare të qëndrueshme gjatë gjithë jetës.

Perspektiva e Njohjes së Kulturës. Kjo perspektivë kërkon që punonjësit e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve të kuptojnë klientët që vijnë nga kultura të ndryshme dhe të përshtasin praktikat e tyre. Kompetencat kulturore arrihet kur agjencitë dhe punonjësit e tyre i pranojnë dhe i respektojnë dallimet kulturore, përfshihen në vetëvlerësime në lidhje me marrdhënien e tyre me kultura të ndryshme, i zgjerojnë njohuritë dhe shprehitë e tyre për të punuar me grupe që vijnënga kultura, situata dhe nevoja të ndryshme.

Vlerat ,aftësitë dhe bazat etike të Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve
Punonjësi i Shërbimeve të Mbrojtjes së Fëmijëve Punonjësit e PMF-së janë faktorët më të rëndësishëm në arritjen e qëllimit të shërbimeve për fëmijët. Ata ndajnë së

bashku vlera, njohuri dhe shprehi që krijohen nëpërmjet arsimimit, trajnimeve, përvojës dhe mbikqyrjes.
Vlerat bazë të punonjësve të PMF-së:
Besim që:

- Të gjithë njerëzit kanë një rezervuar të madh aftësish (mendore, fizike, emocionale, sociale dhe shpirtërore) që mund të përdoren për të lehtësuar ndryshimin.
- Çdo fëmijë ka të drejtë për një familje të qëndrueshme.
- Çdo fëmijë dhe cdo anëtar i familjes duhet të fuqizohet të punojë për të arritur nevojat e tij/saj dhe qëllimet.

Përkushtim ndaj:

- Përdorimit të një praktike të bazuar tek potencialet, me fëmijën në qendër dhe të fokusuar te familja.
- Sigurimit të ndjenjës së sigurisë së fëmijës në kontekstin e familjes së tyre.
- Praktikimit të konfidencialitetit të plotë.

Respekt për:

- Individët me prejardhje të ndryshme raciale, fetare, etnike, kulturore dhe besim se fuqia është te ndryshimi.
- Dinjitetin e cdo individi, individualitetin dhe të drejtën për vet-vetndosje

Njohuritë bazë të punonjësve të PMF-ve: Ata duhet të kuptojnë:

- Sistemet familjare, mjedisin familjar, familjen në një kontekst historik, strukturat e ndryshme të familjes dhe konceptet e fuqizimit të familjes.
- Rritjen dhe zhvillimin individual me vëmendje të veçantë ndaj atashimit dhe kufijve, ndarjes, humbjes dhe zhvillimit të identitetit.
- Abuzimin e fëmijëve dhe dinamikat e neglizhimit.
- Diversitetin kulturor, karakteristikat e popullatave të vecanta dhe implikimet që ato sjellin në procesin e vlerësimit dhe të ndërhyrjes.
- Vazhdimësinë e shërbimeve duke përfshirë sistemin e kujdestarisë, sistemin e kujdesit rezidencial, vendosjen e fëmijëve për të parandaluar rrezikun, mbajtjen e lidhjeve familjare, ribashkimin e familjes dhe birësimin.
- Shërbimet ku përfshihen shërbimet e ndërhyrjes urgjente, trajnimet për prindërimin, këshillimet për familjet, zgjidhjen e konflikteve dhe këshillimin individual apo në grup.

Njohuri të:

- Çështjeve të menaxhimit të rastit dhe përgjegjësive
- Programeve dhe modeleve për mirëqenien dhe mbrojtjen e fëmijës
- Parimit të planifikimit të qëndrueshëm për fëmijët dhe rolin e kujdesit jashtë shtëpisë.

Familjaritet me:

- Problemet e veçanta të varfërisë, shtypjes dhe mohimit.

- Çështje të abuzimit me substancat dhe pasojat e tyre te fëmijët dhe familjet
- Dinamikat e dhunës në familje dhe në komunitet, përfshirë abuzimin e partnerit dhe pasojën e traumës.
- Shërbimet direkte për fëmijët dhe familjet në shëndetin mendor, kujdesin shëndetësor, abuzimin me substancat, arsim, drejtësinë për të miturit dhe sistemet komunitare.
- Shërbime të tjera për familjet në aspektin ekonomik, strehimit, transportit dhe kualifikimin professional.
- Aspektet ligjore që lidhen me praktikën për mirëqënien e fëmijës
- Proceset politike dhe avokuese dhe si ato lidhen me financimin dhe sigurimin e shërbimeve.

Aftësitë bazë të punonjësve të PMF: Aftësi për të:

- Evidentuar pikat e forta dhe nevojat si dhe përfshirjen e familjes në një process vlerësimi të bazuar te potencialet.
- Ndërmarrë veprime të duhura dhe të shpejta kur një fëmijë ka nevojë për mbrojtje.
- Analizuar informacionin kompleks.
- Përdorur shërbimet dhe strategjitë e ndërhyrjes gjatë krizës dhe ndërhyrjes së hershme.
- Vlerësuar gatishmërinë e familjes për të ndryshuar dhe përdorur strategjitë e duhura për rritjen e motivimit dhe për të ngritur një mardhënie ndihmuese me familjen.
- Funksionuar si një manaxher rasti por edhe si një anëtar skuadre, duke bashkëpunuar me shërbimet e tjera.
- Akesuar shërbime për abuzimin me substancat, dhunën në familje, abuzimin seksual dhe problemet e shëndetit mendor.

Gatishmëri për të:

- Zhvilluar dhe mbajtur marrëdhënie profesionale me familjet
- Dëgjuar
- Qenë elastikë
- Punuar me klientë jovullnetarë, duke përfshirë klientë armiqësorë apo rezistentë.
- Punuar me sistemet ligjore përfshirë dokumentimin dhe dëshmitë në gjykatë.
- Fuqizuar fëmijën dhe familjen për të mbajtur ato që ka arritur gjatë trajtimit dhe për të përdorur mbështetjen brenda saj dhe atë të komunitetit.

Ekspertizë në:

- Vlerësimin për abuzim, neglizhim dhe sigurinë e fëmijës dhe të të tjerëve në familje
- Negocimin, zbatimin dhe vlerësimin e planit të rastit me familjen
- Punën me familjen dhe aktorët e tjerë mbështetës për të arritur qëllimet e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve

- Aplikimin e njohurive për sjelljen njerëzore dhe metodat e ndërhyrjeve të suksesshme me fëmijët dhe adoleshentët në faza të ndryshme të zhvillimit

Çështjet etike dhe dilemat në praktikën e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve

1. Përkushtim për klientët. Përgjegjësia parësore e një punonjësi të PMF-së është të kujdeset për sigurinë e fëmijës, qëndrueshmërinë e fëmijës, mirëqënien e fëmijës dhe të familjes.
2. Vetëvendosja. Punonjësit e PMF-së respektojnë dhe promovojnë të drejtën e klientëve për vetëvendosje dhe i ndihmojnë klientët të identifikojnë qëllimet e tyre. E drejta për vetëvendosje mund të kufizohet në rastet kur punonjësi mendon që veprimet e klientit ose veprime të mundshme përbëjnë rrezik për fëmijët e tij.
3. Pranimi i informuar. Punonjësit e PMF-së duhet të ofrojnë shërbime për klientët vetëm në një marrëdhënie profesionale bazuar sipsa rastit në një pranim të informuar. Në rastet kur klientët marrin trajtim jovullnetar punonjësit duhet të sigurojnë informacion për natyrën dhe shtrirjen e shërbimeve si dhe për të drejtën e klientit për të refuzuar shërbimet.
4. Aftësitë. Punonjësit e PMF-së duhet të ofrojnë shërbime dhe ta prezantojnë veten si ekspertë vetëm brenda kufijve të arsimimit të tyre, të trajnimeve, licensave apo certifikimit.
5. Kompetencat kulturore dhe diversiteti social. Punonjësit e PMF-së duhet të kuptojnë kulturën dhe ndikimin e saj në sjelljen njerëzore duke vlerësuar pikat e forta në të gjitha kulturat.
6. Konflikti i interesit. Punonjësit e PMF-së duhet të jenë vigjilentë dhe të shmangin çdo lloj konflikti interesi që mund të ndërhyjë në ushtrimin e diskrecionit professional dhe gjykimit të paanshëm. Punonjësit e PMF-së nuk mund të marrin përfitime të padrejta nga një marrëdhënie profesionale apo t'I shfrytëzojnë të tjerët për përfitim personal.
7. Privatësia dhe konfidencialiteti. Punonjësit e PMF-së duhet të respektojnë të drejtën e fëmijës dhe familjes për privatësi. Ata nuk duhet të nxjerrin informacion nga klientët nëse nuk është i rëndësishëm për sigurinë e fëmijës, për t'i dhënë shërbimet e duhura ose për të arritur qëndrueshmërinë e fëmijës. Punonjësit mund të japin informacion me pranimin e klientit ose të kujdestarit ligjor. Punonjësit duhet të diskutojnë me klientët dhe palët e tjerë të interesuara për natyrën e konfidencialitet si dhe kufijtë dhe të drejtat për konfidencialitet. Punonjësit duhet ta mbrojnë konfidencialitetin e informacionit përveçse në rastet kur ndarja e informacionit do të parandalojë dëmtime të rënda të fëmijës.
8. Qasje ndaj shënimeve. Punonjësit duhet t'u sigurojnë qasje të arsyeshme klientëve te shënimet e tyre. Punonjësit duhet të kufizojnë qasjen e klientëve te shënimet e tyre nëse kanë fakte që kjo qasje do të dëmtojë fëmijën ose familjen. Kur i lihet qasje klientit kihet kujdes që të ruhet konfidencialiteti për individët e tjerë që shfaqen në shënime.
9. Marrëdhënie seksuale dhe ngacmime seksuale. Punonjësit e PMF-së nuk duhet të përfshihen në marrëdhënie seksuale ose kontakte seksuale me klientë të tanishëm apo të kaluar, të afërm të klientëve apo me të tjerë. Njerëz që klientët kanë marrëdhënie të ngushta. Punonjësit e PMF-së nuk duhet t'u japin shërbim individëve me të cilët kanë pasur marrëdhënie seksuale të mëparshme.

Punonjëësit nuk duhet të përfshihen në biseda apo akte fizike të natyrës seksuale me klientët.

10. Kontakti fizik. Punonjësit e PMF-së nuk duhet të përfshihen në kontakte fizike me fëmijët apo prindërit e tyre nëse ka rrezik të ndonjë lëndimi psikologjik.
11. Gjuha e punës. Punonjësit e PMF-së nuk duhet të përdorin asnjëherë gjuhë vulgare në komunikimin e tyre verbal ose të shkruar me klientët. Gjuha duhet të jete e respektueshme, e ndjeshme, në komunikim me klientët dhe komunitetin.
12. Klientët që nuk kanë kapacitetin e vendosjes për veten. Në këto raste punonjësit duhet të tregohen të kujdesshëm që të hedhin hapa të arsyeshme për të mbrojtur interesat e atyre klientëve.
13. Përfundimi i shërbimeve. Punonjësit e PMF-së duhet t'i përfundojnë shërbimet kur është arritur siguria dhe qëndrueshmëria e fëmijës.

Sesioni 5.2: Përkufizimi i mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e mbrojtjes

Objektivi: Të aftësohen pjesëmarrësit të kuptojnë në mënyrë të thelluar konceptin, procesin dhe mekanizmat institucionale të mbrojtjes së fëmijëve, si dhe rolet dhe përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në çdo fazë të këtij procesi. Sesioni synon t'i pajisë pjesëmarrësit me njohuri të qarta mbi sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në nivel vendor dhe kombëtar, duke shpjeguar fazat e ndërhyrjes nga identifikimi deri te rehabilitimi dhe ribashkimi, si dhe mënyrën se si piramida e shërbimeve ndihmon në planifikimin dhe ofrimin e ndërhyrjeve efektive.
Përmes diskutimeve dhe analizave praktike, pjesëmarrësit do të zhvillojnë aftësi për të bashkëpunuar me aktorët institucionalë dhe komunitarë, për të siguruar një mbrojtje të plotë, të bashkërenduar dhe miqësore me çdo fëmijë.
Në përfundim të sesionit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Përshkruajnë procesin e mbrojtjes së fëmijëve dhe fazat që e përbëjnë atë;
- Kuptojnë rolin dhe përgjegjësitë e PMF-së në secilën fazë të procesit të mbrojtjes;
- Identifikojnë dhe analizojnë mekanizmat dhe aktorët kryesorë të përfshirë në mbrojtjen e fëmijëve;
- Shpjegojnë strukturën dhe funksionimin e piramidës së shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës;
- Aplikojnë në mënyrë praktike 7 fazat e procesit të mbrojtjes (identifikimi, vlerësimi, planifikimi, ndërhyrja, monitorimi, rehabilitimi dhe ribashkimi) në rastet konkrete të punës profesionale.

Tematika:

1. Prezantimi i përkufizimit zyrtar dhe elementëve përbërës të sistemit të mbrojtjes së fëmijës.
2. Mekanizmat e mbrojtjes së fëmijëve: Struktura, funksionet dhe ndërveprimi i aktorëve në nivel vendor dhe kombëtar.Roli dhe përgjegjësitë e Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) në bashkërendimin e rasteve.
3. Piramida e shërbimeve të mbrojtjes: Shpjegimi i niveleve të shërbimeve (parandaluese, mbështetëse, ndërhyrëse dhe rehabilituese).Lidhja e piramidës me nevojat e fëmijëve në kontekste të ndryshme dhe rëndësia e reagimit të përshtatur.

- Shtatë fazat e procesit të mbrojtjes së fëmijës: Analizë e fazave: identifikimi, vlerësimi, planifikimi, ndërhyrja, monitorimi, rehabilitimi dhe ribashkimi. Diskutim mbi bashkërendimin ndërmjet institucioneve përgjatë gjithë ciklit të mbrojtjes.
- Aktorët kryesorë dhe mjedisi mbrojtës për fëmijët: Identifikimi i institucioneve dhe aktorëve që kontribuojnë në mbrojtjen e fëmijëve. Diskutim mbi konceptin e "mjedisit mbrojtës", që garanton sigurinë, dinjitetin dhe zhvillimin e fëmijës.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime ne grup – (Shtojca nr. 2)**

Diskutimet dhe puna në grup synojnë të angazhojnë pjesëmarrësit në reflektim, shkëmbim idesh dhe ndërtim të përbashkët të njohurive rreth konceptit të mbrojtjes së fëmijëve. Këto aktivitete u japin pjesëmarrësve mundësinë të artikulojnë kuptimet e tyre, të identifikojnë elementët kryesorë të mbrojtjes së fëmijëve, të analizojnë faktorët që ndikojnë në mirëqenien e fëmijëve dhe të eksplorojnë rolin që secili aktor—përfshirë vetë fëmijët—ka në proces. Përmes bashkëpunimit në grupe dhe diskutimeve të drejtuara nga trajneri, pjesëmarrësit krahasojnë perceptimet e tyre me standardet ligjore dhe institucionale dhe zhvillojnë një qasje më të thelluar, kritike dhe të unifikuar mbi konceptet dhe mekanizmat e mbrojtjes.

- **Ushtrimet (reflektim, ndarje idesh, analizë e rasteve dhe prezantime) (Shtojca nr. 3.**

Ushtrimet synojnë të thellojnë kuptimin praktik të pjesëmarrësve duke i ndihmuar ata të lidhin konceptet teorike me situata reale. Përmes ushtrimeve të reflektimit, ndarjes së ideve, analizës së piramidës së shërbimeve dhe prezantimeve mbi procedurat ligjore, pjesëmarrësit aftësohen të identifikojnë rreziqet, të analizojnë nevojat e fëmijëve, të kuptojnë fazat e procesit të mbrojtjes dhe të vlerësojnë rëndësinë e mekanizmave bashkëpunues. Këto ushtrime nxisin mendimin kritik dhe aftësitë praktike që u duhen PMF-ve për të marrë vendime të informuara, për të vlerësuar rastet dhe për të siguruar vazhdimësi të kujdesit gjatë gjithë procesit të mbrojtjes së fëmijëve.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Mbrojtja e fëmijëve është një proces kompleks që kërkon përkufizim të qartë dhe kuptim të thellë nga të gjithë aktorët.
- Mekanizmat e mbrojtjes dhe piramida e shërbimeve ndihmojnë në adresimin e nevojave të fëmijëve në mënyrë të strukturuar dhe të përshtatur me kontekstin.
- Shtatë fazat e mbrojtjes së fëmijëve përbëjnë një cikël të plotë që garanton sigurinë, mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.
- Roli i aktorëve të ndryshëm dhe krijimi i një mjedisi mbrojtës janë thelbësorë për një sistem efektiv të mbrojtjes së fëmijëve.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

Për këto aktivitete, pjesëmarrësit do të përdorin dokumente ligjore dhe materiale institucionale që ofrojnë përkufizime dhe udhëzime mbi mbrojtjen e fëmijëve, si legjislacioni shqiptar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, protokollet dhe udhëzimet e agjencive shtetërore, si dhe dokumentet e organizatave ndërkombëtare që trajtojnë parimet dhe mekanizmat e mbrojtjes së

fëmijëve.Këto dokumente do të shërbejnë si bazë krahasimi për diskutimet në grupe, prezantimet dhe analizat mbi piramidën e shërbimeve, fazat e procesit të mbrojtjes, rolin e PMF-së dhe rëndësinë e përfshirjes së fëmijëve në vendimmarrje, duke ndihmuar pjesëmarrësit të lidhin teorinë me praktikën dhe të zhvillojnë kuptimin e plotë të qasjes sistemike për mbrojtjen e fëmijëve.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- **Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"** – përkufizimi zyrtar i mbrojtjes së fëmijës, parimet, strukturat dhe detyrimet ligjore.
- **Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë** – dispozitat për pjesëmarrjen e fëmijës në proceset vendimmarrëse, të drejtën për t'u dëgjuar, pëlqimin dhe pjesëmarrjen në procedurat gjyqësore.
- **Kodi Penal (nenet që lidhen me dhunën, abuzimin, trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve)**
- **Protokolli Shtetëror për Mbrojtjen e Fëmijës (Protokolli i NJMF-ve)** – objektivat, detyrat dhe procedurat e punës së PMF; fazat e procesit të mbrojtjes (7 fazat).
- **Udhëzimet metodologjike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për funksionimin e njësive për mbrojtjen e fëmijës**.
- **Standardet e shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet** – lidhja me piramidën e shërbimeve dhe vlerësimin e rrezikut.
- **Rregulloret për grupet shumëdisiplinore në nivel bashkie**.
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (CRC)**

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të përdoren: (Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra,)

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Mbrojtja e fëmijëve

"Mbrojtje e fëmijës" është parandalimi dhe përgjigjja ndaj dhunës, abuzimit, shfrytëzimit dhe neglizhimit të fëmijëve, përfshirë rrëmbimin, shfrytëzimin seksual, trafikimin, punën e fëmijëve dhe praktikat e dëmshme tradicionale, si gjymtimi i organeve gjenitale dhe martesa e fëmijëve. Ky është përkufizimi sipas legjislacionit shqiptar për termin "mbrojtja e fëmijëve". Më poshtë janë edhe disa përkufizime të tjera të realizuara nga institucione apo organizata ndërkombëtare që në përgjithësi ju referohen 3 përbërësve të këtij sistemi: qëllimit të tij, mekanizmave dhe problematikës.

"Mbrojtja e fëmijëve janë masat dhe strukturat për të parandaluar dhe për t'iu përgjigjur dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve".

“Aktivitetet që synojnë zvogëlimin e ekspozimit të fëmijëve ndaj abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit si dhe i ndihmojnë fëmijët të realizojnë të drejtat e tyre themelore për kujdes, mbrojtje dhe drejtësi”.

“Masat ndërdisiplinore të ndërmarra për të garantuar mbijetesën dhe zhvillimin e pranueshëm të fëmijëve pa abuzim. Abuzimi përfshin dhunën apo shfrytëzimin e fëmijëve në çdo mjedis. Mbrojtja e fëmijës është një veprim parandalues por edhe ofron shërbime deri në momentin kur fëmija nuk është më në rrezik”.

Sistemi kombëtar i mbrojtjes së fëmijëve është një qasje gjithpërfshirëse dhe e ndërlidhur për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi dhe dhuna dhe për përmbushjen e të drejtës së fëmijës për mbrojtje. Elementët kyç të këtij sistemi përfshijnë familjet, komunitetet dhe mekanizmat qeveritarë si dhe fëmijët vetë. Përbërësit e sistemit përfshijnë strukturat, funksionet, kapacitetet, vazhdimësinë e kujdesit, proceset e kujdesit dhe llogaridhënia.

Mbrojtja e fëmijëve nuk duhet të ngatërrohet me mbrojtjen e të gjithë të drejtave të fëmijëve, që është përgjegjësi e të gjithë atyre që punojnë më fëmijët. Mbrojtja e fëmijëve iu adresohet vetëm fëmijëve që janë në rrezik ose që ndodhen në kushtet e dhunës, abuzimit, neglizhimit apo shfrytëzimit.

Mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve
(Shënim: ndonëse ky sesion përsëritet në modulin 1 qëllimi është të përforcohet përsëri të kuptuarit për mekanizmin në Shqipëri si dhe të bëhet më mirë lidhja në këtë fazë të kurrikulës)

Mekanizma për mbrojtjen e fëmijëve quhen organe ose institucione shtetërore, në nivel qendror a vendor, të cilët, brenda fushës së veprimtarisë së tyre janë përgjegjës, kryejnë dhe mbulojnë shërbime të specializuara e profesionale për mbrojtjen e fëmijëve.

Mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës
Mekanizmat institucionale për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës janë në nivel qendror dhe vendor. Mekanizmat në nivel qendror dhe vendor bashkëpunojnë ndërmjet tyre për zbatimin e legjislacionit dhe të politikave shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.
Këta mekanizma bashkëpunojnë me organizatat jofitimprurëse, për realizimin e politikave vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës.

Mekanizmat në nivel qendror janë:
- Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës;
- Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës;
- Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës.

Mekanizmat në nivel vendor janë:

a) njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut.
b) njësia për mbrojtjen fëmijës në bashki.

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve

Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është organ këshillimor. Këshilli Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës kryesohet nga ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës dhe përbëhet nga 9 përfaqësues, të përcaktuar nga Kryeministri, në nivel ministri, Avokati i Popullit, 1 përfaqësues nga Shoqata Kombëtare e Bashkive dhe 2 përfaqësues nga shoqëria civile.

Ministri që bashkërendon punën për çështjet e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës

Ministri që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës (Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta) është autoriteti shtetëror përgjegjës, i cili, nëpërmjet strukturës politikëbërëse harton politika dhe programe, propozon ndryshime ligjore dhe nënligjore, kontrollon veprimtarinë e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës, bashkrendon punën me autoritetet shtetërore përgjegjëse për hartimin dhe plotësimin e standardeve për mbrojtjen e fëmijës, nxjerr udhëzime metodologjike për veprimtarinë e njësive të të drejtave dhe të mbrojtjes së fëmijës në organet e qeverisjes vendore, orienton mbështetjen e donatorëve vendas dhe ndërkombëtarë për zbatimin e objektivave të strategjisë kombëtare për fëmijët, ofron mbështetje për organizatat jofitimprurëse në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe bashkërendon punën për përgatitjen e materialeve dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit Kombëtar për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës. Autoritetet shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për bashkëpunim me ministrin që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës, në hartimin e politikave dhe programeve të përbashkëta në këtë fushë.

Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës është person juridik, në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet për mbrojtjen e fëmijës.

Detyrat e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës
Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës ka detyrën e monitorimit dhe kontrollin për zbatimin e ligjit “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës”, të zbatimit të strategjisë kombëtare e të planit të veprimit të saj, përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës.

Njësia për të drejtat e fëmijës në këshillin e qarkut
Njësia për të drejtat e fëmijës, që funksionon brenda strukturës administrative të këshillit të qarkut, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje

sociale, ka për detyrë të monitorojë dhe të vlerësojë mënyrën e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në territorin e qarkut.

Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki
Njësia për mbrojtjen e fëmijës në bashki funksionon brenda strukturës administrative të bashkisë, si njësi e posaçme ose si njësi e strukturave të ngarkuara me çështje sociale dhe ka për detyrë:

1. të vlerësojë dhe të monitorojë në vazhdimësi situatën e familjeve të fëmijëve në rrezik, derisa fëmija të konsiderohet si "jashtë rrezikut";
2. të bëjë identifikimin dhe të bashkërendojë, në mënyrë shumëdisiplinore, mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territorin e bashkisë;
3. të sensibilizojnë komunitetin, të organizojë takime informuese, edukative dhe trajnuese për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë;
4. të bashkëpunojë me administratorët e shërbimeve shoqërore, psikologët e kopshtive, mjekun e familjes, autoritetet përgjegjëse të rendit, punonjësit socialë të qendrave të shërbimeve publike e jopublike, për përmirësimin e situatës së mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë;
5. të shërbejë si qendër informacioni, ku fëmijët dhe familjet në territorin e bashkisë mund të informohen apo të referohen te shërbime të tjera mbështetëse, sipas nevojave që ata kanë;
6. t'i raportojë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës të dhënat statistikore që ka përpunuar për mbrojtjen e fëmijës në territorin e bashkisë;
7. t'i paraqesë periodikisht Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës informacione për situatën e mbrojtjes se fëmijës në territorin e bashkisë.

Pranë bashkisë krijohen grupet shumëdisiplinore për mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve të fëmijëve në rrezik në territorin e bashkisë.

Figura: Piramida e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës sipas nivelit të rrezikut
Në figurën e mëposhtme gjeni Piramidën e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve sipas problematikës së situatës së fëmijës dhe nivelit të rrezikut:

Objektivat e PMF-së janë:(sipas Protokollit të NJMF-së)

- Siguria e fëmijës. Të gjithë fëmijët kanë të drejtë të rriten në një mjedis të mbrojtur, pa abuzim dhe neglizhim. Siguria e fëmijës është përgjegjësia parësore që udhëheq PMF-në.
- Vazhdimësia. Fëmijët kanë nevojë për një familje dhe një shtëpi të qëndrueshme. Ndjenja e vazhdimësisë dhe lidhjes me familjen dhe shtëpinë janë të rëndësishme për një zhvillim të shëndetshëm të fëmijës.
- Mirëqenia e fëmijës dhe familjes. Fëmijët meritojnë një mjedis në të cilin plotësohen nevojat e tyre fizike, emocionale, arsimore dhe sociale. Praktikat e PMF-së duhet të vlerësojnë nevojat e çdo fëmije dhe të promovojnë zhvillimin e shëndetshëm.

Detyrat kryesore të PMF-së janë të:

- Vlerësojë sigurinë e fëmijës;
- Ndërhyjë për të mbrojtur fëmijën nga dëmtimi;
- Fuqizojë aftësitë e familjeve të mbrojnë fëmijët e tyre;
- Sigurojë ribashkimin me familjen ose një alternativë si familje të sigurt për fëmijën.

Fazat e procesit të mbrojtjes.
Ky mision realizohet nëpërmjet një procesi që kalon 7 faza kryesore, të cilat janë:

1. Marrja e raportimit
2. Investigimi/pjesë e procesit të vlerësimit të rrezikut dhe vlerësimit të plotë të rastit.
3. Vlerësimi i familjes
4. Planifikimi i rastit
5. Ofrimi i shërbimit
6. Vlerësimi i progresit të familjes
7. Mbyllja e rastit

Përgjegjësia parësore dhe mjedisi mbrojtës janë koncepte shumë të rëndësishëm për shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve.

Përgjegjësia parësore
Përcaktimi i kohës për t'iu përgjigjur raportimit është shumë i rëndësishëm në vlerësimin e sigurisë së fëmijës. Koncepti i përgjegjësisë parësore lidhet me përgjegjësinë e Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijës për të vendosur nëse fëmija është i sigurt apo jo, përgjegjësi që ushtrohet nëpërmjet një takimi ballë për ballë me fëmijën. Ky takim mund të bëhet nga një punonjës i PMF-së ose nga një profesionist jashtë shërbimeve por i kualifikuar për të bërë vlerësime të sigurisë së fëmijëve.
Mjedisi mbrojtës
Mjedisi mbrojtës arrihet kur nevojat e zhvillimit të fëmijës, kapacitetet prindëruese dhe faktorët e familjes dhe mjedisorë janë në favor të rritjes dhe zhvillimit të shëndetshëm të fëmijës.

Koncepti i vazhdimësisë së kujdesit
Parimi i vazhdimësisë së kujdesit ka të bëjë me shërbimet e integruara për mbrojtjen e fëmijëve që në momentin e raportimit deri në mbylljen e rastit të një fëmije. Ky parim ka dy dimesione: dimesionin e kohës dhe dimesionin e vendit. Dimesioni i kohës lidhet me momentin e raportimit, investigimit, vlerësimit të familjes, planifikimit të rastit, ofrimit të shërbimeve, vlerësimit të familjes dhe mbylljes së rastit. Dimensioni i vendit lidhet me nivelet e kujdesit që janë: familja, shërbimet për përkujdesjen e fëmijës (familja kujdestare, përkujdesi rezidencial, institucionet e drejtësisë për të miturit, etj) komuniteti, institucionet e arsimit, shëndetësisë.

Përfshirja e fëmijës në shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve

Përfshirja e fëmijës është shumë e rëndësishme në gjithë fazat e procesit për mbrojtjen e fëmijëve. Pavarësisht nga mosha e fëmijës ka praktika të përfshirjes së fëmijës në të gjitha fazat. Vlerësimi i dëshirave dhe i ndjenjave të fëmijës duhet bërë në përputhje me moshën e tij dhe me pjekurinë. Rritja në moshë e fëmijëve i bën mendimet e tyre më të rëndësishme për gjykatën. Është e rëndësishme të pranojmë se mendimet e fëmijëve nuk janë vendimtare, sepse fëmija mund të dëshirojë diçka që është në kundërshtim me mirëqenien dhe interesin e tij/saj.

Respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar shprehet në këto alternativa të Kodit të Familjes, të cilat zbatohen në të gjitha procedurat apo praktikat administrative dhe gjyqësore:

- Marrja në konsideratë e mendimit të të miturit.
- Marrja në konsideratë e ndjenjave të të miturit.
- Kërkimi i dhënies së pëlqimit prej të miturit.
- Bërja e ndërhyrjeve gjatë një procesi.
- Qenia i pranishëm e të miturit (në bazë të moshës dhe kapacitetit zhvillimor si dhe specifikës së rastit) në çdo proces që prek jetën e tij/saj.
- Legjitimimi i tij si një kërkues i drejtpërdrejtë në një proces gjyqësor

Sesioni 5.3: Plani individual i mbrojtjes

Objektivi: Të njihen dhe përdoren mjetet dhe mekanizmat për forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë në procesin e menaxhimit vendor.

Tematika:

1. Roli dhe rëndësia e dëgjesave publike si mjet për përfshirjen e qytetarëve dhe dialogun institucional;
2. Organizimi dhe struktura e dëgjimeve publike për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje;
3. Rekomandimet e këshillit si instrument llogaridhënieje dhe përmirësimi të veprimeve, mënyrat për ndjekjen dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve;
4. Praktika të mira për forcimin e kulturës së përgjegjshmërisë në institucionet vendore;
5. Shembuj konkretë të mekanizmave të suksesshëm të llogaridhënies në bashkitë.

Ushtrime – Shtojca nr 2

Diskutime (Aktivitetet #1, #3 dhe #5)

Ky grup aktivitetesh synon t'i njohë pjesëmarrësit në mënyrë të strukturuar me konceptet bazë të Planit Individual të Mbrojtjes dhe me procesin e hartimit të tij sipas Protokollit të Mbrojtjes së Fëmijëve. Përmes prezantimeve në PPT, trajneri shpjegon dimensionet kryesore të planit, rolin e PMF-së, rëndësinë e vlerësimit të rrezikut, ndarjen e përgjegjësive dhe rishikimin periodik të planit. Diskutimi në grupin e madh u jep pjesëmarrësve mundësinë të artikulojnë hapat praktikë të hartimit të PIM-it dhe të identifikojnë veprimet konkrete që duhet të ndërmerren në mënyrë të bashkërenduar. Këto diskutime finalizohen me prezantimin e Takimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve, duke sqaruar se cilët aktorë marrin pjesë, si përfshihen prindërit dhe fëmija, si përcaktohet kohëzgjatja e planit dhe si kryhet rishqyrtimi. Në këtë mënyrë, pjesëmarrësit përfitojnë një kuptim të plotë të rrugëtimit të një rasti – që nga vlerësimi deri te vendimmarrja ndërinstitucionale.

Punë në Grup dhe ushtrime praktike (Aktivitetet #2 dhe #4) (Shtojca nr.3)

Ky aktivitet synon t'i aftësojë pjesëmarrësit të zbatojnë në praktikë hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes duke punuar me raste konkrete. Pjesëmarrësit ndahen në grupe dhe analizojnë raste studimore të niveleve të ndryshme të rrezikut, duke përcaktuar rezultatin e dëshiruar, veprimet që duhen ndërmarrë, personin përgjegjës dhe afatet kohore; më pas plotësojnë tabelën e PIM-it sipas Modelit 5.1. Në një fazë të dytë, grupet punojnë mbi rastin e familjes Beu dhe analizojnë cilësinë e një Plani Individual ekzistues, duke vlerësuar nëse garanton sigurinë e fëmijës, nëse veprimet janë të mjaftueshme dhe nëse përgjegjësit kanë qasje e kapacitet për të zbatuar detyrat. Përmes këtij procesi, pjesëmarrësit zhvillojnë aftësinë për të bërë vlerësim të rrezikut, për të ndërthurur informacionet nga burime të ndryshme, për të shmangur supozimet, për të strukturuar ndërhyrjet dhe për të menduar në mënyrë profesionale rreth forcave dhe kufizimeve të çdo plani mbrojtjeje.

Mesazhet kyç të sesionit:

- **Plani Individual i Mbrojtjes (PIM)** është një mjet thelbësor për menaxhimin e rasteve dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës.
- **Roli i PMF-së** është qendror në hartimin, bashkërendimin dhe zbatimin e PIM-it, në bashkëpunim me aktorët e tjerë.
- **Rubrikat e PIM-it** ndihmojnë në strukturimin e veprimeve sipas nevojave, prioriteteve dhe kohës së duhur.
- **Informacioni nga investigimi dhe vlerësimi** është bazë për hartimin e një plani të saktë dhe të personalizuar.
- **Qëllimi i PIM-it** është zvogëlimi i rrezikut dhe përmbushja e nevojave të fëmijës dhe familjes, përmes një procesi të rishikueshëm dhe të përfshirës.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint të sesionit
- prezantimin në PPT mbi Planin Individual të Mbrojtjes dhe dimensionet e tij,
- modele të Planit Individual të Mbrojtjes për raste studimore,
- raste studimore të detajuara (4 raste) me informacion të nevojshëm për analizë, materiali i familjes Beu me planin e tyre individual të mbrojtjes,
- si dhe tabela për plotësimin e veprimeve, përgjegjësive dhe afateve kohore sipas PIM-it.
- Dokumentet përmbajnë gjithashtu pyetjet udhëzuese për analizën e planeve dhe kriteret për vlerësimin e zbatimit të tyre, duke mundësuar një qasje të strukturuar dhe praktike gjatë gjithë sesionit.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- **Ligji nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës"** (Përkufizimi i rrezikut, përgjegjësitë e PMF-së, parimet, procesi i ndërhyrjes dhe masat e mbrojtjes).
- **Kodi i Familjes** (Pjesëmarrja e fëmijës, përgjegjësitë prindërore, masa mbrojtjeje).
- **Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë** (Nenet për dhunën, abuzimin, shfrytëzimin dhe neglizhencën – të rëndësishme për vlerësimin e rrezikut).
- **Protokolli i Punës së Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve** (përcakton 7 fazat, hartimin e PIM-it, rishikimin dhe rolin e PMF-së).
- **Udhëzimet/Manualet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** për:
    - hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes
    - menaxhimin e rasteve

    - funksionimin e NjMF-ve
- **Formatet zyrtare të Planit Individual të Mbrojtjes** sipas akteve nënligjore (Modeli 5.1 – tabelat e PIM).
- **Rregulloret e Takimeve të Mbrojtjes së Fëmijës** (kush thirret, si zhvillohen takimet, roli i profesioneve).
- **Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (CRC)** – parimet udhëheqëse (interesi më i lartë, pjesëmarrja, mosdiskriminimi, zhvillimi).
- **Udhëzimet për Menaxhimin e Rastit të Mbrojtjes së Fëmijës** (UNICEF / Save the Children / Inter-Agency) – standardet për planifikimin, monitorimin dhe rishikimin e planeve të mbrojtjes.
- **Piramida e Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijës** – për të kuptuar nivelin e shërbimit që lidhet me planin e mbrojtjes.
- **Përshkrimi i rolit të PMF-së dhe mbikqyrësit të rastit** – për takimet e mbrojtjes, bashkërendimin dhe mbajtjen e shënimeve.
- **Udhëzuesit e hartimit të PIM-it me raste praktike** (p.sh. Rasti “Familja Beu”).

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të përdoren (Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, Letra me ngjyra,)

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Plani Individual i Mbrojtjes

Plani Individual i Mbrojtjes është planifikimi i masave konkrete me qëllim mbrojtjen e fëmijës në të ardhmen nëse vlerësohet se fëmija është në rrezik të vazhdueshëm për t’u dëmtuar rëndë.

Plani Individual i Mbrojtjes hartohet nga punonjësi i Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijës në të gjitha rastet kur mendohet se fëmija mund të ndihmohet pa u larguar nga familja (pa kërkuar në gjykatë zhvendosje nga familja).

Plani Individual i Mbrojtjes në rastin e një fëmije në rrezik të menjëhershëm përbëhet vetëm nga hapat fillestarë dhe më urgjentë për të garantuar mbrojtjen e menjëhershme dhe sigurinë e fëmijës. Raste të tilla mund të përmendim: plagosje të rëndë apo vdekje, për t’u trafikuar jashtë vendit, kushtet e tij/saj do të ndikohen nga vendimmarrja e vonuar (psh. një fëmijë që vuan nga diabeti, etj), prindërit/kujdesatarët nuk janë në gjendje ose nuk dëshirojnë të kujdesen për fëmijën.

Parimet kryesore që duhen respektuar gjatë përgatitjes së Planit Individual të Mbrojtjes janë:

- Interesi më i lartë i fëmijës.
- Respekti për fëmijën dhe anëtarët e familjes së tij/saj.
- Fëmija dhe prindërit ose kujdestarët e tij/saj duhet të mirëinformohen dhe të marrin pjesë në vendimmarrje dhe llojin e ndërhyrjes dhe punës së miratuar.

- Konsultimi dhe bashkëpunimi me ofruesit e shërbimeve dhe specialistët e tjerë për të respektuar të drejtat e fëmijës.
- Respektimi i vlerave kulturore dhe tradicionale të fëmijës dhe familjes së tij/saj, por jo nëse kjo e vendos fëmijën në rrezik.
- Rëndësia e mbajtjes së fëmijës në familje dhe sigurimi/krijimi i marrëdhënieve të mira
- Shmangia e dyzimeve të ndërhyrjeve nga shumë organizata të ndryshme për një familje.

Synimi i Planit Individual të Mbrojtjes është të:

- Identifikojë faktorët e rrezikut dhe mënyrat me të cilat fëmijët mund të mbrohen nëpërmjet një plani që përfshin ndërveprim ntë disa shërbimeve, bazuar në informacionin e marrë nga investigimi.
- Përcaktojë qëllimet dhe objektivat afatshkurtra dhe më afatgjata për të ulur mundësinë e dëmtimit të fëmijës dhe promovimi i mirëqënies së fëmijës, përfshirë kontaktet me pjesëtarët e familjes.
- Qartësojë përgjegjësitë e gjithsecilit për veprimet e nevojshme-përfshirë veprimet e pjesëtarëve të familjes-brenda afateve të caktuara kohore.
- Përcaktojë mënyrat për të monitoruar dhe vlerësuar progresin në raport me rezultatet e përcaktuara në planin e mbrojtjes.
- Qartësojë rolin e profesionistit që është përgjegjës për të verifikuar nëse kanë ndodhur ndryshimet e kërkuara dhe cilat veprime duhen ndërmarrë dhe nga cili nëse këto ndryshime nuk kanë ndodhur.

Plani Individual i Mbrojtjes hartohet duke marrë në konsideratë çështjet e mëposhtme:

a. Moshën e fëmijës
b. Fazën e zhvillimit të tij dhe nevojat e tij
c. Kapacitetin prindëror, faktorët e familjes dhe faktorët mjedisorë
d. Nevojat e vlerësuara dhe format e mbrojtjes për të cilat ai ka nevojë duke bërë prioritizim të këtyre nevojave
e. Burimet e pranishme në komunitetin e fëmijës dhe vendodhjen e tyre dhe nëse është e nevojshme shërbimet e tjera të specializuara brenda vendit.

Qëllimi specifik i Planit Individual të Mbrojtjes është:

- Të garantojë sigurinë e fëmijës dhe ta mbrojë atë nga dëmtimi në të ardhmen duke mbështetur pikat e forta të fëmijës, duke trajtuar faktorët e cenueshmërisë dhe faktorët e rrezikut si dhe duke ndihmuar për të plotësuar nevojat imediate të fëmijës.
- Promovojë shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës.
- Të mbështesë familjen dhe anëtarët e familjes më të gjerë për të mbrojtur dhe promovuar mirëqenien e fëmijës gjatë dhe pas rrezikut.

Plani Individual i Mbrojtjes e realizon qëllimin e tij vetëm nëse përcaktohet qartësisht nevoja e fëmijës/familjes, cfarë duhet bërë për ta trajtuar, pse, kur dhe nga kush.

Plani Individual i Mbrojtjes duhet të:

- Përshkruajë nevojat e zhvillimit të fëmijës dhe identifikojë shërbimet e nevojshme për plotësimin e këtyre nevojave
- Caktojë rezultate specifike, të arritshme në nivelin e fëmijës, prindit, familjes dhe mjedisit
- Përfshijë strategji specifike dhe realiste për të arritur ndryshimet e nevojshme
- Caktojë përgjegjësitë e të gjithë aktorëve përfshirë anëtarët e familjes dhe profesionistët përfshirë ata që janë në kontakt të vazhdueshëm me fëmijën psh. mësuesin, mjekun e kopshtit, etj.
- Mënyrat e vlerësimit të progresit, koha dhe raportimi në takimin tjetër të mbrojtjes.

Plani Individual i Mbrojtjes është një format i miratuar në aktet nenligjore të çdo vendi. Vende të ndryshme kanë formate të ndryshme të cilat megjithë ndryshimet, përfshijnë cështjet: Nevojat e paplotësuara të zhvillimit të fëmijës; sjelljet, qëndrimet apo faktorët e rrezikut; veprimet që duhet të ndërmerren për të ndryshuar; afatin e kryerjes së këtyre veprimeve; ofruesit e shërbimeve për fëmijën dhe familjen; treguesit e progresit dhe veprimet monitoruese të nevojshme. Në figurën e mëposhtme jepet një model-Plan Individual Mbrojtje:

Figura 5.1 Model-Plani Individual i Mbrojtjes



Figura 5.1 – Model-Plani Individual i Mbrojtjes

Ndërhyrjet që përcaktohen në Planin Individual të Mbrojtjes kanë elemente që lidhen dhe ndërvaren, por që kanë prioritet sipas renditjes së mëposhtme:

- Veprime që synojnë sigurinë e fëmijës
- Veprime që promovojnë shëndetin e fëmijës dhe zhvillimin e tij
- Veprime për të ndihmuar prindin për t'u kujdesur për fëmijën

- Terapi për fëmijën e abuzuar
- Terapi për prindin abuzues

Planifikimi efektiv lidhet me përcaktimin e rezultateve të qarta që duhet të arrihen. Rezultatet e qarta janë përcaktime se cfarë profesionistët dhe familja dëshirojnë të arrijnë nëpërmjet Planit Individual të Mbrojtjes. Rezultatet përbëjnë qëllimin final që duhet arritur. Rezultatet përcaktohen duke mbajtur në konsideratë dëmin e ndodhur apo të mundshëm për t'i ndodhur fëmijës si dhe çdo nevoje tjetër të identifikuar të fëmijës dhe familjes. Sa më të qarta të jenë rezultatet e dëshiruara aq më të qartë janë aktorët e përfshirë në zbatimin e planit për qëllimin dhe objektivat për t'u arritur. Psh. "të mbrohet fëmija nga dëmi në të ardhmen" është një një rezultat i paqartë që nuk jep informacion as për nevojat dhe as për shërbimet dhe veprimet e duhura për të arritur mbrojtjen e fëmijës. Punonjësi i PMF-së dhe familja zhvillojnë së bashku tregues afatshkurtër dhe afatgjatë që ndihmojnë për një vlerësim të progresit drejt qëllimit bazuar në fakte. Këto masa ndihmojnë për një vlerësim efektiv të ndërhyrjeve, gjë që bëhet rregullisht në takimet për rishikimin e Planit Individual të Mbrojtjes. Në një Plan Individual Mbrojtje përcaktohen rezultatet e dëshiruara, qëllimi, detyrat për fëmijën/familjen dhe aktorët e tjerë si dhe koha e realizimit të cdo detyre.
Përcaktimi i rezultatit, qëllimit dhe detyrave është i nevojshëm në planifikimin për të ulur rrezikun për fëmijën.

Plani Individual i Mbrojtjes: Shërbime Mbrojtjeje në familje (rasti i familjes Beu)
Qëllimi1: Monitorimi dhe Mbikëqyrja e situatës
Përgjegjësi: Mjeku i familjes
Detyra: Ai do të ekzaminojë fëmijën për lëndime apo shenja, gjithashtu do të flasë me prindërit për mardhëniet e tyre dhe ndonjë vështirësi në lidhje me fëmijën
Koha: çdo dy muaj
Qëllimi2: Ndarja/Zhvillimi i fëmijës
Përgjegjësi: Drejtuesja e fëmijët pranë familjes
Detyra: Përmirësimi i shprehive motorike dhe sociale të fëmijës. Drejtuesja e fëmijët do të sigurojë një ndarje të fëmijës nga prindërit për të lehtësuar ata.
Koha: 5 herë në javë 9.00-13.00.
Qëllimi3: Këshillimi i prindërve
Përgjegjësi: Punonjësi i PMF-së
Detyra: Të ndihmojë babain me njohuri për prindërimin dhe të përmirësojë shprehitë e tij
Koha: 2 herë në muaj
Qëllimi4: Zhvillimi i burimeve
Përgjegjësi: Punonjësi i PMF-së
Detyra: Ndihma për të gjetur punë për babain
Koha:Në vazhdimësi
Qëllimi5: Ndarja
Përgjegjësi: Babai
Detyra: Nëse grindjet vazhdojnë midis tij dhe të dashurës ai do t'i kërkojë asaj të largohet nga shtëpia

Pjesëmarrësit në Takimet për Mbrojtjen e fëmijës dhe hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes

Në punën për hartimin dhe zbatimin e Planit Individual të Mbrojtjes janë disa aktorë që marrin pjesë në takimet për mbrojtjen e fëmijës si: Shërbimet për Mbrojtjen e Fëmijës, punonjësit e shërbimit shëndetësor në kopësht/shërbim parësor, shërbimet për mbrojtjen e rendit, zyrat antitrafik, punonjësit e sistemit arsimor, punonjësit e shërbimeve të tjera nëse vlerësohet e nevojshme (psh.punonjësi i ndihmës ekonomike), prokuror nga sektori i të miturve (nëse është e nevojshme) si dhe fëmija dhe prindërit/kujdestarët (nëse fëmija është në moshën e duhur dhe prindi/kujdestari që nuk akuzohet për abuzim). Të gjithë aktorët janë të rëndësishëm por punonjësi i PMF-së, fëmija, prindërit dhe mbikqyrësi i rastit janë më të rëndësishmit në procesin e hartimit dhe zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes.

Përfshirja e fëmijës dhe familjes në hartimin dhe zbatimin e Planit Individual për Mbrojtjen është shumë e rëndësishme për të përmbushur qëllimin e planit. Prindërit/kujdestarët duhet të informohen për mundësinë e pjesëmarrjes në Takimet për Mbrojtjen e Fëmijës, punonjësin përgjegjës për rastin, kohëzgjatja e planit, afatet e rishikimit të planit, etj.
Prindërit/kujdestarët e tij/saj duhet të qartësohen për këto cështje në lidhje me Planin Individual të Mbrojtjes:

- Faktet (abuzimi, neglizhimi, shfrytëzimi, dëmi që fëmija ka pësuar ose mund të pësojë) që çuan në nevojën për të zhvilluar një Plan Individual Mbrojtjeje.
- Çfarë duhet ndryshuar në të ardhmen
- Çfarë pritet nga prindërit/kujdestarët në zbatim të Planit
- Cili është personi i kontaktit për rastin
- Sa kohë do të zgjasë Plani Individual i Mbrojtjes
- A mund të ankohet për përmbajtjen e Planit

Në hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes merren në konsideratë aftësitë dhe motivimi i prindërve apo kujdestarëve për të ndryshuar. Nëse niveli i aftësive dhe motivimit është i ulët atëherë parashikohen në plan ndërhyrje për të rritur aftësitë dhe motivimin e prindërve/kujdestarëve për mbrojtjen e fëmijës. Për të vlerësuar këtë situatë në mënyrë profesionale ndihmojnë pyetjet e mëposhtme:

- Çfarë mendojnë fëmijët për situatën e tyre? Çfarë duan ata të ndryshojnë?
- Çfarë mendojnë prindërit/kujdestarët në lidhje me pasojat e sjelljes së tyre te fëmijët?
- Çfarë duhet ndryshuar nëse prindërit/kujdestarët arrijnë që të plotësojnë nevojat e fëmijës?
- Cilët janë treguesit që prindërit/kujdestarët kanë aftësi dhe motivi për të bërë ndryshimet e kërkuara për të arritur mirëqënien e fëmijës?

Prindërit/kujdestarët mund të jenë të zhgënjyer apo të nervozuar gjatë investigimit dhe kjo nuk duhet interpretuar patjetër si një provë që ata nuk janë të motivuar apo nuk do të bashkëpunojnë. Disa prindër mund të jenë të pamotivuar në fillim për të marrë pjesë në planin e mbrojtjes por gjatë angazhimit në veprime të caktuara mund të gjejnë

motivim për të ndryshuar sjelljen ndaj fëmijës, psh. Prindit mund t'i kërkohet të ndjekë një kurs prindërimi dhe ata shkojnë aty por nuk janë të motivuar për të ndryshuar. Gjatë ndjekjes së këtij kursi ai/ajo ata mësojnë nga kjo eksperiencë dhe ndryshojnë sjelljen e tyre ndaj fëmijës.

Rishikimi i Planit Individual të Mbrojtjes në shumicën e praktikave të shërbimeve të mbrojtjes bëhet çdo 3 muaj. Ky afat përcaktohet dhe nga Protokolli i Punës së Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve miratuar nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Afati i rishikimit përcaktohet në aktet nënligjore për mbrojtjen e fëmijëve.

Plani Individual i Mbrojtjes duhet rishikuar veçanërisht kur:
- Situata e fëmijës ose familjes ndryshon në mënyrë dramatike
- Rritet rreziku i fëmijës
- Fëmija ose familja nuk bashkëpunon sipas planit individual të mbrojtjes
- Fëmija ka kaluar 1 vit në Mbrojtje

Kohëzgjatja e Planit Individual të Mbrojtjes
Plani Individual i Mbrojtjes nuk zgjat më shumë se dy vjet në praktikat e PMF-së. Kohëzgjatja e planit varet nga arritja e qëllimit për mbrojtjen e fëmijës dhe mirëqënien e tij/saj. Nëse në fund të kësaj kohe nuk ka asnjë rezultat dhe fëmija vazhdon të jetë në rrezik atëherë rasti mund të shkojë në gjykatë për një vendim tjetër.

Kriteret për vlerësimin e Planit Individual të Mbrojtjes janë:
- I gatshëm menjëherë-mund të fillojë zbatimi menjëherë dhe të arrijë sigurinë e fëmijës
- I orientuar nga veprimet-shërbimet janë active dhe të fokusuara te faktorët që sjellin siguri për fëmijën dhe jo ndryshim (ndryshimi synohet nëpërmjet Planit për Rastin)
- Krijon qasje- shërbimet janë afër zonës ku banon familja, në rast se telefonohen duhet të vijnë menjëherë
- Sjell efekt të menjëhershëm-shërbimet veprojnë menjëherë për të mbajtur fëmijën të sigurt
- Nuk bazohet vetëm te premtimet-nuk ka pritshmëri që fëmija do të jetë i sigurt sepse prindërit premtojnë që do ta mbrojnë fëmijën (prindi joabuzues) dhe/ose nuk do të sillen në mënyrën e gabuar (prindi abuzues).

Roli i punonjësit të PMF-së në takimet për mbrojtjen e fëmijës është shumë i rëndësishëm. Ai është përgjegjës për:
- Përcaktimin e takimeve për mbrojtjen me frekuencën e nevojshme
- Hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes në bashkëpunim me pjesëmarrësit e takimit të mbrojtjes dhe shpërndarjen e tij.
- Mbajtjen e shënimeve në rastet e kundërshtimeve, sidomos nëse vijnë nga fëmija, prindërit apo pjesëmarrësit e tjerë në takime.
- Sigurimin e një historie të plotë të familjes (përfshirë informacionin e nevojshëm të marrë nga institucione të tjera, p.sh. Ministria e Drejtësisë, policia, etj.)

- Bashkërendimin e veprimeve të të gjithë aktorëve dhe shërbimeve për të realizuar Planin Individual të Mbrojtjes.
- Takimet me fëmijën çdo 10 ditë pune, nëse është e mundur takime vetëm me fëmijën, çdo 6 javë fëmija duhet takuar në mjedisin e shtëpisë.

Mbajtja e shënimeve

Shënimet janë shumë të rëndësishme në aspektin e zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes. Çështjet që duhen mbajtur shënim pas kontaktit me fëmijën dhe familjen janë:

- Data dhe ora e cdo vizite/kontakti me familjen, cilët ishin prezent në takim
- Konfirmimi që punonjësi i PMF-së e pa dhe e kontaktoi fëmijën, ose nëse jo pse
- Cdo informacion që u mblodh ose u vëzhgua gjatë vizitës dhe që është i rëndësishëm në aspektin e faktorëve të rrezikut të identifikuar për fëmijën
- Informacion specifik për kujdesin bazë për fëmijën, shëndetin, arsimin dhe nevojat mjekësore
- Informacion i saktë bazuar në fakte për fëmijën dhe sjelljen e tij/saj
- Çdo incident apo lëndim i ri i fëmijës
- Çdo refuzim për ta takuar fëmijën, duhet rregjistruar si shkelje e Planit Individual të Mbrojtjes dhe duhet raportuar te Mbikqyrësi nga punonjësi i PMF-së.

Çështje specifike të praktikës gjatë zbatimit të Planit Individual të Mbrojtjes

Humbja ose vdekja e një fëmije, subjekt i Planit Individual të Mbrojtjes

Fëmijët që janë subjekte të Planeve Individuale të Mbrojtjes janë nën mbrojtjen e shtetit dhe nëse ndodhin raste të humbjes apo vdekjes së fëmijëve në këto raste, punonjësi i PMF-së duhet të vërë në dijeni menjëherë mbikqyrësin dhe drejtuesin/manaxherin e institucionit. Më pas duhet të ndërmerret një investigim i hollësishëm për vdekjen e fëmijës. Mbikqyrësi i NjMF-së duhet të sigurojë gjithë mbështetjen emocionale për personelin e përfshirë.

Sesioni 5.4: Procedurat miqësore me fëmijët

Objektivi: Të ndahen dhe analizohen përvoja të suksesshme nga bashkitë për të nxjerrë mësime dhe për të përshtatur praktika efektive në nivel vendor.

Tematika:

1. Prezantimi i rasteve studimore të suksesshme nga bashkitë që kanë arritur rezultate konkrete në zbatimin e strategjive dhe planeve, analiza e faktorëve që kanë ndikuar në suksesin e këtyre rasteve;
2. Roli i nismave qytetare në përmirësimin e shërbimeve dhe llogaridhënies vendore;
3. Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve vendore dhe komunitetit në zhvillimin e projekteve;
4. Mënyrat për promovimin dhe përhapjen e praktikave të mira në komunitete të ndryshme;
5. Diskutim dhe reflektim mbi mundësitë e përshtatjes së praktikave të mira në kontekstin vendor të pjesëmarrësve.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Procedurat miqësore me fëmijët janë ato procedura që kryhen prej profesionistëve gjatë procesit të mbrojtjes së fëmijëve të cilat mbajnë parasysh moshën, aspektet e zhvillimit, sigurinë e fëmijës dhe nevojat e vecanta të fëmijës.

Qëllimi i procedurave miqësore me fëmijën është të:

- Garantojnë sigurinë e fëmijës
- Ulin dhimbjen e fëmijës gjatë procesit
- Ulin frikën e fëmijës nga procedura të caktuara
- Rrisin bashkëpunimin fëmijë-profesionist

Qasja e procedurave miqësore me fëmijët

Kjo qasje bazohet në nevojën për të mosviktimizuar përsëri fëmijën e abuzuar gjatë procesit të mbrojtjes. Fëmija gjatë procesit të mbrojtjes kalon në shumë procedura që mund të jenë të frikshme, ankthioze, apo të turpshme për të të tilla si: vizita mjekësore, intervista, investigimi, etj. Koncepti i procedurave miqësore me fëmijët erdhi nga një prokuror Bud Cramer, i cili i krijoi gjatë intervistimit të fëmijëve të abuzuar seksualisht me qëllimin procedimin e suksesshëm të abuzuesve seksualë, por ai dëshironte gjithashtu të krijonte mjedis sa më njerëzor për fëmijët që i nënshtroheshin intervistave dhe hetimeve në rajonet e policisë. Tashmë kjo është një qasje që përfshin standarde të përcaktuara qartë për të realizuar procedura miqësore për fëmijët në procesin e mbrojtjes, të cilat janë:

- Grupet shumëdisiplinore të keqtrajtimit të fëmijëve
- Kompetencat kulturore dhe diversiteti
- Intervistat nga profesionistë të Shëndetit Mendor
- Mbështetje dhe avokaci për viktimat
- Vlerësim mjekësor
- Vlerësim i shëndetit mendor dhe trajtime të nevojshme

- Rishikim i rastit
- Ndjekja e rastit
- Kapaciteti organizativ
- Mjedise të fokusuara te fëmijët

Standardet reflektojnë qëllimin e pasjes së shërbimeve miqësore me fëmijët në një mjedis të vetëm ku mjedisi “punon mirë” për fëmijët dhe ku fëmijët nuk ndjehen të frikësuar.

Intervistimi i një fëmije të abuzuar ka disa elementë të rëndësishëm që përbëjnë procedura miqësore për fëmijët të cilat janë: mjedisi, punonjësi i PMF-së, përmbajtja e intervistës, koha e kryerjes së intervistës.

Mjedisi duhet të jetë një dhomë e rehatshme që siguron ndjenjën e privatësisë për fëmijën dhe përmbush nevojat e fëmijës duke e bërë fëmijën të ndihet fizikisht dhe psikologjikisht të sigurt gjatë intervistës.

- Dhoma e intervistës mund të jetë një dhomë me pasqyrë me një-drejtim që krijon mundësinë që intervistën ta ndjekin edhe profesionistë të tjerë, shpesh përfaqësues të sistemit të drejtësisë.
- Dhoma duhet të jetë e pajisur me objekte dhe mjete me të cilat fëmija mund të luajë gjatë pritjes për të bërë intervistën, të tilla si: lodra, libra, revista, lapsa, etj. Në mjediset e kryerjes së intervistës nuk duhet të ketë materiale informuese apo edukative për dhunën apo abuzimin.
- Dhoma duhet të sigurojë intimitetin gjatë kryerjes së intervistës nëpërmjet zhurmës së mbylljes, gjë që bën që fëmija të ndjehet i sigurt.
- Dhoma duhet të jetë e lyer me ngjyra të buta.
- Dhoma duhet të jetë e mobiluar për të pritur fëmijë të vegjël por edhe fëmijë më të rritur (dy tavolina në përmasa të ndryshme si dhe karriget që i shoqërojnë, një divan ose kolltuk, tapet i butë, etj).
- Dhoma duhet të jetë e pajisur me objekte ndihmuese për të marrë informacionin e nevojshëm (lapsa me ngjyrë, letër, kukulla) të cilat nuk janë menjëherë të gatshme për t’u marrë nga fëmija si dhe disa lodra (pak) të cilat mund të merren lehtë nga fëmija.

Intervistimi dhe procedurat miqësore me fëmijët

Punonjësit e PMF-së ose profesionistë të tjerë që janë caktuar të zhvillojnë intervistën me fëmijën janë një element i rëndësishëm në krijimin e sigurisë së fëmijës.

- Punonjësit duhet të jenë në përgjithësi vetëm gjatë kryerjes së intervistës, profesionistë të tjerë mund ta ndjekin intervistën në dhomën tjetër pranë dhomës së intervistës nëpërmjet pasqyrës me një drejtim. Shumë persona e frikësojnë fëmijën, për këtë është praktikë e mirë që intervista të kryhet nga një profesionist.
- Punonjësi i PMF-së duhet të komunikojë në mënyrë të ngrohtë me fëmijën, të jetë i veshur në mënyrë etike dhe të tregojë respekt për fëmijën dhe familjen e tij.

Përmbajtja e intervistës është e rëndësishme për informacionin e nevojshëm që duhet jo vetëm për të kuptuar çfarë ka ndodhur, për të proceduar abuzuesin por edhe për trajtimin e mëvonshëm të fëmijës. Intervista e fëmijëve të abuzuar janë protokolle të hartuara në mënyrë specifike për llojet e ndryshme të abuzimit dhe në këtë mënyrë garantohet besueshmëria e informacionit, sasia dhe cilësia e informacionit. Gjuha e përdorur, renditja e pyetjeve kanë rëndësi për të siguruar pjesëmarrejen e fëmijës në procesin e intervistimit.

Koha e kryerjes së intervistës varet nga mosha, aspektet e zhvillimit të fëmijës, lloji i abuzimit dhe nevojat e veçanta të fëmijës. Intervista me fëmijët e abuzuar nuk duhet të jetë shumë e gjatë, në disa praktika ky protokoll zgjat deri në 45 minuta. Intervista nuk duhet të përsëritet disa herë sepse e riviktimizon fëmijën, në disa studime theksohet se në rastin e abuzimit seksual nevojitet përsëritja e intervistës për të verifikuar informacionin e marrë nga intervista e parë.

Procedurat mjekësore janë të nevojshme për të verifikuar nëse një abuzim ka ndodhur dhe fëmijët në përgjithësi kanë frikë nga procedurat mjekësore. Qëllimi i procedurave miqësore me fëmijët është të bëjnë fëmijën dhe familjen të përballojë faktorët stresues në mjediset e kujdesit shëndetësor. Qëllimi i procedurave miqësore në mjekësi është të: lehtësojnë dhimbjet e fëmijëve gjatë ndërhyrjeve mjekësore; ta bëjnë kujdesin shëndetësor më pak kërcënues ndaj fëmijës dhe të ndihmojnë në krijimin e bashkëpunimit të fëmijëve që ndihmon fëmijën të ndjehet i sigurt dhe i mbështetur në mjediset e kujdesit shëndetësor.

Fëmijët si dëshmitarë në gjykatë
Fëmijët përjetojnë frikë, ankth dhe faj që po fajëson abuzuesin (prindin/kujdestarin/të afërmin) gjatë proceseve gjyqësore, gjë që është minimizuar duke zhvilluar procedura miqësore me fëmijët në sistemin ligjor. Këto procedura lidhen me mjedisin e intervistës; personin e autorizuar për të bërë intervistën; personin shoqërues për fëmijën para intervistës, gjatë dhe në fund të intervistës; edukimin e fëmijës për procesin ligjor; burimet e informacionit dhe profesionistët e tjerë të përfshirë në procesin ligjor.

Mjedisi i intervistës duhet të sigurojë regjistrimin e intervistës në mënyrë që intervista të dëgjohet në gjykatë. Mjedisi duhet t'u sigurojë qasje prokurorit apo përfaqësuesit ligjor të të akuzuarit të bëjnë pyetje pa qënë në mjedisin e intervistës nëpërmjet psikologut.
Mjedisi i intervistës që të jetë miqësor me fëmijën duhet të jetë pajisur me:

- Kamera që regjistron intervistën (sjelljet e fëmijës dhe përgjigjet)
- Mikrofon për të regjistruar zërin
- Pajisje përrregjistrimin e intervistës
- Mikrofon në dhomën ngjitur për të komunikuar me psikologun në dhomën e intervistës

Sigurimi i informacionit të nevojshëm gjatë intervistës me fëmijën ndihmon dhënien e asistencës psikologjike, trajtimin, asistencën mjekësore dhe ndihmën ligjore që mund të ketë nevojë fëmija.

Profesionisti i autorizuar për të bërë intervistën duhet të jetë një profesionist shumë i kualifikuar.
Fëmijën gjatë procesit të mbrojtjes në procedurat e intervistimit dhe të dëgjimit në gjykatë duhet ta shoqërojë një profesionist shumë i kualifikuar tek i cili fëmija zhvillon besim.

Procesi ligjor është i panjohur për fëmijën, për këtë arsye fëmija në një proces ligjor duhet të informohet për veprimet që do kryhen, personat që do takojnë, pasojat që do vijnë nga procesi ligjor, etj. Burimet e informacionit duhet të jenë të ndryshme dhe nëse është e mundur që informacione të veçanta të merren nga burime të tjera të shmanget intervista me fëmijën.
Të gjithë profesionistët e përfshirë në sistemin ligjor si: prokurorë, gjyqtarë, përfaqësues ligjore duhet të jenë të kualifikuar për të kuptuar rëndësinë e çështjeve të tilla si: mosha e fëmijës; historia e jetës; gjinia; reagimet e fëmijës ndaj abuzimit.

Standarde që përbëjnë procedura miqësore me fëmijën në sistemin e drejtësisë janë:
- Viktima intervistohet nga një psikolog
- Dëshmia lexohet në gjykatë duke shmangur praninë e fëmijës në seancë
- Fëmija nuk intervistohet më shumë se një herë nëse nuk është e nevojshme

Fëmijët e abuzuar seksualisht
Fëmijët e abuzuar seksualisht përjetojnë shumë vështirësi për të treguar për abuzimin që u ka ndodhur. Atyre iu mungon fjalori për të shprehur atë që ndjejnë dhe mendojnë, ata përjetojnë turp nëse flasin për eksperiencën e tyre ose frikë sepse janë kërcënuar në vazhdimësi nga abuzuesi që mos tregojnë. Në disa raste ata vazhdojnë ta duan abuzuesin dhe nuk tregojnë çfarë ka ndodhur ose mendojnë se asnjë nuk do t'i besojë. Megjithatë fëmijët e abuzuar seksualisht e tregojnë atë që ju ka ndodhur, fëmijët më të vegjël iu tregojnë prindërve joabuzues ndërsa adoleshentët ia tregojnë më shumë bashkëmoshatarëve të tyre. Në mungesë të fakteve për abuzimin seksual, fëmijët janë një burim i vlefshëm për të provuar nëse ka ndodhur abuzimi ose jo. Zbulimi i informacioneve nëpërmjet intervistimit është shumë i rëndësishëm për të dërguar rastin në gjykatë.

Mjediset jo të duhura të përdorura për intervistimin e fëmijëve të abuzuar seksualisht si: rajonet e policisë, mjediset e shërbimeve shëndetësore, gjykata, etj përforcojnë ndjenjën e fajit te fëmijët e abuzuar seksualisht, gjë që i përndjek ata gjatë gjithë kohës dhe i bën të mbyllen dhe të mos marrin pjesë në intervistim. Teknikat e duhura intervistuese bëjnë që fëmija të hapet dhe të dëshmojë abuzimin seksual. Intervistat e përsëritura dhe të pastrukturuara lëndojnë fëmijët gjatë procesit. Strukturimi i intervistave për fëmijët e abuzuar është mjeti për të siguruar besueshmërinë, sasinë dhe cilësinë e informacionit të marrë nga fëmijët. Kujdes i madh duhet treguar gjatë intervistimit sepse fëmijët ndikohen nga punonjësi që bën intervistën. Punonjësit që bëjnë intervistimin e fëmijëve të abuzuar seksualisht janë punonjës të trajnuar në mënyrë të veçantë për të zhvilluar këto

intervista. Protokollet e përdorura për intervistat me fëmijët e abuzuar seksualisht japin informacion të rëndësishëm për ndërhyrjet ligjore apo terapeutike në interesin më të lartë të fëmijës.

Informacioni i marrë nga intervistimi i fëmijëve të abuzuar luan një rol të rëndësishëm në:

- Garantimin e sigurisë së fëmijës
- Ofrimi i ndihmës për fëmijën me qëllim rikuperimin fizik dhe psikologjik
- Zbulimin e krimit me qëllim procedimin penal dhe dënimin e abuzuesit;
- Parandalimi i abuzuesit të abuzojë përsëri.

Fëmijët me nevoja të veçanta/aftësi ndryshe
Këta fëmijë duhet të intervistohen në përputhje me kushtet e tyre fizike, psikologjike dhe mendore. Intervista duhet të përshtatet me nivelin e tyre të zhvillimit dhe pa i bërë fëmijët të ndjehen keq. Punonjësit që do të kryejnë intervistën duhet të kenë dijeni dhe të jenë të përgatitur më parë për nevojat e veçanta të fëmijës.

Teknika të veçanta të cilat ndihmojnë në rritjen e reziliencës së fëmijës dhe në rritjen e pjesëmarrjes së tij në procesin e mbrojtjes janë lojërat dhe arti në grup.
Lojërat janë aktivitete ku fëmijët marrin pjesë dhe komunikojnë me njër-tjetrin. Fëmijët e abuzuar tërhiqen nga aktivitetet me bashkëmoshatarët dhe ndiejnë stres, lojërat i ndihmojnë të relaksohen dhe të hyjnë në komunikim. Gjatë lojës ose pas lojës fëmijët reflektojnë për ndjenjat dhe mendimet e tyre, që ndihmon në përballjen e pasojave nga trauma apo përvojës abuzive. Është e rëndësishme që lojërat të jenë të përshtatura me moshën, aftësitë motorike dhe intelektuale të fëmijës, hapësirën.
Pjesëmarrja e fëmijës në procesin e mbrojtjes është e rëndësishme sepse nëpërmjet pjesëmarrjes fëmija njeh dhe vlerëson aftësinë e tij për t'u përballur me situate të vështira. Rezilienca e fëmijës shfaqet më mirë nëse fëmija merr pjesë në gjithë aktivitetet për mbrojtjen e fëmijës.
Arti në grup është një teknikë që përmirëson pjesëmarrjen e fëmijës dhe veprimin e tyre në grup. Në aktivitetet në grup fëmijët ndihmojnë njëri-tjetrin, kuptojnë dhe pranojnë më mirë kushtet në të cilat ndodhen, ndikohen pozitivisht nga reagimi i të tjerëve.

MODULI 6 ZVOGËLIMI I RREZIKUT NGA FATKEQËSITË

Përmbledhje e modulit:

Ky modul trajton konceptin e kopshtit si një mjedis të sigurt për fëmijët dhe synon të rrisë kapacitetet e pjesëmarrësve në parandalimin, mbrojtjen dhe përballimin e fatkeqësive natyrore në institucionet parashkollore. Moduli I pajis pjesëmarrësit me njohuri dhe aftësi praktike për të kuptuar nocionet bazë mbi fatkeqësitë natyrore, llojet kryesore të tyre dhe ndikimin që ato kanë te fëmijët, në aspektin fizik, emocional dhe psikologjik. Ai gjithashtu fokusohet në kuadrin ligjor që rregullon emergjencat civile në Shqipëri, duke përfshirë Ligjin Nr. 8756 dhe standardet minimale që duhet të përmbushë çdo institucion për të garantuar sigurinë e fëmijëve. Përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse, moduli thekson rëndësinë e përgatitjes së stafit, drejtuesve dhe prindërve për të reaguar në mënyrë të strukturuar ndaj situatave emergjente, si dhe zbatimin të parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës për të siguruar mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve në çdo fazë të menaxhimit të rrezikut.

Qëllimi i modulit:

Ky modul synon të krijojë një qasje të re dhe gjithëpërfshirëse për trajtimin e kopshteve dhe fëmijëve si vende të sigurta, duke i vendosur ata në qendër të vëmendjes dhe duke përmirësuar parandalimin, mbrojtjen dhe përballimin e fatkeqësive natyrore në mjediset arsimore, përmes edukimit teorik dhe praktik të stafit, drejtuesve, prindërve dhe gjithë aktorëve të përfshirë.

Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit aftësohen të:

- Përgatiten teorikisht dhe praktikisht në masën 80% për përballimin e fatkeqësive natyrore, duke reaguar në mënyrë efektive në të gjitha nivelet.
- Zvogëlojnë rreziqet nga fatkeqësitë natyrore në kopshtet dhe institucionet parashkollore me 50%.
- Ndërgjegjësojnë 100% drejtuesit e profilit të lartë për zbatimin e politikave dhe programeve për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore, duke siguruar burime njerëzore dhe financiare për realizimin e tyre.
- Identifikojnë, vlerësojnë dhe monitorojnë 100% rastet e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore, si dhe ndërgjegjësojnë për përmirësimin e sistemeve të paralajmërimit në kohë, përmes sigurimit të infrastrukturës për kopshte të sigurta.
- Ndërgjegjësohen 100% për shpërndarjen e informacionit të marrë gjatë trajnimit mbi rreziqet, në të gjitha nivelet e shoqërisë, me qëllim zvogëlimin e efekteve të fatkeqësive natyrore.
- Hartojnë strategji për përfshirjen e fëmijëve të kopshteve, nxënësve, prindërve dhe stafit akademik e menaxhues të institucioneve arsimore në programet për njohjen dhe përballimin e emergjencave civile.

Grupi i synuar

Pjesëmarrës për këtë modul përfshin drejtues, mësues, prindër, staf mbështetës (si mjekë, psikologë, sanitare, roje etj.) të institucioneve arsimore të çdo niveli dhe orientimi, si dhe specialistë të arsimit pranë njësive të pushtetit vendor.

Sesioni 6.1 Nocionet bazë mbi fatkeqësitë natyrore

Objektivi: Të prezantojë pjesëmarrësit me konceptet bazë mbi fatkeqësitë natyrore, të identifikojë llojet kryesore dhe ndikimin e tyre te fëmijët, si dhe të rrisë ndërgjegjësimin për përgatitjen dhe reagimin e sigurt në institucionet arsimore parashkollore.

Tematika:

1. Nocionet bazë mbi fatkeqësitë natyrore- Prezantimi i koncepteve themelore që lidhen me fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë përkufizimin, shkaqet dhe rëndësinë e njohjes së tyre në kontekstin edukativ.
2. Llojet kryesore të fatkeqësive natyrore- Njohja me format më të zakonshme të fatkeqësive natyrore si tërmetet, përmbytjet dhe zjarret, si dhe analizimi i karakteristikave dhe pasojave të tyre në mjedisin parashkollor.
3. Ndikimi i fatkeqësive natyrore te fëmijët- Trajtimi i efekteve që fatkeqësitë natyrore mund të kenë te fëmijët, duke u fokusuar në ndikimin fizik, emocional dhe psikologjik, si dhe nevojën për mbështetje të specializuar.
4. Parimet e Konventës për të Drejtat e Fëmijës në kontekstin e emergjencave- Zbatimi i parimeve të Konventës për të Drejtat e Fëmijës për të garantuar mbrojtjen, sigurinë dhe mirëqenien e fëmijëve gjatë dhe pas situatave emergjente.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime ne grup (Shtojca nr. 2):**

Diskutimet në grup synojnë t'u mundësojnë pjesëmarrësve të analizojnë në mënyrë kritike situatat e fatkeqësive natyrore, të kuptojnë më thellë faktorët që rrisin rrezikun dhe cenueshmërinë e grupeve të ndryshme të popullsisë dhe të reflektojnë mbi masat praktike që duhen ndërmarrë për parandalim, reagim dhe rikuperim. Përmes shkëmbimit të përvojave dhe perspektivave të ndryshme, pjesëmarrësit zhvillojnë aftësi për të vlerësuar rreziqet në mënyrë të integruar, për të planifikuar ndërhyrje të drejtuara tek fëmijët dhe grupet vulnerabël dhe për të forcuar vendimmarrjen e tyre profesionale në situata komplekse dhe të paparashikueshme.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Fatkeqësitë natyrore janë të paparashikueshme, por përgatitja mund të shpëtojë jetë.
- Fëmijët janë më të ndjeshëm ndaj pasojave të fatkeqësive dhe kërkojnë mbrojtje të veçantë.
- Njohja e rreziqeve dhe reagimi i duhur janë pjesë e sigurisë institucionale.
- Edukimi dhe ndërgjegjësimi janë hapa kyç për ndërtimin e një mjedisi të sigurt për fëmijët.

Kohëzgjatja e sesionit:
Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit
Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: *(materiale, cito dokumentin teorik, udhëzuesin, ligjin, manualin)*

- Materiale të prezantimit në PowerPoint.

Pjesëmarrësit do të pajisen me paketën e modulit bashkë me fletë pune. Nga trajneri do të përdoret gjatë gjithë trajnimit projektor, kompjuter. Aftesimi praktike do të shoqerohet me pamje filmike per te konkretizuar informacionet e marra.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:
Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Ligji nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”
- Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligji nr. 10 237/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” (përkatës për strukturat dhe reagimin)
- Vendimet e Këshillit të Ministrave të lidhura me menaxhimin e emergjencave dhe fatkeqësive (p.sh. VKM për planifikimin e emergjencave në nivel bashkie).
- Strategjia e Mbrojtjes Civile
- Plani Kombëtar i Reagimit ndaj Emergjencave Civile
- Planet Vendore të Mbrojtjes Civile (për bashkitë përkatëse të pjesëmarrësve)
- Guidat kombëtare për procedurat e mbrojtjes së fëmijëve
- Manuali i Menaxhimit të Rasteve të fëmijëve në situata emergjente (nëse ekziston në institucionin që organizon trajnimin)
- Kuadri Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë (2015–2030)
- Udhëzues për vlerësimin e rrezikut në nivel komuniteti
- Dokumentet e Bashkive për identifikimin e zonave të rrezikut (përmbytje, rrëshqitje toke, zjarre etj.)
- Harta të rrezikut nga institucionet përgjegjëse (AKMC, IGJEUM, bashkitë)

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndaheN: Projektor, Laptop, Flipchart, marker.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
"Fatkeqësi"
Kuptohet një ngjarje, pasojat e së cilës janë shkaktuar nga forca natyrore të pakontrolluara ose nga arsye të tjera, të cilat kërcënojnë ose dëmtojnë jetën dhe shëndetin e popullatës, të gjësë së gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin, në një masë të tillë, që kërkojnë marrjen e masave të veçanta dhe përdorimin e burimeve të veçanta njerëzore e materiale-teknike.
Fatkeqësi Natyrore
Kuptohen tërmetet, përmbytjet, thatësirat atmosferike të tejzgjatura, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta, zjarret në pyje dhe në mjediset e banuara,

sëmundjet infektive masive etj. Ato përfshijnë humbje jetësh njerëzore, infrastrukture dhe pronash të tjera, dhe ndikojnë në mirëqenien e njerëzve, sigurinë e tyre, shëndetin dhe mjetet e jetesës.

Vlerësim i riskut

Kuptohet analiza sasiore e cilësore e natyrës dhe e rrethanave të tjera, për ndodhinë e pritshme nga fatkeqësia natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.

Reduktimi/zvogëlimi i rrezikut nga fatkeqësitë natyrore përkufizohet si koncept dhe praktikë e zvogëlimit të rreziqeve nëpërmjet përpjekjeve sistematike për të analizuar dhe menaxhuar faktorët që shkaktojnë fatkeqësitë natyrore, duke përfshirë:

- zvogëlimin e ekspozimit në drejtim të rreziqeve
- minimizimin e cenueshmërisë
- menaxhimin e zgjuar të tokës dhe të mjedisit
- përmirësimin e përgatitjes për ngjarje të padëshiruara
- Rreziqet nga fatkeqësitë natyrore mund të zvogëlohen në mënyrë domethënëse nëpërmjet strategjive që minimizojnë nivelin e prekshmërisë dhe ekspozimit ndaj tyre.
- Reagimet humanitare ndaj fatkeqësive natyrore hartohen dhe zbatohen në mënyra që mbrojnë të drejtat e njerëzve të prekur për të jetuar, sidomos të fëmijëve dhe adoleshentëve dhe të drejtat e tjera afatshkurtra dhe afatgjata.
- Humanitarizmi është ndjenjë, përgjegjësi, qëndrim apo vlerë qytetare dhe sociale, e cila zhvillon tek njerëzit kapacitetet reaguese ndaj grupeve të ndryshme të popullsisë, të cilat janë të rrezikuara në momente të caktuara kohore.

Rikuperimi/ripërtëritja i referohet kapacitetit të një individi, apo grupi për të parandaluar, absorbuar dhe rikuperuar nga rreziqet ose efektet e ndryshimeve klimatike, goditjeve të tjera dhe stresit, pa kompromentuar perspektivat afatgjata.

Faktorët që ndikojnë:

- Politikë: lidershipi, pjesëmarrja, përfaqësimi
- Institucionalë: burimet, planifikimi, përgjegjësia, reagimi, sundimi i ligjit
- Kulturorë: transferimi i njohurive, sistemet e besimit, traditat

Faktorë të tjerë:

- Fizikë: strukturat, furnizimi me ujë, higjena
- Ekonomikë: siguria e të ardhurave, aksesi në tregje dhe punësimi, diversiteti dhe fleksibiliteti i mjeteve të jetesës, shërbimet financiare, mbajtja e tokës
- Socialë: komunikimi, rrjetet mbështetëse, organizimi, përfshirja, zgjidhja e konflikteve
- Humanë: siguria ushqimore, shëndeti, edukimi/arsimimi
- Mjedisorë: përdorimi i tokës, aksesi në burimet natyrore, qëndrueshmëria (zhvillimi i qëndrueshëm)
- Grupet që preken nga fatkeqësitë natyrore
- Fëmijët:

- Fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur. Atyre duhet t'ju sigurohen të gjitha të drejtat, përshirë edhe e drejta për arsim edhe në situata të fatkeqësive natyrore.
- Fëmijët kanë kapacitetin të luajnë rolin e tyre në reduktimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike në familje, shkolla, komunitetin ku ata banojnë.

Gratë:
Gratë evakuohen më me vështirësi në nje rast fatkeqësie në raport me meshkujt
Njerëz me aftësi të kufizuara:

- Aftësitë e kufizuara janë dëmtime fizike ose mendore që kufizojnë aftësinë njohëse, mobilitetin dhe aktivitetin e një individi.
- Njerëzit me aftësi njohëse të kufizuara janë në mënyrë të veçantë të prekshëm ndaj rreziqeve të shpejta në kohë; ata mund të mos kuptojnë një alarm dhe nuk reagojnë në kohë për t'u evakuuar.
- Të moshuarit:
- Të moshuarit karakterizohen nga pakësimi i lëvizjes dhe fuqia e muskujve, kufizime të cilat mund t'i privojnë ata nga përgatitja për rreziqet dhe nga mundësia për t'u evakuuar.
- Të moshuarit me shëndet të dobët janë më të prekshëm ndaj sëmundjeve, si malaria, kolera, që përhapen pas fatkeqësive natyrore dhe parashikohet të përhapen më shumë si pasojë e ndryshimeve klimatike.
- Të moshuarit luajnë rol kyç në kujdesin ndaj fëmijëve duke ju lejuar brezave të rinj të investojnë kohë dhe energji në reduktimin e rrezikut apo në përshtatjen e strategjive për t'u mbrojtur ndaj fatkeqësive natyrore

Sesioni 6.2 Kuadri ligjor

Objektivi: Të prezantojë pjesëmarrësit me bazën ligjore që rregullon emergjencat civile në Shqipëri, të rritë ndërgjegjësimin mbi detyrimet ligjore për sigurinë e fëmijëve në institucionet parashkollore dhe të nxisë kuptimin e standardeve minimale për krijimin e një mjedisi të sigurt për ta.

Tematika:

1. Edukimi dhe orientimi në kontekstin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe ndryshimet klimatike. Kjo tematikë synon të zhvillojë njohuritë dhe aftësitë e drejtuesve, stafit akademik, mbështetës dhe prindërve për të kuptuar dhe menaxhuar rreziqet që lidhen me fatkeqësitë natyrore dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike në institucionet arsimore.
2. Baza ligjore për emergjencat civile në institucionet arsimore-.Fokusimi është në njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor që rregullon menaxhimin e emergjencave civile në Shqipëri, me theks të veçantë në Ligjin Nr. 8756 dhe aplikimin e tij në kontekstin e kopshteve dhe shkollave.

- Standardet minimale për sigurinë në institucionet arsimore parashkollore. Kjo tematikë trajton kriteret bazë që duhet të përmbushë çdo institucion arsimor për të garantuar një mjedis të sigurt për fëmijët, duke përfshirë aspektet e infrastrukturës, logjistikës dhe përgatitjes së stafit.

Rezultatet e të nxënit të sesionit:

- Pjesëmarrësit do të identifikojnë aktet ligjore kryesore që lidhen me emergjencat civile (p.sh. Ligji Nr. 8756/2001).
- Do të kuptojnë konceptet bazë të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile në kontekstin e arsimit parashkollor.
- Do të analizojnë standardet për kopshtet e sigurta dhe rolin e tyre në mbrojtjen e fëmijëve.
- Do të reflektojnë mbi detyrimet institucionale për të garantuar sigurinë e fëmijëve në rast emergjencash.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime ne grup (Shtojca nr. 2)**

Pyetjet për diskutim në këtë sesion synojnë të nxisin pjesëmarrësit të reflektojnë mbi mënyrën se si kuadri ligjor dhe institucionet përgjegjëse për emergjencat civile funksionojnë në praktikë, duke lidhur detyrimet ligjore me përvojat e tyre të drejtpërdrejta. Qëllimi është që pjesëmarrësit të kuptojnë më qartë rolin e ligjeve, vendimeve dhe udhëzimeve në parandalimin, përgatitjen dhe reagimin ndaj emergjencave, si dhe bashkërendimin mes niveleve qendrore dhe vendore. Këto

pyetje u ndihmojnë të identifikojnë mangësitë, sfidat dhe mundësitë për përmirësim në zbatimin e detyrave ligjore, duke forcuar aftësinë e tyre për të vlerësuar riskun, për të reaguar në mënyrë të bashkërenduar dhe për të kontribuar më efektivisht në sistemin kombëtar të emergjencave civile.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Kuadri ligjor është themeli për ndërtimin e një sistemi të sigurt për fëmijët në institucionet arsimore.
- Një kopsht i sigurt nuk është vetëm fizikisht i mbrojtur, por edhe i përgatitur për të përballuar emergjenca.
- Standardet e sigurisë duhet të jenë të zbatueshme dhe të monitorueshme në çdo institucion.
- Fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur në çdo situatë, sipas Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- **Ligji nr. 8756/2001 "Për Emergjencat Civile" (i ndryshuar)**
- **VKM nr. 531/2003** – Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit të Emergjencave Civile
- **VKM nr. 533/2003** – Pjesëmarrja e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave
- **VKM nr. 664/2002** – Kriteret dhe procedurat për shpalljen e emergjencës civile
- **VKM nr. 655/2002** – Struktura e sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të EC
- **Udhezimi nr. 15/2003** – Ngritja e komisionit vendor të EC në bashki
- **Udhezimi nr. 16/2003** – Komisioni i planifikimit të EC në nivel qarku

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të shpërndahet: Projektor, Laptop, Flipchart, Lidhje me internetin, marker.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Ky sesion trajnimor synon të prezantojë pjesëmarrësit me bazën ligjore që rregullon menaxhimin e emergjencave civile në Shqipëri, me fokus të veçantë tek institucionet arsimore parashkollore. Objektivat kryesore janë: rritja e ndërgjegjësimit mbi detyrimet

ligjore për sigurinë e fëmijëve në kopshtet dhe shkollat, kuptimi i standardeve minimale për një mjedis të sigurt dhe aftësimi për të reflektuar mbi rolin institucional në rast emergjencash.
Kuadri ligjor bazë për menaxhimin e emergjencave civile përcaktohet nga Ligji Nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, i cili ka si qëllim parandalimin, pakësimin dhe riaftësimin nga dëmet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore, aksidentet industriale, epidemitë apo ngjarje të tjera që rrezikojnë jetën dhe pronën. Ky ligj përkufizon nocionet kryesore si “emergjencë civile” dhe “fatkeqësi natyrore” dhe përcakton detyrimet e institucioneve për të siguruar kushte të përshtatshme për kalimin nga gjendja normale në gjendje emergjente me humbje minimale. Përveç ligjit, Plani Kombëtar për Emergjencat Civile përcakton fazat e menaxhimit (parandalim, gatishmëri, reagim, riaftësim) dhe bashkërendimin ndërinstitucional.
Institucionet arsimore, përfshirë ato parashkollore, kanë detyrime specifike ligjore për hartimin e planeve të emergjencës, sigurimin e infrastrukturës së përshtatshme (dalje emergjente, sinjalistikë, pajisje kundër zjarrit), trajnimin e stafit për reagim ndaj emergjencave dhe informimin e prindërve e fëmijëve mbi masat e sigurisë. Gjithashtu, standardet për një mjedis të sigurt në kopshtet përfshijnë: hapësira të sigurta, pajisje kundër zjarrit, protokolle higjiene dhe shëndeti, si dhe kapacitetin e stafit për menaxhimin e situatave të rrezikut. Këto standarde janë minimale dhe duhet të përmbushen nga çdo institucion arsimor për t’u konsideruar një mjedis i sigurt për fëmijët.
Në përfundim, kuadri ligjor kërkon që çdo institucion arsimor të zbatojë masat e përcaktuara për sigurinë e fëmijëve, duke integruar teorinë me praktikat e menaxhimit të emergjencave. Trajnimi i stafit, ndërgjegjësimi i prindërve dhe zbatimi i standardeve janë elemente kyç për mbrojtjen e fëmijëve në rast fatkeqësish natyrore apo emergjencash civile.

Kuadri ligjor për menaxhimin e emergjencave civile në Shqipëri bazohet kryesisht në Ligjin Nr. 8756, datë 26.03.2001 “Për Emergjencat Civile”, i ndryshuar, i cili përcakton parimet, detyrimet dhe strukturat përgjegjëse për parandalimin, përballimin dhe riaftësimin nga fatkeqësitë natyrore dhe situatat e rrezikut. Ky ligj plotësohet nga një sërë vendimesh të Këshillit të Ministrave, si Vendimi Nr. 206, datë 26.03.1998 për kriteret e pjesëmarrjes së shtetit në përballimin e dëmeve, Vendimi Nr. 654 dhe Nr. 655, datë 18.12.2002 për përdorimin e mjeteve private në situata emergjente dhe ngritjen e strukturës së sistemit kombëtar të planifikimit, si dhe vendimet Nr. 663 dhe Nr. 664 për funksionimin e komisioneve teknike dhe procedurat e shpalljes së gjendjes së emergjencës civile. Gjithashtu, vendimet Nr. 531, 532 dhe 533 të datës 01.08.2003 përcaktojnë organizimin, detyrat dhe përgjegjësitë e shërbimit të emergjencave civile, departamentit për planifikim dhe përballim, si dhe pjesëmarrjen e shtetasve në parandalim. Udhëzimet Nr. 3, 15 dhe 16 të vitit 2003 rregullojnë kriteret e përzgjedhjes së personelit dhe ngritjen e komisioneve vendore dhe të planifikimit në nivel qarku. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij kuadri janë Këshilli i Ministrave, Komiteti Ndërministror i Emergjencave Civile, Ministria e Punëve të Brendshme përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile dhe PMNZSH-së, si dhe strukturat vendore si komitetet e planifikimit, komisionet vendore në bashki dhe kryeplaku në

njësitë administrative. Ky sistem i integruar synon të garantojë reagim të shpejtë, bashkërendim efektiv dhe mbrojtje të jetës e pronës në çdo situatë emergjente.

Sesioni 6.3 Koncepte të emergjencave civile

Objektivi: Të prezantojë pjesëmarrësit me konceptet bazë të emergjencave civile në arsimin parashkollor, duke rritur kuptimin mbi rolin e institucioneve arsimore në menaxhimin e tyre dhe rëndësinë e përgatitjes së stafit dhe fëmijëve për situata të papritura.

Tematika:

1. Nocionet bazë të emergjencave civile në institucionet arsimore- Pjesëmarrësit njihen me natyrën dhe karakteristikat e emergjencave civile, si dhe me llojet më të zakonshme që mund të ndodhin në mjediset e kopshteve dhe shkollave.
2. Kuadri ligjor për menaxhimin e emergjencave civile- Diskutim mbi bazën ligjore që rregullon reagimin ndaj emergjencave civile në Shqipëri, me fokus në zbatimin e saj në institucionet arsimore për garantimin e sigurisë së fëmijëve.
3. Rëndësia e përgatitjes së stafit dhe fëmijëve për situata emergjente- Reflektim mbi rolin e edukimit, planifikimit dhe reagimit të strukturuar për përballimin efektiv të situatave të papritura në mjediset arsimore.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Shërbime të Emergjencave Civile

- Emergjencë Civile

Një situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste, veprime ushtarake (në gjendje lufte), të cilat sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën, për shëndetin e popullatës dhe të gjësë së gjallë, për pasurinë, për trashëgiminë kulturore dhe për mjedisin

- Shërbim i Emergjencave Civile

Shërbimi i bashkërenduar i Policisë së Shtetit dhe të gjitha policive të tjera, shërbimi i shpëtimit dhe i mbrojtjes nga zjarri dhe i urgjencës mjekësore.

- Gatishmëri

Tërësia e masave të marra paraprakisht që bëjnë të mundur reagimin në kohë të forcave dhe mjeteve në rastet e EC.

- "Parashikim" kuptohen veprimtaritë që kryen për studimin dhe përcaktimin e shkaqeve të emergjencave, për përcaktimin e zonave, të territoreve dhe objekteve nga rreziqet e njëjta.
- "Parandalim" kuptohet një kuadër masash që merren para ndodhjes së një ngjarjeje për shmangien ose për zvogëlimin e dëmeve që mund të vijnë nga ngjarja.
- Masa mbrojtëse

Kuptohen masat organizative, teknike dhe çdo masë tjetër për mbrojtjen e menjëhershme individuale dhe kolektive të njerëzve, gjësë së gjallë, pasurisë, institucioneve, trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, kundër pasojave të fatkeqësive natyrore ose fatkeqësive të tjera.

- Tërësi masash për përballimin e EC-ve

Kuptohet përgatitja e autoriteteve publike, e institucioneve dhe organeve të qeverisjes qëndrore e vendore, e personave juridikë, publikë ose privatë, e organizatave publike

dhe e popullatës për një emergjencë civile, si dhe për rastet e një fatkeqësie natyrore, duke përcaktuar marrjen e masave për parandalimin dhe për riaftësimin e gjendjes së shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente.

- "Rrezik" kuptohet një gjendje serioze, reale dhe e menjëhershme, që kanos jetën e njerëzve, të gjësë së gjallë, dëmtimin e pronës publike, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit, që mund të shkaktohet nga fatkeqësitë natyrore ose nga fatkeqësitë e tjera.
- "Riaftësim" kuptohen masat dhe veprimet që kryhen për rikthimin në gjendjen e mëparshme të rajonit (territorit) të prekur nga fatkeqësia.

Shërbimet e emergjencave civile përbëjnë një sistem të integruar veprimesh dhe strukturash që synojnë mbrojtjen e jetës, shëndetit, pronës dhe mjedisit në rast situatash të rrezikshme. Një emergjencë civile është çdo situatë e shkaktuar nga faktorë natyrorë, ekologjikë, industrialë, socialë, veprime terroriste apo ushtarake, që sjell dëme të menjëhershme dhe të rënda për popullatën, gjënë e gjallë, pasurinë, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. Për përballimin e këtyre situatave, funksionon Shërbimi i Emergjencave Civile, i cili është një bashkërendim i Policisë së Shtetit, shërbimeve të shpëtimit, mbrojtjes nga zjarri dhe urgjencës mjekësore. Ky sistem mbështetet në disa faza kyç: gatishmëria, që përfshin masat e marra paraprakisht për të siguruar reagim të shpejtë; parashikimi, që lidhet me studimin e shkaqeve dhe identifikimin e zonave të rrezikuara; dhe parandalimi, që konsiston në masat për shmangien ose zvogëlimin e dëmeve para ndodhjes së ngjarjes. Në rast rreziku, zbatohen masa mbrojtëse, të cilat janë veprime organizative, teknike dhe praktike për mbrojtjen e menjëhershme të njerëzve, pasurisë dhe mjedisit. Përveç këtyre, përballimi i emergjencave kërkon një tërësi masash që përfshijnë përgatitjen e autoriteteve publike, institucioneve, sektorit privat dhe popullatës për reagim dhe riaftësim pas fatkeqësisë. Një element i rëndësishëm është kuptimi i konceptit të rrezikut, që nënkupton një gjendje serioze dhe të menjëhershme që kanos jetën dhe pronën, si dhe faza e riaftësimit, e cila përfshin masat për rikthimin e rajonit të prekur në gjendjen e mëparshme. Ky sistem i organizuar garanton që çdo institucion dhe individ të ketë rolin e vet në parandalimin, përballimin dhe rikuperimin nga situatat emergjente.

Sesioni 6.4 Kopshte të sigurta

Objektivi: Të prezantojë konceptin e kopshtit si një mjedis të sigurt për fëmijët, duke identifikuar standardet bazë të sigurisë dhe duke nxitur reflektimin mbi rolin e stafit dhe infrastrukturës në garantimin e mbrojtjes së tyre.

Tematika:

1. Kopshti si një mjedis i sigurt për fëmijët- Diskutim mbi konceptin e sigurisë në institucionet arsimore parashkollore, me fokus në parandalimin, mbrojtjen dhe përballimin e situatave të rrezikshme.
2. Standardet bazë të sigurisë në institucionet arsimore- Analizë e elementeve që përbëjnë një mjedis të sigurt, si infrastruktura e përshtatshme, pajisjet mbrojtëse, përgatitja e stafit dhe protokollet e reagimit.
3. Kuadri ligjor dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës- Lidhja e sigurisë institucionale me dispozitat ligjore dhe parimet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve, duke theksuar rëndësinë e një qasjeje gjithëpërfshirëse.

Rezultatet e të nxënit:

- Pjesëmarrësit do të kuptojnë përbërësit kryesorë të një kopshti të sigurt (infrastrukturë, logjistikë, staf, protokolle).
- Do të analizojnë standardet ligjore dhe praktike që lidhen me sigurinë në institucionet arsimore.
- Do të reflektojnë mbi rëndësinë e përgatitjes së stafit për të reaguar në situata emergjente.
- Do të lidhin konceptin e sigurisë me të drejtat e fëmijës dhe qasjen gjithëpërfshirëse.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime në grup (Shtojca nr. 2)**

Diskutimi në grup mbi konceptin "Kopshte të Sigurta" synon t'i ndihmojë pjesëmarrësit të reflektojnë në mënyrë praktike dhe bashkëpunuese mbi të gjitha elementet që e bëjnë një institucion parashkollor të sigurt, të shëndetshëm dhe të përgatitur për emergjenca. Përmes pyetjeve dhe shkëmbimit të përvojave, pjesëmarrësit kuptojnë rëndësinë e standardeve të ndërtimit, gatishmërinë e stafit, bashkërendimin me strukturat e emergjencave civile, si dhe rolin që luajnë higjiena, infrastruktura, uji i sigurt dhe mjedisi mbrojtës në parandalimin e rreziqeve. Këto diskutime synojnë të rrisin ndërgjegjësimin, të identifikojnë mangësitë ekzistuese dhe të nxisin ide konkrete për përmirësimin e sigurisë në kopshtet e tyre, duke krijuar një kulturë më të fortë të mbrojtjes së fëmijëve dhe menaxhimit të situatave emergjente.

- Diskutim ndërveprues mbi përvojat dhe perceptimet e pjesëmarrësve.
- Ushtrime në grupe për identifikimin e elementëve të sigurisë.
- Analizë e rasteve konkrete dhe reflektim mbi praktikat e mira.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Një kopsht i sigurt është themeli për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijës.
- Siguria nuk është vetëm fizike, por përfshin përgatitjen, reagimin dhe mbrojtjen emocionale.
- Standardet e sigurisë duhet të jenë të zbatueshme dhe të monitorueshme.
- Fëmijët kanë të drejtë të jenë të mbrojtur në çdo moment dhe situatë.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint.

- Dispozitat ligjore për emergjencat civile
- Standardet e infrastrukturës së kopshtit/fëmijët
- Materiale ndergjegjesuese mbi fatkeqesitë natyrore
- Modele për strategjitë e përballimit të fatkeqësive natyrore në kopshte

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. Ligji nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”– Dokumenti kryesor që përcakton parashikimin, parandalimin, gatishmërinë, reagimin dhe riaftësimin ndaj emergjencave civile.
2. Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) që derivojnë nga Ligji 45/2019, si:– Rregulloret për funksionimin e strukturave të mbrojtjes civile në pushtetin vendor.– Procedurat për vlerësimin e rrezikut dhe hartimin e planeve të emergjencave.
3. Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 “Për Emergjencat Civile” (i zëvendësuar pjesërisht nga ligji i ri, por përdoret ende për referencë në disa institucione).
4. Udhëzimet e Ministrisë së Brendshme / Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile – Udhëzime praktike për menaxhimin e rrezikut, gatishmërinë dhe planifikimin e emergjencave.
5. **Kodi i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë** (në aspektin e mbrojtjes së stafit dhe fëmijëve në objekte arsimore).
6. **Ligji për Arsimin Parashkollor**
7. – Pikat që lidhen me sigurinë, higjienën dhe mbrojtjen e fëmijëve në institucionet arsimore.
8. **Rregullorja e Institucioneve Arsimore për Planin e Emergjencave në Institucion**
9. – Dokumenti i brendshëm i çdo institucioni (kopsht), që duhet lexuar nga pjesëmarrësit për të kuptuar detyrimet konkrete.

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të shpërndahet: Projektor, Laptop, Flipchart, marker.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Kopshte te Sigurta

1. Siguria e ndërtesës – Kërkesa për projektim dhe ndërtim të sigurt

Ndërtimi i institucioneve arsimore dhe kujdestare – si shkolla, kopshte, çerdhe apo spitale – duhet të nisë gjithmonë me një planifikim të hollësishëm të elementeve strukturore dhe të sigurisë. Që në fazën e dhënies së lejes së ndërtimit kërkohet kryerja e një **studimi të pozicionit gjeografik dhe gjeologjik të tokës**, për të vlerësuar rrezikun sizmik, përmbytjet, rrëshqitjet dhe stabilitetin e terrenit. Projekti duhet të garantojë **dalje dytësore të sigurta**, **sisteme kundër zjarrit**, **rrufepritëse**, si dhe furnizim të vazhdueshëm me **ujë, energji elektrike dhe sistem ngrohjeje 24-orëshe**. Gjithashtu duhet të parashikohen **sisteme moderne të komunikimit**, hapësira që përmbushin standardet arsimore dhe hapësira të gjelbëruara për zhvillimin fizik e

emocional të fëmijëve. Ndërtesa duhet të jetë e aksesueshme shpejt nga shërbimet e zjarrfikëses, policia dhe Emergjencat Civile, duke garantuar kohë ndërhyrjeje sa më të shkurtër në raste rreziku. Këto masa sigurojnë që objekti të jetë jo vetëm funksional, por edhe i mbrojtur ndaj fatkeqësive natyrore dhe emergjencave njerëzore.

2. Aftësitë dhe përgatitja e personelit edukativ/arsimor dhe nxënësve

Përgatitja e personelit dhe fëmijëve është po aq e rëndësishme sa edhe siguria strukturore. Stafi pedagogjik duhet të ketë njohuri të qarta mbi legjislacionin e emergjencave, protokollet e evakuimit dhe detyrimet e institucionit në situata rreziku. Personeli duhet të zotërojë aftësinë për të përballuar emocionalisht situatat stresuese, të shmangë panikun dhe të udhëheqë fëmijët me qetësi e profesionalizëm. Për këtë arsye rekomandohet që brenda vitit të zhvillohen të paktën dy simulime të emergjencave, të cilat i ndihmojnë fëmijët dhe mësuesit të ushtrojnë reagimin korrekt gjatë tërmeteve, zjarreve apo skenarëve të tjerë emergjentë. Preparimi praktik rrit ndjeshëm sigurinë dhe efektivitetin e reagimit në situata reale.

3. Bashkëveprimi efikas i strukturave të emergjencave civile me institucionet arsimore

Një element kyç i sigurisë në shkolla dhe kopshte është bashkëpunimi i vazhdueshëm me strukturat shtetërore të emergjencave. Ky bashkëveprim përfshin krijimin e urave të qarta të komunikimit, shpërndarjen e kontakteve të menjëhershme për rastet e emergjencave dhe organizimin e takimeve periodike me përfaqësues të zjarrfikëses, policisë dhe Shërbimit të Emergjencave Civile. Ky bashkëpunim ndihmon në trajnimin e vazhdueshëm të mësuesve dhe nxënësve për rrezikjet e ndryshme dhe rrit ndërgjegjësimin për sjellje të sigurta. Gjithashtu, institucionet duhet të kenë në staf psikologë të trajnuar për menaxhimin e emergjencave dhe për ofrimin e mbështetjes emocionale për fëmijët pas situatave stresuese.

4. Burimet financiare – Investime për sigurinë dhe ndërgjegjësimin

Siguria kërkon investim të vazhdueshëm. Çdo institucion duhet të ketë një buxhet të dedikuar për përballimin e emergjencave, modernizimin e pajisjeve të sigurisë, mirëmbajtjen e infrastrukturës dhe trajnimin e stafit. Po aq i rëndësishëm është alokimi i fondeve për fushata ndërgjegjësimi, të cilat synojnë informimin e komunitetit, prindërve dhe fëmijëve për sjellje të sigurta në rast fatkeqësish. Investimi i qëndrueshëm në siguri krijon një mjedis ku rreziku minimizohet dhe reagimi është i organizuar.

5. Kopshtet e sigurta dhe të shëndetshme – Parimet themelore

Kopshtet dhe çerdhet kanë një rol thelbësor në parandalimin e sëmundjeve dhe në nxitjen e zhvillimit të shëndetshëm të fëmijëve. Materiali udhëzues ndahet në tri seksione kryesore: krijimin e një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm, promovimin e sjelljeve të shëndetshme nga edukatorët dhe fëmijët, dhe ofrimin ose lidhjen me shërbime shëndetësore dhe ushqyerjeje. Këto elemente përbëjnë bazën e një institucioni që jo vetëm edukon, por edhe mbron mirëqenien fizike dhe emocionale të fëmijëve.

6. Siguria fizike e fëmijëve në kopsht

Parandalimi i lëndimeve duhet të jetë prioritet. Kompleksi i kopshtit duhet të jetë i rrethuar dhe i mbyllur me portë për të parandaluar që fëmijët të dalin në rrugë apo drejt zonave të rrezikshme. Një i rritur duhet të mbikëqyrë fëmijët gjatë gjithë kohës, veçanërisht gjatë lojës në ambientet e jashtme. Pajisjet duhet të kontrollohen rregullisht për gozhda, pjesë të thyera, objekte të mprehta, mbeturina dhe elementë që mund të dëmtojnë fëmijët. Materialet e rrezikshme – si ilaçe, mjetet e kuzhinës ose vegla të forta – duhet të vendosen jashtë mundësisë së tyre. Përveç kësaj, duhet të zbatohen metoda të disiplinimit pozitiv, me ndalimin e plotë të dhunës fizike dhe verbale. Stafi duhet të jetë i trajnuar për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi dhe të raportojë rastet te strukturat e mbrojtjes së fëmijës.

7. Uji i pijshëm i sigurt dhe roli i higjienës

Fëmijët nën pesë vjeç duhet të konsumojnë vetëm ujë të sigurt. Uji mund të ndotet lehtësisht gjatë mbledhjes dhe ruajtjes, ndaj rekomandohet trajtim i ujit në pikën e përdorimit, qoftë përmes filtrimit, trajtimit kimik ose zierjes. Uji duhet të ruhet në enë të pastra me rubinet, të mbulohet gjithmonë dhe të mos prekët me duar apo gota të zhytura brenda. Sa të jetë e mundur, çdo fëmijë duhet të ketë gotën e vet. Ndërkohë që zierja është efektive, nuk është gjithmonë praktike për sasi të mëdha, ndaj kopshtet duhet të ndjekin rekomandimet e autoriteteve shëndetësore për metodat më të përshtatshme të trajtimit të ujit.

8. Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm të të nxënit

Një mjedis i sigurt përfshin hapësira lojërash të brendshme dhe të jashtme pa rrezik, ujë të trajtuar, pajisje sanitare të sigurta, zona të higjienës së duarve dhe një sistem të organizuar të menaxhimit të mbeturinave. Zona e gatimit duhet të jetë e izoluar nga fëmijët dhe të ndjekë protokollet e sigurisë kundër zjarrit dhe djegieve. Edukatorët duhet t'u mësojnë fëmijëve zakone higjienike, si larja e duarve para ngrënies dhe pas përdorimit të tualetit.

9. Higjiena e mjedisit dhe siguria ushqimore

Klasat dhe korridoret duhet të pastrohen çdo ditë me ujë dhe detergjentë. Dezinfektimi kërkohet vetëm në raste të sëmundjeve specifike. Zona e kuzhinës duhet të jetë e higjienizuar, me personel të trajnuar në pesë parimet e ushqimit të sigurt: larja e duarve, përdorimi i ujit të sigurt, gatimi i plotë i ushqimit, ndarja e ushqimeve të gatuara nga ato të pagatuara dhe shërbimi brenda dy orëve. Këto masa parandalojnë helmimet ushqimore dhe infeksionet gastrointestinale.

10. Tualetet e sigurta dhe miqësore me fëmijët

Institucionet duhet të kenë tualete të pastra dhe të përshtatura për fëmijët. Tualetet mund të jenë me kanalizime standarde ose me gropa, për sa kohë janë të sigurta dhe nuk ndotin mjedisin. Tualetet alternative ekologjike (EcoSan) janë të avantazhuara në zonat me mungesë uji, por kërkojnë dizajn profesional. Për t'i bërë tualetet të arritshme dhe jo frikësuese për fëmijët, duhet të ketë dritë të mjaftueshme, vrima të vogla, doreza për mbajtje dhe akses për fëmijët me aftësi të kufizuara. Një i rritur duhet t'i shoqërojë fëmijët e vegjël derisa ata të fitojnë aftësi të pavarura.

11. Pajisjet për larjen e duarve

Çdo institucion duhet të ketë pajisje për larje duarsh brenda ndërtesës dhe jo më larg se 5 metra nga tualetet. Rubinetat duhet të jenë të vendosur në lartësi për fëmijët, ndërsa uji dhe sapuni duhet të jenë gjithmonë të disponueshëm. Edukatorët duhet të mbikëqyrin larjen e duarve derisa fëmijët të zotërojnë teknikën, ndërsa pajisje të veçanta për të rriturit duhen vendosur për të garantuar higjienën e stafit.

Ndërtesa

Ndërtimit të shkollave, kopshteve, çerdheve, spitaleve etj. duhet t'i paraprihet me një sërë masash që në momentin e dhënies së lejes së ndërtimit për objektin në fjalë.

Studim për pozicionin gjeografik dhe gjeologjik të tokës

Projekti të parashikojë dalje dytësore të sigurta, sistem kundër zjarrit, rrufepritëse, furnizim me ujë, drita dhe ngrohje 24 orë, sistem ndërlidhje bashkëkohor, hapësira sipas standarteve, hapësira të gjelbëruara.

Objekti të jetë i arritshëm në kohë rekord nga forcat e PMNZSH-së, policia e shtetit, forcat e EC etj.

Aftësia e personelit edukativ dhe nxënësve

- Njohja e legjislacionit nga stafi pedagogjik
- Aftësia për përballimin emocional të situatës
- Aftësia për të shmangur panikun
- Improvizimi i rasteve të EC-ve të paktën dy herë në vit

Bashkëveprim efikas i strukturave shtetërore të EC-ve me stafet pedagogjike

- Vendosja e urave të komunikimit
- Venia ne dispozicion e kontakteve të menjëhershme në raste EC-sh
- Takime të vazhdueshme
- Trajnimi i vazhdueshëm i nxënësve dhe mësuesve nga strukturat e EC-ve
- Psikologë të përditësuar me EC-të dhe trajtimin e këtyre rasteve

Burimet financiare

- Buxhet i mjaftueshëm i parashikuar çdo vit për përballimin e EC-ve
- Buxhet i alokuar çdo vit për fushatat e ndërgjegjësimit për përballimin e fatkeqësive

Material per lexim

Kopshte të sigurta dhe të shëndetshme

Kopshtet mund të parandalojnë sëmundjet dhe të inkurajojnë trajtimin e shpejtë të fëmijëve të sëmurë. Ky material është i organizuar në tre seksione, duke u përqendruar në një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm të zhvillimit të fëmijëve të vegjël (të sigurt nga sëmundjet dhe dëmtimet fizike), promovimin e sjelljeve të shëndetshme nga lehtësuesit e institucioneve arsimore parashkollore dhe fëmijët, si dhe shërbimet shëndetësore dhe të ushqyerjes që një institucion arsimor parashkollor mund të ofrojë ose të krijojë lidhje me to.

Siguria e fëmijëve

Parandalimi i lëndimeve në kopshte duhet të jetë një përparësi. Sigurohuni që të ndërtoni një rrethim dhe portë rreth kompleksit të femijet për të parandaluar që fëmijët

të largohen nga territori dhe të shkojnë në rrugë ose pranë rrjedhave të ujit, depozitimeve të mbetjeve e kështu me radhë. Për më tepër, caktoni një të rritur për të mbikëqyrur fëmijët në çdo kohë, veçanërisht gjatë lojërave në natyrë. Përveç kësaj, kontrolloni shpesh pajisjet e brendshme dhe të jashtme për t'u siguruar që nuk ka gozhda ose gjëra të tjera të mprehta, jashtëqitje kafshësh ose njerëzore, ose mbetje, duke përfshirë kanaçe ose kavanoza që mbajnë ujë të vjetër, që mund të dëmtojnë seriozisht fëmijët që luajnë. Gjithashtu sigurohuni që të vendosin çdo gjë të rrezikshme p.sh., ilaçe, gërshërë, thika larg fëmijëve, në dollap jashtë mundësisë për t'u arritur nga fëmijët.

Në të njëjtën kohë, vendosni dhe zbatoni metoda të disiplinimit pozitiv brenda për fëmijët. Sigurohuni që ndëshkimi trupor të jetë i ndaluar, që mësuesit të jenë të pajisur me teknika të disiplinimit pozitiv jo të dhunshme dhe që strukturat brenda për fëmijët i përgjigjen në mënyrë të përshtatshme kur ka shkeleje të rregullores. Gjithashtu, mund të punoni me ekipin e mbrojtjes së fëmijëve pranë njësisë së pushtetit vendor për të ngritur një sistem referimi që edukatorët dhe stafi ndihmës të mund ta përdorë nëse një fëmijë po abuzohet në kopsht, në shtëpi ose diku tjetër. Fëmijëve duhet t'u mësohet si të luajnë pa përdorur dhunë fizike ose verbale. Kopshtet duhet të respektojnë dinjitetin e fëmijëve dhe t'i mbrojnë ata nga të gjitha format e dhunës, përfshirë dhunën nga stafi dhe në emër të disiplinës.

Ujë i pijshëm i sigurt

Është thelbësore që fëmijëve nën moshën pesë vjeç t'u jepet vetëm ujë i sigurt për të pirë. Shumë sëmundje përhapen përmes ujit të ndotur, më e zakonshmja është diarreja, por edhe sëmundje më serioze, duke përfshirë dizenterinë dhe kolerën. Meqenëse uji mund të ndotet gjatë mbledhjes, transportit dhe ruajtjes, ne ju rekomandojmë që ta trajtoni ujin në pikën e përdorimit (në kopsht). Edhe nëse uji juaj duket i pastër, është më mirë ta filtroni, trajtoni ose zieni atë për t'u siguruar!

Si të ruani ujin

- Ruajeni ujin në një enë të pastër me rubinet.
- Gjithmonë mbulojeni ujin me kapak. Sigurohuni që ta vendosni kapakun përsëri pasi të keni pirë ujin.
- Përdorni rubinetin për të derdhur ujë nga ena e ruajtjes. Mos zhytni asgjë (duart, gotat, etj.) në ujë.
- Nëse është e mundshme, siguroni një gotë për secilin fëmijë për të shmangur përdorimin e të njëjtave gota nga fëmijët dhe përhapjen e sëmundjeve.

Zierja është një metodë e njohur për trajtimin e ujit, por për shkak të sasive të mëdha të ujit të nevojshme për një numër të madh fëmijësh, mund të mos jetë zgjidhja më praktike për fëmijën tuaj. Për më tepër, kërkon dru ose burime të tjera energjie, të cilat kontribuojnë në shpyllëzim. Për mënyra të tjera të trajtimit të ujit referojuni autoriteteve të shëndetit publik në zonën tuaj.

Krijimi i një mjedisi të sigurtë dhe të shëndetshëm

Një mjedis i sigurt dhe i shëndetshëm mësimor përfshin:

- Hapësirë të sigurt lojërash brenda dhe jashtë – materiale të sigurta lojërash, rrethim, mungesë të objekteve të rrezikshme

- Ujë të pijshëm të sigurt – ujë që trajtohet ose vjen nga një burim i sigurt uji, dhe ruhet e përdoret siç duhet për të shmangur ndotjen
- Pajisje sanitare të sigurta – tualete të pastra të përshtatura për nevojat e fëmijëve të vegjël
- Pajisje për larjen e duarve me sapun dhe ujë, të përshtatura për fëmijët e vegjël dhe të pozicionuara pranë tualeteve dhe hapësirës së ngrënies
- Hedhje mbeturinash – kosha dhe sistem për largimin e mbeturinave
- Hapësirë gatimi e sigurt – parandaloni djegiet ose prerjet me thika etj. duke lejuar vetëm të rriturit të hyjnë në zonë

Higjiena në kopshte

Klasat dhe korridoret e femijëve duhet të pastrohen çdo ditë. Nuk ka nevojë të përdoren dezinfektantë (klor) për pastrimin e dyshemeve dhe sipërfaqeve; uji dhe detergjentët janë në rregull, përveç nëse ka pasur një rast të një sëmundjeje specifike, siç është fruthi, meningjiti, kolera ose ebola, të cilat kërkojnë dezinfektim.

Gjithashtu sigurohuni që zonat e përgatitjes së ushqimit të jenë të sigurta dhe higjienike, me vëmendje të veçantë në parandalimin e djegieve dhe zjarreve, si dhe në asgjësimin e ushqimit. Kuzhinierët duhet të mbikëqyren dhe të marrin trajnim mbi pesë aspektet e ushqimt të sigurt:

1. Lani duart para dhe gjatë përgatitjes së ushqimit.
2. Përdorni ujë të sigurt.
3. Gatuajeni ushqimin plotësisht.
4. Mbani ushqimin e gatuar veçmas nga ai i pagatuar.
5. Shërbejeni ushqimin e përgatitur brenda dy orësh ose mbajeni në temperatura të sigurta (të ftohta).

Tualetet

Për të parandaluar përhapjen e sëmundjeve, veçanërisht diarresë dhe krimbave të zorrëve, fëmijët duhet të kenë një vend të sigurt për të urinuar dhe defekuar në çerdhe. Lloji i tualetit do të ndryshojë në varësi të vendndodhjes dhe do të varet nga burimet në dispozicion. Idealisht, tualetet duhet të përmbushin standardet kombëtare për kanalizimet në kopshte (ose çerdhe nëse ka), por tualetet me kosto më të ulët përfshijnë tualete bazë me gropë. Ekziston gjithashtu një gamë e pajisjeve ekologjike të kanalizimeve, të tilla si tualetet EcoSan, të cilat minimizojnë nevojën për ujë, parandalojnë ndotjen e ujërave nëntokësore dhe përfshijnë ripërdorimin e mbeturinave për qëllime bujqësore. Megjithatë, lloji i tualetit EcoSan që i përshtatet më mirë femijet tuaj do të varet nga vendosja (niveli i ujërave nëntokësore, etj.), dhe nevojitet këshilla profesionale për të hartuar tualetet më të përshtatshme për një mjedis të caktuar.Tualetet shpesh mund të jenë të frikshme për fëmijët më të vegjël nëse vrima është shumë e madhe ose dhoma është shumë e errët, gjë që rezulton në gjetjen e një kaçubeje aty pranë ose në kryerjen e nevojave rreth vrimës. Mënyrat për t'i bërë tualetet më miqësore me fëmijët përfshijnë sigurimin që të ketë dritë të mjaftueshme në tualet, vrima të jetë mjaftueshëm e vogël dhe fëmijët të kenë diçka për të mbajtur ndërsa rrinë ulur. Konsultohuni me prindërit, ekspertë të Fëmijërisë së Hershme kur projektoni tualetet për t'u siguruar që ato plotësojnë nevojat e tyre. Tualetet duhet të

plotësojnë gjithashtu nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara (p.sh., blloqe për t'u ulur, doreza në mure dhe rampa për në tualete).

Do të jetë e rëndësishme që një lehtësues ose ndihmës në kopsht t'i shoqërojë fëmijët në tualet dhe t'i ndihmojë ata ta përdorin atë saktë derisa të kenë zotëruar aftësinë (domethënë, të bëjnë jashtëqitje në vrimë dhe jo pranë saj, të pastrohen siç duhet dhe gjithmonë të lajnë duart me sapun më pas). Prandaj, sa më të vegjël të jenë fëmijët, aq më e madhe është hapësira me qëllim që i rrituri shoqërues të hyjë në tualet ose në kabinën e banjës. Meqenëse fëmijët kanë më shumë gjasa të duan të urinojnë sesa të defekojnë, duhet të merret në konsideratë shtimi i urinareve si për vajzat ashtu edhe për djemtë, veçanërisht në kopshte të mëdha. Si vajzat ashtu edhe djemtë mund të përdorin urinare. Kjo zvogëlon nevojën për tualete dhe zgjat jetëgjatësinë e tualetit me gropë.

Pajisje për larjen e duarve

Të gjitha kopshtet duhet të kenë pajisje për larjen e duarve brenda ndërtesës, të vendosura jo më larg se 5 metra nga tualetet. Fëmijët duhet të jenë në gjendje të lajnë duart lehtësisht para se të hanë, pas përdorimit të tualetit ose në kohë të tjera të zakonshme (p.sh., kur mbërrijnë në mëngjes). Rubineti duhet të vendoset mjaftueshëm ulët që fëmijët të jenë në gjendje ta përdorin atë. Një copë sapuni mund të lidhet në rubinet ose të vendoset në një rrjetë për të parandaluar vjedhjen ose ndotjen e sapunit në dysheme. Stafi i çerdhes duhet të sigurojë që uji dhe sapuni të jenë të disponueshëm në çdo kohë. Fëmijët më të vegjël mund të kenë nevojë për ndihmë nga një i rritur për të përdorur rubinetin për të larë duart siç duhet derisa të kenë zotëruar këtë aftësi. Pajisje të ndara për larjen e duarve për të rriturit duhet të jenë gjithashtu të disponueshme në kopshte për të inkurajuar larjen e shpeshtë të duarve nga stafi dhe fëmijët.

Sesioni 6.5 Avokimi

Objektivi: Të prezantojë pjesëmarrësit me një mjet ndërgjegjësues për të gjitha kategoritë përfituese, veçanërisht drejtuesit, duke ndikuar në hartimin e një strategjie dhe plani konkret veprimi për mbrojtjen dhe aftësimin ndaj fatkeqësive natyrore në institucionet arsimore parashkollore.

Tematika:

1. Avokimi dhe forcimi i bashkëpunimit me strukturat vendore- Kjo tematikë trajton mënyrat e influencimit të politikave dhe strukturave përmes ndërtimit të marrëdhënieve, mobilizimit të publikut dhe bashkëpunimit me median, me qëllim përmirësimin e reagimit ndaj fatkeqësive natyrore.
2. Programet e ndërgjegjësimit dhe pjesëmarrja aktive e komuniteti- Fokusimi është në përfshirjen e popullatave të rrezikuara, veçanërisht fëmijëve dhe adoleshentëve, në programet për zvogëlimin e rreziqeve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike përmes analizës, dizenjimit dhe implementimit të veprimtarive konkrete.
3. Analiza e kontekstit dhe kapaciteteve për përballimin e rreziqeve- Kjo tematikë përfshin mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave mbi rreziqet klimatike, prekshmërinë e grupeve sociale dhe efektivitetin e strategjive ekzistuese, si bazë për hartimin e programeve të qëndrueshme dhe të përshtatura ndaj nevojave vendore.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime në grup (Shtojca nr. 2)**

Diskutimet në grup mbi avokimin dhe forcimin e bashkëpunimit me strukturat vendore synojnë t'u mundësojnë pjesëmarrësve të kuptojnë në mënyrë praktike se si ndërtohen marrëdhënie efektive me autoritetet vendore, si mobilizohet komuniteti dhe si përdoret media për të trajtuar rreziqet dhe nevojat e popullatave më të prekshme. Përmes debatit dhe shkëmbimit të përvojave, pjesëmarrësit reflektojnë mbi rolin e tyre në analizimin e rreziqeve, identifikimin e prioriteteve komunitare dhe përfshirjen e fëmijëve e të rinjve në programet e reduktimit të rrezikut. Diskutimet gjithashtu synojnë të forcojnë aftësinë e pjesëmarrësve për të dizenjuar programe avokimi të bazuara në prova dhe të dhëna, për të identifikuar partnerë e aleatë, për të kapërcyer pengesa institucionale dhe për të kuptuar procesin e plotë nga analiza deri te zbatimi. Në thelb, aktiviteti i ndihmon të shndërrojnë informacionin teorik në veprime konkrete dhe të përbashkëta për rritjen e sigurisë dhe reziliencës në komunitet.

- Diskutim ndërveprues me pjesëmarrësit mbi përvojat dhe perceptimet e tyre për identifikimin e rreziqeve dhe reagimeve të mundshme.

- Ndarje të rasteve konkrete dhe reflektim mbi praktikat e mira.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Avokimi dhe bashkëpunimi me strukturat vendore janë kyç për të ndikuar politikat, krijuar aleanca dhe mobilizuar komunitetin në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë.
- Analiza e rreziqeve, prekshmërisë dhe kapaciteteve është baza e çdo programi efektiv dhe duhet të përfshijë pjesëmarrjen e komunitetit, veçanërisht të fëmijëve dhe grupeve të cenueshme.
- Planifikimi i qartë dhe monitorimi, përfshirë objektivat, partneritetet dhe zhvillimin e kapaciteteve të stafit, siguron që programet të jenë efektive dhe të afta të reagojnë ndaj rreziqeve dhe ndryshimeve klimatike.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

Materiale të prezantimit në PowerPoint.

- Fletë pune për identifikimin e emergjencave
- Udhëzues ligjor dhe praktik

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. **Ligjet dhe rregulloret për fatkeqësitë natyrore dhe emergjencat civile**
    - Ligji Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile dhe Menaxhimin e Emergjencave”
    - Aktet nënligjore që përcaktojnë detyrimet e autoriteteve vendore dhe strukturave shtetërore në rast emergjencash.
2. **Ligjet për avokim dhe pjesëmarrje qytetare**
    - Ligji Nr. 119/2014 “Për organizatat jofitimprurëse dhe partneritetin me sektorin publik” (pjesa që përfshin të drejtën për advokim dhe ndikim në politikë).
    - Rregulloret që përcaktojnë mënyrën e komunikimit dhe bashkëpunimit mes institucioneve publike dhe komuniteteve.
3. **Ligji dhe standardet për përfshirjen e fëmijëve dhe adoleshentëve**
    - Ligji Nr. 18/2017 “Për të Drejtat e Fëmijëve” (për pjesëmarrjen aktive në programet e edukimit dhe ndërgjegjësimit).
    - Rekomandimet e Komitetit për të Drejtat e Fëmijës për përfshirjen e fëmijëve në aktivitete të komunitetit dhe menaxhimin e rrezikut.
4. **Rregulloret për menaxhimin e rreziqeve klimatike dhe mjedisore**
    - Ligji Nr. 104/2015 “Për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike” (për hartimin e programeve vendore dhe ndërgjegjësimin e komunitetit).

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të përdoren: Projektor, Laptop, Flipchart, marker.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

AVOKIMI DHE FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME STRUKTURAT VENDORE

Avokimi është një proces i qëllimshëm i ndikimit që synon të ndikojë mbi njerëzit, institucionet, politikat dhe sistemet për të sjellë ndryshime pozitive e të qëndrueshme në komunitet. Ai mbështetet në lehtësimin e komunikimit ndërmjet palëve, negocimin për zgjidhje të përbashkëta, demonstrimin e praktikave efektive dhe ndërtimin e aleancave me organizata, rrjete dhe grupe komunitare. Në thelb, avokimi nuk është vetëm "komunikim", por një arkitekturë veprimesh që lidh provat dhe të dhënat, partneritetet, mesazhet dhe kohëzgjatjen me rezultate të matshme për komunitetin—sidomos për fëmijët dhe familjet.

Avokimi ka tre dimensione themelore që veprojnë njëkohësisht dhe përforcojnë njëri-tjetrin. Së pari, ndërtimi i marrëdhënieve: krijimi i kontakteve të drejtpërdrejta dhe një dialogu konstruktiv me autoritetet vendore (bashki, drejtoritë sektoriale) për të trajtuar nevojat, mangësitë dhe mundësitë. Kjo nënkupton takime periodike, grupe pune ndërsektoriale dhe një kalendar të qartë konsultimesh, ku palët jo vetëm dëgjohen, por bashkëvendosin për prioritete. Së dyti, mobilizimi i publikut: fushata ndërgjegjësuese dhe forma të ndryshme të pjesëmarrjes qytetare (forume komunitare, ditë informuese në kopsht/shkollë, kanale digjitale, minifushata lagjeje) rrisin kërkesën shoqërore për standarde më të mira shërbimi dhe i japin legjitimitet ndryshimit. Së treti, puna me median: përdorimi i mediave vendore e kombëtare, së bashku me kanalet sociale të institucioneve, për të shpërndarë mesazhe të qarta, histori suksesi, problematika reale dhe zgjidhje të mundshme—duke ruajtur etikën, saktësinë dhe dinjitetin e përfituesve.

Për të kaluar nga koncepti në praktikë, avokimi përfiton nga një kornizë operacionale: (1) një hartë aktorësh (bashkia, ZVAP/DRAP, AKMC/strukturat e emergjencave, drejtoritë e shëndetit publik, shkolla/kopshti, OJF-të, prindërit, bizneset vendore) me rolet dhe interesat e tyre; (2) një analizë e kontekstit (ç'politika ekzistojnë, cilat mangësi pengojnë zbatimin, ku duhen lidhje më të mira mes planeve dhe praktikës); (3) mesazhe kyç të thjeshta, të verifikuara me prova dhe të dhëna dhe të përshtatura për audienca të ndryshme (p.sh., "kopshtet e sigurta" si kusht për zhvillimin e fëmijëve, apo "parandalimi kushton më pak se reagimi"); (4) kanale komunikimi të shumëfishta (mbledhje komunitare, tryeza teknike, media, rrjete sociale, buletine) dhe (5) tregues matës (TKP) që lidhin përpjekjet e avokimit me ndryshimin në politika, buxhete, sjellje dhe shërbime.

Përtej parimeve, forcimi i bashkëpunimit me strukturat vendore kërkon mekanizma bashkërendimi të qëndrueshëm. Këto përfshijnë komitete ose grupe pune ndërsektoriale në nivel bashkie (me përfaqësim nga arsimi parashkollor, shëndetësia, emergjencat civile, mirëqenia sociale, financat, mjedisi), që takohen me një ritëm të paracaktuar, miratojnë plane veprimi tre- ose gjashtëmujore dhe mbajnë procesverbale me masa, afate dhe përgjegjës të qartë. Në këtë kuadër, memorandumet e bashkëpunimit dhe plani i përbashkët i komunikimit reduktojnë fragmentimin, sigurojnë koherencë mes nismave dhe e bëjnë të parashikueshëm bashkëpunimin. Ky rrjet vendore kombinohet me rrjete avokimi kombëtare (platforma OJF-sh, rrjete

profesionale) dhe, kur është e nevojshme, me rrjete globale (praktika të mira, standarde, mësime të nxjerra) për të përforcuar standardizimin dhe qëndrueshmërinë. Një avokim efektiv bazohet gjithmonë në prova dhe të dhëna dhe eksperimentim të kontrolluar. Pilotimi i një nisme (p.sh., një protokoll evakuimi në kopsht, një mekanizëm raportimi për rreziqe, një format i ri i këshillimit me prindër) krijon prova konkrete që mund të demonstrohen në takime me vendimmarrësit. Ky demonstrim shoqërohet me rrëfime njerëzore (storytelling etik dhe anonim) dhe të dhëna (tregues të qartë për sigurinë, pjesëmarrjen, cilësinë e shërbimeve). Për të shmangur "kurthin e një herë e kurrë", avokimi fut monitorimin ciklik (p.sh., çdo 90 ditë): çfarë u bë, çfarë ndryshoi, çfarë duhet ndryshe—dhe i publikon në mënyrë transparente për komunitetin rezultatet dhe mësimet.

Një komponent që shpesh anashkalohet është menaxhimi i riskut dhe etika në avokim. Mesazhet duhen të jenë të sakta, të baraspeshuara dhe të respektojnë dinjitetin e fëmijëve e familjeve; të shmangin stigmatizimin e grupeve të cenueshme; të ruajnë konfidencialitetin dhe të përputhen me kodet e etikës profesionale. Po ashtu, hartat e aktorëve dhe mesazhet duhet të rishikohen kur ndodhin ndryshime politike ose institucionale, për të ruajtur përkatësinë dhe për të menaxhuar konfliktet e interesit. Në nivel vendor, kjo nënkupton edhe njohjen e dinamizmit të komunitetit—p.sh., ndërrimet e stafit, riorganizimet bashkiake, prioritetet sezonale—dhe elasticitet në taktikat komunikative (nga takimet ballë për ballë te kanalet digjitale).

Për të matur përparimin, ia vlen të vendosen TKP të thjeshta por domethënëse: numri i marrëveshjeve/akteve të miratuara që lidhen me sigurinë në kopsht, buxhetet e alokuara për masa parandaluese, numri i trajnimeve/ushtrimeve të simulimit të zhvilluara me stafin e kopshtit, përqindja e prindërve të informuar për planin e emergjencave, koha mesatare e reagimit (nga raportimi te veprimi), numri i inspektimeve të infrastrukturës të kryera sipas standardeve, apo rritja e pjesëmarrjes në forumet komunitare. Këta tregues lidhen me objektivat (p.sh., "rritje 30% e familjeve që e njohin planin e emergjencave brenda 6 muajve") dhe me afate reale (p.sh., kalendar tremujor me theme të qarta), duke mundësuar vlerësim të vazhdueshëm dhe mbajtje përgjegjësie horizontale (para komunitetit) dhe vertikale (para institucioneve).

Së fundi, avokimi i suksesshëm e sheh bashkëpunimin me strukturat vendore si një ekosistem: bashkia që planifikon dhe financon, strukturat e emergjencave që trajnojnë dhe bashkërendojnë, sektori i arsimit parashkollor që zbaton protokollet dhe edukon, shëndetësia që mbështet higjienën dhe mirëqenien, OJF-të që sjellin ekspertizë dhe mobilizim, komuniteti/prindërit që bashkëndërtojnë zgjidhjet, dhe media që informon me përgjegjësi. Kur këto hallka lidhen me qëllime të përbashkëta, plane të matshme dhe komunikim të rregullt, avokimi bëhet një motor real ndryshimi—nga politika te praktika—duke prodhuar institucione arsimore parashkollore më të sigurta, më të përgjegjshme dhe më të orientuara drejt nevojave të fëmijëve.

Programet e ndërgjegjësimit për reduktimin e rreziqeve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike janë një komponent thelbësor i menaxhimit të fatkeqësive natyrore dhe forcimit të reziliencës së komuniteteve. Qëllimi i tyre është të rrisin sigurinë, të zvogëlojnë prekshmërinë dhe të ngrenë kapacitete për reagim dhe rikuperim, duke u bazuar në një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin aktorët vendorë, institucionet dhe vetë komunitetin. Një element qendror i këtyre programeve është

përfshirja aktive e popullatave të rrezikuara, veçanërisht fëmijëve dhe adoleshentëve. Ata përjetojnë më drejtpërdrejt pasojat e ndryshimeve klimatike dhe fatkeqësive natyrore, prandaj zëri i tyre është i domosdoshëm për të identifikuar nevojat reale dhe për të propozuar zgjidhje të përshtatshme. Përfshirja e tyre mund të realizohet përmes grupeve të fokusit, simulimeve praktike, seminareve edukative dhe platformave digjitale që lejojnë shkëmbimin e ideve.
Efektiviteti i programeve varet nga ndërtimi i një qasjeje që bazohet në përvojat, prioritetet dhe perceptimet e komunitetit. Kjo nënkupton që çdo program duhet të fillojë me një analizë të thelluar të kontekstit vendor, duke marrë parasysh faktorët socio-ekonomikë, politikat ekzistuese, kapacitetet institucionale dhe burimet e disponueshme. Vetëm mbi këtë bazë mund të hartohen strategji të qëndrueshme dhe të matshme.

Fazat e Programit
Modeli i programimit ndahet në **tri faza kryesore**:

1. **Analiza**
    - Mbledhja e të dhënave mbi rreziqet klimatike dhe natyrore, historikun e fatkeqësive, ndryshimet e vëzhguara dhe të parashikuara.
    - Identifikimi i grupeve më të prekshme dhe faktorëve që rrisin rrezikun (varfëria, mungesa e infrastrukturës, pabarazitë sociale).
    - Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese për rikuperim dhe mangësive institucionale.
    - Konsultimi me aktorët vendorë dhe validimi i gjetjeve për të siguruar transparencë dhe përfshirje.
2. **Projektimi**
    - Përcaktimi i objektivave strategjike dhe rezultateve të pritshme.
    - Hartimi i aktiviteteve konkrete për reduktimin e rreziqeve dhe përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike.
    - Hartimi i një plani avokimi për të krijuar një mjedis politik e institucional mundësues.
    - Hartimi i kornizës së monitorimit me tregues SMART dhe planit të menaxhimit të të dhënave.
    - Përgatitja e buxhetit dhe alokimi i burimeve për zbatimin e masave dhe ngritjen e kapaciteteve.
3. **Zbatimi**
    - Zbatimi i aktiviteteve të planifikuara sipas një plani operacional të hollësishëm.
    - Konfirmimi i partneriteteve dhe rrjeteve të bashkëpunimit me strukturat vendore, OJF-të dhe sektorin privat.
    - Zhvillimi i kapaciteteve të stafit dhe komunitetit për reagim ndaj emergjencave.
    - Monitorimi i progresit dhe përshtatja e strategjive bazuar në mësimet e nxjerra dhe ndryshimet e kontekstit.

Elemente Praktike për Zbatimin

- **Fushata ndërgjegjësimi** në shkolla, kopshte dhe komunitet për sjellje të sigurta dhe masa parandaluese.

- **Simulime emergjencash** për të testuar gatishmërinë e stafit dhe fëmijëve.
- **Platforma informimi** (broshura, aplikacione, rrjete sociale) për komunikim të shpejtë dhe edukim publik.
- **Partneritete me media** për shpërndarjen e mesazheve dhe historive të suksesit.
- **Tregues matës** si: numri i aktiviteteve të realizuara, përqindja e pjesëmarrjes së komunitetit, rritja e njohurive mbi masat e sigurisë, përmirësimi i infrastrukturës.

3. FAZA E ANALIZËS: MBLEDHJA E TË DHËNAVE DHE KUPTIMI i KONTEKSTIT

Faza e analizës synon të mbledhë informacion të thelluar për natyrën dhe shkallën e rreziqeve klimatike dhe natyrore që prek popullatën e synuar, duke u fokusuar në nevojat specifike të fëmijëve dhe adoleshentëve. Gjatë këtij procesi mblidhen të dhëna mbi rreziqet klimatike të ndodhura më parë, ndryshimet e vëzhguara dhe të parashikuara, ndikimin mbi komunitetin dhe efektivitetin e strategjive ekzistuese të përballimit. Po ashtu identifikohen grupet më të prekshme, faktorët socio-ekonomikë që rrisin rrezikun, politikat dhe programet qeveritare në fuqi, si dhe partnerët potencialë që mund të mbështesin programin. Analiza përfshin edhe vlerësimin e kapaciteteve të stafit dhe partnerëve, në mënyrë që projekti të ndërtohet mbi burime reale dhe të trajtojë mangësitë ekzistuese.

3.1. Përcaktimi i qëllimit dhe procesit të analizës

Hapi i parë është sqarimi i qëllimit të analizës dhe mënyra se si rezultatet e saj do të përdoren në fazat pasuese. Përcaktohen aktorët kryesorë, kohëzgjatja, burimet e informacionit dhe teknikat që do të përdoren, duke siguruar përfshirjen e burimeve parësore (intervista, grupe fokusi) dhe atyre dytësore (raporte, statistika). Lehtësuesit duhet të jenë të trajnuar dhe të njohur me metodologjinë për të garantuar cilësi të procesit.

3.2. Analiza e kontekstit të rreziqeve dhe klimës

Ky hap fokusohet në grumbullimin e të dhënave historike dhe aktuale mbi kushtet klimatike dhe rreziqet e lidhura me klimën. Konsultohen grupe të ndryshme sociale për të kuptuar perceptimet mbi ndryshimet klimatike dhe pasojat e tyre. Analizohet se si rreziqet e pranishme dhe të ardhshme mund të ndikojnë në programet aktuale dhe se sa mirë është kuptuar apo zbatuar informacioni klimatik nga popullata.

3.3. Analiza e kapaciteteve të rikuperimit dhe prekshmërisë

Kjo analizë identifikon sa dhe si grupet sociale përballen me rreziqet, cilat janë strategjitë që përdorin dhe sa efektive janë ato. Gjatë këtij hapi identifikohen grupet më të rrezikuara dhe shkaqet e prekshmërisë së tyre, duke konsideruar faktorë si qasje në burime, pabarazi sociale, ndikime politike dhe kushtet e jetesës. Rezultatet ndihmojnë në përcaktimin e ndikimit potencial të programit dhe zonave ku ndërhyrja është më urgjente.

3.4. Analiza e mjedisit të programimit

Këtu vlerësohen mundësitë dhe pengesat e krijuara nga politikat qeveritare, programet ekzistuese, nismat komunitare dhe nismat e sektorit privat. Identifikohen mangësitë në politika dhe praktikat që rrisin prekshmërinë e popullatës së synuar dhe vlerësohet interesi i aktorëve të ndryshëm për të mbështetur zgjidhjet e propozuara.

3.5. Validimi dhe dokumentimi i analizës

Pas përfundimit të mbledhjes së të dhënave, rezultatet diskutohen me aktorët kryesorë për t'u validuar dhe për të qenë të pranueshme nga komuniteti. Procesi dokumentohet në mënyrë transparente dhe të dhënat ndahen me grupet e interesit për të siguruar bazën e programimit në fazat e mëvonshme.

4. FAZA E PROJEKTIMIT: HARTIMI I STRATEGJISË DHE STRUKTURIMIT TË PROGRAMIT

Në këtë fazë përcaktohet arkitektura logjike e programit. Fillimisht saktësohen objektivat kryesore dhe rezultatet e pritshme, më pas hartohen aktivitetet që do të çojnë drejt realizimit të tyre. Programi duhet të marrë parasysh rreziqet klimatike gjatë gjithë kohës së zbatimit dhe të përfshijë strategji përshtatjeje. Gjithashtu gjatë dizenjimit hartohet **plani i avokimit**, i cili synon të krijojë një mjedis politik e institucional mundësues për programin. Në këtë fazë zhvillohet edhe **korniza e monitorimit**, ku përcaktohen treguesit e matshëm, mënyrat e mbledhjes së të dhënave dhe proceset e vlerësimit. Po ashtu hartohet edhe **buxheti**, i cili parashikon kostot financiare, burimet njerëzore dhe materiale, si dhe fondet për ngritjen e kapaciteteve dhe përgjigjen ndaj rreziqeve të mundshme.

5. FAZA E ZBATIMIT: ZBATIMI PRAKTIK DHE MENAXHIMI I PROCESIT

Zbatimi është faza ku aktivitetet e planifikuara realizohen dhe ku programi prodhon rezultatet e tij. Fillimisht hartohet një plan operacional, i cili detajon hapat, përgjegjësitë dhe afatet kohore, duke mbajtur elasticitet për situata të paparashikuara si kushtet e motit. Më pas konfirmohen partneritetet dhe rrjetet e bashkëpunimit, përfshi marrëveshjet zbatim, avokim dhe menaxhim të njohurive. Një element thelbësor është zhvillimi i kapaciteteve të stafit, duke u bazuar në të dhënat e analizës, në mënyrë që ekipi zbatues të jetë i gatshëm të përballojë sfidat dhe të garantojë cilësi në të gjitha fazat e programit.

Figura 1. Procesi i avokimit dhe programimit me bashkëpunim vendor.

Tabela: Fazat e programit, qëllimet dhe prodhimet kryesore

Faza	**Qëllimi**	**Hapat kyç**	**Prodhimet kryesore**	**Treguesit (SMART)**
Analiza	Të kuptohet rreziku, prekshmëria dhe kapacitetet; të përcaktohet	Qëllimi & metodologjia ; të dhëna klimatike &	Raport analize; hartë aktorësh; lista	Tregues të qartë për rrezikun/prekshmërinë ; cilësi e të dhënave; nivel përfshirjeje të aktorëve.

	baza e programimit.	rreziqe; konsultime; kapacitete & prekshmëri; mjedisi i programimit; validim & dokumentim.	mangësish; seria e të dhënave bazë.	
Dizenjimi	Të strukturohet arkitektura logjike; të planifikohen masa përshtatjeje, avokimi dhe M&V.	Objektiva & rezultate; aktivitete; plan avokimi; kornizë monitorimi & menaxhim të dhënash; buxhet.	Korniza ligjore/teoria e ndryshimit; plan avokimi; plan monitorimi; buxhet i hollësishëm.	Tregues SMART; frekuencë e mbledhjes së të dhënave; buxhet i alokuar për kapacitete.
Zbatimi	Të realizohen aktivitetet; të sigurohet cilësia dhe përshtatshmëria ndaj risqeve.	Plan operacional; partneritete & marrëveshje; zhvillim kapacitetesh; monitorim & rishikim.	Raporte progresi; manuale & protokolle; kapacitete të trajnuara; mësime të nxjerra.	Përmbushje e planit; TKP të cilësisë; provë e përmirësimeve dhe përshtatjeve.

MODULI 7 MJEDISI SI EDUKATOR I TRETË

Përmbledhje e modulit:

Ky modul trajton krijimin e mjediseve cilësore të të nxënit në institucionet arsimore parashkollore, duke synuar të rrisë kapacitetet e pjesëmarrësve për të projektuar hapësira edukative të përshtatshme, për të përdorur mjete didaktike në mbështetje të zhvillimit të fëmijëve dhe për të vlerësuar cilësinë e klasave përmes instrumenteve të strukturuara të vëzhgimit. Moduli përqendrohet në lidhjen mes mjedisit fizik dhe social, standardeve zhvillimore dhe praktikave pedagogjike bashkëkohore, duke promovuar një qasje gjithëpërfshirëse dhe të orientuar drejt fëmijës.

Qëllimi i modulit:

Ky modul synon të optimizojë mjediset e të nxënit në institucionet arsimore parashkollore, duke nxitur ndërveprimin, lojën dhe zhvillimin e fëmijëve përmes krijimit të hapësirave të përshtatura dhe përdorimit të materialeve edukative/mësimore që mbështesin zhvillimin tërësor, në përputhje me praktikat më të mira pedagogjike.
Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit aftësohen të:

- Kuptojnë ndikimin e mjedisit në funksion të zhvillimit të fëmijëve.
- Zbatojnë standardet e të nxënit për të dizajnuar klasën, duke organizuar zona të veçanta si zona e artit, zona e leximit, zona e blloqeve etj.
- Vlerësojnë mjediset e të nxënit duke përdorur mjetin e Save the Children, me fokus në sigurinë, aksesueshmërinë dhe përshtatshmërinë zhvillimore.
- Planifikojnë përdorimin e materialeve edukative/mësimore në përputhje me standardet, përmes një procesi që përfshin drejtuesit dhe edukatorët e institucionit arsimor parashkollor.

Grupi i synuar:

Punonjës të arsimit pranë njësive të pushtetit vendor, drejtues vendorë dhe aktorë të tjerë të përfshirë në ofrimin dhe bashkërendimin e shërbimeve për fëmijërinë e hershme.

Sesioni 7.1 Roli i mjedisit të të nxënit

Objektivi: Të kuptohet roli i mjedisit fizik dhe social në procesin e të nxënit të fëmijëve, duke identifikuar elementet që e bëjnë mjedisin edukativ/mësimor të pasur, të sigurt dhe nxitës për zhvillimin, si dhe duke reflektuar mbi ndikimin e tij në marrëdhëniet, komunikimin dhe eksplorimin e fëmijëve.

Tematika:

1. Roli i mjeteve didaktike në zhvillimin e fëmijëve – Kjo tematikë trajton rëndësinë e materialeve edukative si mjete që nxisin mendimin, vetëbesimin dhe eksplorimin tek fëmijët e moshës 3–6 vjeç.
2. Përfshirja e të rriturve dhe burimeve vendore në procesin edukativ/mësimor – Theksohet roli udhërrëfyes i të rriturve dhe vlera e përdorimit të kulturës vendore në krijimin e materialeve të përshtatura për fëmijët.

3. Klasifikimi dhe planifikimi i mjeteve sipas fushave të zhvillimit – Diskutohet ndarja e mjeteve sipas fushave si jeta praktike, gjuhë, matematikë etj., dhe mënyra e planifikimit të përdorimit të tyre për të mbështetur zhvillimin tërësor të fëmijëve.

Rezultatet e të nxënit:

- Pjesëmarrësit do të analizojnë mjedisin si një "edukator i tretë" në institucionet arsimore parashkollore.
- Do të kuptojnë rëndësinë e organizimit të hapësirës sipas interesave dhe nevojave të fëmijëve.
- Do të përvetësojnë parime për krijimin e një mjedisi që nxit eksplorimin, komunikimin dhe vetëvlerësimin.
- Do të reflektojnë mbi rolin e dokumentacionit dhe materialeve natyrore në mbështetjen e të nxënit.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime ne grup (Shtojca nr. 2)**

Synojnë që pjesëmarrësit të kuptojnë rëndësinë e mjedisit parashkollor si një faktor thelbësor në zhvillimin dhe të nxënit e fëmijëve. Pjesëmarrësit do të eksplorojnë sesi hapësirat fizike dhe marrëdhëniet brenda tyre ndikojnë në kureshtjen, krijueshmërinë, bashkëpunimin dhe aftësitë sociale të fëmijëve, duke i ndihmuar ata të ndërtojnë dijen dhe të zhvillojnë vetëbesim dhe vetëfuqizim. Përmes ushtrimeve praktike, grupi synon të analizojë dhe projektojë mjedise të pasura dhe funksionale, të cilat mbështesin aktivitete individuale dhe kolektive, përdorimin e materialeve natyrore dhe ricikluese, si dhe dokumentimin e përvojave të fëmijëve. Diskutimet nxisin reflektimin mbi rolin e mjedisit si "edukator i tretë", mënyrën se si fëmijët ndërveprojnë me hapësirën, dhe si mund të krijohen situata që promovojnë zhvillimin natyror të tyre, duke integruar projektet, interesat dhe nevojat e komunitetit në planifikimin e hapësirave.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Mjedisi është një komponent aktiv në procesin e të nxënit dhe zhvillimit të fëmijës.
- Hapësira duhet të jetë e menduar për të përmbushur interesat dhe kuriozitetet e fëmijëve.
- Dokumentacioni dhe materialet e zgjedhura ndihmojnë fëmijët të reflektojnë dhe të ndërtojnë identitetin e tyre.
- Mjedisi duhet të mbështesë marrëdhëniet, komunikimin dhe punën në grup.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit
Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:
Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

Ligjet dhe rregulloret kombëtare për arsimin parashkollor:
- Standarde për hapësirat dhe sigurinë fizike të institucioneve arsimore parashkollore.
- Normativa për materialet dhe pajisjet që përdoren në klasë.
- Rregullat për përfshirjen e fëmijëve dhe të drejtën për arsim cilësor.

Konventa dhe dokumente ndërkombëtare për të drejtat e fëmijës (p.sh., Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijës):
- Të drejtat për të mësuar në një mjedis të sigurt dhe stimulues.
- E drejta për të shprehur mendimet dhe për të marrë pjesë në aktivitetet që prekin jetën e tyre.

Udhëzime ligjore për dokumentimin dhe mbrojtjen e fëmijëve:

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahen: Projektor, Laptop, Flipchart, marker.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
Një mjedis i përshtatshëm mbështet rolin e edukatorëve në promovimin e zhvillimit dhe të të nxënit të fëmijëve. Është e nevojshme të krijohet një hapësirë tërheqëse, e hapur, që është familjare, dhe e pasur, e organizuar sipas fushave të ndryshme të interesit.
Mjedisi mund të konsiderohet si një sistem i gjallë, në të cilin fëmijët dhe të rriturit ndërtojnë një rrjet të dendur marrëdhëniesh të rëndësishme, të afta për të mbështetur komunikimin.
Institucioni arsimor parashkollor është vendi ku njerëzit jetojnë dhe ku është e mundur të fuqizohet proces i ndërtimit të dijes.
Roli i mjedisit është thelbësor në proceset e të nxënit të fëmijëve. Roli i tij është qoftë i drejtpërdrejtë në marrëdhëniet, shkëmbimin, dialogun dhe përplasjen, por gjithashtu edhe jo i drejtpërdrejtë në kontekstet që ne hartojmë dhe krijojmë. Një mjedis u mundëson fëmijëve të kenë sjellje përkatëse, të cilat i detyrojnë ose shtyjnë ata të krijojnë mundësitë, potencialet dhe aftësitë që ata mund të zotërojnë. Një mjedis i cili nuk pengon proceset njohëse të fëmijëve. Fëmija, i shtyrë nga kurioziteti nga një nevojë natyrale për t'i dhënë kuptim botës, kryen kërkime të vazhdueshme për një fokus të ri dhe fusha të reja për të shqyrtuar dhe eksploruar. Aftësia për të eksploruar është një veprim që lind nga ndërveprimi dhe nga shkëmbimi midis të rriturve dhe fëmijëve. Kjo duhet të jetë një pikë fillestare nga ku ne projektojmë hapësirat, situatat të cilat janë mjete të drejtpërdrejta ose jo të drejtpërdrejta që mbështesin këtë eksplorim.

Mjedisi fizik dhe sistemi psikologjik i marrëdhënieve ndihmon në përforcimin e ndjenjës së sigurisë, vetëvlerësimit dhe vetë-fuqizimit të fëmijës, e cila zhvillohet nga perceptimi i fëmijës se po e dëgjojnë në të gjithë potencialin e tij. Institucionet arsimore parashkollore janë kontekste jetësore që ndryshohen vazhdimisht nga faktet, ngjarjet, aktivitetet, historitë dhe marrëdhëniet personale.

Projektimi i hapësirave duhet të fillojë nga ky botëkuptim. Hapësira është e projektuar që të bashkojë, inkurajojë, dhe jo vetëm të përmbajë këto histori, këto ngjarje. Duhet të mbështesë individin, marrëdhënien dhe grupin në këtë proces të vështirë të ndërtimit të dijes. Duhet të ruajë dhe promovojë kujtesën individuale dhe kolektive.

Veprimet dhe hapat e rëndësishme të këtyre proceseve duhet të jenë qartësisht të dukshme, dhe mjedisi duhet të inkurajojë dhe ushqejë përvojat duke e mbajtur dokumentacionin të dukshëm.

Mjedisi duhet të lejojë marrëdhënien kolektive si edhe reflektimin individual. Duhet të rrisë kureshtjen. Institucioni arsimor parashkollor është një sistem marrëdhëniesh ku fëmijët jo vetëm njihen me një kulturë, por duhet të kenë aftësinë që ta prodhojnë dhe krijojnë atë. Dokumentacioni ka një rol të rëndësishëm. Detyra e dokumentacionit është që t'i ofrojë një grupi dhe një individi aftësinë që të lexojë për veten nga një pikëpamje jashtë vetes, por si një pjesëmarrës. Është e rëndësishme që materialet të zgjidhen dhe renditen. Ato nuk duhet të jenë të strukturuara. Në të shumtën e rasteve ato mund të jenë të natyrshme ose të ricikluara. Fëmijët mund të eksperimentojnë me materialet pa ndonjë pritshmëri, thjesht duke i dhënë shprehje potencialit dhe krijimtarisë së tyre. Gjithashtu natyra dhe materialet natyrore duhet të kenë një vend në klasë. Materialet e ricikluesshme ndihmojnë në ndërgjegjësimin mbi mjedisin dhe natyrën. Fëmijët kanë të drejtë të kenë një mjedis sfidues, ku çdo gjë është menduar që në fillim për të përmbushur interesat dhe kuriozitetet e tyre. Kështu që është thelbësore që mësuesi të vëzhgojë fëmijët dhe mënyrën se si ata e përdorin hapësirën, në mënyrë që të zhvillojë dhe modifikojë vazhdimisht organizmin e hapësirës, që duhet të konsiderohet si një element i gjallë dhe ndryshues dhe jo si një kuti.

Organizimi i hapësirës arsimore është planifikuar për të përmbushur të drejtat e fëmijëve. Duhet të kombinojë nevojën për intimitet/siguri emocionale të fëmijës dhe nevojën për eksplorim/zbulim. Kështu që hapësirat nuk duhet të jenë shumë të ngushta ose shumë të hapura. Duhet të ketë një ekuilibër të mirë midis këtyre dy elementëve. Hapësira në vetvete duhet të jetë një vend që karakterizohet nga një qëllim, të jetë e aftë të komunikojë miqësi, qasje, lexueshmëri dhe ndarje funksionale. Organizimi i hapësirës duhet të inkurajojë dhe mbështesë shumëllojshmërinë dhe cilësinë e marrëdhënieve, duke u mundësuar fëmijëve të punojnë në grupe të mëdha ose të vogla, duke mbështetur çdo përvojë të mundshme të fëmijëve në mënyrë dinamike. Fëmijët punojnë me projekte që janë krijuar nga interesat dhe idetë e tyre dhe mjedisi i të nxënit mund të ndryshojë sipas temës së çdo projekti. Projektet frymëzojnë dhe nxisin krijimtarinë. Ata bazohen mbi punën në grup, kërkimin dhe eksplorimin. Arsimi përqendrohet mbi zhvillimin natyror të fëmijës. Ka fëmijën në qendër. Institucionet arsimore parashkollore, për shembull, duhet të kenë sheshe, ose hapësira të përbashkëta si salla, hyrje, korridore; zona të përbashkëta ku fëmijët mund të mblidhen së bashku me fëmijët nga klasa të tjera.

Klasat duhet të jenë të mëdha, të përbëra nga shumë hapësira (jo domosdoshmërish nga dhoma të veçanta) të gjitha të lidhura me njëra-tjetrën. Ata kanë nevojë për një

zonë të madhe, shumëfunksionale dhe rrethore ku fëmijët të nxiten të diskutojnë dhe shkëmbejnë ndjenjat dhe idetë e tyre. Hapësirat e tjera duhet të mirëpresin çdo veprimtari tjetër të fëmijëve. Fëmijët mund të zhvendosen nga njëra hapësirë te tjetra për të punuar mbi veprimtari të ndryshme me grupe të ndryshme. Kjo i lejon ata të ndërveprojnë dhe komunikojnë me të gjithë shokët dhe shoqet e tyre të klasës.

Mjedisi duhet të konsiderohet si një edukator i tretë. Ne duhet të krijojmë një "bashkëpunim" me mjedisin për të mbështetur së bashku proceset e të nxënit të fëmijëve

Çdo fëmijë duhet të ketë një kuti postare për të dërguar dhe marrë mesazhe nga shokët. Kjo është një mënyrë e përkryer për të nxitur komunikimin midis fëmijëve dhe një mundësi e mirë që fëmijët të shprehin vetveten nëpërmjet vizatimeve dhe mesazheve.

Siç edhe u tha më lart, një nga tiparet më të rëndësishme të shkollave është dokumentimi. Duhet të ketë dokumentacion që i kushtohet fëmijëve. Posterat duhet të jenë të dukshëm në mur në lartësinë e fëmijëve, në mënyrë që ata të lexojnë dhe të shohin përvojat në të cilat ata janë protagonistë. Dokumentacioni u mundëson fëmijëve të riinterpretojnë projektet e tyre dhe prindërve të shohin atë për çka fëmijët kanë punuar.

Çdo klasë ka një tavolinë për informimin e prindërve ku ata shkëmbejnë komente mbi projektet dhe veprimtaritë e përditshme me prindërit.

Sesioni 7.2 Mjetet didaktike në ndihmë të proceseve të të nxënit

Objektivi: Të kuptohet rëndësia e përzgjedhjes dhe përdorimit të materialeve didaktike si pjesë e mjedisit të të nxënit, duke aftësuar pjesëmarrësit në planifikimin, prezantimin dhe rotacionin e tyre në mbështetje të zhvillimit të fëmijëve të moshës 3–6 vjeç.

Tematika:

1. Filozofia mbi përdorimin e mjeteve didaktike- Kjo tematikë prezanton parimin "Dora është rruga drejt mendjes", duke theksuar se fëmijët mësojnë përmes veprimit, prekjes dhe eksplorimit, dhe se materialet edukative/mësimore janë mjete për zhvillimin e tyre të gjithanshëm.
2. Përdorimi i kulturës vendore dhe roli i të rriturit- Diskutohet rëndësia e përfshirjes së elementeve vendore në krijimin e materialeve, si dhe roli i të rriturit si udhërrëfyes i qetë që përgatit mjedisin dhe mbështet fëmijët në procesin e të nxënit.
3. Organizimi dhe planifikimi i mjeteve sipas fushave të zhvillimit- Materialet klasifikohen sipas fushave si jeta praktike, shqisore, gjuhë, matematikë, studime kulturore dhe zhvillim motorik, ndërsa planifikimi përfshin qëllime të qarta, kontrollin e gabimeve dhe rotacionin e materialeve për të ruajtur freskinë dhe përshtatshmërinë e mjedisit.

Rezultatet e të nxënit të sesionit:

- Pjesëmarrësit do të identifikojnë karakteristikat e materialeve didaktike efektive (praktike, vetëkorrigjuese, të bukura, të përshtatshme për zhvillimin).
- Do të kuptojnë rolin e të rriturit si udhërrëfyes në përdorimin e mjeteve didaktike.
- Do të aftësohen të planifikojnë dhe të organizojnë mjedisin e të nxënit sipas fushave të zhvillimit.
- Do të reflektojnë mbi rëndësinë e dokumentimit dhe rotacionit të materialeve për të mbajtur mjedisin të freskët dhe të gjallë.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

Diskutime në grup (Shtojca nr. 2)

Synojnë të thellojnë kuptimin e filozofisë dhe praktikave të përbashkëta për zgjedhjen dhe përdorimin e materialeve didaktike në mjedisin e të nxënit për fëmijët e vegjël, duke theksuar rëndësinë e vëzhgimit të nevojave dhe interesave të fëmijëve, përfshirjen e kulturës vendore, nxitjen e pavarësisë dhe zhvillimin e aftësive të ndryshme përmes materialeve praktike dhe estetikisht të këndshme. Ato ofrojnë një hapësirë për reflektim mbi rolin e të rriturit si udhërrëfyes dhe mbështetës, si dhe për

diskutim mbi mënyrën më të mirë të organizimit, prezantimit dhe rotacionit të materialeve për të mbajtur mjedisin të gjallë dhe stimulues.

Ushtrime praktike (Shtojca nr. 3)
Ushtrimet për këtë material synojnë që pjesëmarrësit të praktikojnë dhe konsolidojnë aftësinë për të vëzhguar nevojat dhe interesat e fëmijëve, për të planifikuar dhe përzgjedhur materiale didaktike të përshtatshme për zhvillimin e tyre, si dhe për të strukturuar dhe organizuar mjedisin e të nxënit në mënyrë që të nxisë pavarësinë, eksplorimin dhe krijueshmërinë e fëmijëve. Ato gjithashtu synojnë të zhvillojnë aftësinë e pjesëmarrësve për të specifikuar qëllimet e drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta të materialeve, për të vendosur mekanizma kontrolli të gabimeve, për të integruar elemente të kulturës vendore dhe për të vlerësuar efektivitetin, estetikën dhe qëndrueshmërinë e materialeve në praktikë. Në këtë mënyrë, pjesëmarrësit praktikojnë një qasje reflektuese dhe të planifikuar që i fuqizon të krijojnë një mjedis të përgatitur dhe nxitës për fëmijët.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Materialet didaktike janë mjete për ndërtimin e mendjes, vetëbesimit dhe eksplorimit.
- Mjetet duhet të jenë të qëllimshme, të bukura, të përshtatshme për zhvillimin dhe të pasqyrojnë kulturën vendore.
- Roli i të rriturit është të përgatisë mjedisin dhe të udhëheqë fëmijën me respekt dhe vëzhgim të kujdesshëm.
- Mjedisi i të nxënit është dinamik dhe duhet të mirëmbahen përmes rotacionit të materialeve.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme

- Materiale të prezantimit në PowerPoint
- Fletë pune për planifikimin e materialeve
- Shembuj konkretë të materialeve natyrore dhe të ricikluara
- Model dokumentacioni dhe tabela për rotacionin

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. **Ligjet kombëtare të arsimit parashkollor** – specifikimet për strukturën, mjedisin, numrin e fëmijëve në grup, kualifikimet e mësuesve dhe kurrikulën bazë.
2. **Rregulloret mbi sigurinë dhe shëndetin në kopsht** – standardet për pajisjet, materialet e përdorura, higjienën dhe menaxhimin e emergjencave.

3. **Udhëzimet mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve** – përfshirë të drejtat e fëmijëve, privatësinë, dhe masat për mbrojtjen nga dhuna, abuzimi apo neglizhenca.
4. **Udhëzimet administrative për dokumentimin dhe raportimin** – si për propozimet, auditimet e materialeve dhe mbështetjen nga drejtoria.

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të shpërndahet: Projektor, Laptop, Flipchart, Markers,ngjitës.

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
Ky sesion fokusohet në rëndësinë e mjeteve didaktike si pjesë e mjedisit të të nxënit për fëmijët e moshës 3–6 vjeç. Fillimisht prezantohet filozofia themelore mbi përdorimin e materialeve edukative/mësimore, e përmbledhur në parimin "Dora është rruga drejt mendjes", duke theksuar se fëmijët mësojnë përmes veprimit, prekjes dhe eksplorimit. Diskutimi vijon me përfshirjen e kulturës vendore dhe burimeve vendore në krijimin e materialeve, duke nënvizuar rëndësinë e pasqyrimit të jetës dhe trashëgimisë së fëmijëve në mjetet që përdoren në klasë. Roli i të rriturit në këtë proces është thelbësor – jo vetëm si prezantues i materialeve, por si udhërrëfyes i qetë që përgatit hapësirën, vëzhgon dhe mbështet fëmijën në eksplorimin e tij.
Materialet didaktike organizohen sipas fushave të zhvillimit: jeta praktike, shqisore, gjuhë, matematikë, studime kulturore dhe zhvillim motorik. Çdo fushë mbështet aspekte të ndryshme të zhvillimit të fëmijës dhe ndihmon në ndërtimin e një mjedisi të pasur dhe të baraspeshuar.
Pjesëmarrësit do të njihen me një model planifikimi për përzgjedhjen dhe prezantimin e materialeve, duke përfshirë qëllimet direkte dhe indirekte, kontrollin e gabimit dhe fjalorin që mund të prezantohet. Në fund, sesioni trajton praktikën e rotacionit dhe mirëmbajtjes së materialeve, si një mënyrë për të mbajtur mjedisin të freskët, të gjallë dhe të përshtatur me nevojat dhe interesat në zhvillim të fëmijëve.

Tematikat kryesore të sesionit

1. Filozofia Themelore mbi Materialet Didaktike
Dokumenti nis me parimin se materialet që i vendosen në duar fëmijëve të moshës 3–6 vjeç nuk janë thjesht objekte për lojë – ato janë mjetet përmes të cilave fëmija ndërton mendimin, ndërton vetëbesimin dhe komunikon me botën. Filozofia e udhëzuesit përqendrohet në kuptimin e thellë të rolit të materialeve në zhvillimin njohës, social, emocional dhe motorik. Ato duhet të jenë të përzgjedhura me qëllim të qartë, të jenë të natyrshme, të bukura, me qëllim edukativ dhe të nxisin pavarësinë e fëmijës. Bukuria dhe funksionaliteti i materialit konsiderohen pjesë e procesit të të nxënit, po aq sa edhe ndërveprimi që fëmija ka me ta.

2. Përshtatja me Kontekstin Vendor: Burimet dhe Kultura
Udhëzuesi thekson rëndësinë e përdorimit të materialeve që pasqyrojnë realitetin kulturor dhe burimet e komunitetit. Çdo kopsht apo qendër ka mundësi të ndryshme financiare, materiale dhe njerëzore, ndaj udhëzimet janë elastike dhe të përshtatura. Përdorimi i materialeve vendore—gurë të lëmuar, materiale të ricikluara, objekte

natyrore apo burime kulturore—ndërton ndjenjën e përkatësisë dhe i ndihmon fëmijët të mësojnë në mënyrë të kuptimshme. Materialet gjuhësore, historitë, muzika dhe aktivitetet praktike duhet të pasqyrojnë traditat, jetën e përditshme dhe peizazhin kulturor të fëmijëve.

3. Roli i të Rriturit në Mjedisin e Përgatitur

Të rriturit nuk janë thjesht prezantues materialesh, por urë lidhëse midis fëmijës dhe mjedisit. Roli i edukatorit është të përgatisë hapësirën, të vëzhgojë me kujdes, të udhëzojë pa ndërhyrë dhe të krijojë një atmosferë respekti, durimi dhe kurioziteti. Qëndrimi i mësuesit konsiderohet si "materiali më i rëndësishëm" në klasë, sepse mënyra se si ai komunikon, si prezanton materialet dhe si i respekton ritmet e fëmijës ndikon drejtpërdrejt në pavarësinë, sigurinë emocionale dhe vetëbesimin e fëmijës.

4. Parimet Udhëzuese për Përzgjedhjen e Materialeve

Dokumenti përcakton disa bindje thelbësore që duhet të drejtojnë çdo përzgjedhje të materialeve:

Dora si Rruga për në Mendje

Fëmijët mësojnë duke bërë, duke prekur, duke manipuluar dhe duke lëvizur. Materialet duhet të jenë praktike dhe të prekshme, në mënyrë që fëmijët të ndërtojnë kuptime konkrete përpara se të kalojnë në abstraksione.

Pavarësia dhe Vetëkorrigjimi

Materialet duhet të ndihmojnë fëmijën të identifikojë vetë gabimin, pa nevojën konstante të ndërhyrjes së të rriturit. Kjo ndërton motivim të brendshëm dhe aftësi zgjidhjeje problemesh.

Përshtatja me Zhvillimin

Materialet duhet të jenë zhvillimisht të përshtatshme dhe të ofrojnë sfida të ndryshme për fëmijë të moshave të ndryshme.

Qëllimi dhe Estetika

Çdo material duhet të ketë një synim të qartë arsimor dhe një formë estetike që të tërheqë vëmendjen e fëmijëve dhe të nxisë respekt për mjedisin.

5. Procesi Ciklik i Planifikimit Didaktik

Planifikimi i materialeve përshkruhet si një proces ciklik, i përbërë nga këto faza:

1. Vëzhgimi

Vëzhgimi i fëmijëve është baza e planifikimit. Edukatori vëren interesat, nevojat, sfidat dhe modelet e sjelljes. Çdo material duhet të lidhet drejtpërdrejt me këto vëzhgime.

2. Organizimi i Mjedisit të të Nxënit

Materialet ndahen në fusha të qarta:

- Jeta Praktike
- Shqisore
- Gjuha
- Matematika
- Studime Kulturore
- Zhvillimi Motorik (i imët dhe i trashë) Ky organizim siguron që fëmijët të marrin stimuj të shumëanshëm që mbështesin zhvillimin holistik.

3. Përgatitja e Menduar
Për çdo material që futet në klasë, mësuesi duhet të sqarojë qëllimet direkte e indirekte, mënyrën e prezantimit dhe kontrollin e gabimit.
4. Prezantimi dhe Vëzhgimi Aktiv
Materialet prezantohen me qetësi dhe qartësi, pastaj i lihet hapësirë fëmijës të eksplorojë në mënyrë të pavarur. Mësuesi rifutet në rolin e vëzhguesit për të identifikuar progresin dhe nevojat e reja.
5. Rotacioni i Materialeve
Mjedisi duhet të jetë dinamik. Materialet që nuk përdoren hiqen, ruhen dhe rrotullohen me të reja që reflektojnë interesat dhe zhvillimin aktual të fëmijëve. Mjedisi mbetet i gjallë, i freskët dhe funksional.

6. Rëndësia e Mjedisit të Përgatitur
Dokumenti thekson se mjedisi nuk është një sfond, por një pjesë aktive e procesit të të nxënit. Një mjedis i mirëorganizuar:

- nxit eksplorimin,
- mbështet pavarësinë,
- lehtëson mësimin e thellë,
- u mundëson fëmijëve të ndërtojnë kuptime përmes përvojës,
- krijon rend dhe qetësi që favorizojnë përqendrimin.

Mjedisi i përgatitur është një faktor kyç që formëson cilësinë e të nxënit dhe mirëqenien e fëmijës.

7. Modeli i Planifikimit dhe Propozimit të Materialeve Didaktike
Ky seksion ofron një strukturë praktike që mësuesit duhet të ndjekin për të planifikuar, propozime dhe vlerësuar materialet. Modeli përfshin:

- përshkrimin e materialit,
- qëllimet edukative/mësimore,
- planin e prezantimit,
- kontrollin e gabimit,
- vëzhgimet mbi përdorimin,
- rishikimin nga Drejtoria.

Ky model standardizon procesin dhe ndihmon në ndërtimin e një mjedisi të përbashkët cilësor në të gjitha klasat.

8. Udhëzimet për mësuesit dhe rdejtorinë
Dokumenti ofron udhëzime konkrete:
Për mësuesit:

- planifikoni materialet në mënyrë të qëllimshme,
- përdorni modelin formal për propozime,
- vëzhgoni dhe rishikoni vazhdimisht efektivitetin,
- bashkëpunoni me drejtorinë për përmirësim.

Për drejtorinë:

- standardizoni cilësinë e materialeve në të gjitha klasat,
- mbështesni mësuesit në furnizime dhe trajnime,

- përdorni modelin për planifikim buxheti dhe bashkërendim pedagogjik.

Ndërsa nisim punën jetësore të formësimit të mjedisit të të nxënit për fëmijët tanë të vegjël (mosha 3-6 vjeç), duhet të jemi të qëllimshëm në lidhje me materialet që u vendosim në duar. Këto materiale nuk janë thjesht lodra; ato janë mjetet përmes të cilave një fëmijë ndërton mendjen e tij, ndërton vetëbesim dhe zbulon botën. Ky udhëzues përshkruan filozofinë tonë të përbashkët dhe një proces të qartë, ciklik për përzgjedhjen, krijimin dhe menaxhimin e këtyre materialeve thelbësore didaktike.
Filozofia jonë e përbashkët: "Pse"-ja pas materialeve
Para se të futemi në këtë proces, duhet ta rrënjosim këtë udhëzues në komunitetin tonë specifik. Njohja e Burimeve: "Ne e kuptojmë që çdo kopsht ka burime të ndryshme. Ky udhëzues është hartuar për t'u përshtatur. Ndërsa do t'i referohemi materialeve klasike, ne festojmë në mënyrë të barabartë krijueshmërinë e materialeve të bëra nga mësuesit duke përdorur burime vendore, të ricikluara dhe natyrore. Një set gurësh të lëmuar për numërim mund të jetë po aq i fuqishëm sa një set i blerë."
Përfshirja e Kulturës Vendore: "Materialet tona didaktike duhet të pasqyrojnë jetën dhe trashëgiminë e fëmijëve. Kjo do të thotë që kartat tona gjuhësore duhet të përfshijnë fruta, kafshë dhe monumente vendore. Fusha jonë e jetës praktike duhet të përfshijë aktivitete relevante për jetën tonë të përditshme dhe praktikat kulturore. Historitë dhe muzika jonë duhet të përfshijnë gjuhën dhe traditat tona vendore. Kjo siguron që të mësuarit të jetë kuptimplotë dhe të ndërtojë identitet dhe krenari."
Roli i të Rriturit: "Përtej prezantimit të materialeve, roli i të rriturit është të jetë një lidhje midis fëmijës dhe mjedisit. Ne përgatisim hapësirën, vëzhgojmë dhe udhëzojmë butësisht. Qëndrimi ynë i respektit, durimit dhe çudisë është 'materiali' më i rëndësishëm në dhomë."
Çdo material që zgjedhim për klasat tona do të udhëhiqet nga disa bindje kryesore:
Dora është Rruga drejt Mendjes: Ne besojmë se fëmijët mësojnë duke vepruar. Prandaj, materialet tona duhet të jenë praktike dhe manipuluese, duke ftuar prekjen, lëvizjen dhe eksplorimin.
Nxitja e Pavarësisë: Materialet tona duhet të jenë autoedukative (vetëkorrigjuese). Kjo do të thotë që fëmija mund ta shohë gabimin e vet pa një të rritur që ta tregojë gjithmonë. A nuk përshtatet pjesa tek i gjithë mozaiku? A ka ujë të derdhur në tabaka? Ky reagim ndërton aftësi për zgjidhjen e problemeve dhe motivim të brendshëm.
Takojme Fëmijët Aty ku Janë: Materialet duhet të jenë të përshtatshme për zhvillimin. Një fëmijë tre vjeç ka nevojë për sfida të ndryshme nga një fëmijë gjashtë vjeç që përgatitet për kopështn fillore. Përzgjedhjet tona do të respektojnë këtë udhëtim të bukur rritjeje.
Qëllimi dhe Bukuria: Çdo material duhet të ketë një qëllim të qartë - një aftësi ose koncept specifik që synon ta zhvillojë. Për më tepër, ne do të përpiqemi t'i bëjmë materialet tona estetikisht të këndshme, të bëra nga elemente natyrore si druri, pëlhura dhe metali, aty ku është e mundur. Bukuria tërheq interesin e fëmijës dhe mëson respektin për mjedisin e tij.
Procesi ynë i Planifikimit: "Si"
Qasja jonë nuk është një konfigurim i njëhershëm, por një cikël i vazhdueshëm vëzhgimi, reflektimi dhe veprimi.

1. Vëzhgimi: Themeli i Gjithçkaje Para se të planifikojmë një aktivitet të vetëm, së pari duhet të bëhemi vëzhgues të mprehtë. Vëzhgoni fëmijët. Me çfarë po përballen? Për çfarë janë kuriozë? Vini re fëmijën që ende nuk mund ta lidhë pallton, grupin që mbledh dhe numëron gurë pafundësisht, ose individin që shikon çdo libër me figura rreth oqeanit. Nevojat dhe interesat e fëmijëve tanë janë plani për planifikimin tonë.
2. Organizimi i Mjedisit tonë të të Nxënit Për të siguruar që mbështesim të gjitha aspektet e zhvillimit të një fëmije, ne do t'i organizojmë materialet tona në fusha të dallueshme:

Jeta Praktike: Materiale për kujdesin ndaj vetes dhe mjedisit (p.sh., derdhje, fshirje, korniza veshjeje) për të zhvilluar bashkërendimin, rendin dhe pavarësinë.
Shqisore: Materiale që përsosin shqisat (p.sh., kuti zanore, tableta me ngjyra, forma gjeometrike) për të ndihmuar fëmijët të klasifikojnë dhe kuptojnë botën përreth tyre.
Gjuha: Materiale që ndërtojnë fjalorin, aftësitë parashkrimore dhe shkrim-leximin e hershëm (p.sh., shkronja me letër zmerile, përputhje figurash, objekte për rrëfim historish). Matematika: Materiale që i bëjnë konceptet abstrakte si sasia dhe sekuenca të prekshme (p.sh., shufra numrash, rruaza numërimi, blloqe modelesh).
Studime Kulturore: Materiale që hapin dritare drejt botës më të gjerë - gjeografi, shkencë, art dhe muzikë (p.sh., harta enigmash, koleksione natyre, figura kafshësh).
Zhvillimi Motorik: Materiale si për lëvizjen e trupit të madh (motorikë e trashë) ashtu edhe për punën delikate me dorë (motorikë e imët) që janë kritike për shëndetin fizik dhe shkrimin.

3. Përgatitje e menduar mirë: Puna e mësuesit Për çdo material që prezantojmë, do të pyesim veten:

Cili është qëllimi i drejtpërdrejtë? (p.sh., Të identifikojë ngjyrat kryesore.)
Cilat janë qëllimet jo të drejtpërdrejta? (p.sh., Zhvillimi i përqendrimit, dallimi vizual dhe përgatitja për aktivitete artistike.)
Si e di fëmija nëse e ka bërë saktë? (Cili është kontrolli i gabimit?).
Çfarë fjalori të ri mund të prezantojmë? Do t'i përgatisim demonstrimet tona të jenë të ngadalta, të sakta dhe ftuese.

4. Arti i Prezantimit dhe Vëzhgimit Kur prezantojmë një material, e bëjmë këtë si një udhërrëfyes i qetë. Ne modelojmë përdorimin e tij, pastaj bëjmë një hap prapa për t'i lejuar fëmijës të eksplorojë dhe zbulojë vetë. Roli ynë pastaj kthehet përsëri në vëzhgim, duke vënë re se çfarë zbulon aktiviteti në lidhje me kuptimin dhe gatishmërinë e fëmijës për sfidën tjetër.
5. Rotacioni: Mbajtja e Mjedisit Gjallë Një mjedis i rrëmujshëm dhe i ndenjur është i tepërt. Ne do të praktikojmë artin e rotacionit. Materialet që nuk përdoren më do të hiqen dhe ruhen me respekt. Ato mund të riprezantohen më vonë ose të zëvendësohen me aktivitete të reja që pasqyrojnë interesat dhe aftësitë në zhvillim të fëmijëve. Raftet tona duhet të ndihen të freskëta, mikpritëse dhe të qëllimshme, me çdo material që luan një rol të qartë.

Ky proces është një udhëtim që ne ndërmarrim së bashku me fëmijët. Është një praktikë e përgjegjshme dhe reflektuese. Duke vëzhguar thellë, duke organizuar me kujdes dhe duke mirëmbajtur mjedisin tonë me kujdes, ne bëjmë më shumë sesa thjesht të ofrojmë aktivitete - ne krijojmë një mjedis të përgatitur që nderon potencialin

e jashtëzakonshëm të çdo fëmije dhe i fuqizon ata të bëhen nxënës të sigurt, të pavarur dhe të gëzuar.

Sesioni 7.3 Instrument për vëzhgimin në klasë – në ndihmë të monitorimit për siguri, aksesueshmëri dhe përshtatshmëri zhvillimore.

Objektivi: Të prezantohen dhe të aftësohen pjesëmarrësit për përdorimin e instrumentit të vëzhgimit për matjen e cilësisë së klasave në institucionet arsimore parashkollore, duke theksuar rëndësinë e tij si mjet për përmirësimin e praktikave edukative.

Tematika:

- Përdorimi i instrumentit të vëzhgimit për cilësinë e klasave- Kjo tematikë prezanton një mjet të strukturuar për vlerësimin e klasave në institucionet arsimore parashkollore, duke përfshirë kriteret e përgatitjes, mënyrën e realizimit të vëzhgimit dhe sjelljen e vëzhguesit në mjedisin edukativ.
- Dokumentimi dhe bashkëpunimi për vlerësim të besueshëm- Theksohet rëndësia e mbajtjes së shënimeve të hollvsishme dhe e bashkërendimit ndërmjet vëzhguesve për të siguruar një vlerësim të saktë, të qëndrueshëm dhe të dobishëm për përmirësimin e praktikave edukative.

Rezultatet e të nxënit të sesionit:

- Pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të përgatisin dhe të realizojnë një vëzhgim efektiv në klasat e kopshteve.
- Do të kuptojnë kriteret dhe mënyrën e pikëzimit të aktiviteteve gjatë ditës.
- Do të aftësohen të mbajnë shënime të hollësishme dhe të analizojnë situatat edukative në mënyrë objektive.
- Do të jenë të vetëdijshëm për rolin e tyre si vëzhgues dhe ndikimin që prania e tyre ka në mjedisin e klasës.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime ne grup (Shtojca nr. 2)**

Synon të theksojë rëndësinë e përgatitjes dhe metodologjisë së vëzhgimit të klasave për fëmijët 3.5–6 vjeç, duke përfshirë familjarizimin me mjedisin dhe instrumentin e vëzhgimit, bashkërendimin me mësuesin përpara fillimit të mësimit, dhe regjistrimin sistematik të aktiviteteve gjatë kohës së qëndrimit në klasë. Ai synon gjithashtu të ndihmojë pjesëmarrësit të kuptojnë mënyrën e kryerjes së vëzhgimit në mënyrë të kujdesshme, objektive dhe të plotë, përfshirë procedurat për ndihmën e fëmijëve dhe bashkëpunimin me vëzhguesit e tjerë, në mënyrë që të matet cilësia e mjedisit të të nxënit dhe të nxirren përfundime të qëndrueshme dhe të besueshme.

- **Simulime praktike (Shtojca nr. 3)**

Simulimi praktik i vëzhgimit në klasat e fëmijëve 3.5–6 vjeç ka për qëllim të vlerësojë cilësinë e mjedisit, rutinat, burimet mësimore dhe ndërveprimet në institucionet e arsimit parashkollor. Vëzhguesi duhet të jetë i familjarizuar me instrumentin dhe mjedisin e klasës, të arrijë para fillimit të mësimit për të marrë informacionin e nevojshëm mbi institucionin dhe mësuesin, dhe të kryejë vëzhgimin për një periudhë 3-4 orëshe. Gjatë vëzhgimit, ai duhet të jetë i kujdesshëm në praninë e tij, të monitorojë aktivitetet dhe të synojë të gjitha veprimtaritë ndërvepruese, duke marrë shënime të hollësishme për çdo paqartësi. Instrumenti i përdorur për vlerësim përfshin rubrika të ndryshme që fokusohen në organizimin e klasës, burimet e mësimit, shëndetin dhe higjenën, rutinat, mjedisin e leximit-shkrimit dhe matematikës, si dhe ndërveprimet mes fëmijëve dhe mësuesit. Pikët për secilën rubrikë llogariten duke u bazuar në përgjigjet e vëzhguesit (“A”, “B”, “C”), duke u konvertuar në një rezultat të përgjithshëm që pasqyron nivelin e cilësisë së klasës në një shkallë nga 1 deri në 5. Ky proces lejon një vlerësim objektiv dhe të strukturuar të mjedisit dhe praktikave arsimore.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Vëzhgimi është një proces profesional që kërkon përgatitje, vëmendje dhe objektivitet.
- Prania e vëzhguesit duhet të jetë diskrete, por efektive për të kapur dinamikën e klasës.
- Pikëzimi duhet të bëhet në kohë reale dhe të reflektojë aktivitetet e vërteta të fëmijëve dhe mësuesit.
- Bashkëpunimi dhe reflektimi ndërmjet vëzhguesve ndihmon në përmirësimin e cilësisë së vlerësimit.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

- Materiale të prezantimit në PowerPoint
- Udhëzuesi i instrumentit të vëzhgimit
- Fletë për mbledhjen e informacionit bazë
- Skema për pikëzimin e aktiviteteve

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Udhëzuesi i instrumentit të vëzhgimit është një dokument orientues që shpjegon mënyrën e përdorimit të një mjeti të strukturuar për vlerësimin e cilësisë së klasave në institucionet arsimore parashkollore. Ai përfshin udhëzime të qarta mbi përgatitjen paraprake, si familjarizimi me mjedisin, komunikimi me mësuesin dhe mbledhja e informacionit bazë për institucionin, si dhe procedurat për realizimin e vëzhgimit në mënyrë profesionale dhe neutrale. Udhëzuesi detajon kriteret e vlerësimit që lidhen me sigurinë fizike, aksesueshmërinë e materialeve dhe përshtatshmërinë zhvillimore të aktiviteteve për moshën 3.5–6 vjeç, duke përfshirë tregues për ndërveprimet edukative dhe organizimin e mjedisit. Gjithashtu, thekson rëndësinë e mbajtjes së shënimeve të

hollësishme dhe bashkëpunimit ndërmjet vëzhguesve për të siguruar një vlerësim të saktë, të qëndrueshëm dhe të besueshëm. Ky udhëzues nuk është thjesht një manual teknik, por një mjet për zhvillim profesional, që synon të ndihmojë edukatorët dhe drejtuesit e institucioneve të reflektojnë mbi praktikat e tyre dhe të ndërmarrin hapa konkrete për përmirësimin e cilësisë së mjedisit edukativ/mësimor.

Ky instrument është hartuar për të matur cilësinë e klasave në kopshte dhe qendra të fëmijërisë së hershme që frekuentohen nga fëmijë të moshës 3.5–6 vjeç. Ai nuk është i përshtatshëm për përdorim në klasa apo qendra për fëmijët 0–3 vjeçarë, pasi kriteret e tij janë të orientuara drejt zhvillimit dhe nevojave të grupmoshës parashkollore. Për të siguruar një vëzhgim të saktë dhe profesional, përgatitja paraprake është thelbësore. Vëzhguesi duhet të jetë i familjarizuar me mjedisin e kopshtit dhe të arrijë në qendër përpara fillimit të klasës, në mënyrë që të komunikojë me mësuesin ose lehtësuesin, të kuptojë strukturën e ditës dhe të vëzhgojë të gjithë procesin e mësimit. Vëzhgimi duhet të zgjasë të paktën 3–4 orë për të mbuluar një gamë të plotë aktivitetesh. Para fillimit të klasës, vëzhguesi plotëson sa më shumë informacion identifikues që mundet, si emri i institucionit, karakteristikat e mësuesit dhe të dhëna të tjera bazë, për të shmangur shpërqendrimin gjatë vëzhgimit. Po ashtu, është e domosdoshme që vëzhguesi të familjarizohet me instrumentin përpara hyrjes në klasë, për të siguruar përdorim korrekt dhe të qëndrueshëm.

Gjatë vëzhgimit, sjellja e vëzhguesit duhet të jetë diskrete dhe neutrale, duke ruajtur një pamje të qartë të pjesës më të madhe të klasës pa ndërhyrë në rrjedhën natyrale të mësimit. Nëse një fëmijë kërkon ndihmë, vëzhguesi nuk duhet të ndërhyjë, por ta drejtojë fëmijën te mësuesi ose lehtësuesi. Pikëzimi i aktiviteteve bëhet natyrshëm, në kohën kur ato ndodhin, pa ndjekur domosdoshmërish rendin e paraqitur në instrument. Është e rëndësishme që vëzhguesi të përpiqet të plotësojë të gjitha pjesët e instrumentit gjatë kohës së vëzhgimit, duke shmangur lënien e boshllëqeve për t'u plotësuar më vonë. Në rast se lind paqartësi për ndonjë pikë, vëzhguesi duhet të marrë shënime të hollësishme dhe t'i diskutojë ato me vëzhguesin tjetër për të siguruar një vlerësim të saktë dhe të besueshëm. Ky proces i strukturuar garanton që instrumenti të përdoret si një mjet profesional për monitorimin e cilësisë së klasave, duke kontribuar në përmirësimin e praktikave edukative dhe krijimin e një mjedisi të sigurt, gjithëpërfshirës dhe të përshtatshëm për zhvillimin e fëmijëve.

Përdorimi i instrumentit të vëzhgimit sjell një sërë përfitimesh të rëndësishme për cilësinë e edukimit parashkollor:

Siguron një vlerësim objektiv dhe të standardizuar

Instrumenti ofron kritere të qarta dhe tregues të matshëm, duke reduktuar subjektivitetin dhe duke garantuar që vlerësimi i klasës të jetë i bazuar në prova dhe të dhëna.

1. **Përmirëson cilësinë e mjedisit edukativ/mësimor**

Përmes vëzhgimit sistematik identifikohen pikat e forta dhe fushat që kërkojnë përmirësim, duke ndihmuar institucionet të ndërmarrin masa konkrete për siguri, aksesueshmëri dhe përshtatshmëri zhvillimore.

2. **Mbështet zhvillimin profesional të edukatorëve**

Rezultatet e vëzhgimit shërbejnë si bazë për reflektim dhe trajnime të mëtejshme, duke i ndihmuar edukatorët të përmirësojnë praktikat e tyre pedagogjike.

3. **Forcon bashkëpunimin dhe transparencën**

Instrumenti krijon një gjuhë të përbashkët mes vëzhguesve, drejtuesve dhe edukatorëve, duke lehtësuar komunikimin dhe bashkërendimin për përmirësimin e cilësisë.

4. Ndihmon në vendimmarrje të informuar

Të dhënat e mbledhura përmes vëzhgimit përdoren për hartimin e politikave vendore, planifikimin e burimeve dhe përmirësimin e standardeve në institucionet parashkollore.

5. Siguron mbrojtjen dhe mirëqenien e fëmijëve

Duke monitoruar sigurinë fizike, qasjen dhe përshtatshmërinë e aktiviteteve, instrumenti kontribuon në krijimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për çdo fëmijë.

Sesioni 7.4 Krijimi i mjedisit cilësor i të nxënit në kopshte në funksion të standarteve dhe kurrikula e re e Arsimit Parashkollor

Objektivi: Të prezantohet funksioni i hapësirave edukative në zhvillimin e fëmijëve, duke kuptuar lidhjen me standardet zhvillimore dhe duke aftësuar pjesëmarrësit në vëzhgimin dhe analizimin e cilësisë së mjedisit edukativ/mësimor.

Tematika:

1. Funksioni i hapësirave edukative në zhvillimin e fëmijëve. Kjo tematikë trajton rolin e hapësirave si konstruksionet, loja me role, biblioteka, atelieja dhe mjedisi i jashtëm në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve, duke i lidhur me qëllimet edukative dhe standardet zhvillimore.
2. Vëzhgimi dhe analiza e cilësisë së mjedisit edukativ- Pjesëmarrësit njihen me mënyrën e vëzhgimit të hapësirave, përgatitjen për vëzhgim, sjelljen e vëzhguesit dhe pikëzimin e aktiviteteve në kohë reale, si mjet për përmirësimin e praktikave edukative.
3. Rëndësia e regjimit ditor dhe rutinës në organizimin e klasës.-Diskutohet ndikimi i strukturës ditore dhe rutinave në krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm, të parashikueshëm dhe mbështetës për zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve.

Rezultatet e të nxënit të sesionit:

- Pjesëmarrësit do të identifikojnë hapësirat kryesore në një institucion arsimor parashkollor dhe funksionin e tyre.
- Do të kuptojnë se si secila hapësirë ndikon në fusha të ndryshme të zhvillimit të fëmijës (fizik, emocional, gjuhësor, njohës, motorik).
- Do të aftësohen të vëzhgojnë dhe të analizojnë mjedisin edukativ në përputhje me standardet.
- Do të reflektojnë mbi rëndësinë e rutinave ditore dhe organizimit të aktiviteteve në funksion të zhvillimit të fëmijëve.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim në grup (Shtojca nr. 2)**

Synon të kuptojë dhe të ndërlidhë mënyrat se si hapësirat dhe aktivitetet në kopsht/parashkollor ndikojnë në zhvillimin e fëmijëve, duke përfshirë aspektet fizike, njohëse, socio-emocionale dhe gjuhësore. Ai ndihmon pjesëmarrësit të analizojnë sesi lojërat, aktivitetet krijuese, leximi, mjedisi i jashtëm dhe rutina ditore ofrojnë mundësi të të nxënit të lirë, ndërveprime sociale dhe ndërtim të kuptimit, duke mbështetur standardet e zhvillimit të arsimit parashkollor dhe praktikat e mira pedagogjike.

- **Ushtrime praktike (Shtojca nr. 3)**

Për analizimin e hapësirave dhe lidhjen me standardet e zhvillimit. Ato synojnë të zhvillojnë aftësinë e pjesëmarrësve për të analizuar hapësirat e mësimit dhe për t'i lidhur ato me standardet e zhvillimit të fëmijëve, duke identifikuar se si mjediset, aktivitetet dhe materialet mbështesin zhvillimin fizik, njohës, socio-emocional dhe gjuhësor.

- **Simulime (Shtojca nr. 4)**

Për vëzhgimin dhe pikëzimin e aktiviteteve gjatë ditës. Aktiviteti synon të zhvillojë aftësinë e pjesëmarrësve për të vëzhguar dhe vlerësuar aktivitetet e fëmijëve gjatë ditës, duke identifikuar mënyrat se si këto aktivitete kontribuojnë në zhvillimin e tyre të gjithanshëm.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Hapësirat edukative janë të lidhura ngushtë me zhvillimin e gjithanshëm të fëmijës.
- Çdo hapësirë duhet të jetë e menduar për të mbështetur një ose më shumë fusha zhvillimi.
- Vëzhgimi i mjedisit edukativ është një proces profesional që ndihmon në përmirësimin e cilësisë së edukimit.
- Rutinat ditore dhe organizimi i aktiviteteve janë thelbësore për sigurinë, parashikueshmërinë dhe zhvillimin e fëmijëve.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme:

Materiale të prezantimit në PowerPoint.

- Tabela e hapësirave edukative me përshkrime dhe standarde
- Udhëzues për vëzhgimin e klasave
- Fletë për pikëzimin e aktiviteteve
- Raste studimore për analizë

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

- Dokumenti teknik udhëzues
- Matrica për krijimin e hapësirave të të nxënit bazuar në standardet e zhvillimit të parashkollorit
    - Për secilën hapësirë: Konstruksione, "Bëj rolin e…", Maskohem, Librat/Biblioteka, Atelie, Mjedisi i jashtëm
- Regjimi ditor dhe rutina
    - Takimi i mëngjesit
    - Loja/koha e lirë
    - Ora e aktiviteteve të planifikuara (projektet edukative)

- Dreka (vakti)

Pajisjet që do të përdoren:

Gjatë sesionit do të përdoren: *Projektor, Laptop,* Flip chart, Markers,ngjitës

PËRMBAJTJA TEORIKE E UDHËZUESIT

Ky sesion trajton hapësirat edukative si elemente kyç në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve në moshën 3.5–6 vjeç. Diskutohet funksioni i hapësirave si: konstruksionet, loja me role, maskimi, biblioteka, atelieja, mjedisi i jashtëm, si dhe rëndësia e regjimit ditor dhe rutina. Çdo hapësirë përshkruhet në lidhje me qëllimin e saj edukativ dhe standardet që mbështet. Pjesëmarrësit njihen me mënyrën e vëzhgimit të këtyre hapësirave, duke përfshirë përgatitjen, sjelljen e vëzhguesit dhe pikëzimin e aktiviteteve në kohë reale.

Temat kryesore lidhen me:

1. **Hapësirat fizike dhe krijueshmërinë** – konstruksione, lojë simbolike, atelie, biblioteka, mjedisi i jashtëm.
2. **Materialet didaktike dhe qasja ndaj të nxënit** – materiale të përshtatura për zhvillim njohës, motorik dhe gjuhësor.
3. **Rutina dhe organizimi ditor** – takimi i mëngjesit, loja e lirë, aktivitetet e planifikuara, ngrënia e përbashkët.
4. **Standardet e zhvillimit të fëmijës** – fizike, motorike, njohëse, gjuhësore, socio-emocionale dhe qasja ndaj të nxënit.

Funksioni i hapësirave edukative në zhvillimin e fëmijëve

Hapësirat edukative në institucionet arsimore parashkollore nuk janë thjesht vende fizike; ato janë mjedise të menduara për të mbështetur zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve. Çdo hapësirë ka një funksion specifik dhe kontribuon në fusha të ndryshme të zhvillimit. Hapësira e konstruksioneve, për shembull, i ndihmon fëmijët të eksperimentojnë me koncepte matematikore dhe fizike, duke zhvilluar aftësitë motorike dhe mendimin logjik. Loja me role dhe hapësira e maskimit u jep fëmijëve mundësinë të shprehin emocione, të ndërtojnë identitetin social dhe të zhvillojnë gjuhën përmes komunikimit. Biblioteka është një hapësirë që nxit shkrim-leximin, imagjinatën dhe aftësitë e të kuptuarit, ndërsa atelija mbështet krijimtarinë, zgjedhjen e pavarur dhe zhvillimin artistik. Mjedisi i jashtëm është po aq i rëndësishëm, pasi ofron mundësi për eksplorim, aktivitet fizik dhe ndërveprim me natyrën, duke ndikuar pozitivisht në shëndetin fizik dhe mirëqenien emocionale. Këto hapësira, të organizuara sipas standardeve të zhvillimit, krijojnë një mjedis të pasur që mbështet qasjen ndaj të nxënit, zhvillimin socio-emocional, gjuhësor, njohës dhe fizik.

Vëzhgimi dhe analiza e cilësisë së mjedisit edukativ

Vëzhgimi i hapësirave edukative është një proces profesional që synon të vlerësojë cilësinë e mjedisit dhe efektivitetin e praktikave pedagogjike. Përgatitja për vëzhgim përfshin njohjen e mjedisit, komunikimin me edukatorin dhe mbledhjen e informacionit bazë për institucionin. Vëzhguesi duhet të jetë diskret, i paanshëm dhe të sigurojë që prania e tij të mos ndikojë në sjelljen natyrale të fëmijëve. Pikëzimi i aktiviteteve bëhet

në kohë reale, duke përdorur instrumente të strukturuara që matin elemente si siguria, aksesueshmëria, përshtatshmëria zhvillimore dhe ndërveprimet edukative. Shënimet e hollësishme janë thelbësore për interpretimin e saktë, ndërsa bashkëpunimi mes vëzhguesve siguron konsistencë dhe besueshmëri. Ky proces nuk është thjesht monitorim, por një mjet për përmirësimin e praktikave, duke ndihmuar edukatorët të reflektojnë dhe të ndërmarrin masa konkrete për zhvillimin e cilësisë.

Rëndësia e regjimit ditor dhe rutinës në organizimin e klasës

Regjimi ditor dhe rutina janë elemente kyç për krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe mbështetës për fëmijët. Një strukturë e parashikueshme i ndihmon fëmijët të ndihen të sigurt dhe të zhvillojnë aftësi për menaxhimin e kohës dhe pritshmërive. Takimi i mëngjesit është një moment i rëndësishëm për ndërtimin e komunitetit, ku fëmijët shprehin ide, dëgjojnë të tjerët dhe mësojnë të marrin vendime. Koha e lojës së lirë u jep fëmijëve mundësinë të eksplorojnë, të ndërveprojnë dhe të zhvillojnë kreativitetin. Aktivitetet e planifikuara, si projektet edukative, i ndihmojnë fëmijët të thellojnë njohuritë dhe të punojnë në mënyrë bashkëpunuese. Edhe momentet e përditshme, si dreka, janë mundësi për të zhvilluar aftësi sociale dhe për të ndërtuar marrëdhënie pozitive. Një rutinë e menduar mirë nuk kufizon fëmijët, por krijon një kornizë fleksibile që mbështet nevojat e tyre individuale dhe promovon mirëqenien.

"Matrica në funksion të krijimit të hapësirave të të nxënit bazuar në standardet e zhvillimit të parashkollorit":

Matrica si mjet për organizimin e hapësirave edukative

Matrica e hapësirave edukative është një instrument praktik që ndihmon edukatorët dhe drejtuesit e institucioneve arsimore parashkollore të planifikojnë mjedisin e të nxënit në mënyrë të strukturuar, duke e lidhur çdo hapësirë me funksionin e saj pedagogjik dhe standardet e zhvillimit të fëmijëve. Organizimi i hapësirave nuk është thjesht një çështje estetike, por një strategji për të mbështetur zhvillimin gjithëpërfshirës të fëmijëve në fusha si shëndeti fizik, zhvillimi motorik, socio-emocional, gjuhësor, njohës dhe qasja ndaj të nxënit.

Emri i hapësirës	**Përse përdoret**	**Standardi**
Konstruksione (të vogla dhe të mëdha)	Në këtë hapsirë fëmijët eksperimentojnë përmes lojës, mundësive për të punuar me koncepte matematikore dhe fizike. Fëmijët duhet të jenë të lirë dhe nëpërmjet vëzhgimit të kuptohen arritjet e të nxënit. Pasja e një tematike mbështet ndërtimin e kuptimtë dhe motivimin.	- Shëndeti Fizik - Qasje ndaj të Nxenit - Zhvillim njohës - Zhvillim motor
"Bëj rolin e ..." "Jam si…"	Në hapësirën e lojës "Bëj rolin e..." fëmijët mund të shprehin lirshëm	- Zhvillim fizik - Zhvillim Socio - emocional

	reflektime personale të thella , mendime dhe emocione . Përmes këtij aktiviteti mund të mbledhim informacion rreth mirëqenies së fëmijëve.	- Zhvillim Gjuhesor dhe Komunikim - Zhvillim njohës - Zhvillim motor
Maskohem	Fëmijët mund të mësojnë edhe nëpërmjet kësaj loje. Duke luajtur në një mjedis tek i cili mund të gjejnë fustane e kostume të vjetra, kapela, këpucë dhe aksesorë për t'i mbështetur në lojën e tyre.	- Zhvillim fizik - Zhvillim Socio - emocional - Zhvillim Gjuhësor dhe Komunikim - Zhvillim njohës - Zhvillim motor
Librat/Biblioteka	Duke filluar me hapjen e librit Leximin e historive Diskutimit Është provuar që është mënyra më e mirë për të filluar Punën me literaturën, kodimin e të nxënit dhe jo vetëm . Kjo i ndihmon fëmijët me tregimin e historive dhe ndërtimin e kuptimit Dy procese që ndihmojnë njëri tjetrin.	• Qasja ndaj të nxënit • Zhvillimi Socio – Emocional • Zhvillimi gjuhesor dhe Komunikimi • Zhvillimi Njohës
Atelie	Fëmijëve u pëlqen të ndërtojnë, vizatojnë Atelija mund të jetë vendi në të cilin gjejnë materiale për t'i përdorur për të gjitha krijimet e tyre artistike.	• Qasja ndaj të nxënit • Zhvillimi Socio – Emocional • Zhvillimi Njohës • Zhvillimi Fizik

	Është e rëndësishme që ata t'i marrin dhe ti përzgjedhin vetë materialet që do të përdorin	
Mjedisi i jashtëm	Marrëdhënia me mjedisin e jashtëm si dhe me oborrin e shkollës/kopshtit është thelbësore. Sa herë që është e mundur fëmijët duhet të qëndrojnë jashtë dhe të jenë të lirshëm të zbulojnë botën përrreth. Kjo ndihmon trupin dhe mendjen.	1. Shëndeti Fizik 2. Zhvillimi Socio – Emocional 3. Zhvillimi Fizik

MODULI 8 PLANI AFATMESËM i KOPSHTIT

Përmbledhje e modulit:

Ky modul trajton rëndësinë, përmbajtjen dhe mënyrën e hartimit të Planit Afatmesëm për Zhvillimin e Kopshtit si një proces gjithëpërfshirës, sistematik dhe decentralizuar, që synon zhvillimin profesional dhe cilësor të institucionit arsimor parashkollor. Përmes përfshirjes së aktorëve të ndryshëm (drejtues, mësues, prindër, komunitet), plani afatmesëm shërben si udhërrëfyes për rritjen e cilësisë së arsimit parashkollor, përmirësimin e kushteve të të nxënit dhe për zhvillimin progresiv të kopshtit në një periudhë 3–4 vjeçare.
Moduli paraqet konceptet bazë të planifikimit afatmesëm, elementet kryesore të tij (kredon, analizën e gjendjes, prioritetet, mbikëqyrjen dhe raportimin), si dhe teknikat që përdoren për të identifikuar pikat e forta e të dobëta të institucionit.

Qëllimi i modulit:

Qëllimi i këtij moduli është të aftësojë drejtuesit dhe mësuesit e kopshtit për të hartuar, zbatuar dhe mbikëqyrur një plan afatmesëm zhvillimi në përputhje me nevojat reale të institucionit dhe komunitetit.

Rezultatet e të nxënit:

Nëpërmjet këtij moduli, pjesëmarrësit aftësohen të:

- Kuptojnë rëndësinë e planifikimit afatmesëm si mjet i decentralizimit dhe zhvillimit profesional.
- Përvetësojnë njohuritë mbi përbërësit thelbësorë të planit (misioni, besimet, vizioni, analiza e gjendjes, prioritetet).
- Zhvillojnë aftësinë për të identifikuar dhe analizuar pikat e forta dhe të dobëta të kopshtit përmes teknikave si “stuhia e ideve (brainstorming)”, “tullumbacja” dhe “SWOT”.
- Aplikojnë praktika efektive për mbikëqyrjen dhe raportimin e zbatimit të planit në mënyrë të vazhdueshme dhe bashkëpunuese.

Grupi i synuar:

Ky modul është i dedikuar për:

- Drejtorët e kopshteve, të cilët kanë rolin kryesor në hartimin, drejtimin dhe zbatimin e planit afatmesëm.
- Mësuesit e kopshteve, si kontribues aktivë në procesin e analizës, planifikimit dhe vetëvlerësimit të kopshtit.
- Anëtarët e bordeve të kopshtit dhe përfaqësues të prindërve, që marrin pjesë në miratimin dhe ndjekjen e zbatimit të planit.
- Përfaqësues të pushtetit vendor dhe të institucioneve arsimore, të cilët mbështesin financiarisht dhe institucionalisht procesin e zhvillimit të kopshtit.

Sesioni 8.1: Përse një plan afatmesëm për zhvillimin e kopshtit

Objektivat: Të kuptohet rëndësia dhe domosdoshmëria e Planit Afatmesëm për Zhvillimin e Kopshtit si një proces gjithëpërfshirës, sistematik dhe i decentralizuar, që synon zhvillimin profesional dhe cilësor të institucionit arsimor parashkollor.
Në përfundim të temës, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë rolin e planifikimit afatmesëm në zhvillimin progresiv të kopshtit.
- Identifikojnë arsyet pse planifikimi vjetor nuk mjafton për të trajtuar të gjitha nevojat dhe sfidat e institucionit arsimor parashkollor.
- Kuptojnë rëndësinë e përfshirjes së aktorëve të ndryshëm (drejtues, mësues, prindër, komunitet) në procesin e planifikimit si pjesë e decentralizimit në arsim.
- Vlerësojnë planin afatmesëm si një mjet profesional që ndihmon kopshtin të zhvillohet, të përmirësojë cilësinë e të nxënit dhe të rrisë përfshirjen e fëmijëve.

Tematikat:
"Përse një plan afatmesëm për zhvillimin e kopshtit"

1. Ndryshimet konceptuale në planifikimin arsimor gjatë viteve të fundit, me theks në planifikimin me pjesëmarrje dhe decentralizimin institucional.
2. Kuptimin dhe përkufizimet e ndryshme të planit afatmesëm të kopshtit si proces krijues, sistematik dhe i qëndrueshëm, që ndihmon në zhvillimin profesional të institucionit dhe pasurimin e përvojave të të nxënit të fëmijëve.
3. Argumentet që tregojnë se planifikimi vjetor nuk është i mjaftueshëm për të zgjidhur problematika komplekse si:
   - zhvillimi profesional i mësuesve,
   - përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara ose nga komunitete të ndryshme,
   - përmirësimi i kushteve të të nxënit,
   - rritja e frekuentimit të rregullt,
   - bashkëpunimi efektiv me komunitetin dhe pushtetin vendor, ✓ menaxhimi i reformave kurrikulare.
4. Theksimi i rolit të planit afatmesëm si një udhërrëfyes 3–4-vjeçar për ndryshime reale, të qëndrueshme dhe cilësore në institucionet parashkollore.

Rezultatet e të nxënit:
Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Artikulojnë vlerën strategjike të një cikli planifikimi 3-4-vjeçar për arritjen e përmirësimeve të qëndrueshme të cilësisë, duke e krahasuar atë me kufizimet e planifikimit vjetor.
- Përcaktojnë karakteristikat kryesore të një plani afatmesëm të kopshtit, duke e përshkruar atë si një proces sistematik, pjesëmarrës dhe të orientuar drejt së ardhmes për zhvillim profesional dhe cilësor. Identifikojnë të paktën tre sfida komplekse të kopshtit (p.sh., ngritja e kapaciteteve të mësuesve, zvogëlimi i braktisjes së fshehur, përmirësimi i mjediseve të të nxënit) që kërkojnë një qasje strategjike shumëvjeçare për t'u zgjidhur në mënyrë efektive.
- Shpjegojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis një plani afatmesëm të zbatuar mirë dhe qëllimit përfundimtar të pasurimit të përvojave dhe rezultateve të të nxënit për fëmijën.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutim në grup (Shtojca nr. 2**)

Diskutimet në grup synojnë të thellojnë kuptimin e rëndësisë së planit afatmesëm të kopshtit si një proces gjithëpërfshirës dhe i decentralizuar, i cili kërkon pjesëmarrjen aktive të të gjithë aktorëve të lidhur me institucionin. Qëllimi është që pjesëmarrësit të reflektojnë mbi arsyen pse planifikimi shumëvjeçar është i domosdoshëm për të adresuar sfidat komplekse të kopshtit—nga zhvillimi profesional i mësuesve, përmirësimi i cilësisë së të nxënit dhe krijimi i një mjedisi gjithëpërfshirës, deri te forcimi i bashkëpunimit me komunitetin dhe menaxhimi i qëndrueshëm i kurrikulës—gjëra që nuk mund të arrihen brenda një viti shkollor. Përmes këtyre diskutimeve, grupet synojnë të kuptojnë rolin e planit afatmesëm si një mjet që orienton ndryshimin real, progresiv dhe të qëndrueshëm në kopsht.

Mesazhet kyç të sesionit:

- Plani afatmesëm është thelbësor për zhvillimin afatgjatë dhe të qëndrueshëm të kopshtit.
- Planifikimi bëhet me pjesëmarrjen e aktorëve të ndryshëm, duke forcuar decentralizimin.
- Ndryshimet cilësore kërkojnë kohë dhe nuk arrihen brenda një viti.
- Plani afatmesëm përmirëson cilësinë e të nxënit dhe mjedisin edukativ.
- Ai ndihmon në adresimin e sfidave të kopshtit dhe në zhvillimin profesional të stafit.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **1.5 orë.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: *(materiale, cito dokumentin teorik, udhëzuesin, ligjin, manualin)*
Materiale të prezantimit në PowerPoint.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. **Udhëzuesi për Planin Afatmesëm të Institucioneve Arsimore Parashkollore** – dokument që shpjegon strukturën, hapat dhe kriteret e planifikimit shumëvjeçar.
2. **Korniza e Politikave të Arsimit Parauniversitar** – për të kuptuar lidhjen mes planifikimit të kopshtit dhe politikave kombëtare e vendore.

3. **Standardet e Cilësisë për Arsimin Parashkollor** – për të lidhur planifikimin me përmirësimin e cilësisë së punës edukative.
4. **Udhëzuesi për Zhvillimin Profesional të Mësuesve të Arsimit Parashkollor** – për të kuptuar rolin e zhvillimit profesional në planin afatmesëm.
5. **Dokumentet e Kurrikulës së Arsimit Parashkollor** (Korniza Kurrikulare, programet, udhëzimet metodologjike) – për menaxhimin e qëndrueshëm të kurrikulës gjatë disa viteve.
6. **Raportet e Vetëvlerësimit të Kopshtit** – dokumente të brendshme të institucionit që identifikojnë pikat e forta, sfidat dhe prioritetet.
7. **Rregullorja e Institucionit Parashkollor / Udhëzuesi për Menaxhimin e Kopshtit** – për rolet, përgjegjësitë dhe proceset e menaxhimit.

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të shpërndahet: *(Projektor, Laptop,* Flip chart, Markers,ngjitës

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

PËRSE NJË PLAN AFATMESËM PËR ZHVILLIMIN E KOPSHTIT

Konceptet dhe mendimet rreth planifikimit në arsim kanë ndryshuar ndjeshëm sidomos gjatë dhjetëvjeçarit të fundit në vendet e zhvilluara perëndimore. Një nga veçoritë më themelore të këtij ndryshimi është planifikimi me pjesëmarrje të gjerë të aktorëve dhe të grupeve, të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo janë të lidhur me të. Ky është dhe një nga treguesit më domethënës i decentralizimit si parim dhe praktikë në arsim, sepse nëpërmjet tij janë vetë institucionet dhe në rastin tonë kopshtit, që duhet të planifikojnë punën e tyre dhe zhvillimin progresiv të kopshtit së tyre. Tregues tjetër i decentralizimit në këtë rast është se përgjegjësia e menaxhimit të këtyre planeve në shkollë kalon tek ata që e realizojnë atë.

Një element domethënës dhe në fakt një dëshmi e decentralizimit, i cili ka zënë vend në planifikimin e punës së kopshtit është plani afatmesëm i kopshtit.Ky plan është një praktikë pune profesionale dhe ka sjellë shumë përmirësime dhe ndryshime pozitive atje ku ai është planifikuar dhe zbatuar me përkushtim. Shembujt dhe praktikat janë të bollshme, por nuk kemi qëllim t'i identifikojmë dhe t'i paraqesim ato, por diçka është vërtet e rëndësishme, një plan i tillë konsiderohet i domosdoshëm dhe mjaft efektiv për ecurinë progresive të kopshtit.

Ka shumë përcaktime ose përkufizime për konceptin plan afatmesëm të kopshtit të tilla si:

→ Plani afatmesëm i kopshtit është një proces intelektual dhe krijues, i cili bazohet në njohje dhe në kërkime të përhershme dhe të kombinuara të nevojave të vetë kopshtit në përshtatje me politikat rajonale dhe të komunitetit, mundësive dhe interesave të tij, drejt një zhvillimi sa më real dhe progresiv."

→ Plani afatmesëm i kopshtit është një proces sistematik dhe i vazhdueshëm në të cilin njerëzit marrin vendime për të ardhmen e kopshtit të tyre".

→ Plani afatmesëm i kopshtit është një mjet i fuqishëm me anë të të cilit kopshti rikrijon vetveten për të arritur synimet e paravendosura".

→ Plani afatmesëm i kopshtit është një cikël sistematik i veprimtarive që e ndihmojnë kopshtin për të kuptuar sa më mirë çështjet e edukimit, për të përcaktuar politikat

më të mira për veten, si dhe për të përcaktuar priroritetet më të rëndësishme për veprim".

→ Plani afatmesëm i kopshtit është një udhëzues i cili bazohet në ato që janë bërë dhe në ato që duhen bërë për të ardhmen".

→ Plani afatmesëm i kopshtit parashikon veprimtari për t'u zbatuar për 3-4 vite arsimi, gjatë së cilës duhet të ndodhin realisht ndryshime cilësore".

→ Një nga përcaktimet që e bën planin afamesëm të kopshtit si shumë të nevojshëm është ai që thekson që:

→ Plani afatmesëm i kopshtit ka si qëllim ta zhvillojë profesionalisht kopshtin, por më e rëndësishmja shërben për pasurimin e përvojave të të nxënit për fëmijën".

→ Nga përvojat e kopshteve tona është e lehtë të dallosh që zakonisht planifikimi i punës së saj bëhet vetëm për një vit shkollor. Sado pozitivë qofshin treguesit që një kopsht arrin brenda një viti, ai është fare pak për të përmirësuar të gjitha problemet dhe vështirësitë që kopshti ka në punën e tij.

- A është e mundur që të gjithë mësuesit e një kopshti të mund të aftësohen për të përdorur forma të larmishme dhe rezultative për të nxënit vetëm me një vit?
- A është e mundur që brenda një viti kopshti të mund të eleminojë pengesat që hasin shumë fëmijë sidomos ata me aftësi të kufizuar, fëmijë të komunitetit rom apo në zonat rurale. Aq më shumë kur punojmë për "qasje për të gjithë" mendoni se sa kohë është e nevojshme?
- A është e mundur që brenda një viti kopshti të sigurojë një mjedis të përshtatshëm për të nxënit"?
- A është e mundur që kopshti të sigurojë një përqindje të lartë frekuentimi të rregullt?
- A është e mundur që vetëm për një vit kopshti të mund të eleminojë defektet që kanë treguar fëmijët gjatë kalimit në klasë të parë?
- A është e mundur që kopshti brenda një viti të planifikojë dhe të menaxhojë me frytshmëri kurrikulën? Po kur kemi raste të reformave të shpeshta kurrikulare, a mund të zgjidhet kjo me një vit?
- A mund të pretendohet krijimi i aftësive në zhvillim gjuhësor dhe matematikor?
- A mund të krijohet një bashkëpunim i efektshëm me komunitetin e kopshtit, me qeverisjen vendore vetëm me një vit?

Kësaj liste të gjatë me pyetje mund t'i shtonim pafund problematika të tjera, të cilat lidhen me kopshtin, e cila për vetë specifikat dhe veçantitë që ky institucion kompleks ka, vërtet këto probleme nuk mbarojnë. Nuk është kjo ajo që duam të evidentojmë .Ajo që ne na intereson, në fakt, janë përgjigjet e këtyre pyetjeve, të cilat në mënyrë të natyrshme kërkojnë shumë vite pune për çështjet e mësipërme.

Sesioni 8.2: Misioni, besimet dhe vizionet e kopshtit

Objektivi:Të kuptohet roli dhe rëndësia e Planit Afatmesëm për Zhvillimin e Kopshtit, e cila përfshin tre elementë thelbësorë: Misionin, Besimet dhe Vizionin.

Rezultate e të nxënit:

Në përfundim të kësaj teme, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Dallojnë dhe përshkruajnë përbërësit kryesorë të planit afatmesem: misionin, besimet dhe vizionin e kopshtit.
- Kuptojnë procesin dhe përgjegjësitë e aktorëve në hartimin dhe miratimin e tij (drejtori, mësuesit, bordi, komuniteti).
- Vlerësojnë rëndësinë e harmonizimit të misionit, besimeve dhe vizionit me qëllimet kombëtare të arsimit dhe me nevojat e komunitetit vendor.

Tematikat:

- Kuptimi i i Planit Afatmesëm për Zhvillimin e Kopshtit.

1. Roli i drejtuesit në ndërtimin e planit si dokument moral e profesional i institucionit.
2. Përmbajtjen dhe formulimin e misionit të kopshtit si deklaratë e qëllimit dhe e drejtimit të përgjithshëm të institucionit në përputhje me standardet kombëtare dhe nevojat e komunitetit.
3. Përmbajtjen e besimeve të kopshtit si vlerat dhe bindjet e përbashkëta që udhëheqin procesin edukativ dhe bashkëpunimin ndërmjet mësuesve, fëmijëve, prindërve dhe komunitetit.
4. Përmbajtjen e vizionit të kopshtit si përfytyrim dhe aspiratë shumëvjeçare për zhvillimin e institucionit, bazuar në misionin dhe besimet e tij.
5. Lidhjen ndërmjet misionit, besimeve dhe vizionit si një tërësi koherente që orientojnë prioritetet, planifikimin dhe kulturën institucionale të kopshtit.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Punë në grup (Shtojca nr. 2)**

Puna në grup synon të zhvillojë një kuptim të përbashkët dhe të konsoliduar mbi kredon e kopshtit, duke përfshirë misionin, besimet dhe vizionin e tij. Pjesëmarrësit do të diskutojnë dhe analizojnë qëllimet afatmesme për fëmijët, besimet që mbështesin realizimin e këtyre qëllimeve, si dhe aspiratat dhe synimet e kopshtit pas katër vitesh, duke kontribuar në formulimin e një dokumenti të qartë dhe frymëzues që udhëheq planin afatmesëm. Grupi ndahet në nën-grupe prej 4–6 pjesëmarrësish, ku secili grup fokusohet në një element të kredos: një grup për misionin, një grup për besimet dhe një grup për vizionin, dhe më pas rezultatet diskutohen dhe harmonizohen në një sesion të përbashkët.

Mesazhet kyç të sesionit:

1. **Misioni i kopshtit** – Përmbledh qëllimet afatmesme dhe arritjet që duam për fëmijët pas katër vitesh.
2. **Besimet e kopshtit** – Reflektojnë fuqitë, mundësitë dhe vlerat që mbështesin realizimin e misionit.
3. **Vizioni i kopshtit** – Paraqet aspiratat dhe synimet për kopshtin dhe fëmijët në një periudhë katërvjeçare.
4. **Puna në grup** – Siguron përfshirjen aktive të të gjithë pjesëmarrësve për të formuluar një kredo të përbashkët dhe të konsoliduar.
5. **Bashkëpunimi dhe konsensusi** – Diskutimet dhe harmonizimi i ideve të grupeve garantojnë që misioni, besimet dhe vizioni të jenë të qarta, të frymëzuara dhe të zbatueshme.
6. **Rëndësia e kredos** – Shërben si themel për të gjithë planet dhe veprimtaritë afatmesme të kopshtit.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë **40 minuta.**

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: *(materiale, cito dokumentin teorik, udhëzuesin, ligjin, manualin)*
Materiale të prezantimit në PowerPoint; Shembuj për hartimin e Kredos; Misionit, Vizionit. Ligji për arsimin parauniversitar; udhëzim për hartimin e PASH-it.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. **Ligji për arsimin parauniversitar**
    - Parimet themelore të arsimit parashkollor dhe përgjegjësitë e institucioneve arsimore.
    - Roli i planifikimit afatmesëm dhe pjesëmarrja e aktorëve të ndryshëm në vendimmarrje.
    - Treguesit e decentralizimit dhe autonomisë së kopshtit në hartimin e planeve.
2. **Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes sipas cikleve të arsimit**
    - Rëndësia e kurrikulës dhe objektivat mësimore për fëmijët.
    - Si lidhet misioni dhe vizioni i kopshtit me standardet kombëtare të arritjeve.
3. **Udhëzime dhe rregullore të Ministrisë së Arsimit**
    - Udhëzime mbi zhvillimin profesional të mësuesve dhe menaxhimin e planeve afatmesme.
    - Roli i bordit të kopshtit në miratimin dhe mbikëqyrjen e planeve.
    - Detyrimet ligjore për sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe gjithëpërfshirës për fëmijët.

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të përdoren:*Projektor, Laptop,* Flip chart, Markers,ngjitës

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

Misioni, besimet dhe vizionet e kopshtit

Plani afatmesëm përbëhet nga tre elemente si: misioni, besimet dhe vizionet e kopshtit

Misioni i kopshtit

Misioni i kopshtit është elementi i parë. Misioni duhet të përmbledhë në pak rreshta arritjen përfundimtare që kopshti ka në përfundim të katër viteve për fëmijën dhe të rinjtë. Për formulimin e misionit, ekipet që e hartojnë, duhet të bazohen te disa dokumente të tilla si:

- Ligji për arsimin parauniversitar.
- Qëllimet e arsimit.
- Standardet e përmbajtjes dhe të arritjes sipas cikleve të arsimit që synon kurrikula.
- Nevojat, interesat e komunitetit arsimor brenda dhe jashtë kopshtit.

Filozofitë bashkëkohore, të cilat sugjerojnë që fëmijët e sotshëm kudo qofshin dhe atje ku edukohen, duhet të përvetësojnë dhe të formojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime të nevojshme për të përballuar të jetuarit jo vetëm në mjedisin e tyre vendor, por akoma më gjerë në mjediset rajonale, kombëtare dhe ato globale.

Misioni si element i planit afatmesëm është i lidhur thellësisht me arritjet dhe rezultatet përfundimtare të kopshtit nga fëmijën dhe të rinjtë.Në këtë mënyrë ai ngërthen brenda vetes arritjet përfundimtare që një shkollë ka në misionin e saj.

Misioni duhet të jetë sa më i shkurtër në formulim. Ai mund të paraqitetet në 3-4 rreshta, duke përmbledhur brenda saj filozofinë që kopshti mbart dhe synon të përmbushë për fëmijën dhe të rinjtë gjatë viteve të studimit në të.

Shembull:

Kopshti ynë është i përkushtuar për të siguruar një mjedis edukativ dhe të sigurtë, i cili do t'i rritë dhe do t'i zhvillojë fëmijët me një personalitet të plotësuar. Kopshti ynë do t'i edukojë fëmijët me aftësi për të nxënë gjatë gjithë jetës. Në përfundim të kopshtit ata do të jenë qytetarë që ndjehen pjesë e një komuniteti dhe gati për të kaluar në një cikël më të lartë edukimi.

- **Besimi i kopshtit**

Pas formulimit të misionit të kopshtit, në mënyrë të natyrshme në planin afatmesëm, duhet pasqyruar besimi i kopshtit për të përmbushur misionin e saj, si element i dytë.

Kësisoj besimi që kopshti ka lidhet me potencialet njerëzore, profesionale, bashkëpunuese për të cilat kopshti beson dhe mendon se duke u mbështetur tek to, do të përmbushë misionin e saj. Besimet nuk mund të jenë individuale, ato mbështeten tek besimet e secilit mësues të kopshtit. Ato duhet mbledhur dhe analizuar, përpunuar nga grupet e punës.Në fund ajo çka mbetet janë vërtet besimet që kopshti formulon në emër të saj. Besimi ka të bëjë me një sërë faktorësh, të cilët duhen pasqyruar në plan të tillë si:

- Besimi ndaj nxënësve
- Besimi ndaj procesit të të nxënit
- Besimi ndaj mësuesve

- Besimi ndaj procesit të mësimdhënies
- Besimi ndaj kopshtit
- Besimi ndaj prindërve

Besimi nga ana tjetër është një motiv i fortë për të ecuar përpara. Në këtë kontekst ai duhet të jetë real, i mbështetur fort në gjendjen dhe mundësitë e kopshtit.

Shembull

Ne besojmë që fëmijët:
- Kanë gjithmonë stile të ndryshme të nxëni dhe natyrisht dhe nevoja të ndryshme për të mësuar
- Kanë nevojë të edukohen jo vetëm nga kopshti deri në klasën e 12, por dhe më tej
- Të gjithë duhet të rriten dhe të zhvillohen me një personalitet të plotësuar

Ne besojmë që të nxënit:
- Është një proces që vazhdon gjatë gjithë jetës
- Është më rezultativ, kur zhvillohet në një mjedis pozitiv të nxëni
- Duhet të jetë motivues, i larmishëm dhe që merr parasysh nevojat individuale të nxënësve

Ne besojmë që mësuesit:
- Përpiqen të japin një edukim për fëmijën i cili natyrisht bazohet dhe ka një përfundim bazuar në vite studimi dhe cikle shkollore
- Duhet të vazhdojnë të nxënët dhe të rriten dhe të zhvillohen dhe ata profesionalisht nga bashkëveprimi me fëmijën e tyre.
- Duhet të mbajnë dhe të freskojnë vazhdimisht stilet e tyre të frytshme të mësimdhënies dhe të të nxënit

Ne besojmë që mësimdhënia :
- Siguron përvoja që nxitin dhe sigurojnë rrijte dhe i aftësojnë fëmijën për të përmbushur plotësht personalitetin e tyre
- Është gjithmonë një sfidë për mësuesit, të cilët kërkojnë cilësi të lartë arritjeje tek fëmijët
- Është përherë e mirëplanifikuar, duke siguruar kështu mundësi për një zhvillim të frytshëm të saj

Ne besojmë që kopshti:
- Kujdeset për rritjen dhe zhvillimin e nxënësve
- Bazohet dhe e zhvillon veprimtarinë e saj duke bashkëpunuar me komunitetin brenda dhe jashtë kopshtit
- Siguron materiale dhe mjedise të përshtatshme për të nxënët
- Është e interesuar për interesat më të mira të nxënësve të saj

Ne besojmë që prindërit :
- Luajnë një rol të rëndësishëm si partnerë në procesin e edukimit në shkollë
- Janë përgjegjës për nxitjen e fëmijëve në mënyrë që ata të përgatiten në vijimësi para se ata të vijnë në shkollë, por dhe për të ushqyerit dhe veshjen e tyre.
- Janë të përfshirë në mnëyrë aktive në veprimtaritë dhe programet e kopshtit, por në mënyrë të veçantë me mësuesit e fëmijëve të tyre
- Janë të vetëdijshëm për rolin e tyre në edukimin e fëmijëve të tyre

- **Vizioni i kopshtit**

Si element i fundit në planin afatemesëm paraqitet dhe vizioni i kopshtit. Pasi është përcaktuar misioni i kopshtit dhe është identifikuar qartë se në çfarë kopshti beson tek vetja e saj, duhet që të formulohet dhe vizioni i kopshtit.

Vizioni i kopshtit paraqet në formën e arritjeve, idealeve, aspiratave, shpresave, dëshirave, përfytyrimeve që kopshti mendon për veten e tij, por në radhë të parë atë që synojmë të arrijë kopshti dhe kryesisht fëmija pas katër vitesh. Duke rimarrë herë pas here idetë e misionit dhe duke përmenduar besimet që kopshti ka tek burimet njerëzore dhe materiale të saj, paraqitet një vizion i saj. Vizioni nuk është asnjëherë i matshëm ose i parashikuar në mënyrë të saktë. Vlera e tij më e rëndësishme është se ai shërben për të përcaktuar prioritetet që kopshti duhet të vendosë për punën e tij katërvjeçare, ndaj shpesh në formulime të vizionit hasim qëndrime, synime të përgjithshme që bazohen tek elementet e kopshtit si kurrikula, mësimdhënia dhe të nxënët, tek mundësitë që kopshti ka për t'i përmirësuar arritjet e nxënesve, të mësuesve etj.

Në fund të fundit vizioni shpreh besimin e kopshtit, të përkthyer në synime dhe në arritje disavjeçare. E thënë më shkurt vizioni paraqet aspiratën katërvjeçare të një kopshti.

Ekipi i planit afatmesem, në hartimin e vizionit, duhet të mbështetet fort jo vetëm tek misioni dhe besimi i kopshtit, por dhe në synimet dhe objektivat e kurrikulës, tek qëllimet kombëtare të arsimit, te standardet përmbajtjes dhe të arritjes, si dhe në udhëzime të ndryshme nga institucionet eprore të arsimit në nivel rajonal dhe kombëtar. Në këto materiale, ekipi mund të hulumtojë ide dhe praktika që paraqesin vizionet e kopshtit shqiptare.

Në përvoja të ndryshme, vizioni i kopshtit, zakonisht, paraqitet me një faqe formati A.4, me anë të disa paragrafëve që variojnë nga 6- 8 të tillë, sipas problematikave që ekipi i ka menduar si vizion të kopshtit. Kjo është një e dhënë më shumë teknike se sa profesionale. Kopshtit vetë sipas ideve dhe mendimeve që duan të paraqesin tek vizioni i tyre, mund të mos e marrin parasysh këtë të dhënë teknike, por gjithsesi vizioni duhet formuluar me anë të fjalive të qarta, që përmbledhin sa më shkurt të jetë e mundur, gjithë problematikën që kopshti realisht e ka shumë komplekse, në formën e synimeve dhe aspiratave që ne dëshirojmë për kopshtin.

Lista e tematikave që mund të përfshijë vizioni:

1. Kopshti si mjedis dhe komunitet të nxëni
2. Puna e përbashkët mësues dhe drejtues kopshti
3. Kushtet e kopshtit
4. Zhvillimi i kurrikulës, zhvillimi profesional i mësuesve, mësimdhënia dhe të nxënët
5. Modele mësimore që janë prioritare
6. Matjet e arritjeve të nxënësve
7. Bashkëpunimi me komunitetin dhe prindërit
8. Kalimi nga një cikël më i ultë arsimimi në një cikël më të lartë, si dhe fëmijët me nevoja të veçanta.
9. Përqëndrimi tek të rejat në edukim, në mësimdhënie, në të nxënë etj.

Shembull

Vizioni i kopshtit:

Kopshti ynë është një komunitet të nxëni, ku të gjithë mësuesit kanë në fokus të nxënët, me besimin tek arritje të larta të fëmijëve, të rinjve dhe të mësuesve. Fëmijët tanë janë një burim i çmuar dhe si të tillë ata duhen edukuar dhe në mënyrë që të zhvillohen me një personalitet të plotësuar. Ne shpresojmë që fëmijët tanë të zhvillojnë aftësi të forta sociale dhe ndërpersonale duke u mbështetur fort në më të mirën që ata mund të bëjnë si në anën intelektuale, por dhe në drejtim të sjelljes së tyre. Fëmijët tanë do të jenë krenarë për kopshtin, pasi ai do t'u mëndësojë atyre zhvillim social dhe akademik. Kopshti jonë do të vazhdojë të jetë gjithnjë i vetëdijshëm për stilet dhe mënyrat e ndryshme për të nxënët e secilit nxënës, duke marrë parasysh veçoritë e tyre intelektuale, sociale, emocionale, si dhe ndryshimet e tyre fizike.

Ne e përfytyrojmë stafin e kopshtit tonë dhe drejtuesit e saj duke punuar efektivisht dhe duke bashkëpunuar së bashku për të siguruar një klimë dhe mjedis arritjesh, një mjedis të sigurtë, i cili lehtëson të nxënët e fëmijëve dhe të rinjve. Praktikat mësimore të mësuesve tanë do të jenë në koherencë me objektivat e kurrikulës dhe drejtuesit tanë do të mbështesin, do të mbikqyrin dhe do të nxitin punën me objektiva, në mënyrë që të arrihen objektivat e dëshiruara.

Kopshti ynë do të vazhdojë të ofrojë për të nxënit një kurrikulë të hapur, kur përveç anës detyruese të saj, do të mundësojë nevojat dhe interesat e nxënësve me anë të veprimtarive kros dhe ekstrakurrikulare. Mësuesit tanë do të vazhdojnë të shkëmbejnë me njëri-tjetrin përvojat e tyre të sukseshme si dhe inisiativat e tyre të reja. Mësuesit do të bashkëpunojnë së bashku për të hartuar dhe zhvilluar një mësimdhënie të planifikuar mirë dhe të bazuar në modele të avancuara që lehtësojnë të nxënët dhe krijojnë mundësi për të shkëmbyer informacione dhe ide si dhe do të mundësojnë një mjedis pozitiv dhe krijues të nxëni. Mësuesit do të përdorin teknika të reja mësimore, duke u mbështetur mbi strategji të sukseshme, por dhe në përdorimin e teknikave dhe metodave të reja në funksion të të nxënit.

Ne i vlerësojmë përvojat e komunitetit si ndihmë të madhe për kopshtin, sepse ato ofrojnë mbështetje për edukimin e nxënësve. Prindërit do të vazhdojnë të luajnë një rol shumë domethënës dhe të rëndësishëm në mbështetjen e edukimit të fëmijëve si në shtëpi dhe në shkollë. Prindërit do ta kuptojnë që mbajtja e një linje të rregullt komunikimi dypalësh, do të bëjë të mundur një zhvillim të plotë të fëmijës si në arritjet akademike por dhe ato sociale. Për këtë kopshti jonë do të jetë i hapur për bashkëpunimin me prindërit, të cilët do të jenë të përfshirë aktivisht në veprimtaritë mësimore dhe edukative të kopshtit.

Kopshti ynë do të zbusë ndjeshëm problemet dhe vështirësitë që shfaqin fëmijën kur kalojnë nga një cikël i ulët në një cikël më të lartë arsimimi. Nga ana tjetër një program i posaçëm mbështetës do të zhvillohet për nxënesit me nevoja të veçanta/ aftësi ndryshe për të lehtësuar kalimin e tyre në një cikël më të lartë arsimi.

Ne do të vazhdojmë të mbështetemi te përvojat tona të kaluara, më të mirat e tyre, si dhe do të jemi në korrent të ideve dhe praktikave të sukseshme në edukim, ku së pari do të fokusohemi më shumë tek përdorimi i teknologjive të reja të edukimit përmes të të nxënit me anë të kompjuterit.

Sesioni 8.3: Analiza e gjendjes së Kopshtit: Infrastrukturë, Shërbime, Partneritete

Objektivat: Të kuptohet rëndësia e analizës së gjendjes si një element thelbësor i Planit Afatmesëm për Zhvillimin e Kopshtit, që mundëson identifikimin e situatës reale të institucionit dhe përcaktimin e drejtë të prioriteteve zhvillimore.

Tematikat:

Analiza e gjendjes në Planin Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit"

- Kuptimi dhe rëndësia e analizës së gjendjes në planifikimin afatmesëm të zhvillimit institucional.
- Përmbajtja e analizës së gjendjes si rubrikë e domosdoshme që paraqet gjendjen reale të kopshtit përpara përcaktimit të misionit dhe prioriteteve.
- Komponentët kryesorë që duhet të përfshihen në analizë:
- Lehtësitë që ofron kopshti për të nxënët (mjediset fizike, infrastruktura, pajisjet, kushtet higjieno-sanitare dhe teknologjike).
- Bashkëpunimet e kopshtit me institucione dhe organizata të tjera (zyrat arsimore, pushteti vendor, organizatat jofitimprurëse, shoqatat komunitare, fondacionet dhe partneritetet ndërkombëtare).
- Kushtet sociale, ekonomike dhe kulturore të komunitetit ku ndodhet kopshti.
- Gjendja financiare dhe burimet që mbështesin zhvillimin institucional.
- Pikat e forta dhe të dobëta që rezultojnë nga analizimi i të dhënave dhe që ndihmojnë në përcaktimin e fushave prioritare të zhvillimit.
- Procedurat dhe mjetet që përdoren për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave në analizën e gjendjes.
- Përdorimin e analizës së gjendjes si bazë për formulimin e objektivave strategjikë dhe veprimeve konkrete të Planit Afatmesëm.

Rezultatet e të nxënit të sesionit:

- Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:
- Të artikulojnë qëllimin dhe rëndësinë kritike të një analize situative në krijimin e një plani afatmesëm të realizueshëm dhe të synuar.
- Të mbledhin dhe katalogojnë të dhëna thelbësore mbi mjedisin e brendshëm të kopshtit, duke përfshirë:
- Gjendjen dhe përshtatshmërinë e ambienteve fizike (klasat, laboratorët, zyrat administrative, bibliotekat).
- Disponueshmërinë dhe gjendjen e sistemeve mbështetëse (ndriçimi, ftohja, banjot, aksesueshmëria).
- Hapësirat e specializuara (për këshillim, fëmijë me aftësi të kufizuara, trajnimin e mësuesve).
- Të hartojnë dhe vlerësojnë bashkëpunimet e jashtme të kopshtit me: Organet qeveritare (zyra arsimore). Organizatat jofitimprurëse dhe donatorët (p.sh., UNICEF, Save the Children). Partnerë të tjerë për binjakëzim, programe rinore dhe mbështetje të specializuar.
- Të sintetizojnë gjetjet nga analiza e brendshme dhe e jashtme për të identifikuar avantazhet strategjike, boshllëqet dhe mundësitë për planin afatmesëm.

- Të dokumentojnë të gjitha gjetjet dhe bashkëpunimet qartë dhe sistematikisht brenda planit afatmesëm për të justifikuar qëllimet dhe strategjitë e tij.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime (Shtojca nr. 2)**

Synojnë të nxisin reflektimin kritik dhe të thelluar të pjesëmarrësve mbi gjendjen aktuale të kopshtit, duke përfshirë burimet, mjedisin fizik, bashkëpunimet dhe sfidat që lidhen me procesin e të nxënit. Qëllimi është të identifikohen pikat e forta dhe të dobëta, të ndahen përvojat praktike, të harmonizohen idetë dhe të përgatitet një plan strategjik i qartë për zhvillimin afatmesëm. Përmes diskutimit, pjesëmarrësit nxisin mendimin kritik, bashkëpunimin dhe vendimmarrjen kolektive, duke rritur ndërgjegjësimin mbi nevojat e nxënësve dhe mënyrat për të përmirësuar cilësinë e mjedisit edukativ dhe të shërbimeve që ofron kopshti.

- **Punë në grup, ushtrime (Shtojca nr. 3)**

Këto ushtrime dhe puna në grup synojnë të përforcojnë bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen aktive të stafit në analizimin dhe përmirësimin e mjedisit të kopshtit, duke identifikuar pikat e forta dhe të dobëta, vlerësuar burimet dhe bashkëpunimet ekzistuese, dhe duke propozuar zgjidhje konkrete për sfidat që lidhen me procesin mësimor dhe zhvillimin e nxënësve. Puna në grup lejon harmonizimin e ideve, ndarjen e përgjegjësive dhe zhvillimin e vendimmarrjes kolektive, duke krijuar një kulturë të përbashkët profesionale dhe duke siguruar që çdo nismë të jetë në përputhje me vizionin, misionin dhe objektivat afatmesme të kopshtit.

Mesazhet kyç të sesionit:

1. Analiza e gjendjes – Njohim realitetin e kopshtit për vendime më të mira.
2. Bashkëpunimi – Staf, prindër, komunitet dhe organizata punojnë së bashku.
3. Puna në grup – Diskutojmë, harmonizojmë ide dhe marrim vendime kolektive.
4. Dokumentimi – Regjistrojmë gjithçka për transparencë dhe për projektet e ardhshme.
5. Përmirësimi i mjedisit mësimor – Sigurojmë kushte optimale për nxënësit.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë 30 minuta.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: *(materiale, cito dokumentin teorik, udhëzuesin, ligjin, manualin)*

- Materiale të prezantimit në PowerPoint

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

Dokumentet ligjore dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit – Standarde për mjediset e nxënësve, sigurinë, pajisjet, kurrikulën dhe të drejtat e fëmijëve.

Përshkrimi i kopshtit dhe mjedisit të tij – Ndërtesa, klasat, laboratorët, bibliotekat, sallat kompjuterike, oborret dhe pajisjet mbështetëse.

Analiza e kushteve sociale dhe ekonomike – Të dhëna mbi komunitetin dhe profilin e nxënësve që frekuentojnë kopshtin.

Bashkëpunimet me institucione dhe organizata të tjera – Drejtoria arsimore, qeverisja vendore, organizata jofitimprurëse dhe projekte ndërkombëtare.
Raporte mbi pikat e forta dhe dobësitë e kopshtit – Identifikimi i mundësive për përmirësim dhe prioritete për planin afatmesëm.

Projektet ekzistuese dhe ndikimi i tyre – Shembuj konkretë të bashkëpunimeve që kanë përmirësuar procesin mësimor dhe mbështetjen e nxënësve.

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të përdoren: *Projektor, Laptop,* Flip chart, Markers,ngjitës

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

1-ANALIZA E GJENDJES

Një element i domosdoshëm në planin afamesëm është dhe rubrika që lidhet me analizën e gjendjes. Në përvojat e huaja, analiza e gjendjes merr përsipër që të paraqesë të dhëna të detajuara për çështje të tilla si:

- lehtësitë që ofron kopshti për të nxënët,
- bashkëpunimet e kopshtit me institucione të tjera,
- kushtet sociale dhe ekonomike, të dhëna për komunitetiin e kopshtit,
- të dhëna për financat e kopshtit,
- pikat e forta dhë të dobëta të kopshtit.

Lehtësitë që ofron kopshti për të nxënët

Paraqitja në planin afatmesëm e lehtësive që kopshti ofron për të nxënët, ka të bëjë me dhënien e informacionit të nevojshëm, përkatës, i cili lidhet me:

- Të dhëna për ndërtesën arsimore, kur është ndërtuar ose rikonstruktuar, sa kate ka, cilësia e saj si ndërtesë që mban parasysh sa vite ka që ekziston si shkollë, sa mjedise ka ajo për klasa, laboratorë, për cikle të ndryshme si: arsimi parashkollor, cikli fillor, cikli i mesëm i ulët, arsimi i mesëm.
- Të dhëna për sistemet e ngrohjes, të ftohjes, për ndriçimin, për banjot, për mjediset shlodhëse
- Të dhëna për mjediset e administratës së kopshtit, për mjediset e mësuesve, për mundësitë që ka kopshti për të patur mjedise për trajnime, takime, këshillime etj.

- Të dhëna për kopshtin që lidhen me mjediset për këshillime psikologjike, për
- trajtim të posaçëm të fëmijëve me vështirësi në të nxënë, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, këshillime për orientimin shkollor etj.
- Të dhëna për bibliotekën e kopshtit, për salla kompjuterësh, si dhe hapësirat e mundshme që fëmijën kanë për të studiuar në shkollë jashtë procesit mësimor.

Bashkëpunimet e kopshtit me organizma të tjerë

Kopshti si institucion ka lidhje dhe bashkëpunon në radhë të parë me drejtorinë arsimore, me zyrat e arsimit sipas zonës ku ajo ndodhet, por dhe me qeverisjen vendore, bashki apo komunë. Ky bashkëpunim gjithmonë duhet të karakterizohet nga mbështetja reciproke për mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe arritjen e synimeve dhe objektivave të kopshtit. Në rastin e planit afatmesëm, kjo linjë ka të bëjë me paraqitjen në këtë plan të bashkëpunimeve që kopshti ka me institucione të tjera, të cilat e lehtësojnë punën e saj. Kështu, p.sh janë shoqatat dhe organizatat e ndryshme jofitimprurëse që veprojnë në fushën e edukimit, por dhe binjakëzimet me kopshti analoge. Në përvojat e kopshtive perëndimore identifikon lehtë që bashkëpunimet e saj me instituciuone të tjera shihen kryesisht me drejtime të tilla si:

- Mbështetjen e fëmijëve më vështirësi në të nxënë, si dhe me aftësi të kufizuara
- mendore dhe fizike.
- Bashkëpunimin me organizata që ofrojnë shërbime në mësimin e kompjuterit.
- Bashkëpunimet me organizata të ndryshme rinore për nxitjen e procesit të
- vendimmarrjes së të rinjve në jetën e tyre.
- Binjakëzimet me kopshte analoge brenda dhe jashtë vendit, si dhe zhvillimi i
- veprimtarive të përbashkëta me përfitim reciprok

Në përvojën shqiptare ka ekzistuar një bashkëpunim i frytshëm i kopshteve në kuadër të projekteve të edukim që janë mbështetur në harkun kohor 1994 e deri më sot nga institucione të tilla jofitimprurëse si: Fondacioni “Soros”, “Unicef”, “Save the Children”, , “Qendra për Edukim Demokratik”, “Zhvillimi i edukimit”,“REC”, “IOM”, “Adrif”, “Kryqi i Kuq”, si dhe mjaft organizata të huaja, të tilla si: USAID, UNDP, etj. Nuk përjashtohen këtu dhe mjaft organizata të tjera si vendore dhe të huaja që kanë vepruar në qytete dhe fshatra të ndryshme të vendit tek kopshtit.

Pikërisht për këto lloj bashkëpunimesh bëhet fjalë dhe në rastin kur përgatitet plani afatmesëm i kopshtit, në të cilin duhen paraqitur me saktësi bashkëpunimet e saj dhe ndikimi që ky bashkëpunim ka në mjedisin fizik apo profesional të kopshtit, gjë e cila mundëson arritjen e synimeve të kopshtit.

Zakonisht në planin afatmesëm shkruhen të gjitha bashkëpunimet e kopshtit, duke filluar që nga bashkëpunimet më afatgjata dhe deri tek ato të shkurtërat, por që patjetër kanë lënë gjurmë në shkollë.

Sesioni 8.4: Analiza socio-ekonomike, financiare dhe institucionale në funksion të planifikimit strategjik të kopshtit.

Objektivat: Të kuptohet rëndësia e përfshirjes së analizës socio-ekonomike, financiare dhe analizës së pikave të forta dhe të dobëta si pjesë përbërëse e planifikimit strategjik në mënyrë që drejtuesit e kopshtit të marrin vendime të bazuara në të dhëna reale dhe të sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm institucional.

Në përfundim të kësaj teme, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë rolin e analizës socio-ekonomike të komunitetit në përcaktimin e nevojave zhvillimore të kopshtit.
- Përshkruajnë mënyrën e mbledhjes dhe klasifikimit të të dhënave për familjet dhe komunitetin që ndikon në procesin edukativ.
- Identifikojnë burimet financiare të kopshtit dhe mënyrat për menaxhimin efektiv të tyre në përputhje me objektivat e planit.
- Analizojnë pikat e forta dhe të dobëta të kopshtit në funksion të zhvillimit institucional dhe arritjeve të fëmijëve.
- Zbatojnë teknika praktike si “Stuhia e ideve (brainstorming)”, “Tullumbacja” dhe “SWOT” për identifikimin dhe përzgjedhjen e elementëve kyç të analizës.
- Përdorin të dhënat e mbledhura për ndërtimin e një plani afatmesëm realist, gjithëpërfshirës dhe të matshëm.

Rezultatet e të nxënit të sesionit:

Pas përfundimit të këtij sesioni, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Të mbledhin dhe analizojnë të dhëna kyçe të komunitetit, duke përfshirë statusin socio-ekonomik të familjes, prejardhjet kulturore dhe asetet vendore mjedisore, për të informuar planifikimin specifik të kontekstit.
- Të interpretojnë dhe projektojnë të dhënat financiare të kopshtit, duke kuptuar kufizimet dhe mundësitë aktuale brenda sistemit të financimit komunal për të krijuar një parashikim financiar realist për planin.
- Të lehtësojnë një seancë të strukturuar "Stuhie idesh(Brainstorming)" që përfshin mësuesit, prindërit dhe anëtarët e komunitetit për të gjeneruar një listë gjithëpërfshirëse të pikave të forta dhe të dobëta të kopshtit.
- Të aplikojnë teknikën e prioritizimit "Tullumbacja" për të vlerësuar në mënyrë kritike dhe për të zgjedhur pikat e forta më strategjike për t'u shfrytëzuar dhe dobësitë më kritike për t'u trajtuar në planin afatmesëm.
- Të kryejnë një analizë bazë SWOT (Pikat e Forta, Pikat e Dobëta, Mundësitë, Kërcënimet) që është e përqendruar te nxënësi, e fokusuar në prioritetet strategjike dhe e ndërtuar përmes kontributit bashkëpunues ose anonim nga palët e interesuara.

Të dhënat sociale, ekonomike dhe financiare në PASH dhe analiza e pikave të forta e të dobëta të kopshtit”

Kjo temë trajton tri fusha thelbësore të analizës së gjendjes në PASH:

- Të dhënat sociale dhe ekonomike të komunitetit:
  - Paraqitja e strukturës sociale dhe ekonomike të familjeve të fëmijëve që ndjekin kopshtin.
  - Identifikimi i diversitetit kulturor dhe historik të komunitetit përreth.
  - Përshkrimi i veçorive të jetesës dhe aktiviteteve ekonomike që karakterizojnë zonën (p.sh. turizmi, artizanati, shërbimet vendore).
  - Vlerësimi i burimeve natyrore dhe infrastrukturës komunitare që ndikojnë në edukimin e fëmijëve (p.sh. mjedise sportive, biblioteka, qendra komunitare, rrjete shërbimesh).
  - Analizimi i mundësive që mjedisi natyror dhe kulturor ofron për zhvillimin e plotë të fëmijëve dhe për mbështetjen e qëllimeve të kopshtit.
- Të dhënat financiare të kopshtit:
  - Kuptimi i rëndësisë së rubrikës financiare në planin afatmesëm.
  - Strukturimi i burimeve të financimit (fondet publike, mbështetja nga pushteti vendor, kontributet e komunitetit, bashkëpunimet me OJF-të).
  - Analizimi i mënyrës së menaxhimit financiar në kushtet aktuale dhe vështirësitë e varësisë institucionale.
  - Planifikimi i buxhetit në përputhje me objektivat strategjikë të PASH-it.
  - Identifikimi i mundësive për përmirësim të menaxhimit financiar dhe rritjen e transparencës ekonomike të institucionit.
- Pikat e forta dhe të dobëta të kopshtit:
  - Qëllimi i analizës së pikave të forta dhe të dobëta në raport me zhvillimin afatmesëm.
  - Parimet bazë të analizës (fokusimi tek nxënësi, selektiviteti dhe perspektiva katërvjeçare).
  - Përdorimi i teknikave të pjesëmarrjes për analizë:
  - “Stuhia e ideve” – mbledhja e ideve nga mësues, prindër dhe përfaqësues komuniteti për pikat e forta dhe të dobëta.
  - “Tullumbacja” – përzgjedhja e elementëve kyç që lidhen drejtpërdrejt me objektivat e PASH-it.
  - “SWOT” – identifikimi individual dhe i strukturuar i forcave, dobësive, mundësive dhe rreziqeve të institucionit.
  - Përdorimi i analizës për të ndërtuar prioritete zhvillimore të matshme dhe të zbatueshme.
  - Sigurimi i konsensusit dhe bashkëpunimit ndërmjet stafit dhe komunitetit gjatë procesit të analizës.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Diskutime (Shtojca nr. 2)**

Diskutimi mbi të dhënat sociale, ekonomike dhe financiare të komunitetit dhe kopshtit synon të rrisë ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve mbi realitetin ku vepron institucioni, duke i ndihmuar ata të kuptojnë nevojat dhe potencialin e fëmijëve, familjeve dhe komunitetit. Ai nxit reflektim mbi diversitetin kulturor, mundësitë dhe sfidat ekonomike, si dhe mbi burimet natyrore dhe infrastrukturore që mund të përdoren për zhvillimin edukativ. Gjithashtu, diskutimi synon të angazhojë pjesëmarrësit në identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta të kopshtit, të mundësive për përmirësim dhe të rreziqeve që duhet të menaxhohen, duke përdorur teknika të **strukturuara** si SWOT, Stuhia e Ideve dhe Tullumbacja. Përmes këtyre bisedave, pjesëmarrësit mësojnë të bashkëpunojnë, të ndajnë ide dhe të vendosin prioritetet për planin afatmesëm të zhvillimit të kopshtit, duke siguruar që vendimmarrja të jetë e informuar, konsensuale dhe e orientuar drejt përfitimit maksimal të fëmijëve.

- **Punë në grup, ushtrime (Shtojca nr. 3)**

Këto ushtrime dhe puna në grup synojnë të zhvillojnë bashkëpunimin dhe komunikimin ndërmjet pjesëmarrësve, të rrisin aftësinë për analizimin e të dhënave sociale, ekonomike dhe financiare të komunitetit dhe kopshtit, si dhe të identifikojnë në mënyrë kolektive pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet që ndikojnë në zhvillimin e planit afatmesëm të kopshtit. Përmes teknika të ndryshme si stuhia e ideve, tullumbacja dhe SWOT, pjesëmarrësit mësojnë të prioritizojnë dhe të marrin vendime strategjike të bazuara në analiza të sakta dhe konsensus grupor, duke rritur kështu përfshirjen e komunitetit dhe efektivitetin e planifikimit.

Mesazhet kyç të sesionit:

1. **Bashkëpunimi dhe përfshirja:** Puna në grup forcon komunikimin dhe mundëson përfshirjen e mësuesve, prindërve dhe pjesëtarëve të komunitetit në procesin vendimmarrës.
2. **Analiza e të dhënave:** Të kuptuarit e të dhënave sociale, ekonomike dhe financiare të komunitetit ndihmon në planifikimin realist dhe të qëndrueshëm të kopshtit.
3. **Përparësia te nxënësi:** Çdo analizë dhe planifikim duhet të fokusohet në nevojat dhe zhvillimin e nxënësve.
4. **Bashkëpunimi me komunitetin:** Përdorimi i burimeve të komunitetit dhe angazhimi i emigrantëve dhe familjeve rrit mbështetjen për PASH-in dhe zhvillimin e aktiviteteve edukative.
5. **Planifikim financiar realist:** Buxheti duhet të jetë i hollësishëm, i qëndrueshëm dhe në përputhje me objektivat dhe prioritetet e planit afatmesëm.

Kohëzgjatja e sesionit:
Sesioni do të zgjasë 60 minuta.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit
Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: *(materiale, cito dokumentin teorik, udhëzuesin, ligjin, manualin)*
Materiale të prezantimit në PowerPoint
Shembuj të mbledhjes së të dhënave sociale dhe financiare, Modeli i analizës SWOT

Listë leximesh për pjesëmarrësit:
Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. **Raporti i të dhënave sociale dhe ekonomike të komunitetit –** përfshin numrin e familjeve, strukturën kulturore, punësimin, burimet natyrore dhe veçoritë historike ose kulturore të zonës rreth kopshtit.
2. **Shembulli i buxhetit afatmesëm të kopshtit** – tregon si planifikohen financat e kopshtit për objektivat 4-vjeçare, duke përfshirë buxhetet nga bashkia, DAR-i, komuniteti dhe OJF-të.
3. **Tabela dhe udhëzime për teknikat "Stuhia e ideve" dhe "Tullumbacja"** – për identifikimin e pikave të forta dhe të dobëta në mënyrë grupore.
4. **Udhëzuesi për analizën SWOT –** për të ndihmuar pjesëmarrësit të identifikojnë mundësitë dhe rreziqet për zhvillimin e kopshtit.
5. **Prioritetet dhe objektivat e PASH-it (Plani Afatmesëm i Zhvillimit të Kopshtit) –** për të kuptuar kontekstin në të cilin do të aplikohet analiza dhe planifikimi financiar.

Pajisjet që do përdoren:
Gjatë sesionit do të përdoren: *Projektor, Laptop,* Flip chart, Markers,ngjitës

PËRMBAJTJA TEORIKE E SESIONIT
Të dhëna sociale dhe ekonomike për familjet e nxënësve, si dhe për komunitetin rreth kopshtit.
Në këtë rubrikë është e nevojshme që të paraqiten të dhëna të sakta për numrin e familjeve që lidhen me fëmijën e kopshtit. Këtu paraqiten dhe kulturat e ndryshme që përfaqësojnë komunitetin rreth kopshtit. Një e dhënë me interes mund të jetë dhe se kur ky komunitet ka ardhur për të jetuar në zonën ku ndodhet kopshti. Kopshti vetë mund të bëjë një klasifikim sipas kontekstit të komunitetit, se sa mund të jetë në përqindje numri i familjeve të pasura, të mesme dhe të varfëra. Gjithmonë është e gabueshme që të bëhet një klasifikim i tillë, pasi duhen marrë parasysh të dhëna të sakta financiare për të nxjerrë varfërinë absolute dhe atë relative. Në këtë rubrikë paraqiten dhe të dhëna se sa është popullsia që mbulon kjo shkollë, me çfarë jeton kryesisht komuniteti i kopshtit, me çfarë biznesesh merren, cila është e vecantë në jetën e këtij komuniteti, natyrisht nëse ka si p.sh turizmi, blegtoria, artizanatet ose dhe zhvillimet shoqërore që kanë të bëjnë me institucione me rëndësi që ndodhen në këtë komunitet. Me interes mund të jetë dhe paraqitja në plan dhe e mundësive që mjedisi natyror rreth kopshtit ofron për rritjen dhe edukimin e nxënësve të saj. Këto mund të

lidhen me burime natyrore si: liqene, dete ose përshtatje që komunitetit ka bërë në mjedisin e tij për të rritur mirëqënien sociale dhe sigurimin e një jete të qetë dhe me zhvillim të qëdrueshem për ta.P.sh pishinat, mjediset sportive, bibliotekat e lagjeve, rrjetet e shërbimeve të kompjuterëve dhe të internetit etj. Kur mjedisis i komunitetit përfaqëson një mjedis historik kulturor, specifik, kjo është një pasuri e madhe për edukimin dhe mbështetjen e qëllimeve të kopshtit.

- Të dhëna financiare për kopshtin

Në plane zhvillimi të kopshteve perëndimore identifikohet lehtësisht dhe rubrika me të dhëna fiannciare për kopshtin. Kjo ngaqë atje parimet e decentralizimit dhe të funksionimit të kopshtit, me kohë janë zbatuar dhe kanë krijuar përvojën e tyre në kontekstin shoqëror, ekonomik përkatës.

Kësisoj, akoma kopshti nuk ka një numër llogarie të vetin. Ai menaxhohet financiarisht nga qeverisja vendore dhe nga drejtoria arsimore, një varësi kjo e dyfishtë që shpeshherë e pengon zhvillimin normal të kopshtit.

Ndonëse ka nisma për ta vënë kopshtin në një menaxhim financiar, ato mbeten përsëri të vakëta dhe me probleme. Drejtime të tilla si:

-Një buxhet për çdo kopsht për të blerë letërsi artistike

-Një buxhet për çdo kopsht për të blerë mjete didaktike, janë vërtet nisma inkurajuese për këtë drejtim.

Po ashtu vetë kopshtet mbledhin dhe sigurojnë një buxhet të konsiderueshëm në raste të veçanta nga komuniteti (kjo varet nga numri i nxënësve dhe familjeve të tyre), i cili në rastet më të mira menaxhohet nga bordi i kopshtit, i cili përgatit një plan veprimtarish, të cilat miratohen nga ky bord.

Një zë financiar mund të jenë të ardhurat që krijohen nga bashkëpunimi me familjet e nxënësve, nga shfrytëzimi me qira i mejdiseve të kopshtit për veprimtari të ndryshme shërbimi, si dhe përfitimet financiare që kopshti merr nga bashkëpunimet me OJF-të që punojnë në fushën e edukimit.

E rëndësishme është që parashikimi financiar në plan të jetë në përputhje me synimet dhe objektivat e planit dhe kopshti sa të jetë e mundur të vendosë saktësisht financat që mendon për progresin e saj. Natyrisht, është e vështirë në kontekstin tonë, kur kopshti s'ka mundësi për të patur llogarinë e tij, por mund të vendosen në plan.

Kopshti siguron të dhënat financiare që janë menduar nga bashkia për të ose nga drejtoria arsimore dhe i vendos në plan në mënyrë që ky buxhet do të lehtësojë zhvillimin e planit afatmesëm, sipas objektivave përkatëse.

Pikat e dobëta dhe të forta të kopshtit

Një rubrikë e posaçme dhe realisht një nga më të rëndësishmet që plani afatmesëm trajton janë pikat e dobëta dhe të forta të kopshtit.

Çfarë duhet të përmbajë analiza për pikat e dobëta dhe të forta të kopshtit. Për të patur një realitet të pikave të forta dhë të dobëta të kopshtit, ekipi i hartimit të duhet të mbështetet në tri parime.

Parimi 1:Identifikimi i pikave të dobëta dhe të forta ka në qendër nxënësin.

Kjo do të thotë se e çdo pjesë e pikave të dobëta dhe të forta vështron nga nxënësi. A janë këto kushte të kopshtit aq të mira sa të sigurohen arritje të mira të nxënësve?

Parimi 2:Identifkimi i pikave të dobëta dhe të forta nuk përfshin të gjitha aspektet e kopshtit.
Kjo do të thotë se pikat e forta dhe të dobëta nuk përfaqësojnë “inventar tërësor” të problemeve që ka kopshti.

Parimi 3: Identifikimin e pikave të dobëta dhe të forta që ka për 4 vite të zhvillimit të planit afatmesëm.
D.m.th. është “punë e brendshme e familjes/kopshtit” kjo analizë.
Ka disa mënyra për të identifikuar pikat e forta dhe të dobëta të kopshtit.
Teknika e parë është “Stuhia e ideve”, kurse tjetra “Tullumbacja”.
Këto dy teknika menaxhimi mund të përdoren kështu:
Mësuesit janë mbledhur që të gjithë nën drejtimin e një moderatori. Në këtë rast anëtar i ekipit krijon “stuhinë”. Secili pjesëmarrës thotë një anë të fortë për mësuesit e kopshtit. Këto shkruhen diku, në një tabelë të zezë.
Nëse kështu “stuhia” zgjatet shumë, moderatori e organizon ndryshe, i ndan pjesëmarrësit në grupe me nga një moderator dhe secilit grup i lë për detyrë të zhbirojë njërin bllok. Dikujt “Ndjekja e kopshtit”, tjetrit “Infrastruktura” e kështu me rradhë.

Cilët duhet të jenë pjesëmarrësit e “stuhisë”?
Në këtë veprimtari duhet të ketë dhe përfaqësues nga këshillat e prindërve, edhe më mirë po të jenë ftuar persona të mirënjohur në komunitetin e kopshtit. Po përse gjithë këta? Për dy arsye.
Arsyeja e parë: Po të dëshirojmë një analizë shterruese, duhet kqyrur nga disa pika vrojtimi, d.m.th. nga këndvështrimi i mësuesit, i fëmijës, i prindit, i intelektualit.
Arsyeja e dytë: Pikat e forta dhe të dobëta identifikohen më gjerë dhe më saktë në mënyrë që të vendosen qartë në plan dhe kjo analizë e thellë jep shumë mundësi për të arritur rezultate në fund të 4 viteve. Kjo teknikë bëhet dhe për pikat e dobëta.
Me anë “të stuhisë “ mblidhen një grumbull anësh të forta por dhe të dobëta. Tani na duhet të përzgjedhim dy prej tyre. Kjo bëhet me teknikën e dytë që është “Tullumbacja”. Secila anë e fortë “peshon një kilogram” dhe të gjitha ato janë ngarkuar në një balonë që ngjitet lart. Papritur tullumbacja fillon të humbasë lartësi dhe, që të shpëtojmë rrëzimin duhet të hedhim “njëkilogramëshin” e parë. Në fund të kësaj teknike duhet të mbeten vetëm pikat e forta që realisht janë të tilla dhe që janë një mundësi e mirë për t’u mbështetur në mënyrë që të realizohen synimet e planit. Kjo do të thotë se duhet të mbeten ato pika të forta që janë të lidhura ngushtë me prioritetet, objektivat dhe veprimtaritë e planit.
Të njëjtën teknikë, pra “Tullumbacen” e përdorim dhe për pikat e dobëta, të cilat janë të listuara, vecse ato peshojnë më rëndë se janë si një barrë e madhe për kopshtin. Në fund, në balonë duhet të mbeten ato pika të dobëta, tek të cilat duhet ndërhyrë urgjentisht për t’i përmirësuar dhe që janë të lidhura ngushtë me proritetet, objektivat dhe veprimtaritë e planit.
Zhvillimi i teknikës së tullumbaces mund të krijojë debate të ashpra, si dhe duhet të mundësojë shkëmbim të argumentave dhe kundërargumentave në mes pjesëmarrësve, por jo përleshje deri në hatërmbetje, siç edhe ndodh nga njëherë. Kjo

punë e hedhjes së peshës së pikave të forta dhe të dobëta është një proces që kërkon konsensus dhe maturi.

Një tjetër mënyrë për të identifikuar pikat e dobët dhe të forta është dhe teknika “SWOT“.

Kjo teknikë krijon mundësi që secili në mënyrë të pavarur të identifkojë pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë që secili ka për të ecur përpara dhe psër të kontribuar në prioritetet e kopshtit, por dhe në rreziqet ose mangësitë që ekzsitojnë tek secili për të përmbushur objektivat. Kjo teknikë mund të konsiderohet dhe konfidenciale, kur secili mësues e bën për veten e tij dhe më tutje anëtarët e ekipit nxjerrin të dhënat e kërkuara nga gjithë fletët që secili mësues në mënyrë individulale dhe anonime ka plotësuar fletën e tij.

Sesioni 8.5 Procesi i planifikimit strategjik dhe mbikëqyrjes së zbatimit të Planit Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit

Objektivi: Të kuptohet procesi i caktimit të prioriteteve, hartimit të objektivave, planifikimit të veprimtarive dhe mbikëqyrjes së zbatimit në kuadër të Planit Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit, si elementë që sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, progresiv dhe të matshëm të institucionit.

Rezultate të të nxënit:

Në përfundim të kësaj teme, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Shpjegojnë rëndësinë e përcaktimit të prioriteteve zhvillimore për planin katërvjeçar të kopshtit.
- Identifikojnë prioritetet që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e cilësisë së të nxënit dhe mësimdhënies.
- Hartojnë objektiva të matshme, të arritshme dhe në përputhje me prioritetet e përcaktuara.
- Përdorin teknika bashkëpunuese për përzgjedhjen dhe klasifikimin e prioriteteve (punë në grupe, diskutim, vlerësim kolektiv).
- Ndërtojnë plane konkrete veprimi për secilin objektiv, duke përcaktuar afatet kohore, përgjegjësit dhe burimet e nevojshme.
- Kuptojnë rolin e mbikëqyrjes dhe raportimit si proces mbështetës dhe motivues në zbatimin e planit.
- Përdorin mjete dhe teknika të vetëvlerësimit institucional për monitorimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të planit

Tematika:

1. “Caktimi i prioriteteve, objektivave, planifikimi i veprimtarive dhe mbikëqyrja në Planin Afatmesëm të Zhvillimit të Kopshtit”.
2. Kuptimi dhe rëndësia e prioriteteve zhvillimore në planin katërvjeçar të kopshtit.
3. Kriteret për përzgjedhjen e prioriteteve që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së edukimit.
4. Procesi i identifikimit, diskutimit dhe klasifikimit të prioriteteve nga mësuesit dhe grupet e punës.
5. Përdorimi i tabelave të klasifikimit për renditjen sipas rëndësisë dhe përzgjedhjen e 2–3 prioriteteve kryesore.
6. Lidhja e prioriteteve me sfidat aktuale arsimore dhe me nevojat e komunitetit të kopshtit.
7. Shndërrimi i prioriteteve në objektiva të matshme dhe të arritshme për periudhën katërvjeçare.
8. Parimet e hartimit të objektivave: qartësi, matshmëri, realizueshmëri dhe ndikim pozitiv në zhvillim.
9. Përfshirja e mësuesve dhe ekipeve të planit në konsultimin dhe miratimin e objektivave.
10. Planifikimi i veprimtarive për secilin objektiv duke përcaktuar afatet, përgjegjësit dhe burimet.

11. Lidhja ndërmjet prioritetit – objektivit – veprimtarive për të siguruar koherencë dhe zbatim efektiv.
12. Krijimi i ekipit të mbikëqyrjes dhe vetëvlerësimit për ndjekjen e zhvillimit të planit.
13. Kuptimi i mbikëqyrjes si proces mbështetës, motivues dhe reflektues, jokontrollues.
14. Përdorimi i mjeteve të monitorimit: intervista, pyetësorë, dhe raporte periodike (3-, 6-, 12-, dhe 48-mujore).
15. Rëndësia e raportimit për vlerësimin e progresit dhe nxitjen e përmirësimit të vazhdueshëm.
16. Bashkëpunimi i stafit, prindërve dhe komunitetit në realizimin dhe mbikëqyrjen e planit afatmesëm.

Metodologjia e sesionit dhe mjetet didaktike

Gjatë sesionit do të përdoren mjetet didaktike si në vijim:

- **Prezantim në PowerPoint (Shtojca nr.1)**

PowerPoint-i lejon paraqitjen e ideve në mënyrë të strukturuar dhe të lehtë për t'u kuptuar. Përdorimi i pikave kryesore dhe grafikëve e bën më të thjeshtë për pjesëmarrësit të ndjekin arsyetimin.Trajnerët dhe pjesëmarrësit në trajnim përfshihen aktivisht gjatë sesionit dhe marrin idetë kyç.

- **Punë në grup, ushtrime (Shtojca nr. 2)**

Këto ushtrime synojnë që pjesëmarrësit të zhvillojnë aftësitë e tyre për të identifikuar dhe klasifikuar prioritetet kryesore të kopshtit, t'i lidhin këto prioritete me objektiva të matshme dhe të realizueshme, dhe të hartojnë plane konkrete veprimtarish për arritjen e tyre gjatë një periudhe katërvjeçare. Përmes punës në grupe, pjesëmarrësit mësojnë të bashkëpunojnë, të diskutojnë dhe të arrijnë konsensus mbi prioritetet dhe objektivat, të planifikojnë veprimtaritë në mënyrë të strukturuar, dhe të praktikojnë mbikqyrjen dhe vetëvlerësimin e zbatimit të planeve. Ushtrimet synojnë gjithashtu të rrisin vetëdijen për rëndësinë e bashkërendimit midis mësuesve, prindërve dhe të gjithë aktorëve të kopshtit, duke nxitur një qasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme për zhvillimin cilësor të nxënësve dhe mjedisit mësimor.

Mesazhet kyç të sesionit:

Zhvillimi efektiv i kopshtit kërkon një proces të strukturuar me katër faza, ku prioritetet e përcaktuara në mënyrë bashkëpunuese përkthehen sistematikisht në objektiva të matshme, plane veprimi të hollësishme dhe një sistem monitorimi mbështetës që përqendrohet në motivim dhe lehtësim në vend të ndëshkimit.

Kohëzgjatja e sesionit:

Sesioni do të zgjasë 60 minuta.

Dokumente që shpërndahen gjatë sesionit

Gjatë sesionit do të shpërndahen dokumentet e mëposhtme: *(materiale, cito dokumentin teorik, udhëzuesin, ligjin, manualin)*

Materiale të prezantimit në PowerPoint

Shembuj të vendosjes së prioriteteve, objektivave dhe instrument lehtësues për të bërë një lidhje të harmonizuar midis prioritetit, objektivave dhe planit të veprimtarive.

Listë leximesh për pjesëmarrësit:

Pjesëmarrësit do të udhëzohen të lexojnë dokumentet e mëposhtme, në mënyrë që të konsolidojnë në vijim njohuritë e marra gjatë sesionit:

1. **Ligjin për arsimin parauniversitar dhe kopshtet –** paragrafe që përcaktojnë detyrat e institucioneve, rolin e stafit pedagogjik, prindërve dhe autoriteteve vendore në zhvillimin e kopshtit.
2. **Rregulloret dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit për planifikimin afatmesëm –** përfshirë ato që lidhen me krijimin e planeve vjetore dhe katërvjeçare të kopshtit, përcaktimin e prioriteteve dhe objektivave.
3. **Udhëzime për monitorimin, mbikqyrjen dhe vetëvlerësimin e institucioneve arsimore –** procedurat ligjore dhe format për raportimin tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor.
4. **Standardet e cilësisë për ambientin e mësimit dhe veprimtaritë edukative –** normativat që përcaktojnë kërkesat minimale për sigurinë, aksesueshmërinë dhe pajisjet e klasave dhe ambienteve të lojës.

Pajisjet që do përdoren:

Gjatë sesionit do të përdoren: *(Projektor, Laptop,* Flip chart, Markers,ngjitës

PËRBAJTJA TEORIKE E SESIONIT

PRIORITETET DHE OBJEKTIVAT E KOPSHTIT

Si caktohen prioritetet e kopshtit

Prioritetet duhet të mundësojnë një plan të gjerë zhvillimi, ato nuk kanë parasysh gjëra dhe probleme të vogla, por marrin përsipër të kthehen në plane katërvjeçare, atëherë kur kanë në qendër të tyre problemet më madhore, që i takojnë shumicës së nxënësve dhe mësuesve, që prekin shumë elementë të kopshtit. Pra prioritet, mund të jetë një drejtim i caktuar, i cili krijon mundësi që kopshti të arrijë vërtet ndryshime cilësore dhe progres në fund të katër viteve. Nga shqyrtimi i planeve afatmesëm të kopshteve të huaja identifkon lehtë se ata konsiderojnë në shumicën e rasteve si prioritete tematikat e mëposhtme si:

Të lexuarit, Të shkruarit, Aftësitë për të zgjidhur probleme në situata të ndryshme,

Aftësitë e të menduarit kritik dhe krijues, Zhvillimi matematik i nxënësve, Përdorimi i teknologjisë në klasë, Zhvillimi profesional të mësuesve dhe drejtuesve.

Mësuesit mund të punojnë në mënyrë individuale, por dhe në grupe, duke përdorur teknikën e mëposhtme, ku secili ose një grup shkruan prioritetet që ata mendojnë se duhet trajtuar.

Zakonisht në përvojat e kopshteve të vendeve të tjera, të cilat zhvillojnë plane afatmesme, përzgjidhen 2-3 prioritete, por kjo nuk është standarde. Në kushtet kur kopshti ynë përballet me reforma tërësore si: refoma të trajnimit të mësuesve dhe drejtuesve, por dhe me probleme të shumta sociale, ekonomike e probleme që lidhen me rikonstruksionin e tyre etj, mundet që në kopshte të caktuara për vetë specifikat dhe vështirësitë që ato kanë, të kenë dhe më shumë prioritete, të cilat ndikojnë në përmirësimin e tyre gjatë zbatimit katërvjeçar përmes planit afatmesëm.

Objektivat

Procesi i përcaktimit të prioriteteve kërkon kohën e vet, por nuk mjafton me kaq. Që prioritetet të jenë pjesë e punës katërvjeçare, duhet që ato të shkruhen në formën e objektivave, të cilat duhet të jenë të matshme, të arritshme dhe që krijojnë motivim, nxitje dhe një proces gjithëpërfshirës për mësuesit, fëmijën, prindërit dhe të gjithë të interesuarit për të ndihmuar zhvillimin e kopshtit.

Objektivat që do të hartohen nga ekipi i planit, pas këtij procesi duhen konsultuar me të gjithë mësuesit, të cilët tani grupohen sipas lidhjeve që ata mund të kenë me prioritetet e fiksuara.

Shumë është diskutuar për procesin dhe profesionalizmin e objektivave. Është e njëjta procedurë siç hartohen objektivat specifike nga mësuesit, ose përvoja tashmë e krijuar për hartimin e objektivave minimale të domosdoshëm. Në rastin e planit afatmesëm, këto objektiva edhe mund të mos i marrin krejtësisht parasysh kërkesat e hartimit të një objektivi, pra ata mund të jenë dhe të përgjithshëm, por ajo që është e domosdoshme mbetet që objektivi të sigurojë tregues pozitivë, përmirësues, progresivë, arritje të mira për fëmijën, për kopshtin në përputhje me prioritetin e caktuar. Pra objektivat duhet të sjellin patjetër një ndryshim, i cili të jetë i dukshëm dhe i matshëm. Më poshtë po japim disa shembuj të objektivave që janë hartuar në përputhje me prioritetet, të cilat përdoren në formate të ndryshme të planit.

PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI i VEPRIMTARIVE SIPAS OBJEKTIVAVE

Kur përfundon procesi i hartimit të objektivave, të cilat duhen arritur dhe përmbushur gjatë katër viteve, është e domosdoshme që për secilin objektiv të hartohet plani përkatës së bashku me veprimtaritë që do të zhvillohen gjatë 1,2,3 apo dhe gjatë 4 viteve. Disa objektiva mund të realizohen në një vit, disa të tjerë kërkojnë 2 apo më shumë vite. E rëndësishme është që planifikimi që do të hartohet nga ekipi të jetë i besueshëm, të jetë i lidhur ngushtë me përmbajtjen e objektivave, në mënyrë që të lehtësojë përmbushjen e tyre. Për këtë ekipi i planit punon në grup dhe përcakton veprimtari të hollësishme për secilin nga objektivat, për të cilat do të punohet. Në këtë rast është e nevojshme një analizë e thelluar e asaj që kërkon objektivi për të menduar, më pas se çfarë veprimtarish mund të bëjmë për arritjen e tyre.

MBIKËQYRJA DHE RAPORTIMI PËR ZHVILLIMIN E VEPRIMTARIVE

Në përvojat e suksesshme të planeve të zhvillimit të kopshtit mund të shikosh lehtë se ato zbatohen gjithmonë nën një mbikqyrje të vazhdueshme dhe me raportime të herëpashershme. Kjo nënkupton që të gjitha veprimtaritë që zhvillohen janë nën një vëzhgim të përhershëm dhe një ekip i caktuar i kopshtit, i cili do të punojë për këtë drejtim, duhet trajnuar më parë dhe kështu ata duhet ta marrin seriozisht këtë detyrë. Ky ekip miratohet që në fillim të procesit të hartimit të planit dhe duhet të përbëhet nga 3-4 veta. Ky ekip mund të ketë mësues, prindër, por kriteri i vetëm është që këta anëtarë nuk duhet të jenë pjesmarrës aktivë dhe hartues të planit.

Mbikëqyrja dhe raportimi për ecurinë e planit afatmesëm të kopshtit nuk bëhet për qëllim më vete, ose për qëllime kontrolli të mirëfillta, përkundrazi ky është një proces mbështetës, lehtësues, nxitës dhe motivues. Në momentet kur raportet e përgatitura për mbikqyrjen informojnë për ecurinë e zhvillimit të planit dhe paraqesin përveç anëve

pozitive dhe ato objektiva dhe veprimtari që nuk kanë ecuri të mirë, ky është vërtet një moment mobilizimi për ekipet përgjegjëse, në mënyrë që puna të jetë më e frytshme, të “shkunden” mësuesit dhe fëmijën nga rutina e përditshme dhe të punohet me ngulm për arritjen e objektivave. Ndodh rëndom në përvojat e kopshteve që mësuesit e ngadalësojnë “hovin” dhe “vrullin” dhe bien pre e “dembelizmit”, por mjeshtëria e mbikqyrësve të planit pikërisht në këtë moment duhet të shfaqet. Ata patjetër duhet të ndikojnë në mënyra të ndryshme, për të nxitur dhe motivuar ekipet përgjegjëse për të zbatuar planet e paravendosura. Nga kjo kuptohet lehtë që Mbikëqyrja dhe raportimi lidhur me zhvillimin e planit nuk është për tendenca kontrolli lidhur me mësues apo nxënës të vecantë, përkundrazi problemet e ndryshme që evidentohen gjithmonë trajtohen në përgjithësi dhe nuk përdoren asnjëherë emra mësuesish, drejtuesish apo nxënësish për t’u ndëshkuar apo për të qenë objekt i ballafaqimit me ecurinë e planeve. Pasi ekipi i mbikqyrjes dhe raportimit është trajnuar, ai fillon intensivisht punën për të mbikqyrur zhvillimin e planit të afatemesëm të kopshtit. Ky ekip mund të quhet dhe ekipi i vetëvlerësimit të kopshtit. Ai përdor në këtë rast teknika të ndryshme vëzhgimi dhe raportimi si: intervista, pyetësorë, formate të raporteve tremujore, gjashtëmujore, njëvjeçare si dhe raportin e pëgjithshëm katërvjeçar.

LITERATURA E KONSULTUAR

Dokumenti i kurrikulës është hartuar duke konsultuar literaturën e mëposhtme:

- Kuadri Ligjor Shqiptar për Vetëqeverisjen Vendore
  - Ligji nr.69/2912 “Për sistemin arsimor parauniversitar
  - Ligji nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”
  - VKM nr.632/2017 Standartet e shërbimit në arsimin parashkollor
  - Urdhër Nr. 31, datë 28.01.2020 – Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare.
  - Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
  - VKM nr. 1101, datë 28.12.2015: Rregullat për transportin e nxënësve të arsimit parashkollor.
  - VKM nr. 873, datë 14.12.2016: kuotat financiare për ushqimin në mensa e kopshte
  - Dispozitat Normative për Arsimin Parauniversitar
  - Udhëzimet e MASR për planifikimin strategjik dhe buxhetimin afatmesëm (PBA) për arsimin parashkollor.
  - Rregulloret e ASCAP-it për monitorimin e cilësisë dhe vetëvlerësimin institucional.
  - Raporti Vjetor i Institucionit Arsimor (Urdhri nr. 31/2020)
  - Komisionet e Sigurisë dhe Etikës
  - Piramida e Shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijës
- Dokumente strategjike jombëtare
  - Strategjia Kombetare e arsimit parauniversitar 2021-2026
  - Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Fëmijërisë së Hershme 0–6 vjeç
  - Standardet e Zhvillimit dhe të Nxënit 3–6 vjeç
  - Protokolli i Punës së Punonjësve të Mbrojtjes së Fëmijëve
  - Standardet e Cilësisë për Arsimin Parashkollor
  - Raporti i vlerësimit të Strategjisë së Arsimit Parauniversitar (UNICEF)
- Praktikat Evropiane dhe standarde ndërkombëtare
  - Korniza e Cilësisë për ECEC (Early Childhood Education and Care)
  - Edukimi Gjithëpërfshirës në Fëmijërinë e Hershme (Agjencia Evropiane)
  - Standardet e OECD-së për cilësinë e ECEC-së
- Qeverisja e hapur dhe pjesëmarrja qytetare
  - Dokument analize vendore për fëmijërinë e hershme
  - Plan Veprimi i Shqipërisë në “Open Government Partnership”
  - Konsultime publike dhe mekanizma formalë vendore
- Kurrikulat e trajnimit për administratën e bashkive, të ofruara nga projekti “Bashki të Forta”- Helvetas.
- Raste studimore dhe praktika të mira të përgatitura nga projekti “Bashki të Forta”- Helvetas.
- Raste studimore dhe praktika nga Shqipëria
  - Programet e “Save the Children”, “UNICEF”, “World Vision” dhe organizatave të tjera në fushën e arsimit parashkollor.

- Opsionet e politikave për Financimin e Edukimit në Fëmijërinë e Hershme– Raport i UNICEF-it që analizon financimin e arsimit parashkollor në Shqipëri dhe rolin e pushtetit vendor
- Analiza sektoriale e arsimit (UNESCO) **–** Raport që jep pamje të thelluar për sfidat dhe mundësitë në arsimin e hershëm në Shqipëri.
- Udhëzuesi për Planin Afatmesëm të Institucioneve Arsimore Parashkollore
- Korniza e Politikave të Arsimit Parauniversitar
- Standardet e Cilësisë për Arsimin Parashkollor
- Dokumentet e Kurrikulës së Arsimit Parashkollor
- Raportet e Vetëvlerësimit të Kopshtit
- Rregullorja e Institucionit Parashkollor / Udhëzuesi për Menaxhimin e Kopshtit
- Prioritetet dhe objektivat e PASH (Plani Afatmesëm i Zhvillimit të Kopshtit)
- Udhëzuesi për analizën SWOT
- Rregulloret dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit për planifikimin afatmesëm
- Udhëzime për monitorimin, mbikqyrjen dhe vetëvlerësimin e institucioneve
- Standardet e cilësisë për ambientin e mësimit dhe veprimtaritë edukative

BIBLIOGRAFIA

- *Konventa për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (ETS No. 005: 1950/1953)*
- *Karta Sociale Evropiane (ETS No. 035: 1961/1965) Konventa e Këshillit të Europës "Për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual*
- *Konventa e Këshillit të Europës "Për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore"*
- *Konventa "Për Marrëdhëniet me Fëmijët" (ETS No. 192: 2003/2005)*
- *Konventa "Për Krimet në Internet" (ETS No. 185: 2001/2004)*
- *Konventa Evropiane "Për Ushtrimin e të Drejtave të Fëmijëve" (ETS No. 160: 1996/2000)*
- *Konventa Evropiane "Për Statusin Ligjor të Fëmijëve të Lindur jashtë Martese" (ETS No. 085: 1975/1978)*
- *Konventa Evropiane "Për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve që i Takojnë Kujdestarisë së Fëmijëve dhe Rivendosjes së Kujdestarisë për Fëmijët" (ETS No. 105: 1980/1983)*
- *Konventa Evropiane "Për Birësimin" (ETS No. 058: 1967/1968)*
- *Konventa "Për mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996;*
- *Konventa e Hagës "Për mbrojtjen e fëmijëve dhe bashkëpunimi për birësimet jashtë vendit" aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 8264, datë 15.06.2000;*
- *Konventa Evropiane "Për marrëdhëniet me fëmijët" aderuar pas ratifikimit me ligjin nr.9359, datë 24.03.2005;*
- *Konventa "Për juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, zbatimin dhe bashkëpunimin, në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9427, datë 13.10.2005;*
- *Konventa "Për aspektet civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9446, datë 24.11.2005;*
- *Protokolli opsional i Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve", "Për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9833, datë 22.11.2007;*
- *Protokolli opsional i Konventës së OKB-së "Për të drejtat e fëmijëve" "Për shitjen e fëmijëve, prostitucionin dhe pornografinë me fëmijë", aderuar pas ratifikimit me ligjin nr. 9834, datë 22.11.2007*
- *Kushtetuta e RSH e vitit 1998;*
- *Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003 "Kodi i familjes"*
- *Ligji nr.10347, datë 04.11.2010 "Per mbrojtjen e te drejtave te femijeve";*
- *Ligji nr. 69/2012 "Per sistemin arsimor parauniversitar ne RSH";*
- *Kodi Penal i RSH;*
- *Kodi i Procedures Penale te RSH;*
- *Kodi i Punes i RSH;*
- *Ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"*
- *Ligji nr. 18/2017 "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës"*
- *"Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Praktika të Mira", Save the Children*
- *"Doracak mbi Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta", Save the Children*
- *Korniza Kurrikulare e Arsimit Parashkollor-ASCAP &UNICEF*
- *Korniza e Vlerësimit të Cilësisë së Kopshtit-ASCAP& UNICEF*
- *Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Një Qasje e Re-ASCAP&UNICEF*
- *Udhëzimi Nr. 26, datë 25.11.2019 "Për mësuesin ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar"*
- *Rregullorja për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare (Urdhri Nr. 31, datë 28.01.2020)*

- *Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Një Qasje e Re"- Manual praktik për përmirësimin e praktikave gjithëpërfshirëse në kopshtet.*
- *"Zbatimi i Kurrikulës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara" (ASCAP, 2024) Udhëzues për planifikimin e mësimdhënies dhe hartimin e PEI-t.*
- *Strategjia Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara.*
- *"Gjithëpërfshirja në Arsim – Moduli 3", MASHT & GIZ (2020)*
- *"Gjithëpërfshirja në Arsimin Parashkollor – Një Qasje e Re", UNICEF & ASCAP (2021)*
- *"Diversiteti, Barazia dhe Përfshirja në Arsim", Inclusion4Schools (2023)*
- *"Udhëzues për Praktikat e Mira të Arsimit Gjithëpërfshirës" (Save the Children, 2022)*
- *Standardet për Projektimin e Kopshteve" (MASR, 2016)*
- *"Inspektimi dhe Vlerësimi i Brendshëm i Kopshtit"*
- *"Zbatimi i Kurrikulës për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara"*
- *"Udhëzues për Mbështetjen e Nxënësve me Aftësi të Kufizuara"*
- *"Udhëzues për Gjithëpërfshirjen e Fëmijëve me Nevoja të Veçanta", MASHT, Handikos & Save the Children (2020)*
- *"Një Shkollë për të Gjithë – Përvojë pune me fëmijët me aftësi të kufizuara në shkollat e zakonshme", Save the Children (2010)*
- *"Partneriteti Shkollë-Familje", CSL & OSFA (2015)*
- *"Moduli 3 – Gjithëpërfshirja në Arsim", MASHT & GIZ (2020)*
- *"Guidë Udhëzuese mbi të Drejtën për Arsimim", FSHDPAK (2007)*
- *"Arsimi gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta – Material burimor për mësuesit ndihmës", Save the Children, ASCAP*
- *"Plani Individual i Arsimit dhe Udhëzuesi për Hartimin e Planit Individual të Arsimit për Fëmijë me Nevoja të Veçanta Arsimore" Save the Children*
- *"Hartimi dhe Zbatimi i Planit Edukativ Individual (PEI)" MASR*
- *"Manual për prindërit – Roli i institucioneve dhe i mësuesve në mbështetje të prindërve për të krijuar partneritet në zhvillimin tërësor të fëmijëve", Save the Children (2014)*
- *"Si të ndihmojmë prindërit për t'u kujdesur për zhvillimin dhe edukimin cilësor të fëmijëve gjatë fëmijërisë së hershme", MASR & UNICEF (2022)*
- *Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë – dispozitat për pjesëmarrjen e fëmijës në proceset vendimmarrëse, të drejtën për t'u dëgjuar, pëlqimin dhe pjesëmarrjen në procedurat gjyqësore.*
- *Kodi Penal (nenet që lidhen me dhunën, abuzimin, trafikimin dhe shfrytëzimin e fëmijëve)*
- *Protokolli Shtetëror për Mbrojtjen e Fëmijës (Protokolli i NJMF-ve) – objektivat, detyrat dhe procedurat e punës së PMF; fazat e procesit të mbrojtjes (7 fazat).*
- *Udhëzimet metodologjike të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për funksionimin e njësive për mbrojtjen e fëmijës.*
- *Standardet e shërbimeve sociale për fëmijët dhe familjet – lidhja me piramidën e shërbimeve dhe vlerësimin e rrezikut.*
- *Rregulloret për grupet shumëdisiplinore në nivel bashkie.*
- *Manualet e hartimit të PIM-it me raste praktike*
- *Udhëzimet e Ministrisë së Shëndetësisë për procedurat mjekësore me fëmijët viktima të dhunës/abuzimit*
- *Udhëzimet e Këshillit të Evropës për drejtësi miqësore me fëmijët*
- *Ligji nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile"*
- *Ligji nr. 10 237/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë"*
- *Strategjia e Mbrojtjes Civile*
- *Plani Kombëtar i Reagimit ndaj Emergjencave Civile*
- *Planet Vendore të Mbrojtjes Civile*

- *Udhëzues për vlerësimin e rrezikut në nivel komuniteti*
- *Ligji nr. 8756/2001 "Për Emergjencat Civile" (i ndryshuar)*
- *VKM nr. 531/2003 – Organizimi dhe funksionimi i Shërbimit të Emergjencave Civile*
- *VKM nr. 533/2003 – Pjesëmarrja e shtetasve në parandalimin dhe përballimin e emergjencave*
- *VKM nr. 664/2002 – Kriteret dhe procedurat për shpalljen e emergjencës civile*
- *VKM nr. 655/2002 – Struktura e sistemit kombëtar të planifikimit dhe përballimit të EC-ve*
- *Udhezimi nr. 15/2003 – Ngritja e komisionit vendor të EC-ve në bashki*
- *Udhezimi nr. 16/2003 – Komisioni i planifikimit të EC-ve në nivel qarku*
- *Vendimet e Këshillit të Ministrave (VKM) që derivojnë nga Ligji 45/2019*
- *Rregullorja e Institucioneve Arsimore për Planin e Emergjencave në Institucion*
- *Ligji Nr. 104/2015 "Për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike"*
- *Ligji Nr. 119/2014 "Për organizatat joqeveritare dhe partneritetin me sektorin publik"*
- *Udhëzimet për përgatitjen e vëzhgimit*
- *Instrumenti i vlerësimit të cilësisë së klasës*